



KOLEGJI UNIVERSITAR "PAVARËSIA VLORË"

PAVARËSIA SCIENTIFIC JOURNAL

ISSN 2304-2664(Online)

Volumi 4

Numër special (1)

Mars, 2018

Bordi Shkencor

Prof. Dr. Luan **GJONÇAJ** – Kryetar

Prof. Dr. Vincenzo **BARBA**

Prof.As.Dr. Ēngjell **LIÇAJ**

Prof. Dr. Habib **HAMAM**

PhD. Siri **HOXHA**

Dr. Myzafer **ELEZI**

Dr. Veronika **DURMISHI**

Dr. Esmeralda **HOXHA**

Dr. Eva **ÇIPI**

Redaktor :

Dr. Engjellushe **ZENELAJ.**

As. Redaktor:

Msc. Enerik **SHABANI**

Msc. Anduel **MEHMETI.**

Pavarësia Scientific Journal/Revista Shkencore Pavarësia, nuk është përgjegjëse për opinionin e shprehur nga autorët. Këto opinione dhe mendime janë të shprehura nga autorët e artikujve dhe nuk shprehin as pozicionin e Kolegji Universitar “Pavarësia Vlorë” dhe as të Pavarësia Scientific Journal/Revista Shkencore Pavarësia.

Botues

Kolegji Universitar “Pavaresia Vlorë”

Bulevardi Vlorë Skelë

PO.BOX 4358 AL-9401, Vlorë

Albania

Email: engjellushe.zenelaj@unipavaresia.edu.al

COPYRIGHT © Kolegji Universitar “Pavarësia Vlorë”

All right reserved

Në vend të Parathënies....

Të nderuara zonja (I nderuar lexues i Revistës)!

Unë e ndjej veten të privilegjuar që ju zonja, jo vetëm iu bashkuat nismës sonë për organizimin e Konferencës Shkencore Rajonale “Zgjerimi i Rolit të Gruas për Zhvillimin Tërësor të Shoqërisë”, por treguat gatishmëri dhe eficiency maksimale, për të arritur deri në finalizimin e aktivitetit tonë.

Unë, së bashku me organizatorët, Blerina Dhrami dhe Saniela Xhaferi, si dhe kolegët që bashkëpunuan, ndjem e privilegjuar që keni dhënë më shumë se profesionalizmin tuaj për këtë aktivitet.

Në momentin e njoftimeve nuk ndeshëm refuzimin e asnjërës prej jush, të gjitha shprehët pozitivitet. Natyrisht, gjatë rrugës, ne si organizatorë patëm lëkundjet dhe ankthin tonë për finalizimin e suksesshmen të Konferencës, por tek asnjëra prej jush nuk e identifikova këtë.

Më vjen në mendje thënia Nënës Terezë: “Ne mbase s’mund të bëjmë gjëra të mëdha, por sigurisht mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe”, dhe ajo ishte një grua.....

Zakonisht përipiqemi të rendim nëpër konferenca shkencore e akademike, brenda apo jashtë vendit, ku përgjithësisht sundojnë figura shumë të njohura publike; dhe në këto aktivitete flasim për rolin e gruas, apo sfidat nga pikëpamja akademike, e ndonjëherë edhe hipotetike, po harrojmë se ne flasim për ju, po më mirë se vetë ju/ më mirë se vetë ne së bashku, kush mund të flas për veten tuaj/kush mund të flas për veten tonë?

Ndaj dhe kur e menduam këtë aktivitet në fokus donim JU!

JU që jeni çdo ditë në këtë qytet, ju që ecni çdo ditë në rrugët e këtij qyteti, ju që përballeni çdo ditë me rutinën, ju që jepni një kontribut të çmuar, por që jo rrallë anashkaloheni.

Ne kërkua shumë nga JU(secila prej jush) mendimet tuaja, ju lamë të lira të shpreheni vetë, ashtu si ju e mendoni, të thoni atë që ndjeni, të thoni gjënë e parë që ju vjen në mendje kur përmendet termi/fjala “grua”, apo një aktivitet me në qendër figurën e gruas...dhe jo pa qëllim e bëmë këtë.

Nëpërmjet kësaj konference kërkua që të zbresim në bazë, ti kthejmë sytë nga

mësueset që merren çdo ditë me fëmijët e këtij rajoni dhe që edukojnë breza, kërkuam mendimin dhe bashkëpunimin nga femrat që aktivizohen në politikën në nivel lokal, sepse ato na sjellin esencën e realitetit të panjohur të politikës lokale; kërkuam angazhimin e specialisteve dhe drejtuesve të institucioneve në nivel lokal, e institucioneve qendrore në nivel lokal; pedagoge që formojnë të rinjtë; kërkuam fjalën e grave sipërmarrëse, të cilat janë të pakta në numër, por kanë thyer një barrierë të rëndësishme në një mjedis ku zakonisht e sundojnë meshkujt.

Kërkuam nga JU(secila prej jush), angazhimin tuaj për këtë Konferencë, por një aktivitet jo thjesht formal, ku të bëhen disa deklaratat; kërkuam ta dokumentojmë fjalën tuaj, që ajo të lexohet dhe të rilexohet; kërkuam të botojmë këtë volum special të revistës Pavarësi Scientific Journal/Revista Shkencore Pavarësia, me fjalë kyç “grua”, dhe autorët të jenë gra, të cilat janë reale, të cilat nuk kanë çdo gjë të gatshme dhe perfekte, gra të cilat i ndeshim çdo ditë si fytyra, apo si emra, por nuk na ndodh shpesh të bisedojmë me to, apo ti dëgjojmë kur flasin; kërkuam që fjalën e grave të zakonshme ta përhapim më tej, ta dëgjojnë dhe lexojnë edhe ata që nuk dinë shumë për ju, apo për jetën tuaj dhe grave të tjera të ngjashme me ju.

Fundja, mendimet e mëdha lindin nga fjalët e thjeshta, sepse në fjalët e zemrës, në fjalët e sinqeriteti përçohet një mesazh, lind një ide, fillon aktivizimi për më shumë ndryshime. Në fjalët e thjeshta, të dala nga njerëzit e thjeshtë dhe real ka shumë domethënie.

Pra kërkuam nga të gjitha ju, sepse secila prej jush ka diçka të veçantë për të thënë, e për të treguar!

Të nderuara zonja!
Ju i jepni vlerë jetës!
Ju i jepni jetë jetës!

Secila prej jush, luan një rol të caktuar në shoqërinë tonë, në këtë komunitet, asnjëra prej jush nuk është më e rëndësishme se tjetra. Secila prej jush është unike, e papërsëritshme. Secila prej jush bën një punë, një detyrë, ushtron një funksion, mban një familje, përpiket të buzëqesh edhe kur përbrenda saj ka stuhi dhe përballon sfida. Secila prej jush ka betejën e saj. Secila prej jush që jeni në këtë sallë si pjesëmarrëse në Konferencën Shkencore Rajonale të organizuar nga Kolegji Universitar “Pavarësia Vlorë”, bashkoheni në një pikë, ju jeni të gjitha gra të arsimuara, dhe i ushtroni detyrat dhe kompetencat në profesionin tuaj falë arsimimit.

Ja pra që fuqia e arsimit dhe e edukimit është arma e sigurt e fitores në çdo fushëbetëje. Fuqia e arsimit është çelësi i sekretit të suksesit të çdo femre, që nga pavarësia ekonomike por edhe tek zhvillimi psikologjik, formimi i karakterit, sjelljet

sociale, e deri tek forca për të përballuar atë çfarë jeta mund të sjell.

“Nëse investon për edukimin dhe arsimin e femrave, në fakt ke investuar për edukimin dhe arsimimin e një kombi”.

Për secilën prej jush, dhe për të gjitha ju, dëshiroj ta mbyll me një Falënderim dhe një Urim:

SUKSESE dhe gjithmonë forcë përball sfidave dhe pengesave!

Ju faleminderit!

Dr. Engjëllushe Zenelaj

Vlorë më, 02 Mars 2018

PËRMBAJTJA

GRATË SI ‘SEKS I DYTË’ NËPËRMJET KUOTAVE GJINORE, DHE NJË QASJE KONSERVATORE NË NJË SHEKULL LIBERAL NADA MEÇORAPAJ	13
ROLI I GRAVE NË VENDIMMARRJE (BARAZIA GJINORE) MSC. DANIELA BEQIRI (SHENAJ)	17
PJESËMARRJA E GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE NË SHQIPËRI MSC. JOADA NGUCAJ	23
LUFTA KUNDER DHUNES NDAJ GRAVE, EDUKIMI I GJINISË MASHKULLORE QË NË FËMIJËRI NADA DAULLJA	29
ZGJERIMI I ROLIT TË GRUAS PËR ZHVILLIMIN TËRËSOR TË SHOQËRISË VOJSAVA SHKURTAJ	33
SFIDAT GRUAS PËR ZHVILLIMIN TËRËSOR TË SHOQËRISË ALBANA HODAJ	39
ROLI I GRUAS NË ZHVILLIMIN E SHOQËRISË SHQIPTARE ALMA BAKIU	43
FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS THEMELI I BARAZISË GJINORE MARIANA CANI	47
IMPAKTI I BARAZISË GJINORE PËR NJË EKONOMI DHE ZHVILLIM SOCIAL TË QËNDRUESHËM OLTA GANAJ	53
GRUAJA DHE DIMENSIONI I SAJ NË KOHË AIDA ALLUSHI	55
LETËRSIA E PËRTEJME DHE ROLI I UNIVERSIT FEMËROR ALBANA LULA	61

ARSIMIM, PASION, PËRQËNDRIM, ANGAZHIM PËR TË RRRITUR ROLIN E GRUAS NË SHOQËRI CHRISTINE TORRES	65
ZGJERIMI I ROLIT TË GRUAS PËR ZHVILLIMIN TËRËSOR TË SHOQËRISË. DOELA HOXHAJ	71
ROLI I GRUAS NË MEDIA PHD (C) MARJETA MËRKURI	75
NGJYRAT - DITA – NATA - NË SYTË E NJË FEMRE... RUDINA MËRKURI	79
TË EDUKOJMË MENDJEN PËR TË EDUKUAR SJELLJEN TEFTA MUSTA	81
GRUAJA, MES FAMILJES DHE KARRIERËS MSC. ANILA HITAJ	85
GRUAJA NË PIRAMIDËN E SAJ DHE SFIDAT E KONSOLIDIMIT TË ROLIT MSC. ANJEZA SHIKO	89
GRUAJA MUNDET MSC. AULONA JONUZI	97
ROLI I GRUAS NË SHOQËRI NË NJË PRESPEKTIVË SOCIALE MSC. INA ISLAMAJ	101
ZBATIMI I LIGJIT PËR NJË EMANCIPIM TË SHPEJTË TË GRUAS SHQIPTARE MELAIZE SELAMAJ	105
STRATEGJIA E BE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE DOKTORANTE MIGENA SHEHU	111
NDIKIMI I FAMILJES DHE KARRIERËS NË SJELLJEN FINANCIARE TË FEMRËS MSC. XHONSILA HOXHA	117

"UNË GRUAJA"...NJË KËNDVËSHTRIM NGA GRUAJA SIPËRMARRËSE	
SILVANA SADIRAJ.....	123
"UNË GRUAJA"...MIDIS BIZNESIT DHE GRUAS	
ING. ZELIHA FERATI	127
TË DREJTAT E GRAVE NË SHQIPËRI	
DR. ARJANA LLANO	131
NJË VËSHTRIM KRAHASUES I ANGAZHIMIT POLITIK TË TË R(IN- JVE)EJAVE NË SHQIPËRI (PËRMES AKTIVIZMIT TË TYRE NË ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE)	
MSC. DAFINA PEÇI	145
E DREJTA PRONËSORE E GRAVE NË SHQIPËRI	
FLAVIA KOLLESHI	153
GRUAJA NDËRMJET ‘PRODHIMIT’ DHE ‘RIPRODHIMIT’	
PHD GERTA MEHMETI	165
RËNDËSIA E SHËNDETIT MENTAL DHE FIZIK PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË CDO FEMRE	
MSC. JERINA CELAJ	171
MODELI I GRUAS NË PROCESIN INTEGRUES “NJË VAKSINË SO- CIALE” NË FORMIMIN E GJENERATËS SË RE	
DR. LEDINA MERKAJ, MSC. FJONA CUKANI	175
GRATË NË VENDIMMARRJEN AKADEMIKE	
DOKT. MERI KRAJA, DOKT. UARDA ROSHI	185
E DREJTA E PËRFAQËSIMIT TË GRUAS NË KUADRIN E BARAZISË GJINORE	
DR. STELA MEÇAJ	193

GRATË SI ‘SEKS I DYTË’ NËPËRMJET KUOTAVE GJINORE, DHE NJË QASJE KONSERVATORE NË NJË SHEKULL LIBERAL

Nada MEÇORAPAJ

Deputete, Kuvendi i Shqipërisë

Abstrakt

Ka dëshmi të vërtetuara dhe në rritje që lidhshipi i grave në proceset e vendimmarrjes politike i përmirëson ato. Gratë tregojnë lidhship politik duke punuar nëpër linja partiake përmes grupeve parlamentare të grave - edhe në mjediset më luftarake politike - dhe duke përkrahur çështjet e barazisë gjinore, siç janë eliminimi i dhunës me bazë gjinore, leja prindërore dhe kujdesi për fëmijët, pensionet, barazia gjinore ligjet dhe reformën zgjedhore.

Unë e shoh si zhvillim sporadik taktikën e ‘kuotave’ për gratë në politikë. Në vend të kuotave, që është një ofertë kategorike, një tavan për çmimin e grave në politikë, parapëlqej një dysheme solide. Një tavan i paracaktuar u bën vend grave, por zor se i lë të rriten.

Kjo e imja është një qasje konservatore, e cila e sheh gruan e fortë dhe gruan politike si të themeluar dhe të dalë nga institucione natyrore si familja apo institucione shoqërore si shkolla, apo të tjera ente, nga ato që Edmund Burke quan ‘gilda’.

Gruaja nuk e zhvillon veten dhe shoqërinë duke marrë përsipër role të tjera që suprimojnë natyrën e saj, por duke luajtur mirë rolet e saj. Roli i parë është familja. Në një shekull liberal dhe liberalizues, kjo pikëpamje konservatore mund të duket e prapambetur dhe aspak e kohës, por është e vetmja që ka rezistuar dhe ka dhënë prova të funksionimit.

***Fjalë kyçe:** gratë, kuota gjinore, angazhim politik*

“Gratë janë ‘seksi i dytë’”, ka thënë shkrimtarja franceze Simone de Beauvoir.

Duke dashur të thotë se ato janë (edhe pse shihen ndryshe) si një gjini më vete, një natyrë më vete, një forcë më vete, dhe jo një nënseks, jo një nënkategori e burrave, e gjinisë mashkullore.

De Beauvoir flet për një revolucion seksual e shoqëror, për çlirimin e femrës nga ‘prangat’ e e një autoriteti gjinor, e një rendi patriarkal ku gruaja shihet si plotësuese, si zëvendësuese me vendin në kuzhinë dhe në dhomën e gjumit.

Këtë parabolë të Revolucionit (të dytë francez) që do shënjohej nga lëvizja e ‘68-ës e rimori, me format dhe synimet e veta, edhe regjimi komunist i Enver Hoxhës. Parulla e famshme e propagandës komuniste e shihte gruan si ‘forcë të madhe në ndërtimin e socializmit’, apo ‘emancipimi i gruas ishte detyrë e madhe e shoqërisë’. E të tjera.

Si Beauvoir, ashtu dhe komunizmi, u përpoqën t’i japin gruas një rol të dizajnit të tyre, jo domosdoshmërisht të nevojave apo dëshirave të saj. Beauvoir si intelektuale franceze e pas Luftës së dytë Botërore, u bë pararendësja e asaj lëvizje që më vonë u quajt ‘feminizmi’ (të pasuar në Amerikë nga Bety Friedan me ‘Mistika feminele’), dhe sot përfaqësohet nga lëvizja e grave të reja ‘Femen’ të cilat zhvishen në vende publike si formë proteste.

Nëse Beauvoir u bë pararojë e feminizmit, ajo u bë gjithashtu, pa dashur ndoshta, edhe paradhomë e një filozofie që e majta botërore e përdori si mjet propagande: sovjetikët e morën shpejt këtë ‘misitike të re feminele’ në posterat e së cilës shfaqej gruaja muskuloze, e cila nuk kishte nevojë për burrin. Të njëjtën grua të burrëruar rimori edhe propaganda e komunizmit shqiptar. Heroinat e saj të para ishin personazhe realë apo fiktivë si ‘cuca e maleve’, Shkurte Pal Vata apo Lilo Labja. Gruaja që linte pas ‘zakonet prapanike’, braktiste fshatin, familjen e të tjera, në favor të revolucionit, emancipimit të gruas etj.

Këta janë dy ‘fjalorë politikë’ që e përdorin gruan si entitet social dhe politik për qëllime të ndryshme. Të dy thërrasin për ‘çlirimin e gruas’. Të njëjtës qasje i takon edhe ‘vernakulari’ (e folmja e përditshme) e post Luftës së Ftohtë apo liberalizmit. E kopjuar nga gjuha kulturore e Perëndimit, ‘barazia’ e gruas në politikë për shembull, kuptohet si avancim me anë kuotash gjinore.

Në politikën shqiptare kjo ‘hise’ përbën 30 përqind të listave të kandidatëve dhe të përfaqësimit parlamentar.

Jo rrallë, kjo kuotë shkelet dhe pranohet një gjobë jo e vogël që i lejon listat të jenë ‘burrërore’. Nganjëherë për taktika elektorale, nganjëherë se nuk është aq e lehtë të gjesh kandidatë gra. Për shumë arsye.

Unë jam një prej deputeteve që kam përfituar nga ‘kuota’ gjinore. Megjithatë, unë besoj se unë dhe shumë kolege të miat të të dy krahëve, nuk jemi përfshirje si kuotë, pra si përpjekje e forcave tona politike për të qenë në rregull me ‘ligjin’.

E bëra këtë hyrje disi të gjatë për të dalë te tema e konferencës së nderuar e cila

ka si synim trajtimin dhe përpunimin e ideve që kanë të bëjnë me ‘zgjerimin e rolit të gruas në zhvillimin tërësor të shoqërisë’. Nëse huazojmë një term nga ekonomia apo ekonomia politike, jemi duke bërë fjalë për një zhvillim të qëndrueshëm. Përkundër zhvillimeve sporadike, me hove, si taktika apo teknika, por pa strategji.

Unë e shoh si zhvillim sporadik taktikën e ‘kuotave’ për gratë në politikë. Në vend të kuotave, që është një ofertë kategorike, një tavan për çmimin e grave në politikë, parapëlqej një dysheme solide. Një tavan i paracaktuar u bën vend grave, por zor se i lë të rriten.

Kjo e imja është një qasje konservatore, e cila e sheh gruan e fortë dhe gruan politike si të themeluar dhe të dalë nga institucione natyrore si familja apo institucione shoqërore si shkolla, apo të tjera ente, nga ato që Edmund Burke quan ‘gilda’.

Gruaja nuk e zhvillon veten dhe shoqërinë duke marrë përsipër role të tjera që suprimojnë natyrën e saj, por duke luajtur mirë rolet e saj. Roli i parë është familja. Në një shekull liberal dhe liberalizues, kjo pikëpamje konservatore mund të duket e prapambetur dhe aspak e kohës, por është e vetmja që ka rezistuar dhe ka dhënë prova të funksionimit.

Çlirimi i gruas nuk ndodh kur ajo i largohet më shumë të qenit grua, por kur ajo e përplotëson veten në këtë njësi natyrore ose transhedentale.

Ky kuptim, mendoj unë, duhet t’i shqetësojë gratë, burrat, shoqërinë në përgjithësi. Këtu, padyshim, luan një rol të pazëvendësueshëm universiteti me qendrat shkencore dhe me intelektualët, por edhe partitë politike që janë institucione lëvizëse dhe promovuese të shoqërisë.

Universiteti është qendra e polisit (qytetit) në kuptimin intelektual dhe shoqëror të fjalës. Aty mund të zhvillohen idetë të cilat shndërrohen më pas në strategji dhe që parashikojnë atë zhvillim të qëndrueshëm shoqëror, pjesë e të cilit është edhe gruaja.

Një përpjekje për të lënë ‘seksin e dytë’ jashtë këtyre platformave është miopi dhe mizogjini. Po kaq e dëmshme është edhe përpjekja për të shpikur mekanizma false për t’i angazhuar gratë. Gratë janë aty si e dhënë natyrore dhe nuk bëhen fakt shoqëror me anë të inxhinjerimit social marksist.

Znj. Nada MEÇORAPAJ, lindur në Vlorë, më 6 Janar 1981. Ka mbaruar shkollën e mesëm në gjimnazin e përgjithshëm publik “Halim Xhelo” në Vlorë, dhe më pas ka ndjekur studimet universitare në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë në profilin Administrim Biznesi. Ka punuar si specialiste turizmi në Këshillin e Qarkut Vlorë, dhe me pas në po këtë institucion ka qenë përgjegjëse për Programin e Zhvillimit të Turizmit. Angazhimet në politikën lokale i ka të hershme, duke filluar që nga ai me i thjeshti si aktiviste në Partinë Demokratike Dega Vlorë, e për ta vazhduar më pas, në shkallët e hierarkisë së strukturës së partisë si anëtare e Kryesisë dhe Sekretare e Seksionit. Në zgjedhjet vendore të vitit 2015 u shpall fituese në listën për anëtare Këshilli Bashkiak , në Bashkinë Vlorë ku dhe ka mbajtur detyrën si N/ Kryetare e Këshillit Bashkiak si dhe N/Kryetare e Aleancës së Grave Këshilltare. Që prej zgjedhjeve të 25 Qershorit të vitit 2017 është deputete në Kuvendin e Shqipërisë.



ROLI I GRAVE NË VENDIMMARRJE (BARAZIA GJINORE)

MSc. Daniela BEQIRI (SHENAJ)

*Drejtor Finance, "Simak Shoes" Ltd
Anëtare Kryesie, Partia Demokratike, Dega Vlorë
danielashenaj@yahoo.it*

Abstrakt

Nuk është e lehtë të jesh grua në një shoqëri ku qendra ka qenë gjithmonë burri. Nuk është e lehtë të përballësh me opinione dhe qëndrime maskiliste. Nuk është e lehtë të arrish të realizohesh në fushën që dëshiron dhe je e aftë. Nuk është e lehtë, por nuk është e pamundur. *"Ndrysho mendimet dhe do të ndryshosh botën"*-(*Norman Vincent Peale*). Çdo ndryshim duhet të fillojë nga ne. Jemi pikërisht ne gratë, që së pari duhet ta shohim veten të barabartë me burrat, pastaj të kërkojmë të njëjtën gjë prej tyre. Gjatë viteve të fundit janë hedhur hapa të rëndësishëm drejt barazisë gjinore dhe vlerësimit të rolit të gruas në shoqëri, dhe mbi të gjitha në vendimmarrje. Kjo, parë si në këndvështrimin e proceseve vendimmarrëse në politike, ashtu edhe në drejtimin dhe vendimmarrjen në sipërmarrjet apo ndërmarrjet e ndryshme. Zhvillimi i shoqërisë, emancipimi, zhvillimi ekonomik dhe përfrimi i mënyrës së jetesës me atë të shteteve të zhvilluara europiane, kanë ndikuar në ndryshimin e opinionit që ekzistonte për gruan në karrierë dhe në vendimmarrje. Një nga kushtet e domosdoshme për integrimin e Shqipërisë në BE është dhe garantimi i të drejtave të njeriut. Pikërisht një prej tyre është e drejta për të qenë të barabartë në mundësi dhe vlerësim; nisur pikërisht nga ky këndvështrim trajtohet roli i gruas në vendimmarrje, duke u fokusuar tek barazia gjinore.

Fjalë kyçe: gratë, barazi, vendimmarrje, arsimim, kualifikim.

1. Hyrje

“*Shtëpia është vendi ku shkojmë, kur s’kemi asgjë më të mirë për të bërë*” - Margaret Thatcher (Gruaja e hekurt)

Mund të duket disfatiste, egoiste, por është realitet i pothuajse gjithë grave në karrierë. Në historinë e Shqipërisë, megjithëse duket paradoksale, për një vend ku epiqendra e gjithçkaje është burri, kemi pasur në nivelet më të larta vendimmarrëse femra të forta, të suksesshme, që dikur i quanim burrërore. Kujtojmë këtu mbretëreshën ilire Teutën, simbolin e gruas që çuditërisht forcoi ushtrinë dhe flotën detare.

Gjithçka lind dhe vdes tek gruaja në çdo aspekt të jetës. Tek gruaja është burimi i jetës që shkon brez pas brezi. Por roli i gruas në shoqëri nuk është vetëm përçimi i jetës, i shpirtit, i vlerave, por shume me i gjere dhe me i rëndësishëm. Gjithmonë gruaja është pare si plotësuese e burrit, aq sa përdoret shumë shpesh shprehja “*pas çdo burri të suksesshëm, qëndron një grua e forte*”. Por ne nuk jemi vetëm mbështetje. Ne dimë të jemi dhe jemi shumë më shumë.

Nuk ka spektër të jetës ku nuk ndihet roli i gruas. Një konflikt i ashpër mes burrash zbutet menjëherë nga ndërhyrja e një gruaje, nga qetësia, nga mungesa e ashpërsisë dhe nga forca e gjykimit, që shpesh për mos te thënë gjithmonë është shumë më e lartë se tek gjinia mashkullore. Pa dashur të bëj atë që femrat nuk duan, të kenë përballë maskulist, as unë nuk dua të bëhem feministe, por ajo që është e vërtetë duhet thënë me zë të lartë. Historia në momentet më të rëndësishme të saj si për mire si për keq ka njohur forcën e gruas, edhe kur nuk kanë qenë protagoniste, kanë qenë frymëzimi, muza dhe shtysa e atyre që kanë qenë vendimmarrës.

Ka fusha të ndryshme vendimmarrjeje, qofshin ato politike, ekonomike, sociale, kulturore, etj. Së pari gruaja ka një rol parësor në vendimmarrjen në bërthamën e shoqërisë, në familje. Më së shumti është gjithmonë gruaja që vendos për caktimin e shkollës së fëmijës, që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejt në edukimin e tij. Është gruaja që vendos nëse duhet investuar tek një talent i caktuar i fëmijës apo tek një tjetër, duke qenë se është ajo që e njeh me mire botën e fëmijës dhe shpirtin e tij.

Por jo gjithçka përfundon këtu. Sipërmarrjet janë shume të suksesshme nëse ato kanë në role drejtuese gra. Gratë janë shumë më të qeta në vendimmarrje, me dyshuese, më kërkuese, dhe më konkurrenente. Ndoshta gratë nga natyra e tyre janë edhe shume me te pavendosura se burrat, por kjo është pikërisht një nga arsytet pse marrin vendime më të pjekura, sepse kërkojnë më shumë informacione, e përpunojnë më shumë atë dhe kërkojnë zgjidhjen më të mire. Gratë vendimmarrëse kane dhe kurajën më të madhe për te rrezikuar dhe dinë të motivojnë stafin. Nisur dhe nga instinkti i mëmësisë dine të dallojnë nevojat e shprehura dhe të pashprehura të stafit, mënyrat më të mira të motivimit dhe ngritjes së kulturës në ndërmarrje.

2. Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes

Në Shqipëri roli i gruas ka qenë i kufizuar për shkak të pabarazisë gjinore, megjithëse në këtë aspekt janë bërë hapa shumë të rëndësishëm. Në vitin 2008 u miratua Ligji 9970 “Par barazinë gjinore në Shqipëri”, të cilin parashikohen të drejta të barabarta për të dyja gjinitë dhe më tepër akoma mbështetet ecja e grave ne politike dhe në vendimmarrje. Në nenin 15 parashikohet shprehimisht:

“Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes¹

1. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:

a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;

b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;

c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;

ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.

3. Partitë politike paguajnë një gjorbë deri në një të dhjetën e fondit shtetëror për financimin e fushatës zgjedhore, nëse shkelin dispozitat e këtij neni, deri në ndreqjen e shkeljes.”

Nëse do të interpretojmë këtë nen, vërejmë se nuk flitet për gratë, por për secilën gjini, që përfshin si burrat ashtu dhe gratë. Duke pasur parasysh se në politike dhe vendimmarrje në Shqipëri pjesa dërrmuese janë meshkujt, me anë të këtij ligji tentohet të rritet pjesëmarrja e grave ne politike dhe ne procesin e vendimmarrjes. Përqindjet e pjesëmarrjes të parashikuara nuk çojnë në barazi të plotë gjinore, por rrisin numrin e grave. Barazia e plotë do të kishte një pjesëmarrje e detyruar 50 %, por kjo nuk përjashtohet si mundësi. Minimumi prej 30 % nuk i ndalon partitë politike që në listat e tyre të vendosin 50 % femra.

Për tu përmendur është mënyra e renditjes së kandidateve në lista, që është praktikisht mënyra e detyrimit të zbatimit nga partitë politike të përqindjes minimale të parashikuara, duke vendosur në çdo tre emra një të secilës gjini. Kjo ka çuar në një rritje të ndjeshme të numrit të femrave në Kuvendin e Shqipërisë. Në legjislaturën nr.9 (2017-2021) numri i femrave arriti në 39, numri më i madh i

1 Ligji 9970 date 24.07.2008, Neni 15

pjesëmarrjes se femrave ne organin ligjvënës pas vitit 1990. Kjo është një arritje e vërtetë në rrugën drejt barazisë gjinore. Ky rezultat është efekt i drejtpërdrejt i ligjit 9970. Kjo duket qartë nga numri i femrave që janë deputete te reja. Kështu nga 55 deputete te rinj, 33 prej tyre janë femra, pra 11 me shume se ata meshkuj. Bie në sy fakti që moshë mesatare e femrave deputete është me e ulët, përkatësisht 42, se ajo e meshkujve që është 48. Ky fakt në vetvete tregon shumë më tepër se një statistike. Pse femrat janë më të reja në moshë? Sepse vetëm ndryshimet e viteve të fundit kanë bërë të mundur hyrjen e tyre në politike. Me parë ishin raste shumë të rralla dhe femrat përballëshin me pengesa të ndryshme, me gjykimin e opinionit dhe me detyrë që u mbylleshin, vetëm sepse ishin femra.

Gjithashtu një nga efektet me pozitive të këtij ligji është pjesëmarrja e femrave ne pushtetin vendor, përkatësisht në këshillat bashkiak. Këtu mund te themi se ne zgjedhjet e fundit lokale u arrit barazia totale, 50% femra dhe 50% meshkuj. Ky efekt u arrit si rezultat i kushtit që çdo listë duhet te ishte e përpiluar nga emra ku në çdo dy prej tyre, njeri te ishte i secilës gjini.

Për të bërë të detyrueshëm përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike, ligji “Për barazinë gjinore”, ka parashikuar edhe sanksione me vendosje gjobe në vlera të konsiderueshme për financat e partive politike deri në një të dhjetën e fondit shtetëror për financimin e fushatës zgjedhore, deri në ndreqjen e listave.

Në këtë artikull janë përdorur disa të dhëna statistikore, me qëllim krahasimin përqindjen e pjesëmarrjes së femrave në Kuvendin e Shqipërisë me përqindjen e pjesëmarrjes në parlamentin grek, italian dhe atë kosovar. Përqindjet e pjesëmarrjes janë respektivisht si më poshtë:

- Greqi 18%;
- Shqipëri 27.86%;
- Itali: Senati: 28.97%, Dhoma e Deputetëve 31.27%;
- Kosovë 31.67%.

Duke parë këto shifra bie menjëherë në sy që përqindja e pjesëmarrjes së femrave në organin ligjvënës shqiptar është shume më e lartë se në atë grek, që është një shtet me demokraci të konsoliduar, ekonomi dhe zhvillim më të madh se të Shqipërisë. Kjo na bën të ndjehemi mire që jemi në rrugën e duhur drejt përfshirjes më të lartë të grave në vendimmarrje, duke përfshirë një nga organet më të rëndësishme të shtetit, si ai ligjvënës.

Në të njëjtën kohë bën përshtypje fakti që përqindja e pjesëmarrjes së femrave në kuvendin e Kosovës është më e lartë jo vetëm se në Shqipëri, por edhe në raport me Italinë, ku i kalon edhe pjesëmarrjen në Senat edhe në Dhomën e Deputeteve. Kjo na bën të shpresojmë se edhe në Shqipëri përqindja e pjesëmarrjes së grave në organin ligjvënës do të rritet me kalimin e grave.

Për të ecur drejt barazisë gjinore aq të dëshiruar është hartuar “Strategjia kom-

bëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit për vitet 2016 – 2020, Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.733, datë 20.10.2016.

Parimet kryesore që udhëheqin këtë strategji janë:

- Barazia gjinore, kusht për një shoqëri të drejtë, të qëndrueshme e socio-ekonomikisht të zhvilluar
- Ndjeshmëri dhe trajtim i barabartë ndaj nevojave të veçanta të të dyja gjinive;
- Njohja, vlerësimi dhe respektimi i diversitetit;
- Tolerancë zero kundrejt dhunës ndaj grave e dhunës në familje ;
- Koordinimi dhe bashkëpunimi ndër-institucional².

Strategjia ndihmon në përf forcimin e rolit të gruas, pasi përveç faktit që është një dokument strategjik, i cili identifikon prioritetet dhe detyrimet e qeverisjes dhe ligjvënësve, ajo ingranon të gjithë instancat që të luajnë rolin që iu takon, duke filluar që nga zbatimi i ligjit, e deri tek hapat dhe iniciativat e tjera të cilat lidhen drejtpërdrejtë me përf forcimin e rolit të gruas.

3. Përfundime

Në ecurinë kohore gjatë tranzicionit në Shqipëri janë bërë ndryshime të ndjeshme të kuadrit ligjor i cili në fokus ka mbrojtjen e figurës së gruas, përf forcimin e rolit të saj, krijimin e mundësive për tu përfshirë në vendimmarrje etj.. Gjithashtu prezenca e organizatave të huaja ndërkombëtare, ka ndikuar së tepërmi në forcimin e rolit të gruas. Strategjia dhe gjithë dispozitat normative të miratuara në Shqipëri hapin rrugën drejt arritjes së barazisë gjinore, drejt fuqizimit të rolit të gruas dhe pjesëmarrjes së saj më të madhe në proceset vendimmarrëse. Por ne(gratë) nuk duhet të përpiqemi çdo ditë për të qenë të gatshme për t'u përballuar me gjininë mashkullore në çdo fushë të jetës. Nuk mund të pranojmë barazi gjinore dhe të na ofrohen mundësitë vetëm sepse jemi femra. Ne(gratë) duam mundësi për konkurrence, për përballje vlerash, për tu vlerësuar për atë që jemi, për aftësitë që kemi dhe për ndryshimin që sjellim.

4. Bibliografia

- Ligji 9970 datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në Shqipëri”
- Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, “Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020” , Miratuar me Vendimin e

2 Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, “Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020” , Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.733, datë 20.10.2016

Këshillit të Ministrave Nr.733, datë 20.10.2016

- OSCE , “*Fuqizimi i grave ne politike*”, OSCE Albania, Tirane, 2013
- Camera dei Deputati, Servizio Studi, “*La partecipazione delle donne alla vita politica e istituzionale Dossier n° 116 - Quinta edizione 30 novembre 2016,*
- Sabina Nielsen, Morten Huse, “*Women directors’ contribution to board decision-making and strategic involvement: The role of equality perception, European Management Review*” (2010)7, 16-29 0 EURAM Macmillan Publishers Ltd, 2010
- <https://www.parlament.al/deputetet/statistika/>

Daniela BEQIRI (SHENAJ) Lindur në 06 Tetor 1976 në Vlorë. E diplomuar në Menaxhim Turizmi në Universitetin “*Ismail Qemali*” Vlorë, më pas ka kryer studimet pasuniversitare në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Ekonomisë për Administrim Publik. Në vitin 2016 është diplomuar për Drejtësi në Universitetin “*Ismail Qemali*” Vlorë, ku dhe vazhdon të ndjekë studimet pasuniversitare për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Përvoja e saj profesionale ka filluar si pedagoge në Universitetin “*Ismail Qemali*” Vlorë. Më pas ka punuar si ekonomiste në Drejtorinë e Shërbimit Rrugor, si Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore në Drejtorinë e Pyjeve, Drejtor në Drejtorinë Rajonale të Punësimit Vlorë, Zv.Drejtor Ekonomik në Spitalin Rajonal Vlorë, Drejtor Ekzekutiv tek “*Romar*” shpk. Zotëron gjuhën angleze dhe italiane. Aktualisht punon si Drejtor Finance në një kompani private. Është aktive në jetën politike lokale, ku mbart detyra në strukturat e forcës politike që aderon.



PJESËMARRJA E GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIMMARRJE NË SHQIPËRI

MSc. Joda NGUCAJ

Juriste, Bashkia Selenicë

Anëtare e Këshillit Bashkiak Vlorë

sinaada10@gmail.com

Abstrakt

Gratë përbëjnë sot një potencial të madh jo vetëm numerik po edhe profesional e intelektual.

Në këtë punim do të dalin në pah përpjekjet e ndryshme të lëvizjeve feministe në përputhje me perspektivat politike të cilat ndikuan në ndërhyrjet politike dhe në eksperiencën e re që tashmë po merrte formë të qartë në Evropë dhe më gjerë.

Gjithashtu nëpërmjet një vështrimi krahasues në vite të ecurisë së pjesëmarrjes së grave në politikë tregojnë që mjaft gra ju është mundësuar të pozicionohen në poste të larta politike, duke thyer paragjykimet që duan gruan pa ide dhe propozime.

Gjatë punimit kam dashur të theksoj edhe çështjen e rritjes së pjesëmarrjes së grave në partitë politike, ku sipas këndvështrimit tim kjo nuk është thjesht çështje numrash e përqindjesh. Ndodh jo rrallë që debati vërtitet të numrat. Në fakt problemi është te pesha reale e tyre në procesin e vendimmarrjes në partitë politike.

Nga gjithë analiza e bëra gjatë punimit si dhe vështrimit krahasues të evoluimit të pozitës së gruas në politikë dhe vendimmarrje rezulton se jo vetëm gratë që nuk janë ende në nivelet që ligji parashikon duke qenë jashtë të drejtës së tyre për akses në fatet e vendit, por janë vetë partitë politike që humbasin, një resurs të madh shoqëror. Ndaj kontributi i grave në partitë politike duhet parë jo vetëm si një e drejtë po edhe si një nevojë e shoqërisë për kontributin e tyre. Gratë përbëjnë sot një potencial të madh jo vetëm numerik po edhe profesional e intelektual

***Fjalë kyçe:** Familje, Grua, Europë, Politikë, Parti Politike,*

1. Pjesëmarrja e Grave në Politikë dhe Vendimmarrje në Shqipëri

Në të gjitha marrëdhëniet e jetës, është një nderim i drejtë dhe mirënjohës ta quash gruan, bashkëshorte. Në çdo vend që ta vendosësh gruan, në çfarëdo detyrë apo sërë, ajo përbën një stoli për vendin që do të zërë dhe një thesar për të gjithë”.

Por cili është roli i gruas shqiptare sot në shoqërinë tonë? Çfarë pengesash has ajo në përditshmërinë e saj? A mundet të flasim për një barazi sa i përket anës profesionale?

Femrat falë aftësisë së tyre të pashtershme, janë të parat që ndërtojnë jetën fuqishëm. Punojnë më shumë, ëndërrojnë më shumë, duan më shumë. Si pjesa më jetësore dhe më elitare njëherësh, femrat, kanë meritën e pazëvendësueshme të jenë lidhja e vetme sociale në një shoqëri ku situatat janë në tranzicion, kushtëzim etj.

Barazia gjinore në pjesëmarrjen politikë është një element kyç dhe parakusht për përparimin e demokracisë. Përmirësimi i pozicionit të gruas dhe të barazisë gjinore mbetet një sfidë jo vetëm për Shqipërinë por edhe për vendet e tjera. Është një fakt i provuar në vende të tjera më të zhvilluara se vendi ynë që, kur gratë marrin pjesë aktivisht dhe në të gjithë nivelet e vendimmarrjes, e gjithë shoqëria përfiton.. Më shumë gra në nivele të larta të vendimmarrjes shpesh do të thotë së shoqëria i kushton më shumë kujdes rritjes së fëmijëve, kujdesit të shëndetit, dhe të drejtave të njeriut, midis të tjerave. Ka gjithashtu evidencë se prania e grave në pozicione të larta të udhëheqjes redukton korrupsionin dhe ryshfetet. Megjithatë as përmbysjet e sistemeve dhe as rotacioni i vazhdueshëm në politikën e vendit nuk kanë ndikuar në përmirësimin e situatës së përfaqësimit të grave në politikë. Shoqëria jonë tashmë do të ishte më demokratike dhe me më shumë gra në qeverisje dhe vendimmarrje.

Një përfaqësim i rritur i grave në nivelet e larta të strukturave të pushtetit do të thotë se gjysma e popullsisë së vendit ka më shumë shanse të gëzojë dobitë që vijnë nga përparimi i demokracisë. Sipas tendencës edhe në vende të tjera, më shumë gra në vendimmarrje shpesh përkthehet në më shumë fuqizim ekonomik, kushte më të mira punësimi, të drejta mbi pronën, infrastrukturë publike miqësore për gratë, dhe një cilësi më e mirë jetese për 49.9% të popullsisë.

Të gjithë problemet e tjera me të cilat përballen gratë shqiptare si shifrat e larta të dhunës në familje, diskriminimi në vendin e punës, ngacmimi seksual, dhe neglizhimi me bazë gjinore mund të adresohen më efektivisht për shkak se zërat e grave do të jenë më të fortë dhe më aktivë aty ku kanë më shumë peshë: vendimmarrja në nivele të larta. Pavarësisht apeleve të ripërsëritura ndërkom-bëtare për pjesëmarrje prej 30% të femrave në politikë, skena mbizotërohet ende

nga meshkujt.

Nga një analizë e shkurtër e evoluimit të pjesëmarrjes së femrës shqiptare në parlament rezulton që, femrat shqiptare janë bërë për herë të parë pjesë e Parlamentit në Legjislaturën e parë, atë të viteve 1945-1950. Në një total prej 82 deputetësh, 6 prej tyre ishin femra.

Katërvjeçari pasues çoi numrin e tyre në 17, duke u rritur progresivisht deri në legjislaturën 1974-1978, ku nga 250 deputetë në Parlament, 88 prej tyre ishin femra. Disa prej tyre, njëkohësisht edhe anëtare të Byrosë Politike të atyre viteve, u emëruan ministre për më shumë se një mandat.

Në legjislaturën më të fundit, para përmbyesjes së diktaturës, në vitet '87-'91 në Parlament hynë 75 gra. Numri më i ulët i femrave në Parlament ka qenë në legjislaturën 91-92, në zgjedhjet e parakohshme, me vetëm 9 gra deputete, tetë të Partisë Demokratike dhe një e Partisë Socialiste, e cila ishte Ermelinda Mexsi.

Në referim të statistikave, ato tregojnë se numri më i madh i femrave në Parlament është arritur pas zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit 2009, ku të gjitha partitë politike janë përfaqësuar nga 23 deputete femra. Vendin e dytë e zënë zgjedhjet e vitit 1996, ku 21 gra fituan mandatin e deputetes.

Zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 u mbyllën me dhjetë gra deputete, ndërsa legjislaturat me më pak deputete femra janë ato të mandatit '92-'96 me 9 gra dhe në vitet 2001-2005 me të njëjtën shifër. Por përmirësim situata do të kishte pas ndryshimit të sistemit zgjedhor, falë të cilit ndarja e grave në grupe parlamentare është e barabartë, ku 11 do të jenë deputete femra nën siglën e Partisë Socialiste dhe 11 të tjera nën siglën e Partisë Demokratike.

Nëse do të lejohej ti quanim të tilla “Veterane të Kuvendit të Shqipërisë” ato do të ishin vetëm dy, zj. Jozefina Topalli nga Partia Demokratike dhe zj. Ermelinda Mexsi nga Partia Socialiste, të cilat kanë qenë përfaqësuese në parlamentin e Shqipërisë me më shumë se dy mandate. Nga statistikat ka rezultuar gjithashtu se grupmosha e femrave në politikë varion nga 30-50 vjeç ku vetëm pak prej tyre janë propozuar si kandidatura të cilat kanë fituar më shumë se një mandat.

Nisur nga profesionet pjesa më e madhe e femrave kandidate vijnë nga profesionet e ekonomistes, juristes dhe pedagoges, por që përgjatë Legjislaturës së fundit nuk kanë mundur as ato të profesionit të aktores.

Megjithatë Shqipëria ka bërë progres për sa i përket kuadrin ligjor në drejtim të rritjes së pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje, situata aktuale tregon se gratë janë ende të nënpërfaqësuar.

Gratë përfaqësojnë përafërsisht 50% të popullsisë në Shqipëri ndërkohë që vetëm 15% e anëtareve të Parlamentit janë gra, duke u renditur kështu mes vendeve me proporcion të ulët të grave në parlamentet kombëtare.

Perceptimi i publikut për pjesëmarrjen e grave në politikë dhe vendimmarrje

është faktor i domosdoshëm për të vlerësuar situatën dhe më e rëndësishmja për të identifikuar arsyet që qëndrojnë pas kësaj. Nga intervista të ndryshme një pjesë e konsiderueshme e të intervistuarve pohojnë se gratë janë të nënperfaqësuar në politikë dhe vendimmarrje, duke fajësuar për këtë mjedisin politik të dominuar nga burrat dhe të karakterizuar nga natyra agresive.

Është vënë re një progres në lidhje me sjelljet e grave në pjesëmarrjen e tyre dhe dëshirën për të parë më shumë femra në pozicione të rëndësishme si një mundësi që ofron më tepër zgjidhje për gratë dhe problemet e komunitetit. Një gjetje optimiste është perceptimi pozitiv për gratë e përfshira në politikë dhe vendimmarrje dhe vlerësimi për aftësitë dhe kapacitetet e tyre për të kontribuar në përparimin e fushave të ndryshme veçanërisht në mbrojtjen e të drejtave të njeriut, çështjet e arsimit, politikat shëndetësore dhe aspektet sociale.

Duhet cilësuar fakti që media së bashku me shoqërinë civile dhe partitë politike, kanë rol të rëndësishëm në rritjen e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje. Gjithashtu ligji “Mbi barazinë gjinore në Shoqëri” dhe Kodi Elektorral japin mbështetjen e nevojshme për veprim.. Ligji në këtë rast shërben si një udhëzues më tepër se sa një mandat pasi zbatimi i kuotës gjinore 30% në fakt ende nuk është realizuar dhe kështu t bën të mendosh se ky ligj ngjason me disa ligje të tjera në Shqipëri, të cilat ekzistojnë në letër, por nuk zbatohen në praktikë. Kur vjen fjala te zgjedhjet, partitë politike preferojnë të paguajnë gjobat nominale të përcaktuara nga Kodi Zgjedhor aktual në vend që të zbatojnë kuotën 30% dhe të emërojnë kandidatet femra në radhën e listave.

Por zbatimi i dobët i ligjit dhe vullneti i pamjaftueshëm politik nuk janë arsyet e vetme pse ne shohim kaq pak gra në pozita udhëheqëse. Përfshirja e grave në anëtarësitë e partive politike, në fushatat zgjedhore dhe në votime është më e ulët se e burrave. Gratë më të moshuara dhe ato me më pak arsim nuk marrin pjesë aq sa duhet si votuese, aktiviste apo udhëheqëse të partive. Gjithashtu, gratë e papuna apo të nënpunësuar shfaqin një nivel të ulët të angazhimit në jetën politike dhe publike. Nga ana tjetër, gratë me të ardhura, punësim dhe arsimim më të lartë priren të jenë më aktive si votuese, anëtare apo udhëheqëse. Kjo do të thotë se fuqizimi ekonomik dhe arsimor është një kusht i nevojshëm për të pasur më shumë gra të pranishme në të gjithë nivelet e strukturave politike.

Një fakt befasues nga një studim në vend ishte se shumica e shqiptarëve pohojnë se gratë janë të nënperfaqësuar në rrethet politike dhe qeveritare, dhe për këtë ata fajësojnë një mjedis politik të dominuar nga burrat dhe mjaft agresiv. Studimi zbulon se ka një perceptim pozitiv për gratë e përfshira në politikë dhe vendimmarrje, si dhe një vlerësim për aftësitë e tyre për të kontribuar në fusha si të drejtat e njeriut, arsimit, shëndetësia dhe politikat sociale. Shumica e votuesve do të votonin me gjithë dëshirë për kandidatet femra dhe e mbështesin emërimin e grave në pozita të rëndësishme. Profesionalizmi dhe reputacioni i mirë janë dy

arsyet kryesore që e shtyjnë elektoratin të votojë për një femër si kryetare bashkie. Gjithashtu nevoja për të pasur më shumë gra në politikë i motivon të interesuarit për të votuar për femrat kandidatë.

Megjithatë ende paragjykimi, mungesa e besimit të kandidatja dhe dyshimi se ajo nuk do të dëgjohet në mjedisin politik shqiptar të dominuar nga meshkuj janë faktorë kryesore që i pengojnë zgjedhësit sidomos burrat të mos votojnë për një femër.


Përderisa standardet ndërkombëtare e kërkojnë dhe perceptimi i publikut vendas e mbështet, çfarë duhet bërë për të rritur përfaqësimin dhe pjesëmarrjen e grave në politikë dhe pozicione udhëheqëse?

Sidoqoftë, janë ligjore apo jo, kuotat në vetvete janë vetëm një pjesë e zgjidhjes. Ajo që nevojitet është gjithashtu edhe presioni që del nga terreni, nga segmentet e popullatës femërore shqiptare, dhe nga veprimi pozitiv, që mund të nxisin rritjen e përfaqësimit të grave dhe t'i detyrojnë partitë politike t'i përgjigjen organikisht kësaj çështjeje shumë delikate ndaj të vetmes që mbi të gjitha sjell jetë, ndaj femrës.

2. Bibliografi

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.8417 datë 21.10.1998 ndryshuar me ligjin Nr.9675 , datë 13.1.2007, ndryshuar me Ligjin Nr.9904, datë 21.4.2008, ndryshuar me Ligjin 88|2012 datë 18.9.2012, ndryshuar me Ligjin 137\2015 ,datë 17.12.2015, ndryshuar me Ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016)
- Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë Tiranë 2016
- KODI Zgjedhor i Republikës Së Shqipërisë Tiranë, maj 2017 (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 2.4.2015)
- Raport “Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimarrje në Shqipëri. ,Gratë dhe vajzat në zgjedhjet vendore. Tiranë, Tiranë 2012-2013
- Manual “Të kuptojmë dhe zbatojmë ligjin Për mbrojtjen nga diskriminimi” Tiranë 2011
- USAID, *Krijimi i një skuadre për bashkërendimin e reagimit ndaj dhunës në familje në Shqipëri. Nisma për të Drejtat e Grave*, Shqipëri
- A.Mandro *Të Drejtat e Grave në kuadrin e të Drejtave të Njeriut*. Tiranë 2008
- Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe MPÇSSHB *Dhuna në Familje - Paraqitja e situatës aktuale*, Prill 2006., Tiranë

MSc. Joda Ngucaj, lindur ne 10 Dhjetor 1985 në Vlorë. Diplomuar në Universitetin “Ismail Qemali”, Vlorë, në vitet 2004- 2008 për drejtësi. Me eksperiencë pune si, Juriste pranë Drejtorisë së Monumenteve të Kulturës Vlorë, Juriste pranë Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Vlorë. Licencuar si Avokate pranë Dhomës Kombëtare të Avokatisë. Aktualisht punon si Juriste pranë Bashkisë Selenicë. Që prej zgjedhjeve vendore të vitit 2015, është e zgjedhur si anëtare e Këshillit Bashkiak në Bashkinë Vlorë.



LUFTA KUNDER DHUNES NDAJ GRAVE, EDUKIMI I GJINISË MASHKULLORE QË NË FËMIJËRI

Nada DAULLJA

*Mjeke familj, Qendra Shëndetësore nr.4 Vlorë
N/kryetare, Partia Demokratike, Dega Vlorë
n.daullja1990@gmail.com*

Abstrakt

Dhuna ndaj grave dhe vajzave është e rrënjësuar në diskriminimin gjinor dhe normat shoqërore dhe stereotipet gjinore që përjetësojnë një dhunë të tillë. Duke pasur parasysh efektin shkatërrues që ka dhuna ndaj grave, përpjekjet janë përqendruar kryesisht në përgjigjet dhe shërbimet për të mbijetuarit. Sidoqoftë, mënyra më e mirë për t'i dhënë fund dhunës ndaj grave dhe vajzave është parandalimi që ajo të ndodhë në radhë të parë duke adresuar rrënjët e saj dhe shkaqet strukturore. Parandalimi duhet të fillojë në fillim të jetës, që në fëmijëri duke edukuar dhe duke punuar me djemtë dhe vajzat e reja duke promovuar marrëdhënie të respektueshme dhe barazi gjinore.

Duhet të organizohen fushata që synojnë luftën kundër dhunës ndaj grave dhe të sensibilizojnë shoqërinë për ekzistencën reale të kësaj sfidë serioze, edhe pse shumë gra sot janë ende viktime të raportit mes frikës dhe pasigurisë në qoftë se ato denoncojnë. Shoqëria përpara se të gjejë shkakun e dhunës, duhet të flasë fort dhe të thyejë heshtjen për të parandaluar dhunën, edhe kur ndodh, ta ndëshkojë atë.

Fjalë kyçe: gruaja, dhuna, edukimi, abuzim

1. Hyrje

Të jesh femër do të thotë shumë, do të thotë të jesh nënë, të jesh grua, të jesh bijë, të jesh motër, të jesh mike. Të jesh femër je vete arkitektja e gjithë shoqërisë.

Gëzuar 8 Marsin e dashura dhe unikja femër. E në fakt e di që të duket e çuditshme që të them gëzuar dhe e di që ke të drejtë në fakt, kur ti thellë brenda teje ke shumë për të bërë e për të treguar në këtë shoqëri e nuk mundesh, se thjesht nuk mundesh...PSE? Po ja pra se nuk të lënë...nuk të lënë ata pjesa maskiliste e shoqërisë sonë e sëmure nga deliri absolut i sundimit.

Gëzuar 8 Marsin zonjë e nderuar dhe thuj “STOP DHUNËS NDAJ TEJE” . Sipas statistikave të Policisë së Shtetit, çdo ditë arrestohen 2 meshkuj për dhunën ndaj femrave, dhe 1 në çdo 3 gra dhunohet nga partneri. Fenomen mjaft i njohur dhe i dhimbshëm ne shoqërinë shqiptare, ku del problemi që në edukim, ku djemtë që të vegjël i edukojmë si superiore dhe u mësojmë fatkeqësisht impotencën e fjalës dhe u kalisim fuqinë fizike ose forcën e armës ne rastin me fatal, ku djali në mënyre te gabuar steriotipizohet si me i forti ose me i afti.

Po çfarë është dhuna? Është ajo sjellje ose qëndrim qe dëmton mirëqenien fizike, emocionale dhe seksuale të personit dhe që ndikon në ndërprerjen e zhvillimit normal të individit. Dhuna në familje është përdorimi i abuzimit fizik, seksual, ekonomik/emocional nga një person në një marrëdhënie intime, i cili është bashkëshort, ish bashkëshort, ai që bashkëjeton, ish bashkëjetues ose personi me të cilin e dhunuara ka patur një fëmijë me qëllim për të krijuar, ose për të ruajtur pushtet dhe kontroll mbi personin tjetër. Prek gratë e të gjitha kulturave, moshave pa marrë parasysh nivelin e arsimimit dhe prejardhjen socio-ekonomike. Dhuna ndodh kudo: në shtëpi, në rrugë, në shkollë, në vendin e punës, gjatë konflikteve etj.,dhe ndodh në disa lloje.

- Dhuna fizike.
- Dhuna emocionale psikologjike
- Dhuna seksuale.
- Dhuna ekonomike
- Izolimi

2. Faktorët e dhunës.

- Faktorë të jashtëm – Ndikimi i kulturës, ekonomisë, politikës, lëvizjet demografike etj.
 - Faktorë të brendshëm familjare.- Modelet me të cilat janë rritur, edukata e familjes
 - Faktorë te nivelit personal- Probleme të shëndetit mendor, çrregullime te personalitetit, abuzimi me alkoolin/drogën, stresi, niveli kulturor etj.
- Pasojat e dhunës te gratë:

- Pasoja fizike .

- Pasoja psikike - Stresi i madh psikologjik, depresioni (4 here me shume se grate e tjera) frike dhe ankth, mungese vetëbesimi, anoreksi dhe pagjumësi, dhimbje koke (2 here me shumë se gratë e tjera), sëmuren 2 herë më shumë se gratë e tjera, tentative për vetëvrasje (6 here me shume se te tjerat) etj.

- Pasojat që lidhen me shëndetin riprodhues – Shtatzani e padëshirueshme, SST, lindje e parakohshme, lindje me fëmijë nën peshë, aborte etj.

- Pasoja te humbjes se harmonisë familjare - Shkurorëzimi , marrja me prostitucion, rënie si viktime e trafikimit etj.

E duke e bërë pak më tepër konkret këtë fenomen po përmend vetëm 2 shembuj (nga dhjetra që ndodhin ditë pas ditë) të rasteve që kane tronditur thelle shoqërinë shqiptare dhe mbare opinionin publik. Të gjithë e mbajmë mend rastin e vrasjes se gjyqtarës Hafizi nga ish bashkëshorti në mes të Tiranës, ngjarje që shërbeu si kambane alarmi për shumë gra, nëna, motra që e vuajnë ndoshta dhe në heshtje këtë fenomen. Apo mos ndoshta ju kujtohet edhe vrasja më e freskët referuar këtij akti te helmatisur po prape ne mes te Tiranës, gjeti vdekjen nga dora e një njeriu studentja ekselente e Fakultetit te Drejtësisë, e cila edhe ne banesën e fundit iku me konceptin se: Armët nuk vrasin njerëz. Njerëzit vrasin njerëzit. Doja që të përmendja vetëm këta 2 shembuj me fund fatal, për mos ta zgjatur me raste të tjera me më pak frikë nga vdekja, por që të gjitha në fakt me këto rezultate makabre finale.

Në qoftë se të gjithë ne, të gjitha ato që e ndiejnë dhunën, e grithë shoqëria civile, I gjithë shteti dhe pushteti nuk vihen në lëvizje për të parandaluar për të marrë masa sanksionuese për të gjithë ata që dhunojnë. E para gjë që duhet të bëjmë është te zbusim dhe ndryshojmë mentalitetin tone, te edukojmë veten dhe familjet tona se femra është qenie njerëzore, e pavarur dhe me te drejta të plota dhe jo prona e dikujt, dhe për me tepër të bindim veten se dominanca e dhunës mashkullore dëmton familjen në të gjitha brezat. Kjo situatë nuk mund të tolerohet më kurrsesi.

Duhet të organizohen fushata që synojnë luftën kundër dhunës ndaj grave dhe të sensibilizojnë shoqërinë për ekzistencën reale të kësaj sfidë serioze, edhe pse shumë gra sot janë ende viktime të raportit mes frikës dhe pasigurisë në qoftë se ato denoncojnë. Shoqëria përpara se të gjejë shkakun e dhunës, duhet të flasë fort dhe të thyejë heshtjen për të parandaluar dhunën, edhe kur ndodh, ta ndëshkojë atë.

Shteti duhet të marrë përgjegjësitë e veta dhe tashme është momenti që instancat të bëjnë veprime konkrete. Dhe që veprimet te jene efektive njësitë administrative duhet të zbatojnë legjislacionin përkatës për të siguruar mundësi strehimi, mundësi rehabilitimi, mundësi trajtimi psikologjik dhe social, dhe mbi të gjitha mbështetje ekonomike për gratë e dhunuara. Ndaj tani duke iu referuar edhe 8 marsit, ditës së gruas, të bashkohemi të gjitha në forma dhe mënyra të ndryshme, të japim kontributin tonë intelektual, qytetar, mendor për të mbrojtur të drejtat

tona, për ti thënë botës mashkullore ndal dhunën ndaj nesh, mos na vrisni, se vrisni vazhdimësinë e jetës, po pra mos vrisni jetën.

Nada DAULLJA, e lindur në Vlorë me 10 Mars 1990. Ka kryer studimet në Universitetin e Mjekësisë, Fakulteti “Mjekësi e Përgjithshme”, Tiranë, diplomuar në vitin 2014. Punon si Mjeke familje në Qendrën Shëndetësore nr.4 Vlorë. Që prej Dhjetorit 2016 N/kryetare PD Dega Vlorë.



ZGJERIMI I ROLIT TË GRUAS PËR ZHVILLIMIN TËRËSOR TË SHOQËRISË

Vojsava SHKURTAJ

Kryetare e Këshillit Bashkiak Vlorë

bshkurtaj@yahoo.com

Abstrakt

Kushtetuta e Shqipërisë sanksion barazimin ndërmjet burrave dhe grave, por në praktikë, shpesh, gratë nuk i gëzojnë njësoj të drejtat e tyre si burrat. Kjo pabarazi është e prekshme në shumë fusha të jetës, veçanërisht problemet sociale me përmasa të gjera si dhuna. Viktimizimi i gruas përforcohet nga gjendja ekonomike, mentaliteti, traditat, ndërgjegjësimi jo i mjaftueshëm. Ky viktimizim bëhet më shumë problematik e shqetësues, pasi shumë burra ndihen të kërcënuar nga koncepti i lirisë së gruas.

Megjithatë statistikat flasin qartë, sot grave u besohen detyra të rëndësishme pasi ato kanë dhënë prova që drejtojnë më mirë, bëjnë projekte konkrete të detajuara me objektivitet për situatën, menaxhojnë korrekt fondet, janë më të përgjegjshme e më komunikuese.

Sigurisht që ka ende shumë për të bërë, e të gjitha së bashku, duke mbështetur njëra-tjetrën ne mund ta bëjmë shoqërinë më të mirë, Shqipërinë më të begatë dhe të ardhmen të sigurt. Si nëna duhet të jemi model për fëmijët tanë e sidomos si promotore të së mirës, pozitives, forcës së shpirtit e të mendjes.

***Fjalë kyçe:** grua, profesioniste, aktiviste.*

Kushtetuta e Shqipërisë sanksion barazimin ndërmjet burrave dhe grave, por në praktikë, shpesh, gratë nuk i gëzojnë njësoj të drejtat e tyre si burrat. Kjo pabarazi është e prekshme në shumë fusha të jetës, veçanërisht problemet sociale me përmasa të gjera si dhuna. Viktimizimi i gruas përforcohet nga gjendja ekonomike, mentaliteti, traditat, ndërgjegjësimi jo i mjaftueshëm. Ky viktimizim bëhet më shumë problematik e shqetësues, pasi shumë burra ndihen të kërcënuar nga kon-

cepti i lirisë së gruas. Kështu po i referohem disa statistikave.

Viti 2012 – 42 viktime të dhunës në familje e trafikimit; 2013- 55//2014 – 92//2015 – 95//2016- 109 nga të cilët 43 janë fëmijë. Një sërë institucionesh e organizmash si: Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore (këshillon qeverinë), Ministria e Punës dhe Shanseve të Barabarta (rol koordinues, mbikëqyrës, mbështetës), Avokati i Popullit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Shëndetësisë, Instituti i komisionit për mbrojtjen nga diskriminimi, një sërë shoqatash e qendrash i përkushtohen krahas problematikave të tjera dhe barazisë gjinore.

Por argumentet e mësipërme kërkojnë që t’u tërhiqet vëmendja politikëbërësve. Mjaft problematike do të ishte gjendja në Shqipëri dhe Vlorë në se nuk do të kishte gra aktive që me veprimtarinë dhe aktivitetin e tyre të advokojnë së bashku për përmirësimin e politikave sociale.

Po i referohem Këshillit Bashkiak në Vlorë. Nga 41 këshilltarë gjithsej janë 20 zonja. Jo vetëm kaq, por kryetarja e këshillit dhe nënkryetarja janë zonja. Kjo jo vetëm si nocion, por edhe si një kontribut i rëndësishëm në zhvillimin e shoqërisë vlonjate.

Ky vlerësim është shumëdimensional si : nëna, bashkëshorte, drejtuese, veprimtare e kontribuuese për zhvillimin shoqëror, social të shoqërisë vlonjate. Puna në këshillin bashkiak do të ishte e pamjaftueshme pa një aleancë si Aleanca e Këshilltareve pa njohur dallime partiake.

Zëri i tyre është i fuqishëm e ka ndikuar në rregullimin e marrëdhënieve me qytetarët e Vlorës nëpërmjet dëgjësive publike e takimeve duke prekur aktualisht problematikat që shtrojnë qytetarët. Në bashkëpunim me qendrat e ndryshme e organizmat që merren drejtpërdrejt me fuqizimin e veprimtarisë e jetës së grave në Vlorë, Aleanca e Këshilltareve, ka arritur rezultatet e prekshme, si:

1. Bonusi i qerasë së apartamenteve për 20-25 gra viktime të mbijetuara të trafikimit dhe dhunës.
2. Pagesa në kopsht e çerdhe për 14 fëmijë nga bashkia (familjeve të dhunuara ose pamundësi ekonomike. Këtu dua të theksoj se në të ardhmen do të futen te plani social i bashkisë trajtimi i fëmijëve në çerdhe e kopshte.
3. Meqenëse papunësia është e theksuar sidomos në qendrat rurale, Aleanca e Këshilltareve u kujdes që një pjesë e grave e vajzave në këto qendra(10 për çdo njësi pra 40) të ndjekin te qendra e formimit profesional kurse te ndryshme profesionale falas (kategori si: parukeri, rrobaqepësi, gatim etj) Veçanërisht për këto gra që janë në vështirësi ekonomike ju rimbursohet rruga falas nga bashkia.
4. U forcua komunikimi me forumet e pavarura të zonave rurale dhe orga-

nizatat joqeveritare për të drejtat e grave duke përditësuar problemet që kanë gratë e vajzat në Vlorë.

5. Nxitje organeve kompetente për shpërblimin e nënave për fëmijët e por-salindur.

6. Komisioni këshillimor qytetar ka në përbërje gra nga forume të ndryshme që ngrenë zërin duke ndikuar në vendimet e Këshillit Bashkiak si: buxheti, taksat, tarifata, rregullimin e territorit, Zonjat: Flora Mecaj, Miranda Xhamo (Orikum), Burbuqe Kamberi (Komuna qendër), Shpresa Shehaj, Matilda Beqo (Novoselë) etj. Janë model i veprimtareve aktive, por jo vetëm, nuk mungojnë në asnjë mbledhje të këshillit bashkiak duke e bërë bashkinë Vlorë ndër të vetmet që në cdo mbledhje ka përfaqësues nga komuniteti.

7. Panairi i Orikumit që zhvillohet çdo vit duke aktivizuar gratë shtëpiake. Kryetari i Bashkisë z.Dritan Leli premtoi që do të gjejë mundësinë për ta përkrahur financiarisht këtë event të përvitshëm sepse, shihen mundësitë për promovimin e shërbimeve; Punim dore (qilima,grep,shporta etj), gatime tradicionale, ambiente të turizmit familjar që shërbejnë për fuqizimin e grave si mundësi për vetëpunësimin e tyre.

8. Bashkëpunimi me organizatën “Një zë i barabartë rom dhe egjiptian” në komunitetin vlonjate, e cila drejtohet nga zonja Rozina Kromuzi, model i një gruaje kurajoze që mundohet të zgjidhë problemet e shumta sidomos të grave të këtij komuniteti, si dhe t’i japë drejtim pozitiv ecurisë së te rejave të po këtij komuniteti, nëpërmjet urave të komunikimit me aleancën e Këshilltareve, pushtetit vendor, duke u bërë pjesë aktive e dëgjësave publike.

Në çdo fushë të jetës sonë gjejmë gra dhe vajza të cilat janë shembull i mirë që GRATË IA DALIN.

Një falënderim të veçantë do të bëja për:

Sherife Shanaj, mësuese e merituar, tashmë në pension. Mjaft aktive në trajtimin, sensibilizimin, bashkëpunimin me prindërit e fëmijëve ndryshe (*autik*). Kurajoze, bashkëvuajtëse me këta prindër, ngre zërin për të drejtat e prindërve e fëmijëve. I shërben në mënyrën më të mirë të mundshme këtij komuniteti.

Vera Lesko, gruaje e hekurt që u be strehë për gratë dhe vajzat, viktimat të trafikimit, në vitet më të vështira për Shqipërinë. Ajo ngriti të vetmen strehëz në Shqipërinë e Jugut për këto vajza e gra. E vlerësuar me tituj nderi nga komuniteti evropian dhe Ambasada amerikane për punën e bërë me qendrën “Vatra”.

Zenepe Luka, model i gazetares luftarake për të sjellë realitetin vlonjat, shkrimtare e mjaft librave, krijuese e fondacionit “*Nermin Vlora*”, përzgjedhëse e promovuese e vlerave të grave intelektuale në Shqipëri e më gjerë.

Drita Aga, një grua profesioniste e zonja, sipërmarrëse e suksesshme, aktive

në “Aleancën Qytetare”, pjesëmarrëse aktive në vendimmarrje në këshillat bashkiak të mëparshëm, drejtuese e “Rotarit” në Vlorë, kësaj organizate të fuqishme mbarëbotërore.

Resmie Ruci, aktore e mrekullueshme, veprimtare e palodhur e përkushtuar, pothuajse e vetnija, për të edukuar e mbajtur gjallë kujtimin e dëshmoreve që dhanë jetën për çlirimin e atdheut. Edukon ndjenjën e atdhedashurisë e patriotizmit te brezat e rinj.

Valbona Brinja, model si Elona, por vlen të theksojmë se sot është mësuese të “*Teli Ndin*” dhe ka dy vjet trajnere e kombëtares “4-16 goca” sot përfaqësuese e Shqipërisë. Mjaft e suksesshme si presidente e shoqatës “KS –Vlora” prej 10 vjetësh, duke stërvitur grupmoshat nga 5-18 vjeç, të

cilët marrin pjesë në kampionate e aktivitete të ndryshme sportive.

Natasha Ahmetaj, model e përfaqësuese e grave intelektuale të fuqishme që kontribuojnë dhe hedhin hapa të rëndësishëm si dekane, drejtuese, menaxhere e suksesshme.

Elona Merkaj, model i suksesit të skuadrës vlonjate basketboll prej 14 vjet kampion, 9 vjet kupa Republikës, 3 vjet lojtarja më e mirë e vitit. Aktualisht drejton në mënyrë vullnetare ekipin e të rejave. Duke pasur pasion për 27 vjet i ka shërbyer sportit më të suksesshëm në Shqipëri, duke luajtur basketboll edhe 6 muajsh shtatzënë. Vazhdon me ekipin e të rejave, mësuese në gjimnazin “*Halim Xhelo*”

Etjona Hoxha, e para grua që ka mbajtur postin e prefektit të Qarkut Vlorë, ish kryetare e këshillit bashkiak, pedagoge e nderuar e UV, doktore e shkencave, e dalluar për devotshmërinë, përkushtimin ndaj detyrave të ngarkuara.

Dorotea Konomi, një grua e nderuar dhe e respektuar nga të gjithë si mësuese, politikane dhe aktiviste e shoqërisë civile.

Liljana Gjika, ish drejtoresha e bibliotekës, mbrojtëse deri në vetëmohim e bibliotekës në vitet 97. Vazhdon të edukojë breza të tëra me dashurinë për librin, krijimet letrare dhe sot aktive duke dhënë shembullin e një zonjë për zhvillimin dhe edukimin e mbarë komunitetit.

Brikena Puka, drejtuese prej vitesh e qendrës “*Vatra*” që me përkushtim, kujajo civile lufton e mbron femrat e dhunuara e të trafikuar.

Enela Mone që drejton qendrën “*Aulona*” që me qetësi e profesionalizëm është bërë paraprijëse e problematikave sociale për gratë e vajzat duke iu ofruar grave e vajzave pap-testin, ekografi, kontrceptivë e vizita falas.

Keti Dhimitri, drejtuese prej vitesh e rinisë vlonjate. Nuk i mungon energjia, dëshira për t’i dhënë drejtimin e duhur të rinjve. Mjaft aktive në vendimmarrjen korrekte të projektvendimeve në Këshillin bashkiak.

Aulona Veizi, drejtuese e Institutit të Ullirit, doktore e shkencave, veprimtare për të shtuar mirëqenien e fshatrave duke i ndihmuar aktualisht me rrënjë ullinj falas dhe këshillim për rritjen e ullirit si një nga produktet më me vlerë në Vlorë.

Laureta Petoshati, shkrimtare, poete, përkthyesë. Organizatore në krijimin e modeleve letrare me krijuesit në Vlorë, fituese e disa çmimeve kombëtare e ndër-kombëtare. Model i gruas kurajoze duke kritikuar regresin.

Migena Balla, pedagoge në UV, doktore e shkencave, drejtuese e Aleancës së Këshilltareve të Vlorës, aktiviste e shoqërisë civile, bashkëpunuese me gratë e komunitetit në Vlorë, e në veçanti grave e vajzave në të katër njësitë administrative, sidomos në Orikum.

Nga ky këshill bashkiak u përzgjedhën si deputete të parlamentit shqiptar dy këshilltare: **znj. Vilma Bello** dhe **znj. Nada Mecorapaj**, të cilat sot, përfaqësojnë komunitetin e Vlorës në Kuvendin e Shqipërisë dhe sfidojnë me përgjegjësinë e marrë nga njëra anë dhe na mbushin me kënaqësi e nderim nga ana tjetër.

Për të treguar punën e shumanshme që bëhet për rolin e gruas në zhvillimin tërësor të shoqërisë po ju sjell disa fakte që tregojnë përmirësimin e dukshëm të jetës ekonomike, sociale, politike të vendit. Sot grave u besohen detyra të rëndësishme pasi ato kane dhënë prova që drejtojnë më mirë, bëjnë projekte konkrete të detajuara me objektivitet për situatën, menaxhojnë korrekt fondet, janë më të përgjegjshme e më komunikuese.

Nga 6091 veta që kërkojnë punë, 3207 janë gra te punësuara, pra 52 %.

Bujqësi 30%, industri 22%, ndërtim 13%, transport komunikacion 16%, arsim 62%, shëndetësi 76%, të tjera 35%.

Më saktë: arsimi në Vlorë nga 1512 gjithsej, femra 1151//drejtues nga 117, 62 janë drejtuese femra. Në bashki nga 1065 punonjës, 613 femra /nga 52 drejtues, 13 femra.

Në sektorin privat shihet dukshëm një rritje e numrit femra aktive në administrim e bizneseve të tyre, respektivisht vitet 2012 -26%/ 2013 -27%/ 2014 -28.2%.

Ndërmarrjet aktive të qarkut Vlorë nga 11.620 //, 3464 ndërmarrje i drejtojnë femrat.

Në UV kontribuojnë zonja 20 As/prof, nga 30 numri i përgjithshëm i prof as/ 1 profesore. Numri i Dr është 74 Dr/.

Janë disa fakte reale ku dimensionin grua përballet me sfidat e zhvillimit dhe nuk është aspak e lehtë të përballesh me këto sfida, pavarësisht vështirësive që mbartin rolet si bashkëshorte, nënë, motër, shoqe nuk i frenojnë për arritur qëllimet. Shpirti luftarak, i dallon drejtueset e institucioneve, mësueseve, mjekeve, shkrimtareve, aktoreve, punonjëset e policisë së shtetit, pedagogeve, sipërmarrëset dhe me rolin që luajnë e nxisin komunitetin të ofrojnë më të mirën e mundshme, duke u lënë

brezave të rinj e komunitetit vlerat në shërbim të shoqërisë e komunitetit ku jetojmë.

Sigurisht që ka ende shumë për të bërë, e të gjitha së bashku, duke mbështetur njëra-tjetrën në mund ta bëjmë shoqërinë më të mire, Shqipërinë më të begatë dhe të ardhmen të sigurt. Si nëna duhet të jemi model për fëmijët tanë e sidomos si promotore të së mirës, pozitives, forcës së shpirtit e të mendjes.

NE, TE GJITHA BASHKË, IA KEMI DALË E MUND T'IA DALIM
GJITHËMONË!

Vojsava SHKURTAJ, lindur në Leskovik, më 26 nëntor 1953, diplomuar në Institutin e Lartë Pedagogjik 3-vjeçar, Shkodër 1974-1968, përfunduar studimet 4-vjeçare të Universitetit të Shkodrës 1982 për *Gjuhë Shqipe dhe Letërsi*. Ushtroi profesionin si mësuese e gjuhës shqipe dhe letërsisë në shkollat e mesme e 9-vjeçare për 38 vjet në Fier e Vlorë. Inspektore e kabinetit pedagogjik në Fier me 1984-1985; drejtuese në shkollat 9-vjeçare: “*Muco Delo*” 2001-2003; “*Lef Sallata*” 2003- 2009. Certifikuar nga MASH dhe ISP për drejtim shkollash, korrik 2003, certifikuar e trajnuar nga Konventa e CEDAW, certifikuar nga National Democratic Amerika(NDI) dy herë: 2008 “*Certifikatë e Merituar*”. Në 2009 fiton titullin “Trajnuese e trajnerëve në politik”, certifikuar për menaxhim efektiv të këshillit bashkiak nga USAID; Drejtuese ekzekutive e fondacionit “*Autizmi Flet Shqip*” 2013-2015: gusht 2015 e në vijim Kryetare e Këshillit Bashkiak, Vlorë. Numëron tre seri botimesh duke krijuar një traditë dhe eksperiencë për kolegët e nxënësit. Disa certifikata mirënjohje nga DAR, Vlorë e Bashkia Vlorë. Së fundmi merr “*Mirënjohje*” nga Qendra Kërkimore Zhvillimore-Peja, Konferenca e 4-t shkencore. Aktualisht që prej zgjedhjeve vendore të viti 2015, mban detyrën e Kryetares së Këshillit Bashkiak Vlorë.



SFIDAT GRUAS PËR ZHVILLIMIN TËRËSOR TË SHOQËRISË

Albana HODAJ

*Drejtor, Drejtoria Arsimore Rajonale Vlorë
a.hodaj@darvlore.edu.al*

Abstrakt

Fuqizimi i rolit të gruas, mbetet një sfidë e madhe për gjithë shoqëritë, jo vetëm për aspektin numerik që përbën kjo pjesë e popullatës globale, por për pamundësinë e progresit demokratik, ekonomik e sociokulturor të shoqërive, pa progresin e faktorit “Grua”, mbështetur kjo në sistemin e saj të vlerave unike, problematikave dhe pritshmërive. Në këtë punim do të trajtohet zgjerimi i rolit të gruas në karrierë, përballja me stereotipin e krijuar, paradigma e re e marrëdhënieve punë-familje si dhe sfidat e saj në vendimmarrje dhe edukim. Përmes kësaj qasjeje, bazuar në të dhëna sasiore në fushën e leadershipit në arsimin parauniversitar të Vlorës, por të kufizuara në rreshtat e këtij punimi modest, synohet të provohet teza se asnjë zhvillim nuk vjen dot në konflikt me rolin e Gruas, si faktor thelbësor në ndryshim të vetes, familjes, shoqërisë dhe lirive sociale.

Fjalë kyce: Grua, fuqizim, sfida, barazi, liri.

1. Hyrje

Në shoqërinë e sotme globale dhe atë shqiptare, roli i gruas në familje dhe karrierën profesionale ka ndryshuar rrënjësisht. Ka një rritje të konsiderueshme të grave në tregun e punës dhe përpjekjeve të tyre për suksesin në karrierë. Rruga drejt këtij sukseesi për një grua, është shumë herë më e vështirë se për një burrë. Pavarësisht faktit të arsimimit dhe nivelit kulturor të grave, shpeshherë përballjet me klanin mashkullor, mbeten sfida të vështira, pothuajse të pamundura, ku për

të arritur suksesin e tyre, burrat si për ironi, pas muskujve të intrigave, marrin mbështetjen edhe nga vetë gratë, kur duhet të ishte e kundërta. Një lobim i fortë i grave për gratë, nisur jo nga identiteti gjinor, por nga rëndësia e përfaqësimit në një organizatë ku zhvillohet karriera e saj me interesa dhe pritshmëri të përbashkëta.” *Gratë, duke njohur njëra-tjetrën, mund të promovojnë vlerat, formimin kulturor e profesional të sho-shoqes me natyrshmëri, me këmbëngulje, me përkushtim” (Ruci, L.2005:36¹).*

Në realitetin lokal vendor, një grua në karrierë vijon të përballet me paragjykimin, diskriminimin, mungesën e kënaqësisë së karrierës dhe stresin në rritje, nga presioni i menaxhimit nga aktorë brenda dhe jashtë organizatës. Gratë hasin barrierë që jo rrallëherë ndërtohen nga vetë gratë. Kjo është sfida e dytë më e madhe për një grua, pas sfidës së parë me vetveten. Nëse një gruaje të re në karrierë, do t’i tregonin sa e vështirë do të ishte kjo ngjitje, sa sfilitëse dhe e pamëshirshme do të ishte, me siguri ajo nuk do ta dëshironte një rrugë të tillë. Do të tërhiqej. Kjo shpjegon qartazi arsyen pse burrat, duke përdorur edhe gratë, arrijnë të çimentojnë pengesat për ta bërë gati ideale e utopike ambicjen e një gruaje në karrierë, kur përballë saj është një burrë. Simbolika vijon të jetë problem shoqëror dhe shoqëria nuk mund ta presë kurrësesi zgjidhjen nga burrat, por nga vetë gratë. Përditë e kudo, në punë, rrugë e familje, në media e politikë, në shkolla, spitale a zyra çdo ditë me një fitore të vogël a përpjekje, mjafton që kjo të ndodhë, për vetë gruan, për familjen dhe mbarë shoqërinë. Por që kjo të ndodhë, duhem unë, ti dhe çdo grua tjetër që guxon t’ia dalë në një botë të egër mashkullore, ku emancipimi krihet në ekrane, por është në krizë të thellë identiteti. Është koha e mundësive, por duhet kthyer në kohën e guximit dhe qëndresës. Kështu mbërrihet progresi. Progresi që e sheh gruan të lirë në bukurinë e vlerave brenda familjes, në dinjitetin e ngjitjes në profesion dhe me gjurmët ku do ecin të tjerët...Kjo është grua që bën dritë...grua në profesion, mision, pasion e vizion.

Një grua në karrierë, përveç angazhimit në punë, ka dhe rolin brenda familjes ku mungesa e besimit, vetëvlerësimit dhe zhgënjimit, bëhen shkaktare të një konflikti që lodh familjen dhe humb qëllimin e kësaj “miniorganizate” ku grua nuk bën dritën që i takon në shtëpi. Dhe nëse një grua dështon në familje, në sistemin e vlerave brenda saj në një klimë të paqte për rritje dhe edukim, sigurisht që cënimi i kësaj qelize bazë, sjell edhe dështimin e sigurt social.Një grua e gjallë, e motivuar, e arrirë profesionalisht e plot vetëbesim, është një aset i paçmuar, jo vetëm për organizatën ku bën pjesë, por edhe për tërë shoqërinë, sepse një grua që ndërton familjen me qeliza dashurie dhe jete, është padiskutim progresi më i shëndetshëm për çdo shoqëri.

Sipas traditës së trashëguar suksezi i gruas lidhet me kujdesin ndaj fëmijëve dhe mbajtjen e shtëpisë.

Paradigma e marrëdhënies punë-familje ka krijuar sot një grua të mbingarkuar

e plot strese nga roli i saj i dyfishtë brenda familjes dhe brenda organizatës. E në rolin e saj si nënë apo si bashkëshorte, lëshime ka vetëm për burrat në karrierë, jo për gratë. Gratë përndiqen nga stereotipi mëshirues gjinor dhe ngjitin shkallët përmes një luftë të pamëshirshme, të pabarabartë dhe të pamerituar.

Kur një grua rritet në detyrë, pritshmërisë janë të ulëta nisur nga ky stereotip i krijuar për gratë si të ndjeshme, të kuptueshme, tërheqëse apo të dobëta, duke krijuar kështu një mit të gabuar, negativ e paragjykes për gratë. Një grua në drejtimin e një institucioni arsimor harxhon shumë më tepër kohë jashtë orarit për të përmbushur detyrat, sesa drejtuesit burra, më shumë mund e angazhim, duke i dhënë vlerat e saj unike dhe krijuar modele identifikuese në institucionin që drejtojnë. Motivuese, konkurruese, me ide e pritshmëri të qarta, të matshme për cilësinë e institucionit që drejtojnë, të tilla gra janë nevojë dhe faktor zhvillimi për masën e nxënësve, mësuesve dhe komunitetit. A nuk është kjo Gruaja, që merr dhe përmbush përgjegjësi në punë dhe familje, duke mos i kursyer vetes kostot e përballjes me këto sfidave, një arterie ushqyese dhe e pazëvendësueshme e zinxhirit shoqëror?

Roli i gruas në jetën publike sot si në vendimmarrje dhe në politikë, nuk është më problem numrash, por sfidë përfaqësimi. Janë krijuar modele frymëzuese në qeverisje, ku gra ministre janë shembuj që rrëzojnë barrierat në komunikim apo shpërfillin gjuhën e shpifjes dhe fyerjes. Po krijohet një kulturë e re, një qasje ndryshe e sjelljes së gruas në politikë, kjo falë përfaqësimit cilësor dhe jo numerik duk ndikuar klimën e jetës publike.

Nisur nga një vështrim i thjeshtë statistikor për nivelin e përfaqësimit gjinor në fushën e arsimit parauniversitar në Shqipëri, janar 2018, konstaton se nga 38 drejtori dhe zyra arsimore vendore, 20 (53%) drejtohen nga gra, kurse 18 (47%) drejtohen nga burra. Po të lexojmë më lokalisht të dhënat për administratën civile në njësinë arsimore vendore (DAR) Vlorë e njëjta periudhë, nga 17 punonjës, 12 (70%) janë femra. Në institucionet arsimore të varësisë së drejtorisë aktuale rajonale, për tri bashkitë Vlorë, Selenicë, Himarë, për arsimin publik dhe jopublik nga 1957 mësues/e gjithsej, 1546 (79%) janë femra. Po kështu për të njëjtat të dhëna, nga 149 drejtorë/nëndrejtorë të institucioneve arsimore, 97 (65%) janë femra. Edhe nëse u referohemi të dhënave në zyrën arsimore Sarandë, vartëse të DAR-it Vlorë, të dhënat tregojnë se nga 451 mësues gjithsej, 366 (82%) janë femra. Ajo që kuptohet lehtësisht nga këto shifra, është forcimi i stereotipit të profesionit të mësuesit dhe pse jo, një lloj mitizimi profetik se gruaja po rrëmben çdo ditë e më shumë territor në fushëbetejën më të vështirë të shoqërisë, rritjen, nxënien dhe edukimin e moshës parauniversitare nga arsimit parashkollor e deri në arsimin e mesëm të lartë. Ky pushtet gjithnjë e më shumë do t'ju takojë grave, sepse tiparet e lidhshpimit menaxhues e drejtues në arsim, kanë nevojë mbi çdo lloj kualifikimi profesional dhe përfaqësues, për një pushtet që ngjizet nga gjeneza e mëmësisë e

nëse jemi duke krijuar një dimension të ri të stereotipit femëror në edukim, le t'ia lëmë këtë fuqi Gruas, si arma e saj drejt progresit të gjeneratave.

Ndryshimet socioekonomike kanë ndikuar dhe vazhdojnë të ndikojnë jetën e grave dhe rolet e tyre në familje e shoqëri. Nuk mund të ketë zhvillim, pa lirinë ekonomike të gruas. Varfëria, papunësia, lypja, trafikimi, prostitucioni, depresioni, krimi, dhuna etj, janë përditshmëria e lajmeve në mediat kombëtare, lokale dhe botërore, ku gratë janë objekt dhe subjekt rrëfimi nëpër ekranet që për fat të keq, arrijnë shikueshmërinë me të tilla fakte tronditëse e që janë dëshmi e një shoqërie në kontraste të forta brenda progresit dhe regresit, sa primitive, kanunore, aq dhe bashkëkohore, por së qeni larg asaj demokratike.

Forcimi i rolit të Gruas në radhë të parë është liri e vetë saj e kur Ajo si pjesa më e madhe e një shoqërie gëzon të plotë këtë të drejtë themelore, qartazi kemi të bëjmë me një botë të hapur, që rrëzon pengesa e shtron rrugën e aspiratave për secilin. Por sado optimiste të jenë shoqëritë sot, me ndarjet e mëdha sociale, racore, fetare, identitare, sociokulturore e gjinore në botë, askush të mos presë se rrugën do ta gjejë shtruar me dafina. Rruga e një gruaje është më e vështira që kur ajo është zgjedhur për barrën më të rëndë të njerëzimit: krijimin e jetës, vazhdimin, progresin, ekzistencën e kësaj bote të vrazhdë, që vetëm Gruaja di ta përsosë, por kurrë vetëm pa pjesën tjetër të shoqërisë, të secilit. Ndryshimet vijnë ngadalë, kalojnë përmes pengesave, por vijnë, sepse një grua që lind jetën, mund të bëjë gjithçka, jo vetëm për lirinë dhe fuqinë e saj, por mbarë njerëzimin. *Ndryshimi është guximi për të ecur, duke vrarë frikën e të qenit Grua, me fuqinë që vetëm një Grua mund ta ketë!*

Albana HODAJ, lindur më 29 Dhjetor 1972 në Vlorë, diplomuar në vitin 2002 si Mësuese e Gjuhës Shqipe dhe e Letërsisë, dhe më pas ka kryer studime pasuniversitare në profilin Shkenca Komunikimi, Teori dhe Modele Komunikimi. Ka filluar përvojën në fushën e arsimit si mësuese në Shkollën 9-Vjeçare “*Marigo Posio*”, Vlorë, me pas për vite me radhe pa punuar si mësuese dhe organizatore e eventeve arsimore e kulturore në shkollat jopublike “*Perla*” dhe “*Shkolla Internacional*”. Në Shkurt të vitit 2012 është emëruar Administratore e Rajonit NR. 1 Vlorë. Nga Dhjetori i vitit 2013 ushtron detyrën si Drejtor në Drejtorinë Arsimore Rajonale Vlorë.



ROLI I GRUAS NË ZHVILLIMIN E SHOQËRISË SHQIPTARE

Alma BAKIU

*Drejtor, Shkolla e Mesme Publike “Jani Minga” Vlorë
bakiualma1@gmail.com*

Abstrakt

Në realitetin e tyre të zakonshëm, në çdo vend të botës, janë gratë që duhet të përballen si shtëpiake me peshën e familjes dhe të fëmijëve, dhe si të punësuar me peshën profesionale. Për t’u quajtur të realizuara duhet t’ia dalin me sukses të gjitha këtyre sfidave, pa u lodhur. Në realitetin shqiptar, në mënyrë të vecantë, gratë e kanë edhe më të vështirë, sepse duhet të përballen me mundësitë sociale të kufizuara, me mentalitetin e shoqërisë, me pabarazinë gjinore dhe dhunën njëkohësisht, cka ua bën ekzistencën më të vështirë dhe ndonjëherë të pamundur.

Ky punim fokusohet në fuqinë që kanë gratë për të bërë ndryshimin, së pari duke marrë pjesë në jetën civile dhe politike të vendit. Gratë kanë të drejtën legjitime për ta bërë këtë. Së dyti, realiteti, qoftë shoqëror apo politik, bëhet më i ndjeshëm ndaj problemeve të shoqërisë, më i butë dhe më i paqtë nga prania e femrës, sepse gratë dinë të ndikojnë paqësisht në vendimmarrje duke zbutur sjelljet agresive mashkullore. Së treti, është një e drejtë njerëzore e grave për t’u ndjerë dhe për të qenë realisht të barabarta me burrat në cdo aspekt të jetës.

Fjalë kyçe: *gruaja shqiptare, ndryshim, vlera.*

“Është një grua në fillesën e të gjitha gjërave të mëdha” De Lamartin.

Mes mijëra thënieve të tjera dedikuar grave, preferoj këtë, sepse mendoj me të vërtetë, se janë gratë ato që i japin peshën e vërtetë ekzistencës së shoqërisë njerëzore dhe mbajnë mbi supë të sotmen dhe të nesërmen e saj. Në realitetin e tyre të

zakonshëm, në cdo vend të botës, janë gratë që duhet të përballen si shtëpiake me peshën e familjes dhe të fëmijëve, dhe si të punësuar me peshën profesionale. Për t'u quajtur të realizuara duhet t'ia dalin me sukses të gjitha këtyre sfidave, pa u lodhur. Në realitetin shqiptar, në mënyrë të vecantë, gratë e kanë edhe më të vështirë, sepse duhet të përballen me mundësitë sociale të kufizuara, me mentalitetin e shoqërisë, me pabarazinë gjinore dhe dhunën njëkohësisht, cka ua bën ekzistencën më të vështirë dhe ndonjëherë të pamundur.

Agresiviteti i sjelljes ndaj femrës na është shpalosur nëpërmjet mediave jo rrallë në muajt e fundit. Ka pasur sjellje ekstreme të burrave ndaj grave, duke u marrë jetën në mënyra nga më makabret e absurdet, pavarësisht formimit, shtresës shoqërore, shkollimit apo prejardhjes. Sa herë ndodhin ngjarje të tilla tronditëse, shoqëria bëhet e ndjeshme dhe kërkon ndryshimin.

Dicka është e sigurt, nuk ka zhvillim dhe as demokraci të vërtetë në një shoqëri ku gruaja nuk ka të drejta të barabarta me burrin dhe ku vendimmarrja si në shoqëri ashtu edhe në politikë nuk është në balancë gjinore. Historia e vendit tonë dëshmon se që nga fillimet tona ilire, gratë kanë qenë në krye të jetës së shtetit (Mbretëresha Teutë). Në krijimet popullore arbëre, gruan shpesh e gjejmë me emërtimin “Zonja mëmë” për të dëshmuar nderimin dhe vendin e rëndësishëm që ajo kishte në familje. Një lloj statusi që i jepte të drejtën për të vendosur për çështje të familjes e të bijve, një model për t'u ndjekur nga bijat gjithashtu.

Gruaja shqiptare ka sjellë një potencial të vërtetë mendor jo vetëm brenda kufijve të Shqipërisë, por edhe në vende të tjera të Evropës, jo vetëm në kohët moderne, por që në periudhën e Rilindjes evropiane. Ishte një kohë kur ende ishte shumë e vështirë që femra të cante në rrugën e dijes, në shoqëri dhe me kurajë duhet t'i deklamonte botës se ishte po aq e zonja sa edhe një mashkull, në mos edhe më. Një figurë e tillë e jashtëzakonshme do të bënte epokë në shekullin e 17-të në Itali, Elena Peshkopia, e lindur 25 mars 1646 në Vencia prej prindërve emigrantë. E **para grua shqiptare në botë** që më 1678 ka arritur të marrë doktoraturën në filozofi. Gjatë shekullit kur jetoi ishte gruaja më e ditur në Evropë. Ajo u shkollua si fillim në Venezia, në shkollën “Santa Maria dhe San Gallo” të themeluar dhe financuar prej fisnikëve shqiptarë të Venedikut që në 1442, dhe më pas studioi dhe mbrojti doktoraturën në Universitetin e Padoves ku do të punonte si lektore e Matematikës deri në fund të jetës së saj të shkurtër dhe ku sot ndodhet një bust për nder të saj.¹

Ky është një prej modeleve të shkelqyera të grave shqiptare që kanë bërë ndryshimin e botës dhe që na tregojnë se ne mundemi. Kemi kaq shumë nevojë për modele të vlefshme, në cdo kohë e periudhë. Të tilla modele sot, në shoqërinë globaliste ka me qindra, vajza e gra shqiptare që me punën dhe aftësitë e tyre të jashtëzakons-

1 <http://filozofia.al/index.php/2017/02/06/elena-peshkopia-shqiptarja-e-pare-ne-bo-te-doktorature-ne-filozofi/>

hme ndikojnë në ndryshimin pozitiv të Evropës e të botës, si në fushën e shkencës po aq edhe në fushën e artit.

Po sot në shoqërinë shqiptare, kush e bën këtë ndryshim?

Mendoj se ndryshimin më të madh e kanë në dorë vetë gratë. Është aftësia dhe forca e natyrshme e tyre që do të sjellë ndryshimin.

Së *pari* pjesëmarrja e gruas në jetën civile dhe politike të vendit mund të ndikojë në zhvillime të rëndësishme, sepse duhet të jenë gratë që të vendosin për realitetin e tyre, për të krijuar e zbatuar ligje. Gratë kanë të drejtën legjitime për ta bërë këtë. Nga ana tjetër gratë kanë dhuntinë e përgjegjshmërisë dhe durimit, për t'u shkuar gjërave deri në fund dhe kjo do të sillte rezultate të dukshme në jetën e vendit.

Së *dyti*, realiteti, qoftë shoqëror apo politik, bëhet më i ndjeshëm ndaj problemeve të shoqërisë, më i butë dhe më i paqtë nga prania e femrës, sepse gratë dinë të ndikojnë paqësisht në vendimmarrje duke zbutur sjelljet agresive mashkullore.

Së *treti*, është një e drejtë njerëzore e grave për t'u ndjerë dhe për të qenë realisht të barabarta me burrat në cdo aspekt të jetës. Është e drejtë civile që gratë të marrin vendime për jetët e tyre dhe të fëmijëve.

Zvillimet politike dhe ekonomike të shoqërisë shqiptare nuk do të ishin të tilla pa rolin vendimtar të grave. Pjesëmarrja e grave në një përqindje më të lartë në politikat vendimmarrëse nuk është vetëm një kusht i vendosur nga BE, por një zhvillim i domosdoshëm për të përmirësuar jetën e vendit në cdo drejtim. Të mos e marrësh në konsideratë potencialin femëror, është si të mohosh 50% të potencialit të vërtetë të shoqërisë shqiptare.

Po të hedhim një vështrim nëpër botë, nuk është se gjërat flasin më pozitivisht në këtë drejtim. Jo vetëm në politikë, por edhe në institucionet financiare dhe organizatat ndërkombëtare më të rëndësishme, të tilla si: Bashkimi Europian, Kombet e Bashkuara, NATO, Banka Botërore dhe grupet e tjera të fuqishme, burrat vazhdojnë të mbizotërojnë pozitativisht drejtues, por ky nuk është një fakt që duhet të na stepë.

Në Shqipëri gjërat po shkojnë drejt përmirësimit dhe shifrat për pjesëmarrjen e grave në pozicione drejtuese dhe në jetën parlamentare e dëshmojnë këtë. Në parlamentin e vitit 1997 nga 144 deputetë, vetëm 11 ishin femra. Në parlamentin e 2001-shit ishin vetëm 9 gra deputete, ndërsa sot në parlamentin shqiptar janë 42 femra që na përfaqësojnë denjësisht. Ka ardhur ndoshta momenti që vetë gratë të marrin vendime për vazhdimësinë e politikave në dobi të tyre.

Në realitetin tonë, për të arritur rezultate konkrete dhe ndryshime të dukshme, duhet që të promovojmë dhe të nxitim aftësitë e grave në të gjitha fushat e jetës. Duhet t'i bëhemi mbështetje konkrete cdo iniciative sado modeste, që do të sillte përfshirje më të madhe të grave në jetën sociale të vendit. Duhet të ndërgjegjësojmë të rinjtë, bijtë tanë, se nuk ka qytetërim në një shoqëri që dhunon dhe mohon të

drejtat e gruas. Duhet të nxitim mediat që të promovojnë modelet më të shkëlqyera të grave, në jetën shoqërore të qytetit apo vendit.

Si përfundim, ne gratë duhet të jemi të vetëdijshme për vlerën që mbartim. Ne gratë duhet t'i bëhemi mbështetje njëra-tjetrës dhe të japim maksimumin në emër të së nesërme, për të treguar se jemi po aq të forta sa edhe të brishta, po aq luftarake sa edhe të mencurapo aq sakrifikuese sa edhe të gatshme për të luftuar. Të vetëdijshme dhe krenare se jeta lind prej grembit tonë, rritet në duart tona dhe lulëzon prej syve tanë.

Së fundi po e mbyll me një thënie të së madhërishmes Nënë Tereza, modelit më të bukur të nënës e të gruas, që toka shqiptare i ka falur botës: *“ Jo të gjithë ne mund të bëjmë gjëra të mëdha. Por ne të gjithë mund të bëjmë gjëra të vogla me dashuri të madhe.”*

Alma BAKIU, lindur në Vlorë, me 20 Tetor 1972, diplomuar në Universitetin e Tiranës, për Gjuhe Shqipe e Letërsi më 1999, si dhe më pas përfunduar një Master Shkencor në Universitetin “*Ismail Qemali*” Vlorë, më 2012. Me një përvojë 19 vjeçare si mësimdhënëse në shkolla të ndryshme publike e jopublike të qytetit. Trajnuese në nivel lokal për Metodologjinë e Mësimdhënies. Pjesëmarrëse në konferenca të ndryshme shkencore. Njohëse e mirë e gjuhës angleze dhe italiane. Aktualisht Drejtore në gjimnazin publik “*Jani Minga*”.



FUQIZIMI EKONOMIK I GRUAS THEMELI I BARAZISË GJINORE

Mariana CANI

*Drejtor, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Vlorë
cani.mariana@yahoo.com*

Abstrakt

Fuqizimi ekonomik dhe politik i grave përbejnë dy shtyllat më të rëndësishme për të garantuar te drejtat e tyre . Nëpërmes fuqizimit të grave familjet dhe shoqëritë fuqizohen në tërësi, sepse një shans i ofruar gruas është një shans i ofruar mbarë shoqërisë. Sigurimi i të drejtave të barabarta të grave dhe burrave më nuk është vetëm detyrim moral, por më shumë, është faktor shumë i rëndësishëm i cili na mundëson zhvillim, por edhe një paqe të qëndrueshme. Për këtë arsye, përdërisa barazia gjinore garantohet me ligj, implementimi i saj nuk duhet të jetë çështje opsionale, apo mënyrë se si ne e zgjidhim atë.

Gratë do të jenë të fuqishme kur ti kenë realisht këto të drejta .Një vend mund të zhvillohet ekonomikisht vetëm nëse do të bëjë të mundur pjesëmarrjen e grave në këtë proces, pasi bëhet fjalë për përfshirjen e gjysmës së popullsisë.

Për te garantuar realisht fuqizimin e grave kërkohet bashkëpunimi i të gjithë faktorëve politike ekonomike e sociale dhe aktorëve të shoqërisë. Po ajo kërkon në radhe të pare vullnet politik dhe një bashkëpunim shumë të mirë me sipërmarrjen private, sepse ajo që ka rolin kryesor në ekonomi për pasojë është dhe punëdhënësi më i madh. Na duhet të pohojmë rolin vendimtar të tij në fuqizimin ekonomik të grave duke e shtrirë fuqizimin e grave në radhë të parë në vendin dhe tregun e punës.

***Fjalë kyçe:** grua, fuqizim ekonomik, barazi gjinore, tregu i punës,*

1. Situate aktuale

Barazia gjinore është një faktor dhe tregues shume i rëndësishëm ne zhvillimin e një vendi. Ne se nuk kemi barazi gjinore do te ndeshemi me pabarazinë e cila shfaqet me një ndikim shume te forte negativ ne raportet ndërmjet grave, vajzave dhe burrave, djemve. Dhe jo vetëm kaq po ajo reflektohet ne fenomene ekonomike, politike e sociale si vendimmarrja, punësimi etj .

Ndryshimet social ekonomike pas viteve 90 në Shqipëri sollën ndryshime të rëndësishme ne strukturën ekonomike të shoqërisë, ne nivelin e jetese si dhe ne ekuilibrin gjinor i cili është përkeqësuar në disfavor te grave.

Gjate periudhës se tranzicionit Shqipëria ka bere ndryshime progresive ne lidhje me të drejtat dhe liritë e njeriut por kjo gjë nuk është reflektuar ne progres për të gjitha fenomenet e jetës sociale e ekonomike. Kështu mund të pohojmë se është thelluar pabarazia ekonomike dhe veçanërisht ajo ndërmjet burrave e grave.

2. Situata demografike dhe struktura gjinore

Popullsia e Shqipërisë pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur është një popullsi e re. Sipas INSTAT (*statistikat e vitit 2016*) mosha mesatare ne vendin tone ishte 37 vjeç. Gratë përbëjnë 49% të numrit të popullsisë kundrejt 51% qe zënë burrat. Ne se do ti referoheshim regjistrimit te bërë në 2011, popullsia urbane e cila është në rritje përfaqëson 53.7% të popullsisë ndërsa ajo rurale 46.3%.

3. Situata e tregut të punës

Ekzistenca e pabarazisë gjinore ndërmjet burrave dhe grave e ka bazën tek pabarazia ekonomike që është e lidhur ngushtë me punësimin. Nëse do të kërkojmë barazi ekonomike ndërmjet burrave dhe grave në radhe të pare duhet të garantojmë mundësi dhe punësim pa barriere ndërmjet tyre. Thënë në këtë mënyrë duket si paradoks. Po ti referohemi Kushtetutës se RSH dhe Kodit të punës ne te dyja theksohet barazia si një parim i rëndësishëm: E drejta e për pune dhe shpërbllim të barabartë. Po kur vjen puna ne terrenin konkret shohim që përpara grave ka një mal me arsye që i pengojnë të bëhen pjese aktive e tregut të punës;

Referuar anketës se Forcave të punës për vitin 2016 na rezulton le te hedhim një vështrim mbi tregun e punës :

Forca e punës është 1365000 vete ku meshkujt përfaqësojnë 56.2% dhe femrat 43.8% Kjo flet për hendekun ne punësim ndërmjet dy gjinive qe do pasqyrohet ne hendek ndërmjet te ardhurave.

Numri i të punësuarve ishte 1157000 ku 56.2% janë meshkuj dhe 43.8% janë femra

Të papunë 208000 ku meshkujt zënë 59% dhe femrat 41%

Shkalla e punësimit për grupmoshën 15-64 vjeç është 55.9%. Për meshkuj 61.9% dhe për femrat 49.7%. Hendeku gjinor është 12.2 pike përqindje. Në krahasim me vitin 2015 shkalla e punësimit është rritur me 6.5%.

Shkalla e papunësisë për grupmoshën 15-64 vjeç është 15.6%. Për meshkuj të kësaj grupmoshe shkalla e papunësisë është 16.4% dhe për femrat 14.6%, pra për meshkujt është 1.8 pikë përqindje më e lartë se femrat. Kjo tregon se meshkujt janë me aktive (pra janë në kërkim të një pune) se femrat.

Femrat kane një nivel më të lartë arsimor se meshkujt por kanë diferencë në paga, dmth kanë paga më të ulta. Për vitin 2016 hendeku gjinor në paga ishte 6%, pra meshkujt kanë një paga mesatare bruto më të lartë se femrat.

Femrat kryejnë 86% të punës së papaguar (punët në familjen bujqësore) në shkallë vendi dhe janë tërësisht përgjegjëse për detyrimet familjare.

Përqindja e punësimit është më e lartë në zonën qendrore dhe bregdet dhe më e ulët në zonat verilindore, gjë që tregon se femrat në këto rajone janë akoma më të disavantazhuara.

Në profesionet e ushtruara ka një ndarje specifike të tillë që: 50% e nr të punësuarve femra është e përqendruar 30% në profesione si specialist dhe 20% si punëtore shërbimi. Përqindja e lartë në profesionist/specialist lidhet me nr e femrave të punësuar në arsim dhe shëndetësi ku gratë janë dominante. Po kështu është i lartë edhe nr i grave që punojnë në bujqësi dhe veçanërisht në profesione fillestare siç është industria fason.

Ndërsa meshkujt kane % më të lartë në profesione si ligjvënës, punëtore në tregti, operatore impiantesh dhe makinerish që paguhën më shumë.

Duhet të përmendim një fakt interesant për vitet e fundi (Anketa 2016) : Në grup profesionet Drejtues, profesioniste dhe teknike që përfaqësojnë 17.7% të të punësuarve meshkujt kapin shifrën 15,3% ndërsa gratë 20.8%. Kjo ndoshta lidhet edhe me faktin që kemi një rritje të numrit të grave në poste drejtuese ekzekutive, duke filluar me Zv kryeministre dhe 7 ministre, me një numër të konsiderueshëm të grave zv.ministre, drejtore të përgjithshme, drejtuese drejtorish në ministri dhe institucione qendrore ,drejtuese institucionesh të nivelit të dy

E njëjta situatë paraqitet në tregun e punës edhe në Qarkun e Vlorës;

Në totalin e të papunëve 52.6% janë femra;

Në totalin e të papunëve të grupmoshës 16-29 vjeç (të rinjtë) 52.8% janë femra;

Në grupin e të papunëve që përfitojnë ndihme ekonomike 52% janë femra;

Në totalin e të papunëve të formuar në kurset e formimit profesional 25% janë femra.

• *Cilat janë disa nga arsyet e kësaj situatë*

1. Vajzave u mohohet shkollimi ,sidomos ne zonat rurale. Shumë prej tyre përfundojnë arsimin 9 vjeçar dhe këtu e mbyllin .Këtu ndikojnë shume faktorë ,mentaliteti,shkolla larg e pamundësia ekonomike etj

2. Ne zonat rurale gratë janë të angazhuara me punët ne shtëpi dhe ekonominë vetjake. Në të shumtën e rasteve ato bëjnë pune te papaguara. (punët e familjes bujqësore)

3. Mungesa e shërbimeve sociale si kopshte, çerdhe si dhe ambientet e përshtatshme e programet e riintegrimit të tyre në treg pas lejes se lindjes. Kjo e bën praktikisht të pamundur pjesëmarrjen e tyre në punë në periudhën kur kanë fëmijët të vegjël.

4. Mungojnë shërbimet mbështetëse për personat me problem ne familje si persona me aftësi të kufizuara, pleq etj të cilët nisur edhe nga mentaliteti i familjeve shqiptare kërkojnë shërbim vetëm nga femrat e familjes. Krijimi i këtyre shërbimeve do të bënte të mundur që gratë të bënin një planifikim me efikas ndërmjet kohës se punës dhe asaj në shërbim te familjes, pra punës se paguar dhe asaj te papaguar.

5. Mungesa e infrastrukturës, rrugë, ndriçim, transport publik në zonat periferike të qyteteve e qendrave të banuara..

6. Problematika që kanë të bëjnë me kushtet e punës dhe zbatimin e legjislacionit në fushën e punës penalizojnë më shumë gratë se burrat .

Duke njohur këtë situatë qeveria shqiptare ka ndërtuar strategjinë për pune dhe aftësi 2014-2020 **Aftësi me të larta dhe pune më të mirë për të gjithë femrat dhe meshkujt.**

4. Konkluzione dhe Rekomandime

Në këtë kuadër janë përcaktuar edhe masat që do të merren dhe që do të sjellin fuqizimin ekonomik te gruas.

Së pari : Duhet bërë përcaktimi i grupeve të cenushme dhe i barrierave me të cilat ato përballen me qëllim krijimin e kushteve në të cilat femrat dhe grupet në disavantazh mund të kontribuojnë në rritjen ekonomike..

Së dyti : Duhem marrë masa të posaçme praktike si dhe duhen evidentuar rezultatet e fuqizimit te grave meqenëse rritja ekonomike e qëndrueshme nuk mund te arrihet pa pjesëmarrjen e femrave si faktorë te barabarte ekonomik edhe si punëtore me page edhe si e vetëpunësuar dhe sipërmarrëse

Së treti : Te krijohen mekanizma të cilët sigurojnë qe përfitimet e shoqërisë nga reformat ekonomike te sjellin rrjedhoje të barabarte për gratë/vajza e burrat / djemtë.

Në një linje me Konventën kundër të gjitha formave te diskriminimit dhe normat e BE dhe Këshillit të Evropës, strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi do të ketë një kontribut te veçante në fuqizimin ekonomik te femrave dhe ngushtimin e hendekut gjinor duke ndjekur ndërhyrjet e mëposhtme :

1. Heqja e pengesave për gratë dhe vajzat kur flitet për mundësitë e qasjes në punësim dhe formim.
2. Krijimi i mundësive për femrat veçanërisht në zonat rurale që të marrin pjesë në tregun formal të punës.
3. Trajtimi dhe gjetja e shkaqeve që në rrënjë lidhur me pjesëmarrjen e ulët të femrave ne tregun e punës dhe korrigjimi i ndasive gjinore.
4. Fuqizimi i kapacitetit kombëtar për riintegrimin e objektivave që lidhen me barazinë gjinore ne praktikatat e hartuara, në shërbimet qe marrin parasysh faktorin gjini si dhe ne monitorimin e tyre,

Dhe derisa reflektojmë se si t'i tejkalojmë këto sfidat, barazia duhet të vazhdojë të jetë principi ynë udhëheqës. Gratë duhet të jenë të pranishme në mënyrë të barabartë në tavolinat vendimmarrëse, si në procese politike po ashtu edhe në bordet e korporatave. Në duhet që bashkërisht të rrisim edhe më tej zërin e grave për pjesëmarrje më të gjerë dhe rol më të madh në themelimin dhe kujdesin për bazamentin e një shoqërie të drejtë dhe me të drejta të barabarta.

Mariana CANI, lindur në 20 dhjetor 1957, në Vlorë. Diplomuar si Ekonomist i Specializuar për Ekonomi Politike, në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit të Tiranës. Ka kryer studime pasuniversitare në fushën e drejtësisë për pushtetin ekzekutiv me fokus në problemet juridike dhe menaxhuese të pushtetit ekzekutiv. Ka filluar karrierën si ekonomiste në Ndërmarrjen Riparim Shërbime, Vlore, më pas si mësime në Shkollën e Mesme Tregtare, Vlore. Ka punuar si Drejtor, Dega INSIG Vlorë, pedagoge e jashtme në Universiteti “Ismail Qemali”, Vlore. Ka njohuri shumë të mira të gjuhës ruse dhe italiane. Prej vitesh është aktiviste në OJF dhe forumin politik ku aderon. Ka mbajtur detyra të tilla si zv.Presidente e Shoqatës “Vatra e Gruas Vlonjate”; Anëtare e Këshillit Bashkiak, Vlorë, Anëtare e Këshillit të Qarkut, Vlorë. Aktualisht mban detyrën e Drejtorit, Drejtoria Rajonale e Shërbimit Kombëtar të Punësimit Vlorë.



IMPAKTI I BARAZISË GJINORE PËR NJË EKONOMI DHE ZHVILLIM SOCIAL TË QËNDRUESHËM

Olta GANAJ

*Drejtor, Shtëpia e Foshnjës Vlorë
oltaganaj@yahoo.it*

Abstrakt


*'M'u desh shumë kohë për të pasur një zë që të dëgjohet dhe tani që e kam,
nuk do të hesht', Madeleine Albright.*

Unë, gruaja me të drejtat e mia përpara ligjit, me konventat ndërkombëtare në mbrojtjen time, në fjalimet brilante të politikës... Por me një realitet sa kontradiktor, aq edhe diskriminues në jetën e përditshme. Unë e parë si pronë e dikujt ndër vite, genie e pavlerë dhe e paaftë, inferiore ndaj seksit të kundërt dhe e pazonja për të arritur suksesin. Gjithmonë në luftë me kohën, kompleksitetin dhe barrierat mendore për t'i treguar vetes, familjes dhe botës që Unë Gruaja ekzistoj, jam këtu përballë jush dhe jam e fortë për t'ja dalë mbanë. Ka patur shumë Lëvizje Feministe gjatë shek.XIX – XX, të cilat kanë patur në fokus të tyre fitimin e të drejtës së votës, punësimin dhe arsimimin e grave. Po sa është arritur barazia gjinore dhe edukimi gjinor në arsim? Integrimi gjinor është një tregues i zhvillimit social-ekonomik të një vendi. Arsimimi është një e drejtë themelore e çdo individi, i cili tregon më së miri arritjet e barazisë gjinore dhe zhvillimin që sjell më pas. Rritja e arsimit tek gratë dhe vajzat redukton ndjeshëm transmetimin e varfërisë nga brezi në brez dhe rrit kapacitetin e tyre për të kontribuar në aspektet sociale, ekonomike dhe politike të zhvillimit kombëtar. Ky është një aksion i madh social, i cili duhet të vijë nga shumë anë por mbi të gjitha është një betejë e cila duhet të fillojë nga vetë gruaja. Gratë duhet të jenë të vetëdijshme për rolin e tyre, si në familje ashtu edhe në shoqëri. Ato duhet të mendojnë ndryshe për veten dhe pozicionin në familje. Gratë duhet të ndërgjegjësohen se me arsimimin e tyre, nuk arrijnë vetëm t'u tregojnë të tjerëve aftësitë, por ato janë promotore të përmirësimit të shëndetit, të ushqyerjes dhe të edukimit në familje si dhe fuqizojnë pozitat e gruas në proceset e vendimmarrjes në shoqëri. Vendi ynë pas viteve 1990 ka bërë përpertime të dukshme, por ka akoma shumë për të bërë jo thjesht për t'u dhënë grave

një pozicion të barabartë me burrat, por për të përfutur si shoqëri nga gjithçka që një barazi e shëndetshme gjinore sjell me vete. Tashmë janë rrëzuar disa tabu, rënia e të cilave i ka hapur rrugë optimizimit për këtë proces, gruaja në jetën publike, gruaja në politikë. Edhe pse të gjithë kanë qenë e janë dakord, nga e thëna në të bërë është një hendek i madh. Aq sa duhej një ligj për barazinë gjinore, i cili të respektohej nga të gjithë. Rishtazi kemi parë barazi gjinore në këshillat bashkiak, deri diku në listat për deputet dhe në pozicione kyçe drejtimi dhe menaxhimi nga gratë. Kjo nuk është arritur nga dëshira e mirë e dikujt, por nga rritja e vetëbesimit të gruas, nga rritja e tyre profesionale dhe konkurrenca që ato paraqesin në jetën e një vendi. Vendet demokratike, vendet me zgjedhje dhe institucione që burojnë nga zgjedhjet, kanë një barazi gjinore të shëndetshme ku impakti i barazisë gjinore reflektohet në një ekonomi dhe zhvillim social të qëndrueshëm.

***Fjalë kyçe:** barazi gjinore, zhvillim social dh ekonomik i qëndrueshëm, arsimim i gruas.*

Olta GANAJ, lindur në Vlorë, më 02 Mars 1982. Diplomuar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Shkencave Sociale me titullin Psikologe Klinikiste. Perfundon studimet postgraduate në 2014 masteri i shkencave. Gjatë kësaj periudhe ka marrë pjesë në trajnime të ndryshme nga UNICEF, SAVE THE CHILDREN, TERRE DES HOMMES, AMICI DEI BAMBINI, MSHMS mbi standardet e shërbimeve sociale dhe komunikimit nëpërmjet lojës dhe të nxënimit me fëmijët në nevojë, specifikisht me fëmijët e institucioneve të përkujdesit social. Kurs mbi formimin profesional bazuar në kuadrin ligjor dhe institucional për zbatimin e politikave të përfshirjes sociale të hartuara për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve. Trajnime në lidhje me çështjet e zhvillimit të fëmijëve dhe puna me fëmijët me aftësi të kufizuara. Në kuadër të ndryshimeve ligjore për të drejtat e fëmijëve dhe mbrojtjen e tyre, pjesëmarrëse në trajnimin e paketës burimore për monitorimin dhe inspektimin me pjesëmarrjen e fëmijëve dhe standardet për fëmijët në situatë rruge. Në bashkëpunim me Cooperazione Italiana dhe ekspert të fushës sociale të Regione Marche si pjesë e grupit të punës për hartimin dhe më pas vënien në zbatim të Planit Social për të Miturit të Bashkisë Vlorë për vitin 2009 e në vazhdim pjesë e tryezave për Planin Social të Bashkisë Vlorë në bazë të dinamikës së zhvillimit social. Aktualisht mban pozicionin e Drejtore të Shtëpisë së Foshnjës Vlorë që prej Qershorit të 2007.



GRUAJA DHE DIMENSIONI I SAJ NË KOHË

Aida ALLUSHI

*Mësuese e gjuhës angleze “Muço Delo” Vlorë, Shqipëri
ida.alushi@gmail.com*

Abstrakt

Sot gratë kanë provuar se mund të jenë të barabarta me burrat. Me kalimin e kohës ato tashmë e kanë lënë pas imazhin e tyre të ‘shtëpiakes’ dhe çdo ditë e më shumë po kontribuojnë në zhvillimin e shoqërisë. Roli i saj i dyfishtë si ‘femër’ dhe ‘nënë’ e bën atë të ketë më shumë përgjegjësi se burrat. Progresi i arritur nga gratë nuk është arritur thjesht nga simpatia apo mbështetja e dhënë, por nga përpjekjet e vazhdueshme të tyre. Gruaja është i vetmi person që ka treguar se mund t’ia dalë mbanë si në punë, shoqëri, familje, duke u përballur me sfida, duke marrë mbi vete përgjegjësi si dhe duke mos u ndalur së faluri e ofruari energji e dashuri. Kjo i ka bërë ato të kenë vendin e tyre kudo duke se janë të afta e të prera në marrjen e vendimeve, përgjegjësi të sakta e të paanshme në gjykim. Nuk është gjinia ajo që përcakton suksesin e një profesioni por intelijenca dhe aftësia për të përmbushur të plotë detyrimet që kërkohen në çdo profesion. Prandaj ato duhet të mbështeten në kapacitetet e tyre për të konkurruar si të barabarta me burrat.

Fjalë kyçe: grua, dimensionin kohë, barazi gjinore, roli i gruas.

1. Barazia gjinore

Mëmësia nënkupton të jesh qendra e jetës së fëmijës duke shpenzuar kohë dhe energji në rritjen e tij duke anashkaluar dhe sakrifikuar nevojat e veta. Barazia në familje, largimi i rolit të gruas nga thjesht një edukatore e fëmijëve dhe amvisë duke kaluar pjesën më të madhe të kohës në familje, por edhe barazia në familje

e vendimmarrje janë hapat e parë drejt forcimit të rolit të saj, si dhe shembulli më i mirë për t'u ndjekur prej fëmijëve apo dhe shoqërisë. Një fëmijë i edukuar mirë prej saj është një e ardhme e sigurt për vendin. Edukimi sa më i mirë i nënës tek meshkujt kthehet në respekt për femrën kur rriten, në emancipimin e tij dhe zhvillim për shoqërinë. Roli i nënës në familje dhe ekuivalentimi i rëndësisë se këtij roli në shoqëri është lufta e përditshme që femrat zhvillojnë sot.

‘Çdo grua që i kupton problemet e drejtimit të një shtëpie do të jetë më e aftë për të kuptuar problemet e drejtimit të një vendi.’ - **Margaret Theçër**.

Emancipimi i gruas është hapi i parë drejt pozicionimit të saj në shoqëri.

Gjithmonë ka ekzistuar ideja se midis burrave e grave ka shumë ndryshime të cilat shpesh janë konsideruar si të pakapërcyeshme. Madje gratë janë konsideruar më pak inteligjente se burrat thjesht për faktin se ato nuk kanë patur të njëjtat mundësi punësimi dhe zhvillimi në shoqëri sikurse burrat. Por tani është bërë e qartë se ndryshimi midis burrit e gruas ka qenë thjesht pjesë e kulturës dhe edukatës së shoqërisë sonë. Koha tregoi se kur grave u jepet mundësia, ato dinë të shpalosin gjithë kapacitetin e tyre në fusha të ndryshme. Gratë janë të afta të punojnë në çdo profesion madje në disa prej tyre ato mund të jene shume me te afta se burrat. Pavarësia ekonomike e promovon dhe e çon gruan drejt një barazie gjinore si dhe ndarjes së përgjegjësive brenda familjes. Janë nënat ato që duhet të pranojnë rolin prindëror të bashkëshortëve e të tyre si të barabartë me to. Nëse burrat nuk do të pranojnë këtë rol aq me pak mund të pranojnë barazinë në punë e në pagese me gratë. (*Esping-Andersen, 2009; Goldscheider, 2010*). Roli i ri i femrës dhe rritja e dimensionit të saj në pavarësi ekonomike dhe në marrjen e përgjegjësive të cilat me parë i përkisnin vetëm burrave çoi në ndarjen të barabartë të përgjegjësive. Megjithatë kjo rritje e rolit të tyre nuk shoqërohet me barazinë e pagesës mes tyre (*Bianchi et al., 2000; Anxo et al., 2011; OECD 2012*). Zvogëlimi i diferencës gjinore për punën e papaguar është për shkak të grave që investojnë më pak kohë në punët e shtëpisë, duke marrë parasysh përfshirjen e tyre më të madhe në punën e paguar, sesa për shkak të një rritjeje të konsiderueshme të kontributit të punës së meshkujve (*Sayer et al., 2004; Craig & Mullan, 2010; 2011*).

Sipas të dhënave të viteve të fundit numri më i madh i studenteve në universitet shqiptare janë femra krahasuar me numrin e djemve por vetëm një pjesë e vogël e tyre kërkojnë punë apo gjejnë mundësi punësimi në profesionin e tyre apo edhe sipas meritave dhe aftësive që kanë. Kalvari i gruas në karriere ka qenë përherë i gjatë e i mundimshëm. Të rralla kanë qenë rastet kur ato kanë udhëhequr, marr çmime apo tituj, madje kur një grua në karriere ka spikatur apo kur i është dëgjuar zëri ajo është emërtuar si ‘e hekurt’. Rastet kur femrat nuk ia kanë dalë dot kurrsesi nuk duhen të quhen dështime por duhet të merren si sfida. Në mund të bëjmë gjithçka që bëjnë burrat por ata nuk mund të bëjnë dot gjithçka që ne bëjmë

. Nuk duhet harruar se asgjë nuk është arritur pa mund , përpjekje e lufte duke nisur që nga e drejta e votës e deri tek e drejta për të shprehur e aplikuar njohuritë dhe dijet tona në fusha ku mund të kontribuojmë më mirë. Nëse kthehemi prapa në kohë, shohim se gratë janë përballur me shumë padrejtësi dhe kanë luftuar fort për të fituar të drejtat e tyre. Gruaja është konsideruar si ‘e pazonja’ për të arritur suksesin. Disa gra zgjodhën karrierën e tyre si një mjet mbështetës financiar, të tjera si domosdoshmëri për mbijetesë, disa u braktisën plotësisht nga burrat e tyre, kurse disa zgjodhën të mos martohen për të patur mundësi të bënin karrierë . Disa iu nënshtruan faktit se mund të jetohet vetëm me rrogën e burrit apo se duhet të kesh lejen e bashkëshortit për të punuar duke u varur prej tyre pa patur mundësi të tregojnë se sa ato vlejné vërtet. Kur gruaja përpiket te jap kontributin e saj ajo përballet më shume problem që kërkojnë kurajo, vetëbesim dhe vullnet të fortë. Ajo është parë si një qenie që qëndron në krah të burrit. Disa nga pengesat që gruaja ndesh në karriere lidhen ngushtë me pamjen , moralin dhe rolin e saj në shoqëri. Shpesh në profesionet që bazohen kryesisht ne punën e gruas vendosen limite moshe gjë që nuk ndeshet në asnjë prej profesioneve ku mbizotërojnë burrat. Burrat shpesh kanë konsideruar punën e gruas si një pengesë në mbarëvajtjen e familjes ndonëse është e qartë se roli i saj tregon se ajo është një menaxhere e shkëlqyer. Rrallë do të gjeni burra të cilët i kanë inkurajuar gratë të ndjekin ëndrrat e tyre për të qenë një grua në karriere e për të treguar vlerat e tyre. Ishte pothuajse e paimagjinueshme të mendoje se femrat do të kishim mundësinë t’i shihnim si deputete, ministre apo drejtuese institucionesh të rëndësishme të shtetit. Sot ato janë kudo, madje mund fare mirë të konkurrojnë edhe për president të një shteti, kryeministre apo edhe kryeparlamentare .

2. Roli i gruas sot

Ka disa fusha ku roli i gruas në vendin tonë ka nisur të ndihet dhe të vlerësohet ashtu si duhet. Le të marrim rastin e sistemin tonë arsimor ku vitet e fundit është vërejtur një fenomen që duhet përshëndetur. Vetëm disa vite më parë drejtorët e nëndrejtorët e shkollave i shin kryesisht meshkuj (ndonëse numri i mësueseve femra ishte shume me I madh) , pasi roli i tyre lidhej ngushtë thjesht me disiplinën. Sot kjo shifër ka ndryshuar ndjeshëm duke bërë që numri i drejtoreshave femra të rritet.

Ato kanë treguar se jo vetëm mund ta bëjnë këtë detyrë por kanë arritur të drejtojnë shkollat që renditen si më mirat në qytet bazuar në kartën e performancës, ashtu sikurse dhe të udhëheqin reformat në arsim si baza për ndryshimin e shoqërisë dhe të së ardhmes e cila nis nga bankat e shkollës. Mësuesit janë heronjtë, frymëzuesit dhe ata që udhëheqin drejt një botë të re. Ata janë simboli i frymëzimit, përkujdesjes, punës dhe sakrificës duke u përballur me sfida në çdo

kohë. Është i vetmi profesion ku femra shfaqet në të gjithë dimensionin e saj si: nënë, psikologe, prind e mike duke treguar gjithë fuqinë e saj

3. Konkluzione

Barazimi i rolit të gruas me burrin në ditët e sotme nuk mund të arrihet veçse duke forcuar rolin e gruas në shoqëri. Kjo gjë mund të arrihet në shumë mënyra por ajo me e spikatura është duke u angazhuar në çështje me interes në shoqëri. “Unë e ngre zërin-jo që të bërtas, por që, ata që nuk kanë mundësi të shprehen, të mund të dëgjohen ne nuk mund të kemi sukses kur gjysma prej nesh ngurojnë.”- Malala Yousafzai, fituese e çmimit Nobel.

Duke insistuar e mos dekurajuar do të kemi mundësinë të tregojmë sa vlejme si dhe do ti japim rëndësinë e duhur rolit tonë në shoqëri. Nuk kemi përse të presim që të aprovohen ligje për barazinë gjinore për të kërkuar vendin tonë në shoqëri. Çdo grua duhet ta kuptojë se asgjë nuk është e pamundur e as nuk dhurohet në jetë. Jeta është një libër ku vetë je autori i saj. Kujdesu që ta shkruash sa më bukur atë.

4. Referenca

- Esping-Andersen, G. (2009). *The Incomplete Revolution: Adapting to Women's New Roles*. Cambridge: Policy Press.
- Goldscheider, F., Olah, L.S., & Puur, A. (2010). *Reconciling studies of men's gender attitudes and fertility: Response to Westoff and Higgins*. *Demographic Research*, 22(1), 189-197.
- Craig, L., & Mullan, K. (2010). *Parenthood, Gender and Work-Family Time in the United States, Australia, Italy, France and Denmark*. *Journal of Marriage and the Family*, 72 (October 2010),
- Craig, L., & Mullan, K. (2011). *How Mothers and Fathers Share Child-care: A Cross-National Time-Use Comparison*. *American Sociological Review*,
- Gash, V. (2009). *Sacrificing their Careers for their Families? An analysis of the penalty to motherhood in Europe*. *Social Indicators Research*, 93, 569-586.

Aida ALLUSHI, lindur në Vlorë, më 02.04.1979. Diplomuar në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë për anglisht, ndërsa studimet pasuniversitare i ka kryer në po këtë universitet për Përkthim dhe Interpretim. Ka filluar karrierën si Mesuese e gjuhës angleze në shkollën 9 vjeçare “Muço Delo” Vlorë ku dhe vazhdon aktualisht të jetë mësime të aty, si dhe në të njëjtën kohë ka punaur si pedagoge e jashtme në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë. Gjithashtu rendit disa eksperiencia profesionale si trajnuuese e mësuesve të gjuhës angleze pranë DAR, Vlorë; si interprete me grupin e vëzhguesve të OSBE- ODHIR për zgjedhjet parlamentare; drejtuese e rrjetit profesional të gjuhës së huaj në qarqun Vlorë. Pjesëmarrëse në shumë konferenca të ELTA’s në lidhje me metodat e mësime të aty. Është përfshirë në disa projekte të organizuara nga MAS, UNDO, ELTA, ISSETI, WFL, British Council etj., si “Projekti për një Anglishte Globale”, “Dimesioni gjinor në tekstet parashkollore”, “Fuqizimi i mësuesve nëpërmjet metodave të reja në klasë”, “Integrimi i TIK në mësime të aty”, “Anglishtja në klasat e së ardhmes”. Zhvillimi profesional në mësime të aty e gjuhës angleze si një gjuhë e huaj”, “Të mësosh anglisht në botën e re”, “Mësime të aty e anglishtes në dekadën e re”, “Gjuha angleze dhe komuniteti”, “Faktorët që ndikojnë në procesin kërkimor të përkthimit”. Përveç gjuhës angleze zotëron dhe gjuhën italiane.



LETËRSIA E PËRTEJME DHE ROLI I UNIVERSIT FEMËROR

Albana LULA

Shkrimtare, Anëtare e Klubit të Shkrimtarëve "Petro Marko"
alba8186@yahoo.it

Abstrakt

Universi femëror, është folur kaq shumë për të, shumë flitet, shumë do të flitet akoma, mbetet për tu parë si? Universi femëror është shumë dimensional, është i mrekullueshëm, me nuanca ngjyrash pafund, duket kaq i prekshëm, kaq i afërt, një botë e vogël, perfekte, por njëkohësisht është edhe i largët, duke u bërë gati i paprekshëm. Askund më bukur se aty, mund të gërshetohen e shkuara e largët, e tashmja dhe e ardhmja, dhimbja dhe shpresa, durimi dhe forca, jeta dhe vdekja. Është e vështirë të rrefesh historinë e secilit zë femëror, sepse ata janë të ndryshëm, sepse çdo grua është e ndryshme. Poezia është grua, ka qenë përherë e tillë. Në traditën e lashtë greke, romake, ilire, ajo ka qenë përherë aty, aq shumë saqë universi femëror ngatërrohej shpesh me krijimin e vetë poezisë, me thelbin e saj duke u shkrirë në një të vetme. Gruaja shkruan për të mos harruar, për të mos hequr dorë nga kujtimet, shkruan për ti ulëritur botës mbarë padrejtësitë, shkruan për të nxjerrë në dritë mundësi ndryshimi, shkruan për të vënë në dukje kushtet e jetës së një gruaje, që shpesh herë mundohen të fshehin, shkruan për të mos hequr dorë nga ëndrrat, shkruan për të jetuar. Letërsia e përtejme shndërrohet në tokën e amëshuar ku të gjithë duan të shkojnë.

***Fjalë kyçe:** Grua, univers femëror, poezi,*

Për shekuj me radhë gruaja është parë si objekt i krijimit të poezisë, si një objekt i bukur për tu ekspozuar, është lënë gjatë në hije, por hija nuk i ka hije gruas, sepse ajo shkëlqen prej një dritë qiellore, ajo ka vendin e saj në këtë botë. Sot flaka e vargjeve të një gruaje po ndriçon gjithmonë e më shumë. Gruaja është poezi, gruaja është grua brenda poezisë dhe jashtë saj. Magjia e fjalëve të saj, mënyra

si çdo varg depërton thellë në shpirt është e mrekullueshme. Toka është grua, bota është grua, vetë jeta është grua. Gruaja ka fuqinë për të krijuar mrekullinë dhe fjalët e duhura për ta rrëfyer atë. Është e vështirë të analizosh shpirtin e një gruaje nëpërmjet letërsisë së përtejme, asaj letërsie që shkon përtej kufijve, përtej gjuhëve, përtej kulturave, përtej etnive dhe feve. Është pikërisht letërsia e përtejme, ajo që i kalon kufijtë e shkruar e të pashkruar, që e lejon gruan të flasë për historinë e jetës së saj, për tokën e djegur të shpirtit të saj, për dhimbje gjymtyrësh të rraskapitur që enden tunelesh të vetmuar, për identitetin e mohuar, për kohën e pakohë të vendeve aq shumë të dashur, dhimbshëm të humbur, e lejon të flasë për veten, aq sa rrëfimi shndërrohet në shtëpinë e saj. Ajo shfaqet tërësisht e zhveshur nga gjithçka, me shpirtin e ndriçuar, aty ku shpesh fjalët për të kaluar kufijtë e një gjuhe tjetër, të një kulture tjetër, mungojnë. Nëpërmjet fjalës së shkruar, gruaja dëshiron të shërojë historinë e jetës së saj të copëzuar. Është pikërisht aty, historia e një jete, përgjatë një udhëtimi, që në fleta të bardha merr formë. Përtej botës së njohur, ekziston një tjetër botë e panjohur, një botë e mundur ku anije të mbushura me dhimbje përplasen shkëmbinjve të thepisur, ku hidhet poshtë e bardha dhe e zeza, për ti shpëtuar boshit dhe për të ndjerë plotinë, ku zbrazen shpirtin të mbushur me gjak dhe ujë, për tu rimbushur me ngjyra rrëzëllitëse, ku kristale lotësh përvëlues, djegin shpirtin. Fuqia e fjalës së shkruar të një gruaje, dëshmitare e një tmerri pafund, shkon përtej pështjellimit fillestar dhe i jep zë heshtjes së verbër, indiferencës vrasëse.

Gruaja shkruan, gratë shkruajnë dhe mund ti përziejnë të gjitha gjuhët e botës nëse është e nevojshme, për të krijuar ura lidhëse, për të kaluar përtej boshit, përtej kaosit, për të treguar rrugën e mundimshme të të shkruarit, e vetmja rrugë e cila mund të rrëzojë mure, i vetmi port i sigurt ku mund të ankorohen anije shprese. Gruaja shkruan për veten, për të rrëmbyer të drejtën për ti thënë botës "Unë jam pjesë e jotja, e pandarë!" Gruaja shkruan duke gdhendur me fjalë ashpërsinë e atyre kufijve shpesh në dukje të pakapërcyeshëm, traumën e atij udhëtimi duke ju arratisur një kohe të pakohë, ajo shkruan duke u gjendur shpesh mes asaj që thuhet dhe nuk thuhet, mes gjuhës së saj dhe një tjetre, mes kulturës së saj dhe një tjetre. Gruaja shkruan për të mos harruar, për të mos hequr dorë nga kujtimet, shkruan për ti ulëritur botës mbarë padrejtësitë, shkruan për të nxjerrë në dritë mundësi ndryshimi, shkruan për të vënë në dukje kushtet e jetës së një gruaje, që shpesh herë mundohen të fshehin, shkruan për të mos hequr dorë nga ëndrrat, shkruan për të jetuar. Letërsia e përtejme shndërrohet në tokën e amshuar ku të gjithë duan të shkojnë.

Albana Lula, ka lindur në tetor të vitit 1981, në qytetin e Vlorës. Shkollën e mesme e ka mbaruar në gjimnazin “*Ali Demi*”. Arsimin e lartë e ka marrë midis Universitetit “*Gabriele D’Annunzio*” Pescara dhe Universitetit “*Ismail Qemali*” Vlorë duke u diplomuar në Administrim Biznes. E dashuruar pafundësisht me detin, i cili është pjesë e pandashme e poezive të saj, ka botuar 3 vëllime me poezi. Botimi “*Mësomë të qesh*” i vitit 2003, ishte i pari që e hodhi në rrugën e mundimshme, por edhe të mrekullushme të poezisë. Në vitin 2007 vjen vëllimi i dytë me poezi i titulluar “*Takim me heshtjen*”. Shtëpia botuese Toena në vitin 2009 do të jetë ajo që do të botojë vëllimin e tretë me poezi në dy gjuhë, shqip dhe italisht të titulluar “*Stinë e çmendur/ Folle stagione*”. Në vitin 2011 do të provojë veten me një tjetër zhanër, atë të prozës, duke botuar sërish tek Toena, “*Natë e pafund*” novela. Është anëtare e Klubit të shkrimtarëve “*Petro Marko*” prej më se dhjetë vitesh.



ARSIMIM, PASION, PËRQËNDRIM, ANGAZHIM PËR TË RRITUR ROLIN E GRUAS NË SHOQËRI

Christine TORRES

*Vullnetare e Korpusit të Paqes, Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Qarku Vlorë
christinetorres46@yahoo.com*

Abstrakt

Nuk ka pasur një kohë më kritike për udhëheqjen e grave të kualifikuara si në shoqërinë globale komplekse të sotme. Ndërsa kriza e re lind, zërat e qartë dhe të fortë të grave të arsimuara duhet të mbahen parasysh. Pozita e grave profesionale në Vlorë duhet të përcaktohet qartë dhe komuniteti duhet të kuptojë se kontributet e tyre do të jenë plani për të ardhmen.

Nëse të gjitha aspektet e shoqërisë civile duhet të përfaqësohen nga zyrat publike, duhet të dëgjohen të gjitha zërat. Gratë paraqesin perspektiva unike - duhet të pranohen përvojat e grave të cilat kanë formime të ndryshme. Është me rëndësi që të jepen mbështetje për mendimet e të moshuarve, të rinjve, të profesionistëve dhe të pakualifikuarve. Gratë që kanë status dhe pushtet ,në komunitet, janë lidere të dukshme, por të gjithë zërave duhet t'u jepet mundësia të jenë pjesë e strukturës së përbashkët sociale.

Për të arritur këtë zë të vetëm përfaqësues, në radhë të parë midis kualifikimeve të nevojshme është thelbësor një edukim me baza. Duke pasur parasysh fokusin e shoqërisë në përgjithësi, arsimimi është padyshim çelësi më i madh për lidership-in e suksesshëm. Nëse shqyrtojmë rolet e grave në shoqërinë e sotme, shohim se ato që drejtojnë janë në mënyrë të pashmangshme profesionistet e mirëarsimuara, të cilat kanë kontribuar me sukses duke përkushtuar kohë dhe përpjekje për të përmirësuar mjedisin e tyre të menjëhershëm.

***Fjalë kyçe:** grua, edukim, pasion, fokus, realizim.*

1. Introduction

There has not been a more critical time for the leadership of qualified women as in today's complex global society. As new crises arise, the clear and strong voices of educated women must be heeded. The position of professional women in Vlore must be clearly defined, and the community must realize that their contributions will be the plan for the future.

If all aspects of civil society are to be represented by public offices, all voices must be heard. Women present unique perspectives – the experiences of women of all backgrounds must be acknowledged. It is vital that the opinions of the elderly, young, professional and unskilled be given support. The women of status and power in the community are the obvious leaders, but all voices must be given the opportunity to be part of the common social fabric.

To achieve this single representative voice, first and foremost among the needed qualifications is the absolute imperative of a fundamental education. Given the focus of society in general, it is without a doubt the greatest key to successful leadership. If we examine the roles of women in today's society, we see that those who provide guidance are inevitably the well-educated professionals who have successfully contributed time and effort to bettering their immediate surroundings. We can define these roles in four important phases:

- Education
- Passion
- Focus
- Commitment

2. Education

Genuine achievement in educational systems is recognized globally as the answer to many of the world's most critical problems: poverty, hunger and violence. As each of these issues are devastating large swathes of cultures and various societies, the realization is growing that these fundamental ills can only be healed by the dedication of educated individuals on the community and national stage.

Leaving women out of the national conversation is a critical error. All perspectives should be valued as having some credence – even those not on the professional level. Finding those voices and educating them can only make the conversation stronger and louder. Women must be given the opportunity to have their passions directed to the best possible outcome.

Some reports have concluded that women and girls are more likely to suffer from poverty, hunger and illiteracy than men and boys. Wherever the illiteracy rates for girls and women is higher, poverty and hunger rates are also higher. Education is key for women not only economically, but to release from them the most severe cases of social repression. Where girls and women are taught to read, receive basic education and are encouraged to pursue higher academics, the community itself benefits. In very strong language, depriving half the population of education is tantamount to self-destruction.

Achieving gender equality, both economically and socially, should be a high priority for the women leaders in any community. It is an investment in their own society that pays benefits for years to come. Professional women may understand all too well the conditions of repression that are the results of women not being able to sustain their educations. Societies that harbor conservative norms for women and girls are not the economic leaders of the world – they are endlessly entangled in poverty and lack of positive structure. Since many successful women have achieved their leadership roles through struggle and against social odds, they are the ones who should recognize the need most of all for a sound education for women. As quality and quantity of educational prospects are presented, the professional woman's guidance is a vital benefit of their own experiences. The fitness and quality of tomorrow's leaders falls on the shoulders of the dynamic and forthright role models of this community.

3. Passion

All too often overlooked in the cold light of academic education is the personal passion that can propel an eager young mind from status quo to singular achievement. A leader displays an energy level that supersedes those who are merely qualified. This type of enthusiasm maximizes all the potential of a young or mature woman. Emotions are often used to disqualify women from certain endeavors, the old thought being that emotion and passion have no value to the workplace. On the contrary, the passion of a committed individual is a pure demonstration of pride and a signal of the complete involvement that success often demands. Consider a charismatic leader, someone whose passion and drive are undeniable. She lifts up her co-workers, subordinates and associates by her belief in her work.

Believing in a cause and demonstrating that belief is only possible by someone who is truly enthusiastic, informed and educated about the issue before them – it cannot be manufactured at will. People are motivated by internal and external causes – these are forces that define a character and produce results and solutions. Understanding and recognizing these forces in women lays the groundwork for evolving relationships, and can establish useful platforms for future endeavors.

Internal motivation is passion personified. A strong will can be an effective means of achieving unique civil goals: what might be considered a highly personal initiative needs to be evaluated based on its merit. Women who have pursued passionate goals may not have the expertise to turn their dreams into reality, and the ability to combine this energy with obvious potential should be nursed to fruition. The support networks that successful women often cite as a foundation of their success are far more valuable than desire alone.

Externally driven passion is encouraged by outside forces. Seeing a wrong and righting it is a simplistic but true statement. As most communities struggle to find their ways through past errors and future uncertainties, a leader who can identify a need and involve herself completely in all the ramifications associated with it will undoubtedly succeed where a less passionate individual could be overwhelmed by it. This type of passionate nature is often identified with women – those who have a solid background in community involvement, are educated in the issues involved and have a clear understanding of how to get the best from her associates should be in leadership positions. This passion, in the hands of someone who is truly and honestly certain of her abilities, should be appreciated in its fullest potential.

4. Focus

Consider a handful of issues facing women today: sexual harassment, career opportunities, equal pay, and family-work balance. Where do you start to address these issues? How do you sustain a continuum of forward thinking solutions? The answer in many cases is focus. Despite the many achievements of modern women, we still face many obstacles. When speaking of empowerment, the general observation is of a starved population suddenly over-run with possibilities. How to make those possibilities concrete is the issue, and the answer is focus.

Issues facing women today are often concerned with the failures of society – violence in the home, opportunities lost due to gender, lack of political strength. To turn failures into sustainable successes, focusing on the positive rather than negative make-up of the issue is vital. Negative energy blocks problem solving and team building; focus gives import to details, opinion and results. The lack of focus is often given as a reason for project failure, and it wastes precious time in the process. Focus allows you to work your way through obstacles, roadblocks that would otherwise prohibit active problem solving. A persistent, determined and focused leader guarantees that failure is never the final result. Flexibility is not a forgotten asset: focus does not mean rigidity. When adversity over-shadows achievement, a steady focus on all positive aspects of a community or social issue will present workable solutions.

5. Commitment

The word commitment suggests purpose, intention and direction. When suggesting a long-term action plan, the word commitment indicates a project has the necessary components to be a success. In civil engagement, a leader is committed to the best practice in serving her community. A leader's intentions are made public, clearly demonstrating the nature of the issue and the work necessary to achieve the desired results. Commitment cannot be short-sighted. It is by definition a promise, agreed to and accepted by all parties involved. A discussion of commitment often includes the word strength – a leader is measured by their commitment and strength, although it is commonly misused in hopeful agreements. A commitment cannot be half a pledge, it must make clear that only a fully involved individual, committee or organization is accepting the responsibility for a promise. Such strength is an asset in any situation, but particularly when it is used to tread the tricky path of social inequality.

A community leader will be tested on her commitment in the face of great odds. This promise will be revisited throughout the course of a campaign, during a project or in the scrutiny of some aspect of community involvement. What can be changed will be, what can be improved, should be. As qualifications are scrutinized and growth is debated, a woman in public life is sure to be questioned. Having the focus, passion and commitment necessary to meet contemporary needs will be the hallmark of our next group of professional leaders. Education is an unquestioned attribute for any kind of success, and especially so for contemporary women who undertake the betterment of society. Understanding these concepts and employing them to their fullest capability is a crucial step for enhancing the lives of women everywhere.

Christine TORRES, lindur 25 Dhjetor 1950 në Kaliforni, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Është diplomuar për Art, Letërsi Angleze, profil minor psikologji, në Universitetin Shtetëror të Kalifornisë. Ka kryer disa trajnime dhe specializime në Institutin e Kulinarisë së Amerikës, në Hyde Park Nju Jork, kurse formimi në historitë dhe kulturë spanjolle në CSU Fullerton mbajtur në Barcelonë të Spanjës. Ka punuar si asistente dhe konsulente në disa insitucione dhe agjensi, si dhe numëron një sërë përvojash si vullnetare në vende të ndryshme. Aktualisht është vullnetare e Korpusit të Paqes pranë Dhomës së Tregtësisë dhe Industrisë në Qarkun Vlorë.



ZGJERIMI I ROLIT TË GRUAS PËR ZHVILLIMIN TËRËSOR TË SHOQËRISË.

Doela HOXHAIJ

*Presidente në gjimnazin “Ali Demi” Vlorë, deputete në Parlamentin Rinor Vlorë
hoxhajdoela@gmail.com*

Abstrakt

Shoqëria shqiptare është një shoqëri e cila ndikohet ende nga mentaliteti i vjetër dhe i prapambetur që vendos në drejtim të shoqërisë maskilizmin, si term kryesor dhe i vyer për mbarëvajtjen e rregullave të këtij të fundit, rregulla këto jo në barazim, drejtësi të plotë pasi çënojnë të drejtat e gjinisë femërore.

Pjesëmarrja e grave në çdo fushë të formimit të karrierës është shumë e rëndësishme, por theksi në këtë punim është vënë më shumë në angazhimin e grave në politikë. Të merresh me politikë është një detyrë shumë e rëndësishme pasi ndërmer veprime të cilat ndikojnë në zhvillimin e vendit. Megjithatë, ende gratë janë të papërfaqësuar plotësisht në shumicën e legjislativave demokratike dhe jo vetëm në Shqipëri.

Analizimi i të dhënave statistikore ka nxjerrë rezultate mbi aftësitë e femrave dhe se si perceptohen këto aftësi nga të dyja seksjet, por gjithashtu vënë dukje edhe dobësitë e femrave sidomos në vendimmarrje dhe vetëvlerësimin.

Në qoftë se gratë do të njohin plotësisht potencialin e tyre dhe luftojnë për të shfaqur çdo pjesë dinjitoze të tij, atëherë sigurisht, që shoqëria jonë, Shqipëria do të bëhet një vend më i mirë.

Fjalë kyçe: seksizmi, angazhimi politik, diversitet, simbiozë gjinore.

“Çdo grua që kupton problemet e mbarëvajtjes së një shtëpie është shumë më afër kuptimit të problemeve të mbarëvajtjes së një vendi.”- është shprehur Margaret Thatcher, duke theksuar mjeshtërisht në një fjali të vetme aftësitë e papërsëritshme të gruas, që nga ekuilibri i drejtë, aftësia për përshtatje, detyrat e shumta, ndjeshmëria dhe shpirti i lidërsipit.

Shoqëria shqiptare është një shoqëri e cila ndikohet ende nga mentaliteti i vjetër dhe i prapambetur që vendos në drejtim të shoqërisë maskilizmin, si term kryesor dhe i vyer për mbarëvajtjen e rregullave të këtij të fundit, rregulla këto jo në barazim, drejtësi të plotë pasi cënojnë të drejtat e gjinisë femërore.

Sigurisht që pas tranzicionit të sistemit nga ai monopartiak në një sistem poli-partiak demokratik në realitetin e vështirë shqiptar, vajzat dhe gratë filluan të jenë pjesë aktive e jetës sociale dhe jo vetëm, në Shqipëri, edhe pse me ritme të ngadalta, por frytet e produktivitetit filluan të çelnin pak nga pak.

Ndryshimi i parë dhe themelor për barazinë gjinore dhe për të lejuar vajzat dhe gratë të jenë individë të shëndetshëm dhe aktive në vendimmarrje, ishte dallimi i përdorimit të termave ‘femër’ dhe ‘vajzë/grua’. Përodrimi i termit ‘femër’ është një term seksist, ndërsa përdorimi i termave ‘vajzë/grua’ është term i cili përcakton drejtë fillesat e barazisë gjinore.

Ndryshimi më pas filloi të ndihëj në pjesëmarrjen në arsim dhe rritja e kërkesave për vende pune. Në këtë moment arrijmë të kuptojmë dhe ndërgjegjësimin e vetë vajzave dhe grave për rëndësinë dhe potencialin që ato kanë. Angazhimi në jetën politike në vend ka qenë gjithashtu një çast themelor dhe vendimtar i cili na paraprin se në vitet e ardhshme do të kemi një shoqëri me vajza dhe gra më aktive, të arsimuara dhe të suksesshme në fusha të ndryshme.

Pjesëmarrja e grave në çdo fushë të formimit të karrierës është shumë e rëndësishme, por unë do të doja ta vendosja theksin në angazhimin e grave në politikë. Të merresh me politikë është një detyrë shumë e rëndësishme pasi ndërmerr vepërime të cilat ndikojnë në zhvillimin e vendit. Megjithatë, ende gratë janë të papërfaqësuar plotësisht në shumicën e legjislaturave demokratike.

Në demokracinë “përfaqësuese” është jetësore që çdo pjesë e popullsisë të përfaqësohet proporcionalisht. Mungesa e tanishme e zërave femërorë në parlament simbolizon paragjykimin e vazhdueshëm të pandërgjegjshëm shoqëror. Politikanët gra duhet të preferohen njësoj si politikanët meshkuj, sepse në parlament duhet të reflektohet balanca gjinore e elektoratit të tyre.

Përderisa është e mundur për burrat të flasin për çështjet e grave, disa tema të debatit (p.sh. për çështjet familjare) ende konsiderohen si më pak të rëndësishme sesa ekonomia apo politika e jashtme. Mandati ose përfshirja në listat zgjedhore e më shumë deputeteve gra do të inkurajonte më shumë debate rreth politikës sociale dhe kështu do të jetë i mundur prodhimi i legjislacioneve konstruktive me rëndësi për jetën e njerëzve të vërtetë.

Aktualisht ekziston një rreth vicioz, në të cilin gratë nuk shohin ndonjë pikë logjike në qëndrimin e tyre në parlamentit, sepse është parë (megjithatë pa të drejtë) si një institucion i dominuar nga meshkujt. Nuk duhet të shihet si në kundërshtim me legjislacionin për të drejtat e njeriut - askush nuk i ndalon njerëzit të qëndrojnë

në zgjedhje. Kjo masë (përfshirja e më shumë emrave të grave në listat zgjedhore ose vendosja e kuotave 50-50) thjesht do të përpiqet të kapërcejë seksizmin institucional në komisionet e përzgjedhjes të partive politike të vendosura, e cila për aq kohë ka penguar një numër përfaqësuesish të grave që të bëhen kandidatë.

Bota në shekullin e XXI është bota e diversitetit, ku burrat dhe gratë ndajnë së bashku përgjegjësitë si në zyrë, ashtu edhe në jetën familjare. Diversiteti u bën mirë jo vetëm kompanive, por mundëson edhe anë të mira për shoqërinë dhe ekonominë si një e tërë. *“Ngritja e femrave do të thotë ngritje e ekonomisë sonë dhe ngritje e vendit tonë... Duhet të sigurohemi që... dikush është në krah të tyre.”* - Barack Obama.

Gratë janë të pranishme jo vetëm në jetën politike, por edhe në sipërmarrje. Sipas një studimi të bërë nga INSTAT në vitin 2013, pothuajse 66.4 % e të pyeturve i perceptojnë gratë në pozicionet drejtuese si tepër profesioniste, 40% besojnë se gratë kanë aftësi të mira analitike, 40.5 % mendojnë se ndershmëria është karakteristika kryesore e grave. Gjithsesi, gratë në krye të sipërmarrjeve shqiptare janë të prirura të arrijnë rezultate më pak të mira në fushën e vendimmarrjes (13.6 % vetëbesimit (23.6%) dhe aftësive të planifikimit strategjik (20.2%). Vetëm një e treta e të pyeturve i konsiderojnë gratë me aftësi të larta lidhësi. Ndryshe nga burrat në pozicione ekzekutive, gratë janë të pajisura me një sërë aftësish pozitive. Ato janë më të qëndrueshme (31.3%) më të angazhuara (36.1%) dhe shumë më tepër efektive në diskutime (negocime) (33%).


Nga ana tjetër, gratë perceptohet se kanë mungesë vetëbesimi dhe janë nguruese në marrjen e rreziqeve përsipër. Pikërisht në këtë pikë, nevojitet informimi, sesionet trajnuese, ofrimi i vendeve të punës për fitim eksperience, afrimi i grave në organizata të ndryshme etj, në mënyrë që tek ato të kultivohet ndjenja e vetëvlerësimit dhe vetëbesimit dhe ndjesia e iniciativës, ambicies për të ecur përpara duke marrë përsipër rrezikun dhe duke punuar fort për produktivitet të lartë.

Diversiteti dhe simbioza gjinore në punë janë shumë të rëndësishme. Gratë dhe burrat duhet të bashkëpunojnë sepse plotësojnë njëri tjetrin. Karakteristikat e burrave, si vetëbesimi, komoditeti në vendimmarrje dhe negociimi efektiv na çojnë drejt një reagimi më të shpejtë dhe ndaj çështjeve dhe zgjidhjeve. Perceptimi i përgjithshëm është që burrat tentojnë të jenë më efektivë në arritjen e qëllimeve. Ndërkohë që gratë janë më të përqendruara në qëndrueshmërinë, zbutjen e komunikimit, ndaj dhe prej kësaj vjen dhe shmangia e konflikteve. Gjithashtu, gratë duket se ndryshojnë prej burrave edhe për arsyen se kanë aftësi të forta angazhimi dhe negociimi që shpesh u mundësojnë atyre gjetjen e zgjidhjeve më të mira.

Për të shprehur mendimin tim, do të thoja se problemi apo ngërçi qëndron te vetë gratë, sepse ato ende nuk e pranojnë veten e tyre si individë produktivë të shoqërisë, ende nuk i vendosin në zbatim idetë, aftësitë, gjenialitetin që mbart një mendje dhe një zemër vajze, motre, bashkëshorteje dhe një gruaje të hekurt për

të përballuar me vendosmëri çdo situatë qoftë kjo e këndshme ose jo. Në qoftë se gratë do të njohin plotësisht potencialin e tyre dhe luftojnë për të shfaqur çdo pjesë dinjitoze të tij, atëherë sigurisht, që shoqëria jonë, Shqipëria do të bëhet një vend më i mirë.

Doela HOXHAI është lindur në Vlorë, më 22.09.2000. Aktualisht është nxënëse në gjimnazin “*Ali Demi*”, ku është dhe presidente e këtij gjimnazi. Është deputete në Parlamentin Rinor Vlorë . Është trajnuar në Akademinë e Liderëve të Rinj në vitin 2016, ka qenë pjesë e sesioneve informuese në qendrën e BE. Fituese e formatit të debatit “*Karl Popper*” në rang qyteti dhe pjesëmarrëse në rang kombëtar. Është njohëse e mirë e gjuhës angleze dhe gjermane.



ROLI I GRUAS NË MEDIA

PhD (c) Marjeta MËRKURI

Gazetare, Anëtare e Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë

Email: m_merkuri@yahoo.com

Abstrakt

Gjatë viteve, mediat sociale kanë provuar të jenë një mjet i fuqishëm në drejtim të ngritjes së vetëdijes dhe mobilizimit të fushatave mbi një sërë çështjesh pasi - përtej përdorimit të saj si një mjet i rrjeteve sociale - lejon çdo individ të ndajë përmbajtje dhe opinione në një audiencë globale menjëherë. Aktivistët e të drejtave të grave kanë qenë të shpejtë ta pranojnë këtë rëndësi, prandaj në kohët e fundit mediat sociale kanë treguar më shumë potencialin e tyre për tërheqjen e vëmendjes në fuqizimin e grave dhe çështjet e të drejtave të grave siç janë diskriminimi, pabarazitë gjinore dhe stereotipet negative.

Përkundër përmirësimit ndër vite, ende ka shqetësime sa i përket prezantimit të grave dhe rolit të saj në media, por sidomos edhe hapësirës që atyre iu kushtohet. Roli i gruas në shoqëri ka ndryshuar nëpërmjet pikëpamjeve të vazhdueshme të grupeve feministe gjatë dekadës së fundit dhe disa prej këtyre ndryshimeve reflektohen edhe në televizion, film ose portrete të tjera mediatike të gruas.

Mediat dhe ndikimi i tyre mbetet një prej fushave më sfiduese në angazhimin drejt arritjes së barazisë gjinore. Sfida kryesore mbetet ndryshimi i mentalitetit, i krijuar në shekuj në dallimet dhe diskriminimet gjinore, të ndikuara po ashtu nga tradita, kultura apo religjioni.

Fjalë kyçe: grua, media, gazetari.

1. Hyrje

Çdo ditë e më shumë po flitet për të drejtat dhe lirinë e gruas, për rolin e tyre në shoqëri, emancipimin e tyre e po ashtu edhe praninë e gruas në media.

Barazia gjinore është një temë që has një trajtim të gjerë e ngjall polemika të ashpra dhe media ndodhet përballë presionit të stereotipeve të krijuara nga vet shoqëria.

Duke respektuar lirinë e shprehjes, roli i mediave është të japë dhe të mbështesë një imazh të denjë të individit e në këtë rast të gruas në shoqëri. Gruaja duhet të mbështetet dhe të trajtohet si forcë e domosdoshme e zhvillimit shoqëror. Ajo nuk duhet të paraqitet “*si seks i dobët*” por si një individ që duhet të gëzojë të drejta të barabarta në të gjitha shkallët e përfaqësimit të shoqërisë. Për shumicën e audience, roli i grave në media duket si një problem që është zgjidhur me kohë. Mediat kanë një përgjegjësi të madhe për promovimin e barazisë gjinore dhe jo thjesht për pasqyrimin e saj. Çështja nuk është thjesht nëse gratë përfaqësohen në media por edhe si përfaqësohen. Roli i imazhit dhe portretizimit të saj në media vjen si një zë i fuqishëm i grave dhe nevojës së tyre për të promovuar edhe më tej rolin e gruas në aspektin e progresit shoqëror të vendit.

Shumë media dinë vërtetë të vlerësojnë imazhin e gruas, të promovojnë vlerat e saj dhe për më tepër të krijojnë një stereotip pozitiv nëpërmjet televizionit. Gratë janë ato qenie që priren të jenë të buta, më të komunikueshme dhe prania e tyre në ekran duket dikur e zbut edhe më tej aspektin pamor. Gruaja sot ka një rol të rëndësishëm dhe shumë themelor në shoqërinë shqiptare e cila ka dëshmuar se di të drejtoj burrat dhe të asimiloj paragjykimet e ndryshme të stereotipeve të krijuara. Në programe të ndryshme radiofonike dhe televizive zë vend mjaftueshëm minutazhi ku flitet për femrën dhe veçanërisht për gratë në vende të ndryshme të botës të cilat janë shfaqur si një faktor i rëndësishëm jo vetëm nëpërmjet medias por edhe në tryeza dhe takime të rëndësishme ku nga ana e burrave ka patur jo vetëm kontestime por edhe kundërshtime të ashpra në mendime e vendime.

Janë pikërisht gratë të cilat shpeshherë luftojnë pareshtur kundër këtyre fenomeneve diskriminuese duke u kthyer një shembull i vyer dhe një model domethënës për të gjitha gratë e tjera në mbarë botën, veçanërisht në shoqëri të prapambetura dhe ku kërkohet dhe janë të nevojshme modele të tilla.

Shumë sociologë, psikologë por edhe aktivistë të të drejtave të grave në mbarë botën, por edhe në vendin tonë, kanë ngritur zërin për përmirësimin e imazhit të gruas në media por edhe nevojën për vetë ngritjen e kontributit të vet mediave në arritjen e barazisë gjinore dhe përmirësimit të rolit të gruas në shoqëri në përgjithësi.

Përkundër përmirësimit ndër vite, ende ka shqetësime sa i përket prezantimit të

grave dhe rolit të saj në media, por sidomos edhe hapësirës që atyre iu kushtohet. Roli i gruas në shoqëri ka ndryshuar nëpërmjet pikëpamjeve të vazhdueshme të grupeve feministe gjatë dekadës së fundit dhe disa prej këtyre ndryshimeve reflektohen edhe në televizion, film ose portrete të tjera mediatike të gruas. Në të njëjtën kohë, është e evidente që progresi i portretizimit të gruas në media në arritjen e barazisë gjinore nuk është në nivel të kënaqshëm. Kur mediat prezantojnë tema, ngjarje, situata, ato ua atribuojnë ato shkrime personave dhe grupeve të caktuara. Mirëpo, edhe pse mediat kanë një rol të rëndësishëm për të sfiduar stereotipet gjinore, fatkeqësisht media vet ka qenë shpesh pjesë e problemit, në vend se të ishte pjesë e zgjidhjes.

2. Kujt i kushtohet më shumë hapësirë në media, burrave apo grave?

Analiza e artikujve në gazetat ditore në Shqipëri, për një periudhë 5 ditore, ka mundësuar që të krahasohet qasja e mediave në raport me përfshirjen e grave dhe të burrave në shkrimet e gazetave. Rezultatet tregojnë shumë qartë se prezantimi i burrave, në raport me gratë, është dukshëm shumë më i lartë, ku burrat dominojnë në shumicën e artikujve në gazeta apo në 63 për qind të rasteve, ndërsa artikujt ku të dyja gjinitë janë prezent në artikujt e gazetave përbëjnë 25%. Por, rezultatet janë shqetësuese për faktin se mediat janë ende larg për të arritur barazinë në prezantimin e grave, në raport me burrat, ngaqë artikujt ku gratë janë prezente, si protagonistet në artikuj, zënë vetëm 10% të hapësirës në gjithë artikujt, në gazetat ditore.

Gjithashtu, prezantimi dhe hapësira që u është dhënë burrave në fushën e politikës, në krahasim me hapësirën që u është dhënë grave në po këtë fushë, janë dukshëm të pabarabarta. Gratë janë paraqitur vetëm 5.4 % të hapësirës krahasuar me burrat që përbëjnë afro 73% të rasteve. Edhe tek temat sociale, diferenca është shumë e evidente, ku prezantimi i gruas është në 13% të hapësirës ndërsa burrat në 49% të hapësirës. Edhe në fushën e kulturës dominojnë burrat në 55% ndërsa sporti është fushat ku dominimi i burrave është jashtëzakonisht më i lartë në krahasim me gratë, afërsisht 96%.

Përfundimisht, është më se e qartë që roli që luajnë mediat në trajtimin e problemeve sociale, në fokus me çështje gjinore, është jetik për përf forcimin e pozitës dhe të imazhit të gruas në shoqërinë tonë. Mediat dhe ndikimi i tyre mbetet një prej fushave më sfiduese në angazhimin drejt arritjes së barazisë gjinore. Sfidat kryesore mbetet ndryshimi i mentalitetit, i krijuar në shekuj në dallimet dhe diskriminimet gjinore, të ndikuara po ashtu nga tradita, kultura apo religjioni.

Doktorant Marjeta Mërkuri, ka përfunduar studimet në Antropologji në Universitetin Kapodhistriu të Athinës, është specializuar në Shkenca komunikimi dhe gazetari. Ka kontribuar prej 18 vitesh në fushën e gazetarisë edhe si anëtare e Kryesisë së Unionit të Gazetarëve të Shqipërisë, edhe si drejtuese e një prej mediave lokale në qytetin e Vlorës. Aktualisht ndjek studimet e doktoraturës pranë Universitetit European të Tiranës. Është lektore e lëndës së komunikimit në Kolegjin Universitar “Pavarësia Vlorë”. Është autore e librit “Etika dhe komunikimi”, autore e artikujve shkencorë të botuar në revista brenda dhe jashtë vendit.



Nga fjala e një shkrimtareje....

NGJYRAT - DITA – NATA - NË SYTË E NJË FEMRE...

Rudina MËRKURI

Shkrimtare

Çdo femër mbart një vizion enigmash në pelegrinazhin e gjatë të jetës. Jeta e saj krijon abstraksion në hapësirën për vetveten. Sepse dita e re sjell një përpjekje, një sfidim të çastit magjik, fatlum, apo hidhërues. Bota reale e çdo femre pushton botën fatlume apo të gënjeshtër. Ëndrra e saj depërton në shpirt, në deje e kapilarët e një gjaku të vrullshëm. Çdo ditë ajo shkund pluhurin e përgjumjes, sfidon tensionin duke kthyer rrugën në asfaltin e gjatë. E dalëngadalë thujse nata krijon botën e gjumit. Nata e gjatë si për inat të dremmit apo mbart momente frymëmarrje impulsive, e kjo femër thotë “*jo kam diçka për të bërë*”. Mendja e saj novatore punon, mposht kontradiktat e trupit dhe zhdok qetësinë e shurdhët të vetmisë. Çdo femër jeton në netët e bardha nëpërmjet ëndrrës dhe imagjinatës. Sepse çdo labirint, çdo prag që ajo shkel kanë tronditje, heshtje, madhështi. Kështu vjen e bukura femër si një dritë e bukur në një sfond.

Femër! Në krye në herës ke për të qenë më e bukura, grishëse, tunduese, konvertimi i brishtësisë prej një lule që nuk vyshket me aromën dehëse ku të gjithë përkulen. Ti jeton që të krijosh jetë, duke qenë fakti më i rrallë dhe më i papërsëritshëm, dëshmia ku lind dhe përtërihet njerëzorja. Bashkë me moshën më të bukur kur ti hedh hapat e parë m ti rritesh ecën si një shtojzovallë dhe ja tek e zgjedh udhën tënde, udhën që ti e hap mendje lirë duke shkelur mbi mijëra tabu, klishe dhe gjembat e pamundësisë. Ti je dora e zgjatur për një fëmijë që rrëzohet, je përkundja e një djepi, je mëmësia e ëmbël që lotin dhe qarjen e foshnjës pushon, je bukuria ku stinët grinden me shoqja shoqen, sepse ti je përmbi stinët. Të shoh si një hapësirë blertë e plot ngjyra një ylber që bashkon dy skaje të qiellit. Je frymëmarrja e paepur ku lind e ngjizet jeta, lëvizja që mposht ngrirjen ndalesën, ndërprerjen e elementëve. Kur flas për ty më vegon përpjekja e ditëve sfidim i çastit magjik, përfytyrimi dhe bota reale, një pjalm që pështjell ajrin, hijeshinë, frymën delikate mbi gjoksin e një burri, lundrimin e guximshëm drejt misterit, ëndrrës asaj që s’preket e nuk shihet ndihet nga shpirti që afron. Femër ti je nëna, motra, e dashura. Gruaja, apo shoqja. Ti nuk je “*prona e dikujt*”, sepse ti je vetë lindja. Je arsyeja sublime për të qenë mbretëresha e familjes. Ti e ndjen se pas reve fshihet një diell i bukur. Prite atë diell! Është dielli yt. Aty, ti je si e vërteta, je më

origjinalja, je bukuria, paqja, buzëqeshja e ëmbël e zotit që ia dhuroi tokës. Koha për ty bukuri i ka ndalur akrepat dhe çastet, minutat presin siç prët lulja rrezen e agimit që të ngrejë kryet e të çeli petalet vesuar nga mëngjesi.

Ç'zemër e madhe! Zemër nënë, zemër gruaje. Grimcë pafund emocioni si yjësitë dhe pluhuri kozmik nëpër gjirin e Artemidës, në *“udhën e qumështit”*, ashtu je edhe ti, femër e mbjellë nga duar dashurie. Tërhiqen brenda teje e struken në ngjarjet e misterit tënd për të prekur aty vegimin hyjnor, si dritë si energji në horizont. Ndoshta ti je Zoti femër që lindi gjithmonë. Mijëra sy që ngulen thellë në ato mori shkëndijash që ndezin zjarrin në atë shqisë të padukshme. Dorëzohen përpara teje një libër që fund ska.

Rudina Mërkuri lindur në qytetin bregdetar të Vlorës me 10.6.1970. E diplomuar në degën e Infermierisë në Fakultetin e Shëndetit Publik dhe Master Shkencor në degën Patologji e Përgjithshme, ndërsa aktualisht ndjek studimet për fizioterapi. Pasioni për botën e letrave e ka shoqëruar që nga fëmijëria e deri më sot. Në vargjet poetike, ajo shfaq të verbalizuara mrekullitë natyrore, traditat tona kombëtare, bukurinë femërore dhe vlerat njerëzore, duke u munduar të perceptojë të lexuesi një lloj meditimi, magjepsje ndaj të bukurës, ku të gjithë përulemi. Ka botuar në shumë gazeta dhe revista prestigjioze, në dy antologji dhe së fundi është përfshirë në antologjinë e potave të jugut. Është vlerësuar me çmime speciale, si gazeta *“Bota press”*, gazeta *“Dituria”* në Suedi, revista *“Dituria”*, Antologjitë *“Maja Çajupjane”*, *“Shpirti i Fjalës”* në Rumani, *“Sa-kra”* në Kosovë, *“Diplomë Excellence”* në Rumani nga Unioni Kulturor Shqipëri – Rumani, etj. Aktualisht është duke përgatitur për botim librin e dytë.



TË EDUKOJMË MENDJEN PËR TË EDUKUAR SJELLJEN

Tefta MUSTA

*Mësuese e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe,
Shkolla e mesme “Naim Frashëri” Vlorë
mustatefta@gmail.com*

Abstrakt

Çdo ditë për vajzën është betejë e shumëfishtë. Çdo mëngjes ajo mbart në shpatullat e brishta të gjitha pritshmëritë si ato familjare, personale, të shkollës, të mësuesve etj.

Deri tek diplomimi apo tek punësimi i saj, femrës i duhet jo të ecë, por të rendë. Mundimin e lodhjes ia zbeh eleganca; shenjat e vështirësive ia fsheh buzëqeshja; dobësinë ia mposht dashuria. Se unë besoj fort se femra nuk i dëshiron gjërat, por i dashuron ato. Kjo gjë e bën identitetin e saj të pamatshëm dhe të adhureshëm.

Për fat të keq ka edhe një pritshmëri tjetër që s’ dihet kush e shpiku, por dihet që çuditërisht po e ushqejmë më dëshirë të gjithë: rivaliteti me botën mashkullore

Nuk jam antimaskiliste, përkundrazi, gjykoj se dashuria e burrave është liri, ndërsa ajo e bijve është përplotësi. Nuk mundem as t’i paragjykoj e as t’i etiketoj, sepse ky do të ishte dështimi ynë si gra, si nëna, si bija, si shoqe a si mike të tyre. Thjesht dua t’i ftoj të jenë me ne, përkrah nesh ose diku rrotull nesh. Për të na dashur, për të na mbrojtur, për të na ngritur. E sigurt është që ata janë njerëzit që na duan më shumë. Unë asnjëherë nuk kam menduar se mes nesh duhet të ketë rivalitet. Rivaliteti nuk ekziston si fenomen i pavarur: atë e krijojnë njerëzit e vegjël. Të mëdhenjtë nuk vënë kurrë kufij. Pikërisht këtë portë duhet të hapim: “të rrisim djem e vajza të mëdhenj”.

***Fjalë kyçe:** vajzë, arsimim, barazi.*

Unë nuk kam lexuar asnjë statistikë mbi çështjen e karrierës së grave në Shqipëri dhe mundet që të mos e kem informacionin shkencërisht të saktë, por di

që kam informacionin realisht të saktë. Se fundja njerëzit nuk janë tërësisht statistikë. Njeriu hyn në statistikë pasi ka bërë një rrugë të gjatë pas së cilës triumfi apo humbja e tij e shndërrojnë në një numër. Personalisht mendoj se numrat na duhen jo për t'u motivuar, por për t'u justifikuar. Mendimi im mund të jetë pesimist, por jemi në një shoqëri që e fillon statistikimin e problemeve të femrës vetëm kur ato rriten, ose më saktë, kur punësohen. Është shumë vonë. Atëherë nuk ka kohë për asgjë: as për të ndryshuar, as për të përmirësuar e fatkeqësisht as për të rifilluar.

Deri tek diplomimi apo tek punësimi i saj, femrës i duhet jo të ecë, por të rendë. Mundimin e lodhjes ia zbeh eleganca; shenjat e vështirësive ia fsheh buzëqeshja; dobësinë ia mposht dashuria. Se unë besoj fort se femra nuk i dëshiron gjërat, por i dashuron ato. Kjo gjë e bën identitetin e saj të pamatshëm dhe të adhurueshëm.

Pas 24 vitesh përvojë pune në arsimin e mesëm unë them se secila vajzë është gjeni! Është gjeni sepse, pavarësisht nëse vjen nga familje e pasur apo e varfër, nga zonat urbane apo rurale, nga fshati apo nga qyteti, kalon sflitje të jashtëzakonshme për të arritur qëllimin e saj. Çdo ditë për të është betejë e shumëfishtë. Çdo mëngjes ajo mbart në shpatullat e brishta të gjitha pritshmëritë:

Së pari-të familjes, e cila i kërkon dhjeta në çdo lëndë mësimi; i kërkon sjellje dinjitoze, shpesh sipas formatit që u intereson të rriturve; të ruajë raporte të mira me opinionin; u kërkon të respektojë oraret; të lexojë libra; të shkojë nëpër kurse private; të mësojë më shumë se dy gjuhë të huaja; të bëhet krenaria e tyre dhe e fisit të tyre; të mbajë veten bukur dhe në fund fare i përcakton edhe degën universitare ku do të vazhdojë studimet, në mos edhe bashkëshortin.

Së dyti-pritshmëritë e saj, të cilat e tërheqin çdo ditë drejt formimit të vetëdijes dhe ndjeshmërive femërore; të plotësimin si qenie shoqërore; drejt dëshirës për t'u bërë profesioniste e mirë; për të siguruar të ardhme financiare të sigurt për vete dhe familjen që pritet të ndërtojë; për të siguruar një karrierë të lavdërueshme.

Së treti-pritshmëritë e shkollës, konkretisht të mësuesve, të cilët notat dhe sjelljen e saj, i kanë njësi matëse të punës së tyre, por edhe shpërblesa të saj.

Por për t'i arritur këto, ne të rriturit, ne që kemi ndërtuar e menaxhojmë këtë lloj bote ku ajo do të hyjë, i kërkojmë sakrificat. Ajo e ka të qartë se sakrificë nuk do të thotë të heqësh dorë nga komoditeti, por nga e domosdoshmja. Dhe ajo in bën të gjitha sakrificat. Në buzëqeshjen e gëzuar të dhjetës, unë dalloj pagjumësinë dhe lodhjen e saj; e shoh trishtimin e saj teksa refuzon ftesën e shoqes a shokut për të dalë në mbrëmje, e lexoj gëzimin e saj të premtën, ngaqë e di se do të mundet të dalë, pavarësisht se të shtunën diku në një kurs do të shkojë patjetër.

Është e çuditshme! Të rriturit kërkojnë prej fëmijëve gjithçkanë, por u japin vetëm diçkanë. Të tjerat shpesh i mbulojnë me shprehjen “Do të t'i mësojë jeta”, kur në fakt jeta jemi ne. Bijave tona u kemi lënë vetëm një rrugë: atë të sfl-

itjes. Mbase po ndjekim traditën, mbase po fshihemi pas filozofisë justifikuese se kështu e ka jeta, por di me siguri që po gabojmë. Unë mendoj se duhet të ndalemi.

Për fat të keq ka edhe një pritshmëri tjetër që s’ dihet kush e shpiku ,por dihet që çuditërisht po e ushqejmë më dëshirë të gjithë: rivaliteti me botën mashkullore. Betejat e vogla brenda klasave shpejt zhvendosen në zyra e institucione. Dhe shpe-shherë edhe në shtëpi. Paqartësia e përgjithshme që kaplon njerëzit bëhet shkak justifikuese i dështimit dhe kjo sjell dhimbje e dhunë.

Nuk jam antimaskiliste, përkundrazi, gjykoj se dashuria e burrave është liri, ndërsa ajo e bijve është përplotësi. Nuk mundem as t’i paragjykoj e as t’i etiketoj, sepse ky do të ishte dështimi ynë si gra, si nëna, si bija, si shoqe a si mike të tyre. Thjesht dua t’i ftoj të jenë me ne, përkrah nesh ose diku rrotull nesh. Për të na dashur, për të na mbrojtur, për të na ngritur. E sigurt është që ata janë njerëzit që na duan më shumë. Unë asnjëherë nuk kam menduar se mes nesh duhet të ketë rivalitet. Rivaliteti nuk ekziston si fenomen i pavarur: atë e krijojnë njerëzit e vegjël. Të mëdhenjtë nuk vënë kurrë kufij. Pikërisht këtë portë duhet të hapim: “*të rrisim djem e vajza të mëdhenj*”.

Tefta MUSTA. është lindur në Berat, më 31.05.1971. Është diplomuar në Universitetin e Tiranës, dega gjuhë shqipe dhe letërsi. Prej 24 vitesh punon mësuese në shkollat e mesme të qytetit Vlorë. Ka qenë bashkëkoordinatore e projektit “*Cilësi dhe barazi në arsim*” zbatuar në vitin 2004 në shkollat e qytetit nga Banka Botërore dhe PNUD, në kuadër të objektivave të mijëvjeçarit. Në vitin 2007 ka qenë vlerësuese në projektin e alter tekstit të zbatuar nga Ministria e Arsimit. Njih mirë gjuhën angleze dhe ka mbrojtur gjuhën italiane. Prej nëntë vitesh është mësuese koordinatore e qeverisë së nxënësve dhe aktiviteteve artistike të shkollës ku punon.



GRUAJA, MES FAMILJES DHE KARRIERËS

MSc. Anila HITAJ

*Specialiste e Turizmit, Këshilli i Qarkut Vlorë
hitajanila@gmail.com*

Abstrakt

Balancimi që kërkon jeta e një gruaje ndërmjet familjes dhe karrierës merr gjithmonë një vëmendje, e cila vjen e rinovuar.

Nëse kemi probleme brenda familjes, atëherë nuk mund të jemi të suksesshëm në shoqëri. Aty burojnë vlerat e shoqërisë. Është shumë i rëndësishëm edukimi i fëmijëve për t'iu gëzuar gjërave të thjeshta të jetës dhe kultivimi i dëshirës për të ndihmuar, respektuar dhe për t'iu gjendur gjithkujt që ka nevojë. Jam një familjare e lumtur dhe kjo më bën një njeri të lumtur falë njerëzve me të cilët jetoj. Gruaja nuk lodhet asnjëherë ta shpërndaj këtë ndjesi me gjithë njerëzit që takoj, punoj, komunikoj, pavarësisht momentit në të cilin ndodhem. Është i pallogaritshëm një çast i trishtë krahasuar me pozitivitetin që përcjell sinqeriteti dhe mirësjellja tek një njeri. Duhet të pranojmë se bota e grave dhe vajzave është e ndarë në dy pjesë, në njërin janë gratë dhe vajzat që ia kanë dalë dhe në anën tjetër janë gratë dhe vajzat që gjenden në kthetrat e diskriminimit dhe dhunës së përditshme.

***Fjalë kyçe:** grua, familje, vlera karrierë.*

“Unë grua”, ky përcaktim të krijon ndjesinë që i vendos vetes një ndarje dhe që aty mund të them ç'të dua, të sulmoj dhe të kem të drejtë. Të shkruarit autobiografik, në një intervistë është shumë e vështirë pasi duhet të jesh i sinqertë, shumë i vërtetë, “*duhet të jesh real se aty i jep vlera vetes*”, thotë i madhi Dritëro. Të flasësh për veten është gjithmonë punë e rrezikshme, nuk e di sa mundet njeriu të jetë objektiv.

Kur Saniela më ftoi për të diskutuar, mendova të shkruaja diçka natyrale pa shumë fjalë të tepërta .

“Dëshironi të njihni veten si jeni” ? - Pyesni të tjerët

“Dëshironi të dini një mendim sa më objektiv dhe pa dorashka se si është femra sot? Pyesni edhe meshkujt.” Kështu u kërkova disa miqve të mi të jepnin mendimin e tyre për ne gratë.

Femra në Shqipëri vazhdon të mbetet e “*shtypur*”, jo e barabartë me meshkujt dhe më e dhimbshme mendoj se ka një ndjenjë inferioriteti ndaj tyre. Mendoj se këto vijnë për shumë arsye. Një ndër to është pavarësia ekonomike, ana tjetër është vetë faji i femrës sepse siç e dimë, liria, pavarësia, barazia, fitohen nuk t’i dhuron askush, ndaj femrat duhet të ndërgjegjësohen vetë sepse unë e besoj fort që nuk ka për t’u ndërgjegjësuar pjesa tjetër e shoqërisë po nuk u ndërgjegjësuat femra vetë. Arbi (Drejtor i World Vision Qarku Vlorë)

UNI nuk ka gjini! Realisht në punët që kam bërë dhe bashkëpunimet që kam patur në pjesën dërrmuese të proceseve nuk janë trajtuar situatat në bazë të gjinisë por në bazë të aftësive. Kam patur fatin të punoj me shumë njerëz. Shumë prej eprorëve të mi kanë qenë femra si në Shqipëri dhe Greqi. Femra tepër dinamike dhe me vizion në punën që bënin. Në ato pozicione nuk u gjenden se ishin femra dhe dikush u dha postin për barazi gjinore, por sepse ishin të aftë dhe të zotë si individ, si menaxher. Fatmirësisht kam vënë re se edhe në Shqipëri koncepti gjinor po venitet dhe vetë tregu përcakton kush do bëjë para dhe kush jo, ambiciet nuk kanë gjini, kush punon me veten dhe me rrethin social ecën para dhe merr atë që i takon. Jeta nuk është gjithmonë e drejtë apo e lehtë dhe ka goditje edhe” poshtë rripit “ qoftë mashkull ose femër, por besoj se kërkesa që ka gjithsecili ndaj vetes përcakton rolin e tij në shoqëri pra s’ka gjini, por ka nevojë për këmbëngulje dhe punë

Unë personalisht nuk i qëndroj asnjëherë etiketimeve gjinore kur ka të bëjë me punën por aftësitë dhe rrethanat që mund të ndihmojnë ose ndalojnë dikë të ketë sukses. Pervini (Konsull në Konsullatën e Përgjithshme të RSH –së në Janinë : *“Kur shkoj të marr porosinë, ka femra që nuk flasin fare, e japin porosinë meshkujt, madje disa as që i pyesin se çfarë dëshirojnë për të ngrënë por vetëvendosin.*

“Femrat përbëjnë gjysmën e popullsisë dhe janë gjysma ime e preferuar po ndodh tani një rritje e “feminizmit”, që ka më shumë mentalitet viktimizues dhe agresiv. Jo për çdo gjë e kanë fajin meshkujt. Rëndom femrat janë armike të vetes dhe nuk i shtrijnë dorën njëra-tjetrës. Një femër e pavarur dhe e guximshme nuk viktimizohet, një mashkull i vërtetë nuk frikësohet nga një femër e pavarur dhe e fortë.” Nertili, i diplomuar (punon kamerier, me një librari në shtëpi).

Kur mbarova gjimnazin, më doli shkolla për Gjuhë - Letërsi (pasioni im), por bëra vetëm vitin e parë, pasi emigruam dhe kështu u detyrova ta lija shkollën. Kur u kthyem im shoq më regjistroi në shkollë edhe pse unë nuk doja pasi ishim bërë me fëmijë, një familje e zgjeruar, shkolla ishte me pagesë dhe nuk doja të shpenzonim. Por ai më thotë: “Mama ti nuk mund të rrish pa një diplomë, pasi ke kapacitet dhe aftësi. Diploma do të ishte një vlerë e shtuar. (Gjithmonë e kam

vlërësuar këtë veprim të tij). Fillova universitetin në 2003 – 2007. Ishte viti i parë që u hapën degët e studimit me kohë të pjesshme, pasi me kohë të plotë ishte e pamundur për mua dhe kushtet në të cilat ndodhesha. Isha një nënë me tre vajza, e vogla e sapolindur, me stërgjyshen e fëmijëve që jetonte dhe jeton ende me ne.

Më pas vendosëm të hapim një biznes të vogël familjar. Fillova të angazhohesha edhe në jetën politike si vullnetare.


Prej katër vitesh jam specialiste e Turizmit, Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë.

Bashkëshorti im thotë gjithmonë: *“Mama (kështu më flet gjithmonë) të lutem mos u sëmur, kujdesu për veten sepse ti u përket të gjithëve nga pak, nëse ti nuk je mirë, asnjë nga ne nuk është mirë”*. Kam punuar për vite me radhë kopshtin ose “bahçen” me stërgjyshen e fëmijëve të mi. Kam nostalgji për atë kohë pasi çdo ushqim e merrnim nga kopshti dhe parapërgatisnim ushqimet për dimër.

Mbase diskutova më shumë në aspektin familjar por unë mendoj se gjithçka në jetë funksionon si në familje. *Nëse kemi probleme brenda familjes, atëherë nuk mund të jemi të suksesshëm në shoqëri. Aty burojnë vlerat e shoqërisë*. Është shumë i rëndësishëm edukimi i fëmijëve për t’iu gëzuar gjërave të thjeshta të jetës dhe kultivimi i dëshirës për të ndihmuar, respektuar dhe për t’iu gjendur gjithkujt që ka nevojë. Jam një familjare e lumtur dhe kjo më bën një njeri të lumtur falë njerëzve me të cilët jetoj. Nuk lodhem asnjëherë ta shpërndaj këtë ndjesi me gjithë njerëzit që takoj, punoj, komunikoj, pavarësisht momentit në të cilin ndodhem. Është i pallogaritshëm një çast i trishtë krahasuar me pozitivitetin që përcjell sinqeriteti dhe mirësjellja tek një njeri. Falënderoj bashkëshortin, babin dhe vajzat që më kanë nxitur për gjithçka. Duhet të pranojmë se bota e grave dhe vajzave është e ndarë në dy pjesë, në njërin janë gratë dhe vajzat që ia kanë dalë dhe në anën tjetër janë gratë dhe vajzat që gjenden në kthetrat e diskriminimit dhe dhunës së përditshme.

“Duhet pra që gruaja shqiptare të përpiqet dhe të rrëfëhet e denjë për të drejtat njerëzore. Lipset që të bëjë forcime për t’u lartësuar intelektualisht dhe shpirtërisht, duke njohur vendin e vërtetë që i ka hije të zërë.” Mit’hat Bej Frashëri: *Grave Shqiptare*, “Plagët tona”, 1924.

MSc. Anila HITAJ, lindur në Laç, më 07 Nëntor 1971, diplomuar në Universitetin e Vlorës, Dega e Mësuesisë “Cikli i ulët” 2003-2007. Gjithashtu kam mbaruar Masterin e Shkencave në Financë Publike dhe Administrim Publik, temën “ Motivimi në sektorin publik dhe atë privat” Kam punuar fillimisht si e vetëpunësuar në biznesin tim. Sot jam Specialiste e Turizmit, Arsimit, Kulturës dhe Çështjeve Sociale në Këshillin e Qarkut Vlorë prej katër vjetësh. Koordinatore e projektit “ PASSAGE” si përfaqësuese e Këshillit të Qarkut Vlorë, me partnerë nga Gjermania, Finlanda, Danimarka, Kenti Itali dhe Greqi. Kam bërë disa trajnime nga ASPA, “ Menaxhimi i sistemit të planifikimit të integruar për njësitë e qeverisjes vendore”“ Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut”. Pjesëmarrje Aktive në “Puna Ndër-sektoriale për Mbrojtjen e Fëmijëve”“Prezantimi me Administratën Publike” Trajnim për “Drejtues të institucioneve të arsimit parauniversitar”, “Si duhet të jenë edukatorët sot” etj. Anëtare e Asamblesë Kombëtare të Partisë Socialiste, Anëtare e Bordit Drejtues si përfaqësuese e Këshillit të Qarkut Vlorë në Drejtorinë Rajonale të Formimit Profesional Publik Vlorë. Trajnim për shkrimin e broshurave turistike, Shtator 2015 në kuadër të një projekti në bashkëpunim me Agjensinë Kombëtare të Turizmit, mbështetur nga projekti: “Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit në zonat rurale në Shqipëri” financuar nga Ministria Federale për bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ) dhe zbatuar nga Shoqëria Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar (GIZ) Lidërsipin e Udhëheqjes Tiranë, 2016 , Koordinatore e FFKGJ/ 2015 për Qarkun e Vlorës.



GRUAJA NË PIRAMIDËN E SAJ DHE SFIDAT E KONSOLIDIMIT TË ROLIT

MSc. Anjeza SHIKO

*Drejtor, Drejtoria e Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes Konsumatore, Bashkia Vlorë
agness_shiko@yahoo.it*

Abstrakt

Margaret Thatcher, si referenca historike e suksesshmërisë së gruas në karrierë do të thoshte;

“Nëse keni për të thënë diçka pyesni një burrë, nëse keni për të bërë diçka pyesni një grua”.

Nisur nga ky citim, punimi im do të bëjë një analizë sa të përgjithshme aq edhe personale të figurës së gruas, me vështirësitë dhe lehtësirat që ajo has në rrugën e saj të karrierës.

Ne jemi një shoqëri që aspirojmë të jemi kandidatë drejt Evropës, ndodhur përpara një mentaliteti maskilist të mbartur nga historia, ne si gra hasim barrierë përballë sfidave që duam të kalojmë dhe qëllimeve të parashikuara.

E pse duhet të kuptojmë palën mashkullore, këtë krijesë që është krijuar për mbështetje dhe garanci në familje dhe në jetën shoqërore, ne e shikojmë si sfidë?

Në rrugën time të karrierës, apo të krijimit të familjes dhe personalitetit profesional, kam hasur shumë vështirësi. Diku më është dhënë dora për t’u ngritur e ecur para, diku jam paragjykuar se jam një grua. Një grua që kërkon që të marri e të japi në të mirë të shoqërisë dhe përmbushjes vetjake. Na pret një aksion i madh, ne si gra të ushqejmë çdo ditë dëshirën për të ecur para, për tu arsimuar e kualifikuar më shumë, për të qenë një benefit në familje dhe shoqëri dhe e gjitha kjo për tu përkthyer jo si një përmbushje egoiste e jona, por si një karakteristikë apo pikë e fortë që ne kemi.

***Fjalë kyçe:** grua, barazi gjinore, karrierë, mjedisi i punës*

1. Hyrje

Figurës së gruas, nëse do ti bëjmë një paradë nga pikëpamja sasiore dhe cilësore, do të themi se ka evoluar shumë. Kjo për vet faktin se ne nuk jemi ajo pjesa plotësuere e së gjithës, por ne jemi të domosdoshme, të dobishme, të ndjeshme, të kujdesshme, këmbëngulëse dhe të paepura.

E parë në nivel global, sipas një raporti të kryer nga Deloitte Touché Tohmatsu në vitin 2010, gratë janë të prirura të përparojnë më shpejt në karrierën e tyre brenda ambientit qeverisës, sesa në sektorin privat. Pothuajse 10% e shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara udhëhiqen nga gratë, krahasuar me 3% të 1,000 kompanive të para shumëkombëshe, të cilat kanë në krye presidente ose drejtuese gra. Gratë përfaqësojnë përafërsisht 20% të numrit të përgjithshëm të parlamentarëve në mbarë botën, krahasuar me 13, 5% të grave që mbajnë një pozicion drejtues në 500 kompanitë e para më të mira amerikane.

E parë në nivel kombëtar, emancipimi i gruas në Shqipëri ka akoma rrugë për të bërë. Nëse ne i referohemi asaj në pozicionet drejtuese në nivel vendor, koha ka treguar se kemi bërë shumë për barazinë gjinore në nivel drejtimi. Nëse para 15 vitesh flitej për një shifër as 30% gra në drejtim, sot kemi 50% drejtuese gra. Për të arritur deri në këtë nivel përqindje pjesëmarrjeje të gruas në drejtim është dashur shumë dhe ka qenë një proces i vështirë.

Kur diskutohet dhe flitet për gruan që duhet të jetë pjesë më aktive në jetën politike apo administratë publike, të gjithë pohojmë në parim burra e gra që gruaja duhet të jetë më prezent, por kur duhej të vendosej një grua në drejtim, këtu hasnim në një mal pothuaj shumë të vështirë për ta kaluar, por jo e pamundur.

Falë barazisë gjinore që në të shumtën e rasteve u bë e detyrueshme me ligj si për rastin e zgjedhjeve në këshillat bashkiak një detyrim indirekt, ka bërë që edhe drejtuesit vendorë të respektojnë barazinë gjinore në emërimet e drejtueseve. Edhe pse ky proces ka qenë i vështirë për të arritur deri në ditët e sotme, vihet re që konkurrenca është bërë më e drejtpërdrejtë dhe prania e grave është kudo, në nivele të lartë apo të mesme drejtuese, në nivel vendor apo nivel qendror, në sferën politike apo publike, në çështje ekonomike apo sociale.

Po të hedhim vështrimin në administratën publike qendrorë apo vendore të gjithë jemi pjesë e realitetit që shumë vajza apo gra janë zgjedhur në nivele drejtuese, kjo falë më shumë garancive që kanë dhënë përballë burrave apo djemve.

Duhet theksuar se, një grua për të arritur në nivele drejtuese ka kaluar një betejë të vazhdueshme të cilën e ka fituar me punë, punë dhe vetëm punë. Pasioni për profesionin ka qenë një shtysë e madhe që më ka udhëhequr vazhdimisht. Dëshira, vendosmëria dhe kureshtja për të mësuar gjëra të reja ka qenë një nxitje e madhe për mua në 15 vite eksperiencë pune në administratë publike.

Një faktor i rëndësishëm që ka ndikim në bërje karrierë për një grua është edhe mjedisi punës. Falë një mjedisi pozitiv, bën që çdo kush që ka dëshirën për të ecur të kryejë specializime-kualifikime -trajtime përgjatë gjithë karrierës së saj.

Po të shikojmë në programet kualifikuese ne nuk kemi dallime gjinore, si institucione ligjzbatuese ne e shikojmë të qartë respektimin në rritje të dokumenteve zyrtarë kombëtar dhe ndërkombëtarë. Pra fryma e sfidës profesionale ka ndryshuar. Referuar “KONVENTA PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ GRAVE “, në nenin 10 ne do të lexojmë se respektohen

a) Kushte të njëjta të bërjes së karrierës dhe të kualifikimit profesional, të frekuentimit të shkollave dhe të marrjes së diplomave në institucionet arsimore të të gjitha kategorive si në fshat ashtu edhe në qytet; kjo barazi sigurohet në arsimin parashkollor; të përgjithshëm, teknik profesional dhe në arsimin teknik të lartë , si dhe në çdo institucion tjetër të kualifikimit profesional;

apo ne nenin 11.

c) Të drejtën për të zgjedhur lirisht profesionin dhe vendin e punës, të drejtën për ngritjen e postit të punës, për punë të qëndrueshme, për të gjitha përfitimet dhe kushtet e punës, të drejtën për përgatitje profesionale dhe rikualifikim, duke përfshirë mësimin e personave në ekonomi, ngritjen profesionale dhe kualifikimin e herëpashershëm .

Ky dokument gjen mbështetje implementimi në institucionet tona, ne shohim që arsimimi dhe kualifikimi i gruas po njeh nivele të larta, referuar posteve në ministri apo kryeministri, drejtori të ndryshme, gra të cilat vijnë nga një karrierë profesionale e konsoliduar.

2. Gruaja në piramidën e saj dhe sfidat e konsolidimit të rolit

Çdo ditë unë takoj gra të mrekullueshme, të cilat i kam kolege, bashkëpunëtore, ndajmë një kafe së bashku. Në çdo përfshirje ato nxjerrin në pah cilësi të tilla, si: fuqinë frymëzuese, qëndrueshmërinë, bërjen e shumë gjërave njëherësh, ndjeshmërinë, vlerat morale, shpirtin e lidërshiptit, aftësitë komunikuese, vizionin, frymën e skuadrës, këmbënguljen, fleksibilitetin dhe pasionin. Këto cilësi i bëjnë gratë të pranishme, tani më shumë se asnjëherë tjetër, si një pasuri e vlefshme e shoqërisë sonë në jetën sipërmarrëse, universitete, si dhe në institucione publike, në parlament, media, art dhe në fusha të tjera.

Ndërkohë që burrat dhe gratë janë dy modele të ndryshme rolesh në menaxhim, studimet e sociologëve dhe psikologëve që e kanë hulumtuar këtë subjekt tregojnë se burrat janë më shumë të përqendruar te pushteti në kuptimin e prestigjit dhe statusit në hierarkinë shoqërore, ndërkohë që stili kryesor i menaxhimit të grave bazohet në ndikimin përmes bashkëpunimit me të tjerët, duke kërkuar për mendime

dhe këshilla. Në këtë mënyrë, ato priren të frymëzojnë dhe të rrisin përfshirjen më tepër se presionin. Psikologët thonë se gratë kanë aftësi organizative e punë në ekip më të mirë dhe nuk janë më pak të afta se burrat, por megjithatë kjo ka sjellë përparimin e tyre me ritme të ngadaltë në shkallët e karrierës.

Duke mos u shkëputur nga profesioni si ekonomiste, nëse bëjmë një analizë SWOT/FDMK të rolit të gruas në drejtim do të kishim paraqitjen si më poshtë:

<p>1. Përparësitë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Fuqizimi i ligjit për barazinë gjinore - Konventat e ratifikuara - Aftësi komunikimi shumë të mira - Guximi dhe marrja mbi vete përgjegjësi - Raporte shumë të mira bashkëpunimi me kolegët - Dëshira për të guxuar, menaxhuar dhe drejtuar - Tolerance, durimi dhe modestia - Këmbëngulja luftarake duke ruajtur butësinë e gruas - Aftësitë për të negociuar dhe deleguar detyra - Prirja e gruas ndaj një mënyre pune të rregullt, të shtruar dhe formale - Rezultate shumë pozitive në punë - Më pak të korruptueshme për të thënë të pakorruptueshme - Përgjegjëse për familjen dhe themeli I shoqërisë - Vendosmëria për ti çuar punët deri në fund - Gratë pranojnë gabimet dhe nga ato nxiten të punojnë e të bëjnë më shumë përpjekje për të ndryshuar 	<p>2. Dobësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vështirësia për të marrë pushtet në ambientin ku ato drejtojnë - Ushtrimi i autoritetit - Mjedisi i vështirë dhe tejet mashkullor në Shqipëri - Nivelet e drejtimit ende monopol të burrave apo djemve - Fuqizimi ekonomik tek burrat dhe më pak te gratë, pavarësia ekonomike ende të pa fituar - Dhuna ndaj grave qoftë kjo verbale apo psikologjike
--	--

<p>3. Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - Mbështetje e grave për trajnime dhe kualifikime - Rritja e buxhetit dhe donacioneve vendore dhe ndërkombëtare - Ndryshime në qasje të shoqërisë shqiptare ndaj dhunës - Zbatimi i kuadrit ligjor për barazinë gjinore - Fuqizimi ekonomik I gruas 	<p>4. Rreziqet</p> <ul style="list-style-type: none"> - Përqendrimi i burrave tek pushteti dhe statuti në hierarkinë shoqërore
--	--

3. Konkluzione dhe Rekomandime

Nuk ka asnjë dyshim që pozita e grave në familje dhe në shoqëri, qoftë nga ana sociale qoftë në aspektin sociologjik mbetet një nga treguesit e rëndësishëm sintetik, mënyrë e sigurt për të matur dhe treguar nivelin e zhvillimit të qytetërimit tonë, masën dhe intensitetin e procesit të integritetit të jetës sociale dhe familjes shqiptare. Të drejtat qytetare dhe kërkesat për plotësimin e standardeve të qytetarisë femërore janë me shumë rëndësi për gruan dhe pozitën e saj intime e sociale, rolin e saj në familje dhe shoqëri.

Të drejtat e qytetarisë së grave nuk mund të jenë më objekt në dorën e burrave, të cilët akoma dëshirojnë të kenë ekskluzivitetin e përcaktimit të madhësisë së qytetarisë për gratë në familje dhe shoqëri. Kjo betejë për të drejtat e qytetarisë nuk është objekt që duhet të mbesë në dorën e burrave. Koha kërkon që respektimi i të drejtave qytetare të gruas në familje dhe shoqëri, të mos shikohet si një sfidë e papërballueshme, por së bashku me programe dhe investime në dije të krijojmë gruan si figurën kryesore të edukimit të brezave.

Edukimi i brezave fillon nga edukimi i nënës. Në programet e edukimit duhet të kemi barazi gjinore. Kurrikulat duhet të jenë formuluar në mënyrë gjithëpërfshirëse, pa dallimet ky profesion shkon për burrat dhe ky për gratë.

Rekomandime për vendimmarrësit për rritjen e përfaqësimit të gruas në nivele drejtuese:

- Në rregulloret e funksionimit të institucioneve të tyre të parashikohet vendosja e kuotës gjinore në nivele drejtuese brenda institucionit.

- Të ruhet balanca gjinore në funksionet drejtuese.
- Të përcaktohet një buxhet në ngritjen e kapaciteteve të grave në institucionet vendore duke i mbështetur ato me trajnime dhe specializime.
- Të kryhen fushata sensibilizimi me aktorët kryesore në fushën e mjekësisë dhe edukimit, si fushata për ekzaminime mjekësore falas apo seanca këshillimore, edukim karriere dhe programe edukimi në zonat rurale.

4. Bibliografi

1. Ferree, Myra Marx dhe Patricia Yancey Martin. 1995. *Feminist Organizations Harvest of the New Woman's Movement*. Piladelfia: Temple University Press.
2. Garcia, Ada dhe të tjerë. (& Konfederata Europiane e Sindikatave). 1999. *The "Second Sex" of European Trade Unionism*. Bruksel: Konfederata Europiane e Sindikatave.
3. Këshilli i Europës. 2000a. *Positive Action in the Field of Equality Between Women and Men: Final Report of the Group of Specialists on Positive Action in the Field of Equality between Women and Men (EG-S-PQA(2000))*. Strasburg: Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Divizioni i Barazisë ndërmjet Burrit dhe Gruas, Këshilli i Europës.
4. Këshilli i Europës. 2000b. *National Machinery, Action Plans and Gender Mainstreaming in the Council of Europe Member States since the 4th World Conference on Women (Beijing 1995)*. 18 Shtator 2000 Strasburg: Drejtoria e Përgjithshme e të Drejtave të Njeriut, Divizioni i Barazisë ndërmjet Burrit dhe Gruas, Këshilli i Europës.
5. Këshilli i Europës. 2000c. *Council of Europe activities since 1995 in the field of equality between Women and men related to the strategic objectives in the Beijing and Vienna Platforms for Action, 54f*. Strasburg: Këshilli i Europës.
6. Mackay, Fiona dhe Kate Bilton. 2000. *Learning from Experience: Lessons in Mainstreaming Equal Opportunities, Governance of Scotland Forum*. Edinburg: University of Edinburgh
7. Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët. 2000. *"Women in Transition"*. Nju Jork: Kombet e Bashkuara.
8. Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim. 2000. *Women's Political Participation and Good Governance: 21st Century Challenges*. Nju Jork: Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim

9. Dhamo, M. & Co. *Analiza e teksteve të shkollës fillore në kuadrin e edukimit me shprehitë për jetën* UNICEF, Tiranë 2006

Anjeza SHIKO (ÇOTA), lindur në Vlorë, më 30 gusht 1980, diplomuar në Universitetin e “*Ismail Qemali*” Vlorë, Fakulteti i Tregëtisë, Dega Administrim Biznesi, diplomë profili Menaxher Biznesi. Përfunduar Masterin Shkencor me titull “Marketing dhe Menaxhim Financiar”, Tiranë. Gjithashtu është diplomuar në Drejtësi, Fakultetit i Shkencave Humane, Departamenti i Drejtësisë, Universiteti “*Ismail Qemali*” Vlorë. Në përfundim të masterit profesional me titull “Shkenca Administrative” Departamenti i Drejtësisë, Universiteti “*Ismail Qemali*” Vlorë. Përfunduar kursin pasuniversitar “Vlerësim i pasurive të paluajtshme”, Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Tiranë dhe pajisur me licencë vlerësuese. Përfunduar specializimin për “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik”, Ministria e Financave Tiranë. Dëshmi aftësi për “Kontabiliteti i Informatizuar ALPHA” dhe “Kontabiliteti i Informatizuar Financa 4.0”. Përfunduar kurs trajnimi “Kontabël i miratuar”, pajisur me certifikatë, organizuar nga Lidhja Profesionale, Kontabël të Miratuar. Pjesëmarrëse më kurse trajnimi si: “Parandalimi i konfliktit të interesit”, “Prokurimi publik me mjete elektronike”, “Funksionet e përbasjkëta dhe të deleguara”, “Procedurat e buxhetimit”, pajisur me certifikatë, organizuar nga Instituti i Trajnimit të Administratës Publike. Moderatore në workshopin “Etapat e buxhetimit me pjesëmarrje”, organizuar nga Bashkia Vlorë. Ka punuar si specialiste, përgjegjëse dhe drejtore në Bashkinë Vlorë me një eksperiencë prej 15 vitesh. Aktualisht drejtore e Drejtorisë së Shëndetit Publik dhe Mbrojtjes Konsumatore në Bashkinë Vlorë.



GRUAJA MUNDET

MSc. Aulona JONUZI

Kryeaudituese, Kontrolli i Lartë i Shtetit
ajonuzi@klsh.org.al

Abstrakt

Gratë kontribuojnë në shoqëri në mënyra dhe në fusha të ndryshme. Gruaja sot angazhohet në aktivitete social për një shoqëri më të mirë. Gratë sot zgjedhin profesione në fusha me impakt në shoqëri si mjekësi, inxhinieri, IT, etj fusha të cilat disa dekada më parë nuk imagjinoreshin të prekeshin nga gruaja. Gratë sot trajnohen e kualifikohen e megjithatë diferencat mes burrave dhe grave vijnë ende sot në formën e hendekëve të pagesave, mundësive jo të barabarta për avancim dhe përfaqësimeve të ç'balancuara në procese të rëndësishme vendimmarrjeje.

Në të gjithë diversitetin e kontributeve të përmendura më sipër, asnjëherë nuk duhet harruar roli i gruas si nënë, në zhvillimin e aspekteve emocionale dhe psikologjike të fëmijëve në veçanti e brezave në përgjithësi. Në këtë kontekst gruaja luan rolin e saj më të rëndësishëm, atë të edukimit dhe disiplinimit të brezave.

***Fjalë kyçe:** gruaja, zhvillim social, barazi gjinore.*

1. Hyrje

Dëshiroj ta nis këtë shkrim modest me 3 figura femërore që kanë sjellë ndryshime thelbësore në historinë e njerëzimit, si shembulli më i mirë se gruaja mundet! Është detyrë e të gjithëve, të njohim arritjet dhe kontributet e grave, dhe të inkurajojmë rritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të potencialit të tyre si kontribut jo vetëm individual por edhe shoqëror.

Sozhurner Truth (1797 – 1883) Abolicioniste Afrikano-Amerikane dhe aktiviste e të drejtave të grave. Në vitin 1851, ajo mbajti fjalim-in e famshëm “A nuk jam unë grua?”, e cila në gjuhë të thjeshtë shpjegon se si gratë janë të barabarta me burrat.



Marie Curie (1867 – 1934) ishte një shkencëtare polake që fitoi çmimin Nobel në Kimi dhe Fizikë. Puna e saj kërkimore ishte në fushën e radioaktivitetit. Gjatë Luftës së Parë Botërore, Kuri praktikoi përdorimin e Rrezeve-X, si dhe zbuloi 2 elementë të rinj polonium dhe radium. Puna e saj shkencore u bë edhe më e njohur për shkak të diskriminimit që në atë kohë ekzistonte përkundrejt grave. Ishte profesoresha e parë femër në Universitetin e Parisit, e cila për hir të së vërtetës shembi shumë barrierë në shkencë.



Nënë Tereza (1910-1997) ia dedikoi jetën e saj shërbimit ndaj të varfërve duke u bërë ikonë globale e duke fituar më tej çmimin Nobel për Paqen në vitin 1979.



2. Përse është i rëndësishëm roli i gruas.

Zhvillimi social është njëkohësisht proces dhe produkt që përfshin përpjekjet e drejtuara drejt përmirësimeve në cilësinë e jetës brenda shoqërive. Pjesëmarrja e individëve dhe grupeve ndodh në mënyrë implicite brenda zhvillimeve sociale (Mary Ann Brenden et al). Përfshirja e njerëzve në procesin e marrjes së vendimeve që ka të bëjë me jetët e tyre lidhet ngushtësisht me rritjen personale dhe me dinjitetin e tyre. Nën këtë këndvështrim, pjesëmarrja është një komponent kritik i rritjes së cilësisë së jetës dhe si pasojë e zhvillimit social.

Gratë janë një element i rëndësishëm i shoqërisë. Shoqëritë moderne prej kohësh

kanë nisur të njohin identitetin individual të grave. Tashmë gjerësisht pranohet se gruaja ka aspiratat e saj, aftësitë dhe cilësitë po aq sa burri si dhe gjithashtu pranohet që ajo duhet të ketë mundësitë për të zhvilluar mbështetur mbi zgjedhjet e saj.

Gratë kontribuojnë në shoqëri në mënyra dhe në fusha të ndryshme. Gruaja sot angazhohet në aktivitete social për një shoqëri më të mirë. Gratë sot zgjedhin profesione në fusha me impact në shoqëri si mjekësi, inxhinieri, IT, etj, fusha të cilat disa dekada më parë nuk imagjinoheshin të prekeshin nga gruaja. Gratë sot trajtohen e kualifikohen.

Nuk është sekret tashmë fakti që gratë, historikisht janë përballur me barriera më të mëdha se sa burrat kur bëhet fjalë për pjesëmarrjen në ekonomi për shembull. Diferencat mes burrave dhe grave vijnë ende sot në formën e gap-eve të pagesave, mundësive jo të barabarta për avancim dhe përfaqësimeve të ç'balancuara në procese të rëndësishme vendimmarrjeje.

Nga një anketë për një studim, të realizuar nga Fondacioni Rockefeller, pasja e grave në pozita lideri për të shërbyer si role model, është kritike jo vetëm për avancimin në karrierë të grave, por gjithashtu për të prodhuar impakt të gjerë shoqëror sa I takon pagesave të barabarta, politikave të punësimit në mënyrë që të përfitojnë si burrat ashtu edhe gratë, por edhe për të tërhequr forcë pune të diversifikuar.

Gjithashtu barazia gjinore në tregun e punës është bërë një linjë europiane parësore. Kështu Bashkimi Europian ka krijuar një legjislacion të rëndësishëm në fushën e barazisë gjinore I mbështetur në identifikimin e mundësive të barabarta për gratë dhe burrat si një “detyrë parësore” e BE-së, dhe njëkohësisht kusht për zhvillimin ekonomik të tregut. Si rrjedhojë, në ditët e sotme, promovimi i mundësive të barabarta gjinore është një element qendror në politikat dhe planifikimin ekonomik të BE-së dhe shteteve anëtare në veçanti. Traktati i të Drejtave Themelore të Bashkimit Europian garanton si një parim themelor barazinë midis burrave dhe grave.

Në këtë kontekst, barazia gjinore ka të bëjë me realizimin e të drejtave të njeriut për të gjithë. Injorimi sistematik dhe diskriminimi i vazhdueshëm ndaj pothuajse gjysmës së popullsisë së botës është jo etik dhe cënon të drejtat themelore të njeriut.


Në të gjithë diversitetin e kontributeve të përmendura më sipër, asnjëherë nuk duhet harruar roli I gruas si nënë, në zhvillimin e aspekteve emocionale dhe psikologjike të fëmijëve në veçanti e brezave në përgjithësi. Në këtë kontekst gruaja luan rolin e saj më të rëndësishëm, atë të edukimit dhe disiplinimit të brezave.

Ajo që dua të them është që, vërtetë duhet të luftojmë fort për të arritur atë që duam, por lufta jonë parësore duhet të jetë ajo e të gdhendurit të një modeli shembull për fëmijët tanë. Ky duhet të jetë motivi mbas çdo përpjekjeje tonën për të

ecur përpara. Jam e bindur që nëse motivi devijon, impakti do të jetë thellësisht dhe vetëm individual, ndërsa kontributi ndaj shoqërisë I cënuar .

Prandaj dëshiroj ta mbyll këtë shkrim me një shprehje frymëzuese: “Për gratë e forta! Që të mund t’i njohim ato! Që të mund të jemi ato! Që të mund t’i rrisim ato!”

MSc. Aulona JONUZI. Lindur në Vlorë më 22.11.1981, është diplomuar për financë pranë Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Ekonomisë. Gjithashtu pranë këtij Fakulteti në vitin 2013 u diplomua në MBA. Ka një eksperiencë 10 vjeçare në sektorin bankar si specialiste kredie për bizneset e vogla dhe të mëdha. Prej 4 vjetësh punon pranë Kontrollit të Lartë të Shtetit si kryeaudituese. Është trajnuar në shumë institucione evropiane dhe në Amerikë në fushën e auditimit. Gjithashtu numëron një numër të konsiderueshëm artikujsh në gazeta shqiptare për problematikat gjatë procesit të auditimit dhe standardizimit të procedurave. Është njohëse e gjuhëve të huaja si anglisht dhe italisht.



ROLI I GRUAS NË SHOQËRI NË NJË PRESPEKTIVË SOCIALE

MSc. Ina ISLAMAJ

*Psikologe klinike, Spitali Psikiatrik "Ali Mihali" Vlorë
ina21islami@gmail.com*

Abstrakt

Të jesh grua nuk është një përcaktim natyror, biologjik apo psikologjik. Ajo është produkt i historisë së civilizimit derisa ka arritur statusin e saj aktual.

Gratë luajnë shumëllojshmëri të roleve të rëndësishme në shoqërinë tonë që nga lindja e tyre deri në fund të jetës. Edhe pasi i luan të gjitha rolet dhe të gjitha punët në kohë dhe në mënyrë eficiente në shoqërinë moderne, ajo është e dobët, sepse burrat janë ende gjinia më e fortë e shoqërisë.

Cilët janë elementet e gruas se suksesshme: e para historia e saj personale, familjare apo vitet e para të jetës aty ku fëmija në një nga stadet e zhvillimit psiko-seksual identifikohet me prindin e të njëjtit seks. Më vonë ndodh fillon projektimi, marrim elemente, detaje të asaj që duam të krijojmë tek vetja jone.

Përcaktimi i rolit të saj social i përshtatet dinamikës së kohës që ajo jeton. Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e gjithë secilit pa të cilën nuk mund të imagjinojmë suksesin e jetës. Janë tërësisht përgjegjëse për suksesin e vazhdimësisë së jetës në planet përmes lindjes apo riprodhimit. Kushtet e tyre sot kanë ndryshuar, ato marrin pjesë në aktivitete më shumë sesa familja dhe fëmijët. Ky zhvillim është rezultat i edukimit dhe vlerave sociale që ato mbartin. Fatmirësisht stili i jetës së tyre po ndryshon jo vetëm në cilësinë e vendit të punës por edhe në zotërimin e posteve të ndryshme drejtuese.

***Fjalë kyçe:** grua, feminizëm, rol social.*

Historia e feminizmit mbart në vetvete tërësinë e lëvizjeve dhe aktiviteteve sipas një rrjedhje kronologjike me ideologjinë e përbashkët që ka synuar dhe synon të drejta të barabarta për gratë. Edhe pse feministët në mbarë botën janë motivuar

nga shkaqe, qëllime dhe synime në varësi të kohës, kulturës dhe vendit, shumica e historianeve feministe përëndimore pohojnë se të gjitha lëvizjet që punojnë për të fituar të drejtat e grave duhet të konsiderohen lëvizje feministe. Të hershme janë kohët kur ato protestonin për të drejtën e votës, të pronës, të abortit dhe shumë të tjera. Po sot? Si ka ndryshuar shoqëria jonë dhe cilat janë sfidat që ndikojnë dhe përcaktojnë rolin e saj si vajzë apo grua?

Së pari, ne duhet të qartësojmë kuptimin skematik të fjalës grua. Ne nuk lindim të tilla, nuk lindim vajza apo gra. Ne bëhemi të tilla. Të jesh grua nuk është një përftim natyror, biologjik apo psikologjik. Ajo është produkt i historisë së civilizimit derisa ka arritur statusin e saj aktual.

Së dyti, për çdo grua në veçanti është historia e saj personale, fëmijëria e saj që e përcaktojnë atë si grua, që krijojnë esencën e saj të përhershme, atë që ne e quajmë feminitet. Ndryshimet biologjike përcaktojnë patjetër rolet tona sociale, por ato ndikohen së tepërmi nga konteksti social që i rrethon. Ndryshimet biologjike janë të dukshme dhe sinjifikative dhe padyshim që për një grua është e rëndësishme lindja dhe të qenurit nënë, por nuk është kjo baza e ndryshimit mes rolit të gruas dhe burrit.

Përcaktimi i rolit të saj social i përshtatet dinamikës së kohës që ajo jeton. Gratë luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e gjithë secilit pa të cilën nuk mund të imagjinojmë suksesin e jetës. Janë tërësisht përgjegjëse për suksesin e vazhdimësisë se jetës ne planet përmes lindjes apo riprodhimit. Kushtet e tyre sot kanë ndryshuar, ato marrin pjesë në aktivitete më shumë sesa familja dhe fëmijët. Ky zhvillim është rezultat i edukimit dhe vlerave sociale që ato mbartin. Fatmirësisht stili i jetës se tyre po ndryshon jo vetëm në cilësinë e vendit të punës por edhe në zotërimin e posteve të ndryshme drejtuese. Nuk mund ta harrojmë se jeta e një gruaje është shumë më tepër e komplikuar se jeta e një burri.

Një grua duhet të kujdeset për jetën e saj personale dhe nëse është nënë duhet të kujdeset për jetën e fëmijë ve të saj. Ajo ka një jetë më të komplikuar sepse respekton të gjitha rolet sociale që i mbivendosen si vajze, mbese, kunate, grua, nënë, gjyshe etj jo se meshkujt nuk kanë role sociale, por diferencojnë dukshëm në respektimin e këtyre roleve krahasuar me gratë. Interesi i tyre në aktivitete sociale dhe kulturore është rritur. Gratë janë profesioniste, punojnë për familjen dhe kanë një koncept individual dhe të pavarur të të menduarit. Si nëna, roli i tyre në zhvillimin emocional dhe psikologjik të fëmijës është bërë gjithnjë dhe më sinjifikativ. Ajo nuk është vetëm krijuese e jetës, por dhe një mentore shumë e mirë për vazhdimësinë e saj.

Gratë bashkohen në vlera të përbashkëta: janë biologjikisht me të ndjeshme, janë gjithmonë të interesuara për jetën e fëmijëve dhe të komunitetit të tyre, janë për paqe dhe zhvillim dhe asnjëherë për luftë territoriale apo gjenocide. Gruaja ka një mision ne jete atë të krijimit të jetës dhe mbarëvajtjes së saj. Sa me shumë

të forta ekonomikisht janë gratë aq më shumë para shkojnë për edukimin dhe mirëqenien e fëmijëve të tyre, sa më shumë të jenë të përfshira ato në qeverisje aq më tepër demokratik është shteti. Gratë po realizojnë një revolucion sot në shoqërinë tonë përmes punës së tyre për ti treguar shoqërisë se ato janë prezente sepse janë së bashku dhe luftojnë për veten. Sot, gratë advokojnë për të pasur një përfshirje të barabartë politike, ekonomike dhe sociale.

Në këto kushte roli dhe funksioni i vajzës, gruas merr një konotacion më të plotë. Po përse shpesh herë ka një keqkuptim në përkufizimin e fjalës feminizëm? Ndonjëherë ka një konfuzion kaq të madh në këtë fjalë, sa që te luftosh për të drejtat e grave duket sikur ky koncept bëhet sinonim me urrejtjen ndaj burrave. Dhe nëse ka diçka që duhet ndryshuar duhet nisur nga ky koncept. Feminizëm do të thotë: femrat dhe meshkujt duhet të kenë të drejta të barabarta. Pra, një barazi në të drejtat politike, ekonomike dhe sociale. Ekziston një korrelacion i drejtë lidhur me fuqizimin e gruas dhe pushtetin e saj. Dhe jo pak herë ky pushtet përkufizohet për ato gra që duhet të jenë të forta, agresive dhe jo pak here dhe armike me meshkujt. Ky nuk është fuqizimin, pushtet dhe aq më pak femnilitet. Nëse flasim për feminizëm duhet të mendojmë barazinë në mundësi, në të drejta dhe në liritë tona të barabarta si qenie humane.

Në shoqërinë e sotme shqiptare, gruaja përkufizohet me epitete si e brishte, e kujdesshme, familjare, riprodhuese, amvise e mire. Në fakt gruaja është më tepër se kaq. Gruaja është toke, është bujare si toka, e forte si toka, e mire si toka, e thelle si toka, por si kundër edhe toka gruaja po përball disa sfida që janë shumë të mëdha. Ajo duhet dhe përpiqet të jetë e suksesshme. Gruaja e suksesshme është e konsoliduar në profesionin e saj, e ka të qartë atë që dëshiron të beje dhe do të arrij. Por, gruaja sot në shoqërinë tonë vuan një rol të dyzuar për të pranuar rolet tradicionale si ato të nënave të tyre por njëkohësisht duhet të di tu përshtatet dhe sfidave të kohës së sotme. Pritshmëritë ndaj grave sot kanë ndryshuar, dikur detyrat që shtroheshin ndaj saj kanë qene: te jetë e aftë të riprodhohet, të gatuar, të kujdeset për fëmijët, për burrin, vjehrrin dhe vjehrrën. Ndërsa sot, përpos gjithë këtyre detyrave duhet gjithashtu të ketë një profesion, të dijë gjuhë të huaja, të bëjë kërkime shkencore, të bëjë mastera dhe doktoratura, të kujdeset për veten, fëmijët, të mos prish fjalë me burrin të trajtohet fizikisht etj. Përgjithësisht ato gra të suksesshme janë ato që realizojnë të paktën 70% të këtyre detyrave. Cilët janë elementet e gruas së suksesshme: e para historia e saj personale, familjare apo vitet e para të jetës aty ku fëmija në një nga stadet e zhvillimit psiko-seksual identifikohet me prindin e të njëjtit seks. Më vonë ndodh fillon projektimi, marrim elemente, detaje të asaj që duam të krijojmë tek vetja jone.

Përveç detajeve që duam të jemi te zonja apo te suksesshme duam të jemi dhe te bukura, sepse është kënaqësi të ndihesh dhe e bukur. Në vazhdimësi të pritshmërive tona, pritshmëritë vetjake janë te ngjashme me ato sociale. Në presim të jemi nëna

shumë të mira, por çfarë ndodh në një kontekst social ku koha që i kushtohet familjes dhe fëmijës është shume e pakët. Gruaja ka një peshë të madhe mes jetës së saj familjare dhe asaj profesionale dhe ky dyzim reflektohet dhe tek fëmijët. Në këtë kontekst ka një gjurmë të madhe në mënyrën si e konceptojmë veten, qe do të thotë për çdo gjë duhet të kujdesemi, të tregojmë interes përveç vetes jo, kjo shkon paralelisht me kontributin që gruaja jep për këdo përveç vetes së saj jo.

MSc. Ina ISLAMAJ, lindur në Vlorë, diplomuar për Psikologji në Fakultetin e Shkencave Sociale , pranë Universiteti të Tiranës, ku edhe aty ka kryer studimet pasuniversitare për Master Shkencor në Psikologji Klinike. Ka përvojë profesionale si vullnetare në disa institucione publike dhe organizata joqeveritare të cilat kanë në fokus mbrojtjen sociale të shtresave dhe grupeve në nevojë si për shembull *CRCA “Children’s Right’s Center of Albania” World Vision Albania, Qendra Shqiptare për Shëndetin Mendor*. Ka njohuri shumë të mira të gjuhës frënge dh angleze. Që nga Marsi i vitit 2015 punon si psikologe klinike në Spitalin Psikiatrik “*Ali Mihali*” Vlorë.



ZBATIMI I LIGJIT PËR NJË EMANCIPIM TË SHPEJTË TË GRUAS SHQIPTARE

Melaize SELAMAJ

*Administratore Njësia Administrative Orikum, Bashkia Vlorë
melaizeselamaj@yahoo.it*

Abstrakt

Edhe pse bazat ligjore mbi të drejtat e barazisë gjinore konsiderohen të plota, problem ende kyc mbetet zbatimi i tyre. Sidoqoftë pavarësisht arritjes individuale të disa grave në sektorin publik dhe privat, disniveleli midis zonave rurale dhe qytet-eve të mëdha e bën Shqipërinë një vend që ka akoma shumë punë për t'ju afruar një nivel barazie gjinore të respektueshme

Në Bashkinë e Vlorës, në konceptimin e politikave të saj është vendosur në kulturën e punës një qasje të re, harmonizimi i dimensionit gjinor në disa faza të buxhetit të saj. Është e nevojshme që nismat e marra duhet të bashkërendohen me aktorë të ndryshëm që veprojnë në këtë fushë, në mënyrë që mos të ngelen thjeshtë në kuadrin e sensibilizimit, por të shndërrohen në një punë të drejtpërdrejtë dhe të prekshme në 4 njësitë administrative të Vlorës. Vetëm në këtë mënyrë do të bëjmë të mundur sensibilizimin e qytetarëve për të përdorur mjetet dhe shërbimet e këtij mekanizmi, por edhe të realizojmë korrigjimin e të gjitha dukurive të dhunës.

Krijimi i drejtësisë sociale për gratë përmbledh një ristrukturim të thellë të shoqërisë dhe mënyrën se si njerëzit mendojnë rreth kësaj dhe si përjetojnë shoqërinë.

***Fjalët kyçe:** emancipim, diskriminim, barazi gjinore.*

1. Hyrje

Gjatë shekujve roli i gruas në shoqëri ka marr një zhvillim gjithmonë dhe me të rëndësishëm sigurisht që ka ndryshuar, nga ndezja e oxhakut shtëpiak ka arritur

në një pothuajse emancipim të kompletuar femëror dhe gruaja ka fituar kështu rolin e saj të rëndësishëm në shoqëri, duke fituar hap pas hapi ato pak të drejta dhe liri në krahasim me burrin, ky i fundit ka qenë gjithmonë në qendër të aktiviteteve politike, kulturore dhe sociale.

Zhvillimi i rolit të gruas në shoqëri ka patur ngritje-ulje dhe mund të them në mënyrë të përmblodhur se ka një diferencë të madhe që i përket shoqërisë shqiptare midis qytetit dhe fshatit. Është e vërtet që sot gruaja mund të zgjedh, të punoj, të votojë, të krijojë ose jo familje. Por a mund të flasim për mundësi të barabarta? Sigurisht që jo. Shqipëria mbetet ende një vend në zhvillim, ende nuk është anëtarësuar në BE, me një ekonomi jo të qëndrueshme, tradita dhe kanune që ende respektohen në disa zona, kjo automatikisht që ndikon dhe në rolin e gruas dhe zhvillimit e saj në shoqëri. Pavarësisht konventave, traktateve, dhe akteve nënligjore shumë rrugëdalje të fituara, gruaja ende sot, edhe pse më e vetëdijshme dhe e lirë, kërkon akoma shumë punë dhe bashkëpunim për të luftuar kundër paragjykimëve dhe mentalitetit.

Dokumenti ku janë mbështetur të gjitha ligjet, vendimet dhe udhëzimet mbi të drejtën e barazisë gjinore ka fillesat e tij me Konventën mbi Eliminimin e të gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW), miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së, dhe hyri në fuqi në 1981.¹

CEDAW është një dokument i rëndësishëm udhëheqës në veprimtarinë e përditshme qeveritare për barazi gjinore dhe për shoqatat e grave, sepse mbi bazën e saj dhe të rekomandimeve të komitetit të CEDAW janë ndërmarrë nisma për përmirësime ligjore, të tilla si: hartimi dhe miratimi i ligjit 9970, datë 24.08.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri”²; Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Ligji nr.10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, Ligji nr.9198, datë 26.2.20014 Për Një Shoqëri Gjinore të Barabartë³, etj.

Nuk dëshiroj të trajtoj gjatë bazat ligjore dhe dokumentet pasi mund të konsiderohen të plota, më tepër duhet të fokusohemi tek zbatimi i tyre. Në qytetin e Vlorës, shoqata joqeveritare, Qendra Aulona, Aleanca e Grave Këshilltare gjithnjë dhe më shumë po i kushtojnë vëmendje rolit të gruas duke bërë lobime dhe aplikime për zbatimin në terren të të drejtave të grave në shoqëri. Për të tretin vit

1 Konventa e CEDAW e 1979 është ratifikuar nga 185 shtete. Shqipëria e ratifikoi CEDAW në vitin 1993 me Ligjin nr. 1769, datë 9.11.1993.

2 Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 fq zyrtare ligje.gov.al

3 Ligji nr. 9198, miratuar më 26.02.2004, Për Një Shoqëri Gjinore të Barabartë (2004), plotëson kuadrin ligjor lidhur me të drejtat e barabarta mes burrit dhe gruas. Ligji konsiston në vendosjen e të dyja seksëve në pozita të barabarta në fushën e punësimit, arsimit, vendimmarrjes, kundër diskriminimit dhe ngacmimeve seksuale. Përveç kësaj, ky ligj parashikon ndëshkim ligjor në rast se konstatohen shkelje të tij.

radhazi Bashkia Vlorë në buxhetin e saj ka miratuar një fond special të dedikuar vetëm barazisë gjinore për bashkëpunimin me organizata dhe donatorë.

Me zgjedhjet e 2015 Këshilli Bashkiak i Vlorës përfaqësohet nga 20 gra këshilltare dhe 21 anëtarë burra pra është respektuar ekuilibri i barazisë gjinore të përfaqësimit. Me reformën e re administrativo-territoriale ku ish komuna dhe ish Bashki u shkrinë, është respektuar barazia gjinore për sa i përket përfaqësimit, ku nga 4 Administratorë në territorin e Vlorës, 2 janë femra. Mund të themi se gratë vitet e fundit janë më tepër të përfaqësuara në postet publike.

Bashkia e Vlorës në konceptimin e politikave të saj ka vendosur në kulturën e punës një qasje të re, harmonizimin e dimensionit gjinor në disa faza të buxhetit të saj. Është e nevojshme që nismat e marra duhet të bashkërendohen me aktorë të ndryshëm që veprojnë në këtë fushë, në mënyrë që mos të ngelen thjeshtë në kuadrin e sensibilizimit, por të shndërrohen në një punë të drejtpërdrejtë dhe të prekshme në 4 njësitë administrative të Vlorës. Vetëm në këtë mënyrë do të bëjmë të mundur sensibilizimin e qytetarëve për të përdorur mjetet dhe shërbimet e këtij mekanizmi, por edhe të realizojmë korrigjimin e të gjitha dukurive të dhunës.

Në lidhje me pjesëmarrjen e grave në vendimmarrje, Shqipëria e ka tashmë të sanksionuar në ligj dhe në Kodin Zgjedhor kuotën gjinore prej 30% të përfaqësimit në Parlament. Përfaqësimi i grave në parlament në zgjedhjet e qershor 2017 arriti për herë të parë 28 %, përmirësim i dukshëm në krahasim me zgjedhjet e vitit 2013, kur vetëm 18 % e të zgjedhurve ishin gra.

Shoqëria patriarkale vazhdon të mbizotërojë sidomos në zonat rurale. Gruaja dhe pasuria në emrin e saj mbetet ende një problem madhor për dhënien e kredive për shkak se pjesa më e madhe e pasurive të paluajtshme regjistrohen në emër të Kryefamiljarve burra. Fan Noli e ka krahasuar gruan shqiptare me një mbretëreshë : “Mbretëresha pa Kurorë”. Mbretëreshë pa kurorë pasi Shqipëria vazhdon ende të mbetet një nga shoqëritë ende me faktorin patriarkal të vendosjes. Pasuritë e paluajtshme në pjesën më të madhe janë të regjistruara në emër të babait, vëllezërve ose të bashkëshortit.

Sidoqoftë pavarësisht arritjes individuale të disa grave në sektorin publik dhe privat, disnivele midis zonave rurale dhe qyteteve të mëdha e bën Shqipërinë një vend që ka akoma shumë punë për t’ju afruar një nivel barazie gjinore të respektueshme.

Janë të rëndësishme në këtë kontekst aktet ligjore të BE-së për promovimin e barazisë gjinore. Një masë e re në Marrëveshjen e Komunitetit Evropian është dhe Neni 141 për pagesë të barabartë ndërmjet burrave e grave, i cili siguron se vendet anëtare do të zbatojnë parimin e pagesës së barabartë për punë të barabartë pa diskriminuar për shkak të seksit. Për arritjen e barazisë së plotë ndërmjet burrit dhe gruas në punë, shtetet anëtare duhet të marrin masat për lehtësimin e përfshirjes së seksit të nën-përfaqësuar apo të parandalojnë ose ekuilibrojnë situatën e pafa-

vorshme në karrierën profesionale.⁴

Me nënshkrimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit u hapi një rrugë e re në ndërmarrjen e reformave konkrete dhe të zbatueshme nga ana e shtetit Shqiptar për plotësimin e standardeve mbi barazinë gjinore.⁵

Problemet e qeverisë shqiptare në çështjet e barazisë gjinore vazhdojnë të qëndrojnë kryesisht në disa pika: në përfaqësimin e lartë të grave në punën e papaguar, rrezikun për rikthimin në strukturat e shoqërisë patriarkale, për shkak të nivelit më të lartë të papunësisë të gratë, e lidhur kjo e fundit me rolin e tyre të veçantë në familje, feminizmi i varfërisë, dhuna kundër grave etj.

Duke u bazuar në Progres-Raportin e vitit 2013 nga Komisioni Europian theksohet se një ndër hapat pozitivë në lidhje me të drejtat e grave dhe barazinë gjinore u morr në maj të 2013, me miratimin e ndryshimeve në Kodin Penal që e cilësojnë përdhunimin dhe dhunën seksuale në martesë si një veprë penale. Mekanizmi i referimit për dhunën në familje duhet të konsolidohet më tej, është e domosdoshme gjithashtu një koordinim i mirë ndërmjet institucioneve qendrore dhe vendore që të përmirësohet, si edhe duhet të ngrihen strukturat që mungojnë, konkretisht streha publike dhe shërbimet sociale përkatëse për viktimat.

Plot 50% e grave që i janë drejtuar gjykatës për mbrojtje, e kanë tërhequr më vonë këtë kërkesë. Janë rritur ndjeshëm rastet e raportuara të dhunës së rëndë në familje. Duhet të vendoset një numër telefonik falas dhe një sistem për kompensimin e viktimave gjithashtu dhe të shtohen mjediset për nevoja urgjente.

Shfrytëzimi i kapaciteteve femërore në sektorin publik është një avantazh krahasues. Siç thuhet në Deklaratën e Athinës (1992), gratë përfaqësojnë gjysmën e talenteve dhe aftësive potenciale të njerëzimit dhe nën-përfaqësimi i tyre në marrjen e vendimeve është një humbje për shoqërinë në tërësi.⁶

Organizata të ndryshme qeveritare dhe jo kanë rëndësi të veçantë pasi mund të bëhen promotorë të të drejtave njerëzore të grave dhe vajzave. Për këtë arsye, ka nevojë për t'u përqendruar së bashku në disa fusha kyçe, përmes ndërhyrjeve të përbashkëta të ndërgjegjësimit dhe informimit lidhur me shkaqet dhe pasojat e dhunës, mbështetjes direkte, avokimit, lobimit dhe ndërgjegjësimit, në mënyrë që të punohet drejt trajtimit konkret të vështirësive që lidhen me këto fusha. Krijimi i drejtësisë sociale për gratë përmbledh një ristrukturim të thellë të shoqërisë dhe

4 Te drejtat e grave në kontekstin e të drejtave të njeriut pdf. Aleanca Gjinore për Zhvillim. Autorët: As. Prof. Dr. Arta Mandro Aurora Guxholli, MA Dajana Berisha. Tiranë 2008. ISBN: 978-99956-18-57-5

5 Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2007-2012. Dokument i Ministrisë së Integritit. Tiranë, 2007. Për më shumë informacion shih <http://mie.gov.al/skedaret/1190023508-PKZMSA%202007%20-%20finali.pdf>

6 Deklaratë e nënshkruar nga gratë ministre të vendeve anëtare të BE-së në Samitin e Parë Europian për Gruan në Marrjen e Vendimeve, Athinë 3 nëntor 1992.

mënyrën se si njerëzit mendojnë rreth kësaj dhe si përjetojnë shoqërinë.

2. Bibliografi

1. Konventa e CEDAW e 1979 , ligje.gov.al
2. Ligji nr. 1769, datë 9.11.1993, ligje.gov.al
3. Ligji Nr. 9970, datë 24.7.2008 fq zyrtare ligje.gov.al
4. Ligji nr. 9198, miratuar më 26.02.2004,
5. Aleanca Gjinore për Zhvillim “*Për Një Shoqëri Gjinore të Barabartë*” Tiranë (2004),
6. Prof. Dr. Arta Mandro Aurora Guxholli, MA Dajana Berisha “*Te drejtat e grave ne kontekstin e te drejtave te njeriut* “ , Tiranë 2008, ISBN: 978-99956-18-57-5
7. Dokument i Ministrisë së Integritimit “*Plani Kombëtar për Zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit 2007-2012*”, Tiranë, 2007. <http://mie.gov.al/skedaret/1190023508-PKZMSA%202007%20-%20finali.pdf>
8. Deklaratë e nënshkruar nga gratë ministre të vendeve anëtare të BE-së në Samitin e Parë European për *Gruan në Marrjen e Vendimeve*, Athinë 3 nëntor 1992.

Melaize Selamaj, lindur në Orikum-Vlorë, me 18 gusht 1987, diplomuar në Kolegjin Universitar “Pavarësia Vlorë” për Shkenca Politike me certifikatë merite “Student i dalluar”, ku edhe ka mbaruar në korrik 2014 Diplomën Master Shkencor në “Të drejtë Publike dhe Ndërkombëtare Publike”. Znj. Selamaj ka punuar si Specialiste e Dokumenteve në Sektorin e Lejeve të Drejtimit pranë Drejtorisë Rajonale të Shërbimit të Transportit Rrugorë Vlorë dhe nga 2015 ushtron funksionin si Administratore në Njësisë Administrative Orikum, Bashkia Vlorë. Është trajnuar gjithashtu nga institucione vendase dhe të huaja.



STRATEGJIA E BE PËR ARRITJEN E BARAZISË GJINORE

Doktorante Migena SHEHU

*Specialist, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë
shehu.migena@gmail.com*

Abstrakt

Shtetësia është gjuha e përbashkët për të shprehur aspiratat për idealet demokratike të përfshirjes, pjesëmarrjes dhe anëtarësisë qytetare. Sidoqoftë, vazhdon të jetë një boshllëk i rëndësishëm midis angazhimeve zyrtare ndaj barazisë gjinore dhe qytetarisë së barabartë - në ligjet dhe kushtetutat e shumë vendeve, si dhe në dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut - dhe realitetin e jetës së grave. Barazia gjinore vlerëson progresin drejt dhe pengesat e mbetura për të siguruar shtetësi të barabartë për gratë, zhvillon strategji për ndjekjen e këtij qëllimi dhe identifikon pyetje të reja që do të formojnë hetime të mëtejshme.

Efektet e ndarjes nuk janë gjithmonë negative për gratë; jo të gjitha punët e dominuara nga femrat janë të paguara të ulëta ose përfshijnë kushte të këqija pune. Sipas, “Strategjisë së Nxitjes së Barazisë Gjinore” të Komisionit Europian, normat më të larta të punësimit të femrave mund të shoqërohen edhe me nivele më të larta të ndarjes dhe segregimi mund të ofrojë mbrojtje kundër humbjes së vendeve të punës në rëniet ekonomike.

Promovimi i barazisë gjinore është një aktivitet thelbësor për BE-në: barazia midis grave dhe burrave është një vlerë themelore e BE-së, një objektiv i BE-së dhe një nxitës për rritjen ekonomike. Bashkimi synon të promovojë barazinë ndërmjet burrave dhe grave në të gjitha aktivitetet e saj. Strategjia e Komisionit Europian 2010-2015 për barazinë ndërmjet grave dhe burrave, i dha përparësi pesë fushave kyçe për veprim: pavarësi ekonomike e barabartë për gratë dhe burrat; pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë; barazia në vendimmarrje; dinjiteti, integriteti dhe përfundimi i dhunës me bazë gjinore; dhe promovimi i barazisë gjinore përtej BE-së.

Fjalë kyçe: barazi gjinore, promovim, strategji, BE,

1. Hyrje

Ka disa ligje të ratifikuara ose hartuara në Republikën e Shqipërisë të cilët pozicionojnë gruan në raport me burrat.

Ligji Nr. 9907, datë 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në Shqipëri”, rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësinë dhe shanse të barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmën e tyre në zhvillim në të gjitha fushat shoqërore.

Një publikim i fundit nga Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD) në Shqipëri dhe UN Women, i cili analizon barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave, vlerësoi përparimet e deritanishme në vend, por theksoi se më shumë duhet bërë për përmirësimin e jetës së grave dhe vajzave në Shqipëri.

Dosja Gjinore, përqendrohet në shtatë sektorë kyç ku ende vazhdojnë pabarazitë gjinore dhe diskriminimi gjinor dhe hedh dritë mbi format e veçanta të diskriminimit të shumëfishtë me të cilin përballen grupet e pafavorizuara dhe të marginalizuara të grave dhe vajzave.

“Qeveria e Shqipërisë ka bërë përparime të rëndësishme në krijimin e kornizave përkatëse institucionale dhe të politikave për arritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave, në përputhje me standardet dhe detyrimet ndërkombëtare, rajonale dhe kombëtare për barazinë gjinore”, shkruhet në dokument.

Dosja vlerëson krijimin e mekanizmave institucionalë në fushën e barazisë gjinore, por vëren se këto institucione vazhdon të mos kenë burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare.

Ajo thekson gjithashtu se mbledhja e të dhënave të ndara sipas seksit në Shqipëri shumë e rëndësishme për zhvillim politikash, buxhetim dhe monitorim të përparësive kombëtare të zhvillimit, është larg së qenët e kënaqshme, megjithëse vitet e fundit janë bërë hapa përpara¹.

1 Ivana Dervishi “Barazia gjinore në Shqipëri, një rrugë e gjatë drejt balancimit të peshores”, <https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>; 8 Shkurt 2017.


2. Gratë dhe puna

“Sot gratë në Shqipëri përballen me vështirësi dhe pengesa të shumta në aksesin në tregun e punës dhe vazhdojnë të mbajnë barrën e shumëfishtë të roleve tradicionale gjinore” thotë raporti.

“Përfshirja dhe fuqizimi ekonomik i grave mbetet problematik. Pjesëmarrja e grave në forcën e punës është e ulët dhe një përqindje e lartë e grave dekurajohen të hyjnë në tregun e punës. Përveç kësaj, puna e përkujdesit të papaguar është fushë ekskluzive e grave, çka pengon pjesëmarrjen e tyre në punë prodhuese dhe të paguar” shton ai.

“22 për qind e grave joaktive në punë merren me punë shtëpie, ndërsa kjo ndodh në vetëm 0.2 për qind të rasteve të burrave joaktiv në punë, përmendet në raport. Thuhet gjithashtu se të rinjtë e moshës 15-29 vjeç kanë gati dy herë më shumë gjasa (53 për qind) të jenë në kërkim të punës, sesa të rejtat (21 për qind), të cilat mendohet se tërhiqen për t’u kujdesur për familjen.

Figura 6: Përqindja e ndërmarrjeve të regjistruara kohët e fundit, sipas vitit dhe seksit të pronarëve/menaxherëve*



Burimi: INSTAT 2016

Gratë mbizotërojnë në sektorët e prodhimit të industrisë së lehtë dhe shërbimet jashtë tregut, një tendencë që ka ardhur duke u rritur kohët e fundit. Gratë janë të përqendruara në sektorë si shëndetësia dhe arsimit dhe në një farë mase përfaqësohen edhe në shërbime, shitje me pakicë dhe tregti. Ato kanë gjithashtu më pak gjasa të jenë në pozicione të larta drejtuese, vetëm 14,6 për qind. Hendeku gjinor i pagave është po ashtu jo i plotë në Shqipëri².

2 Ivana Dervishi “Barazia gjinore në Shqipëri, një rrugë e gjatë drejt balancimit të peshores, <https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>; 8 Shkurt 2017.

3. Gratë dhe politika

Në mbarë globin gratë janë dramatisht të papërfaqësuar në qeverisjen qendrore dhe në parlament. Duke iu referuar statistikave dhe të dhënave nga Unioni Ndërparlamentar - IPU, rezulton se në nivel ndërkombëtar gratë zënë 15.7% të vendeve në parlament. 2 Duke iu referuar burimit të mësipërm, vendet arabe kanë përfaqësim më të ulët të grave në parlament, vetëm 6.5% dhe përqindja e grave të përfaqësuar në parlamentet e kontinentit Amerikan është 18.6%. Një situatë e ngjashme paraqitet në Europë, ku përqindja e grave në parlament (përveç vendeve nordike) është 18.5%. Vlen për t'u theksuar fakti se vendet e Europës Veriore janë në krye të listës për sa i përket kësaj përqindjeje, me Suedinë në vend të parë me rreth 44%. Këto shifra tregojnë se pothuajse të gjitha vendet, drejtojnë politikën në mënyrë të tillë, që përjashtojnë afërsisht gjysmën e burimeve dhe talenteve të tyre njerëzore. Jo vetëm në politikë, por edhe në institucionet financiare dhe organizatat ndërkombëtare, të tilla si: Bashkimi Europian, Kombet e Bashkuara, NATO, Banka Botërore dhe grupet e tjera të fuqishme, burrat vazhdojnë të mbizotërojnë pozitën drejtuese. Në këtë prag fushate elektorale pjesëmarrja e gruas në politikë është bërë pjesë e diskutimeve të grave, anëtare të partive politike apo jo, grave të angazhuara në lëvizjen e gruas në Shqipëri, politikanëve e analistëve të medias. Tashmë është fakt: Në Shqipëri, pjesëmarrja e gruas në proceset vendimmarrëse në përgjithësi dhe në politikë në veçanti, mbetet në nivele shumë të ulëta në krahasim me vendet e tjera të Europës Lindore e Qendrore. Ligji aktual shqiptar duket se nuk e favorizon këtë. Një mazhoritar i përzier me proporcional nuk premtonte kuota të përcaktuara qartë për gratë. Vullneti i partive politike për të futur përqindjet e pjesëmarrjes së gruas në vendimmarrje ka mbetur në letër.


4. Referenca

1. Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, “Strategjia kombëtare për barazinë gjinore dhe plani i veprimit 2016-2020”, Miratuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.733, datë 20.10.2016,
2. Komisioni Europian, “Strategjia e nxitjes së barazisë gjinore’ Dokumenti “Angazhimi Strategjik për Barazinë Gjinore 2016-2019” i Komisionit Evropian 74
3. Ivana Dervishi “Barazia gjinore në Shqipëri, një rrugë e gjatë drejt balancimit të peshores, <https://www.reporter.al/barazia-gjinore-ne-shqiperi-rruge-e-gjate-drejt-balancimit-te-peshores-burra-gra/>; 8 Shkurt 2017.
4. Afroviti Gusho “Barazia Gjinore dhe vendimmarrja”, Botim i Qendrës

“Aleanca Gjimore për Zhvillim” Tiranë, Maj 2005

5. INSTAT, “Tregu i punës” 2016, www.instat.gov.al

Doktorante Migena SHEHU, lindur më 20.10.1988, në Tiranë, diplomuar në vitin 2010 për shkencë politike, pranë Fakultetit të Shkencave Sociale, Universiteti i Tiranës, ku edhe ka kryer studimet Master i Shkencave për Marrëdhënie Ndërkombëtare. Aktualisht vazhdon studimet doktorale në Universitetin e Tiranës për marrëdhënie ndërkombëtare. Ka përvojë pune në disa institucione të arsimit të lartë si publike dhe private ku ka qenë e angazhuar në mësimdhënie si lektore apo edhe pranë qendrave kërkimore për asistime në redaktime shkencore të disa botimeve akademike. Zotëron gjuhën angleze, franceze dhe italiane. Është pjesëmarrëse në disa konferenca shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare ku ka mbajtur disa referate në lidhje me fushën e studimeve. Aktualisht mban detyrën si specialiste pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.



NDIKIMI I FAMILJES DHE KARRIERËS NË SJELLJEN FINANCIARE TË FEMRËS

MSc. Xhonsila HOXHA

*Specialist, Drejtorja e Përgjithshme e Përmbartimit, Tiranë
hoxha.xhonsila@hotmail.com*

Abstrakt

Sjellja e individëve ndaj riskut varet nga një sërë faktorësh të ndryshëm që mund të jenë të jashtëm, pra që “thithen” nga mjedisi ose faktorë të brendshëm, që lidhen me karakteristika të individit. Një nga këta faktorë është gjinia.

Gjinia si një faktor demografik mund të shihet si faktor i jashtëm dhe i brendshëm njëkohësisht. Të lindësh femër apo mashkull është diçka që individi nuk ka të drejtën e zgjedhjes. Mirëpo nga ky fat i vendosur nga Zoti individit, dashur padashur, i duhet të reagojë në mënyra të ndryshme ndaj dukurive të ndryshme, përfshirë këtu edhe sjelljen ndaj financave e riskut financiar.

Sipas studimeve femrat janë më tepër kundërshtuese të riskut sesa meshkujt. Ky tipar është i lindur me femrën, në shumicën e rasteve. Gjithashtu ato zotërojnë më pak asete me risk sesa meshkujt beqar apo çiftet e martuar dhe e reduktojnë riskun e marrë përsipër kur numri i fëmijëve rritet, ndryshe nga meshkujt beqarë apo çiftet e martuar (Nancy & Bernasek, 1998)

Fjalë kyçe: grua, familje, karrierë, financa

1. Hyrje

Disa stereotipa bazohen në faktin se gratë shpenzojnë më shumë në familje ndërsa burrat kujdesen për investimet afatgjata. Gratë priren të jenë më shumë të orientuara për të drejtuar paratë e tyre. Ndërkaq, burrat kanë tendencën të jenë të rezervuar në shpenzimin e parave në gjëra të vogla, por ata kanë tendencën të

kryejnë shpenzime të mëdha për blerje të tilla si shtëpi, makinë, tokë etj.

Femrat shpesh nuk janë mbajtëse të mëdha të rrezikut dhe kështu, investimet e tyre bëhen në fusha të njohura dhe të parashikueshme. Dallimet në menaxhimin e parave mes gruas dhe burrit kanë në thelb faktin se nga natyra gruaja është më kundërshtuese e riskut sesa burri kur bëhet fjalë për marrjen e një vendimi financiar. Burrat dhe gratë jetojnë në planetë të ndryshme dhe veprojnë në orbita të ndryshme financiare. Një numër i madh studimesh kanë treguar se sjelljet midis burrit dhe gruas në lidhje me investimet dhe kursimet janë të ndryshme. Meshkujt shpesh rrezikojnë në financa duke rrezikuar me projekte të mëdha dhe ambicioze. Duke u mbështetur në punën e tyre dhe kontaktet, meshkujt janë më të ekspozuar ndaj një game të larmishme të mundësive për investime më tepër sesa femrat (Cawood & Inc, 2005)

2. Gratë, burrat dhe “çështjet e financave”

Gratë në krahasim me burrat kanë qasje të barabarta për të investuar, por pjesë e rëndësishme e shpenzimeve të tyre janë shpenzimet për paraqitje *fizike dhe siguri*.

- **Paraqitja fizike.** Njerëzit tërheqës kanë tendencë për të bërë progres në karrierë edhe në botën e biznesit. Femrat i kushtojnë shumë rëndësi paraqitjes së tyre fizike, shpenzojnë shumë më tepër për veshje, artikuj kozmetik, kujdesin personal etj.

- **Siguria.** Femrat nga natyra kanë tendencë të jenë më të prirura për të parandaluar rrezikun, veçanërisht si nëna. Gratë mund të shpenzojnë më shumë për pushime, dhurata për miqtë, familjen dhe bashkëpunëtorët. Për më tepër, gatishmëria e grave për të dhuruar është një prirje e re e vënë re nga organizatat, të cilat kanë theksuar se dhuratat më të mëdha jepen nga donatore femra.

Edhe pse gratë e martuara kanë qenë tradicionalisht përgjegjëse për menaxhimin, burrat e tyre ende marrin shumicën e vendimeve të mëdha në lidhje me blerjet dhe investimet.

Për shkak të përgjegjësive financiare dhe të ardhurave më të ulëta, gratë kanë pak mundësi për të ndërtuar sigurinë financiare; shpesh ndalojnë së kursyeri kur ato bëhen nëna, pastaj ndodhen në situata të vështira për të filluar përsëri. Në një studim të bërë nga Shoqata e Siguruesve Britanike ka rezultuar se 36% e grave që punojnë nuk kursejnë për pension (Cawood & Inc, 2005).

Konstatohet se ka pak ose aspak efekt në pagat e femrave statusi civil pasi merren parasysh karakteristika individuale të tilla si edukimi apo eksperiencia. Nuk ka një model të qartë për gratë përmes grupmoshave. Por ka, gjithashtu, forca indirekte (duke përfshirë punët në shtëpi dhe fëmijët) lidhur me martesën që nd-

ikojnë në fitimet e grave përgjatë jetës. Ekziston një lidhje sipas studimeve mes gjendjes civile dhe pagës për burrat e cila thotë që një burrë i martuar ka pagë më të lartë sesa të pamartuarit. Kjo lidhje nuk është e njëjtë për femrat. Në vend të kësaj, diferencat në pagë mes grave të martuara dhe atyre të pamartuara mund të shpjegohet nga faktorë të dukshëm të lidhur me martesën, sidomos lindja dhe rritja e fëmijëve. Studimet kanë treguar se meshkujt e martuar kanë paga rreth 11% më të larta sesa burrat që nuk kanë qenë asnjëherë të martuar ndërsa meshkujt që janë të divorcuar kanë paga 9% më të larta sesa ata që janë beqarë. Kjo përqindje më e lartë për burrat e martuar ekziston pavarësisht numrit të fëmijëve. Përfundimi për meshkujt është i pagabueshëm: meshkujt e martuar fitojnë më shumë (*Chiodo & Owyang, 2003*). Por a kemi të njëjtën lidhje edhe për femrat? Jo domosdoshmërisht. Megjithatë femrat beqare të moshës 20-26 vjeç fitojnë mesatarisht 17% më shumë sesa bashkëmoshataret e tyre të martuara, kjo nuk është e gjithë çështja. Moshja dhe gjendja civile janë vetëm dy faktorë që mund të ndikojnë në pagën e grave. Karakteristika të tilla si edukimi, eksperiencia, kohëzgjatja në punë dhe sidomos fëmijët janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në të ardhurat e grave. Në momentin që këto faktorë merren parasysh, efekti i martesës në pagat e grave bëhet statistikisht parëndësishëm. Shumë studime kanë treguar se martesja ka pak ose aspak efekt në të ardhurat e grave (*Korenman & Neumark, 1992*). Por ajo që ekziston është një lidhje mes moshës së martesës dhe pagave të grave. Një studim i vitit 1994 nga ka treguar se shtyrja e martesës në një moshë më të vonë rrit të ardhurat e grave. Edhe pse ata arritën në përfundimin se rritja e të ardhurave e shoqëruar me një martesë të vonuar pakësohet me kalimin e viteve, kjo lidhje çon në përfundimin se një pjesë e karrierës e ndërtuar herët është thelbësore për pagën e një gruaje. Kjo tregon që kapitali human (edukimi, trajnimet etj) është më i lehtë të formohet herët në jetë dhe konfirmon se femrat e reja, beqare do të jenë më të përkushtuara në karrierën e tyre gjatë jetës. (*Chandler, Yoshinori, & Werbel, 1994*) Një nga elementët që përmenden kur studiohen të ardhurat e grave është koha kur ato sjellin në jetë fëmijët. Ndërkohë që për meshkujt pasja e fëmijëve nuk përbën një element vendimtar në të ardhurat e tyre, kjo nuk vlen kur bëhet fjalë për të ardhurat e grave. Për gratë, fëmijët sjellin një kompleksitet të ri në jetën e tyre. Jo vetëm që ata kërkojnë kohë dhe përkushtim të madh, por gratë shpesh e lënë tregun e punës kur bëhen me fëmijë dhe derisa ata janë të vegjël. Koha e shpenzuar larg punës ka një efekt negative në të ardhurat e gruas sepse ajo sakrifikon eksperiencë të vlefshme për karrierën e saj që mund ta merrte ndërsa rri në shtëpi për tu kujdesur për të vegjlit. Edhe nëse një mama e re vendos të rikthehet të punojë, kërkesat e fëmijëve bëjnë që ajo të ulë kohën dhe energjitë që i përkushton karrierës. Në një studim të bërë në vitin 2002 nga ekonomistët *Caçutt, Guner dhe Knowels* u pa se gratë me paga më të ulëta ishin ato që kishin më shumë fëmijë apo që i kishin bërë ata më shpejt sesa gratë me të ardhura më të larta. Ata panë se moshja në të cilën gratë kishin fëmijën e tyre të parë rritej nga

23 vjeç për gratë me të ardhura më të ulëta në moshën 26.7 vjeç për gratë me të ardhura më të larta. (*Caccutt, Guner, & Knowles, 2002*). Kërkimet thonë se gratë e martuara, sidomos ato me fëmijë ka më shumë të ngjarë të punojnë të punë të cilat i ofrojnë fleksibilitet apo orare me kohë të pjesshme në mënyrë që të balancojnë përgjegjësitë që ato kanë për punën dhe familjen. Për ta kompensuar, gratë mund të pranojnë edhe paga më të ulëta në këmbim të fleksibilitetit më të lartë.

3. Konkluzione

Me fjalë të tjera, nuk janë vetë fëmijët arsyeja e të ardhurave më të ulëta për gruan. Vetëm nëse ajo vendos të sakrifikoj të ardhurat e saj të larta për rritjen e fëmijës.

Në këtë mënyrë mund të themi se femrat janë kundërshtuese të riskut më tepër sesa meshkujt. Kjo vjen si pasojë e natyrës së saj që është më tepër mbrojtëse, kërkuese e sigurisë dhe sakrifikuese ndaj familjes por edhe si pasojë e faktorëve të jashtëm, të induktuar nga shoqëria. Martesa vetë nuk ndikon drejtpërdrejtë në të ardhurat dhe sjelljen e femrës ndaj financave por ajo ndikon tërthorazi nëpërmjet faktorëve që lidhen me të siç janë të pasurit e një fëmije, mosha e martesës, numri i fëmijëve apo mosha në të cilën ato kanë fëmijën e parë. Pra, ajo që vlen të theksohet në fund të këtij shkrimi është që një femër, për të pasur të ardhura të larta duhet të synoj ti arrij ato para se të krijoj një familje e të ketë fëmijë pasi në këtë periudhë ajo mund ti përkushtohet plotësisht karrierës, trajnimeve e realizimit të të ardhurave, mund të rrezikoj më shumë në investime riskore por që mund të sjellin shumë përfitime. Pas krijimit të familjes, nga vetë natyra sakrifikuese e femrës ajo priret për të krijuar kushte të sigurta për familjen e saj.

4. Referenca:

1. Nancy, J., & Bernasek, A. (1998). Are women more risk averse? *Economic Inquiry* , 620-630
2. Cawood, F., & Inc, A. (2005). *Personal finance for senior*.
3. Chiodo, A., & Owyang, M. (2003, April). Marriage, motherhood and money: How do women's life decisions influence their wages? *The regional economist* . , pp. 632-648.
4. Korenman, & Neumark. (1992) Chandler, T., Yoshinori, K., & Werbel, J. (1994, December). Do Delays in Marriage and Childbirth Affect Earnings? *Social Science Quarterly* , pp. 838-853.

5. Caccutt, E., Guner, N., & Knowles, J. (2002, May). Why Do Women Wait? Matching, Wage Inequality and the Incentives for Fertility Delay. *Economic Dynamics*, pp. 815-855.

Xhonsila HOXHA. Ka përfunduar studimet e larta Bachelor në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, dega Finance dhe Masterin Shkencor në Financë, Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës. Në vitet 2015-2016 ka punuar si financiere në njërin nga organizatat më të mëdha në Shqipëri, e cila merret me mbrojtjen e të drejtave të grave dhe nxitjen e zhvillimit të tyre.. Ka qenë pjesë e aktiviteteve, trajnimeve e konferencave të ndryshme. Kam realizuar disa publikime të punimeve të mia në konferenca të ndryshme kombëtare e ndërkombëtare ku jam paraqitur si bashkautorë ose si autore e vetme. Më poshtë të listuara disa prej tyre: “Krizë ekonomike në Shqipëri dhe tregu i punës”, “Ku e shohim ne mundësinë e të bërit biznes prej të rinjve”, “Social Insurance in Albania incritical Position. Berati Region”, “Problemet ekonomike të hapësirave urbane”, “**Personal** budgeting indicated by individual characteristics”, “Challenges and prospects of hydropower options in Albania. Can Albania lead the region?” Nga viti 2016 e në vazhdim punon si financiere pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë.



"UNË GRUAJA"...NJË KËNDVËSHTRIM NGA GRUAJA SIPËRMARRËSE

Silvana SADIRAJ

*Administratore "Fjortes" sh.p.k
silvanasadiraj@yahoo.com*

Abstrakt

Gruaja luan një rol të rëndësishëm në ditët e sotme në shoqëri. Nëse kthehemi prapa në kohë, do të shohim se gratë janë përballur me shumë padrejtësi dhe kanë luftuar fort për të fituar të drejtat e tyre.

Në ditët e sotme roli i femrës është zgjeruar masivisht. Nëse kthehemi pas në kohë e rimarrim sërish rrjedhën e ngjarjeve ajo ka fituar së tepërmi role; role, të cilat duhet t'i kishte të fituara që në lindje, por ja që ju mohuan. Femra sot nuk është veçse një bijë, një bashkëshorte, një nënë ajo ka role të tjera në shoqëri, përpos gjithë të shpërmendurave, të cilat janë rolet në familje. Ajo ka rolin të ushtrisë profesionin që dëshiron, të zgjedhe, të zgjidhet, të drejtojë në instancat më të larta shtetërore.

Një grua e suksesshme frymëzon te tjera gra. Kur punoni si drejtuese, si e zgjedhur, mbani premtimet e bëra, punoni me këmbëngulje dhe vullnet. Punoni me profesionalizëm dhe shfaqni paanësi politike ne ushtrimin e detyrave politike.

***Fjalw kyçe:** gruaja, profesioniste, familja.*

Gruaja zë një rol të rëndësishëm në ditët e sotme në shoqëri. Nëse kthehemi prapa në kohë, do të shohim se gratë janë përballur me shumë padrejtësi dhe kanë luftuar fort për të fituar të drejtat e tyre. Më parë femra konsiderohej apo vlerësohej në sajë të dy faktorëve;

1. e destinuar për të kryer punët e shtëpisë,
2. e destinuar për shtimin e anëtarëve të familjes.

Me kalimin e kohës, këto barriera mendore dhe kompleksitet u zhduken, dhe

shoqëria njohu rolin tejet të rëndësishëm që gruaja ka zënë në ditët e sotme.

Gruaja në familje është shtylla kryesore e funksionimit të rregullit familjar. Luan personazhin kryesor, luan rolin me qetësi. Që kur nis dita, ajo duhet të mendojë të rehatojë nga A në ZH familjen. Të kujdeset për veshjen, për ushqimin për pastërtinë, për lulet, gjelbërimin. Derisa, në politikë thuhet, pas një burri të suksesshëm qëndron një grua e zonja. Unë them që pas një familje intelektuale të emancipuar dhe e rregullt, qëndron një grua e hekurt. Të gjithë e dimë që një rol të madh në shoqëri e kudo luan femra dhe më saktësisht grujat!

Femra është një force e madhe lëvizëse në shoqërinë e sotme. Dhe në sajë të këtyre botëkuptimeve që ekzistonin për femrën, femra nuk mund të nxirrte në pah vlerat e saj, por me evoluimin dhe emancipimin e pareshtur të shoqërisë edhe femra mundohet të zërë vendin e saj që i takon në shoqëri. Dhe roli i saj nuk është i paket.

Evoluimi i rolit të femrës në shoqëri nuk mund të themi se ka qenë i menjëherëshëm, përkundrazi ka qenë i vështirë, i mundimshëm e gradual. Femra është e aftë të vendose në funksion të gjitha potencialet e saj, të jetë në detyra të mëdha shtetërore, duke filluar që nga detyrat më të thjeshta e deri tek ministre, drejtore, kryetare parlamenti etj. Shumë femra kanë drejtuar dhe drejtajn shtete të fuqishëm si: Margaret Thecer “*zonja hekurt*” siç është etiketuar, Angela Merkel, Hillari Clinton, kryetarja e gjykatës së lartë në Hage, Doris Pack, e plot të tjera që me punët e tyre kanë çuar përpara shoqërinë.

Të jesh grua në Shqipëri ndodh që të kesh frikë të konkurros me burrat për poste. Në shoqërinë shqiptare me orientim ende të fuqishëm maskilist, me doza të forta të mentalitetit tradicional vazhdon të mbijetojë dhe prodhojë steriotipet gjinore, dhunën, diskriminimin dhe pabarazitë me gjininë tjetër. Prania ende e fuqishme e steriotipeve gjinore dhe dhunës në familje është dëshmia më e qartë se problemi i pabarazisë gjinore është prezent, strukturor dhe kompleks. Fakti që të drejtat e grave janë legalizuar si pjesë integrale e të drejtave të njeriut, është një hap progresiv në rrugën e zhvillimit demokratik të vendit.

Në ditët e sotme roli i femrës është zgjeruar masivisht. Nëse kthehemi pas në kohë e rimarrim sërish rrjedhën e ngjarjeve ajo ka fituar së tepërmi role; role, të cilat duhet t’i kishte të fituara që në lindje, por ja që ju mohuan. Femra sot nuk është veçse një bijë, një bashkëshorte, një nënë ajo ka role të tjera në shoqëri përpos gjithë të shpërmendurave, të cilat janë rolet në familje. Ajo ka rolin të ushtrojë profesionin që dëshiron, të zgjedhe, të zgjidhet, të dretojë në instancat më të larta shtetërore.

Pavarësisht gjithë këtyre serish disa role të saj janë të cinguar, ose cingohen vazhdimisht nga meshkujt, për këtë arsye betejat e femrave nuk kanë të sosur, lëvizjet feministe nuk shuhet kurrsesi sepse femrat kërkojnë barazinë aq shumë të munguar nga e kaluara e të cinguar në ditët e sotme. Sot, të drejtat e femrës

janë një ndër temat më bashkëkohore në trojet shqiptare dhe në përmasa botërore.

Në të gjitha fushat e artit roli i femrës është mjaft i spikatur, kontributi i tyre është i konsiderueshëm në emancipimin e femrës, role të bukura kanë realizuar aktoret tona të mëdha, të skenës dhe ekranit si Margarita Xhepa, Tinka Kurti, Yllka Mujo, etj. Në fushën e mjekësisë mjeke duararta që operojnë me sukses e shpëtojnë jete njerëzish, shkencëtare të ndryshme e deri në Hënë ka dhënë kontributin e saj femra! Ja pra që roli i femrës është shumë i madh në shoqëri ashtu sikurse edhe në familje.

Gratë arrijnë të marrin arsimimin me të mirë dhe zotërojnë një sërë aftësish dhe kualifikimesh që kanë dhënë rezultate të kënaqshme në botën e punës. Gruaja ka arritur të arrij poste prestigjioze, të drejtojnë, si dhe të jetë pjesë e qeverisë. Ajo nuk ndihet me inferiore ndaj burrave dhe arrin të marrë vendime të rëndësishme. Përkushtimi dhe puna e saj kanë bërë që shumë kompani sot të preferojnë gratë ndaj burrave për zgjidhjen e çështjeve me rëndësi. Numri i grave që punojnë është rritur dhe ky faktor ka bërë që ato të kenë fituar pavarësinë e tyre. Edhe roli i saj në familje ka ndryshuar. Nëse dikur familjet ishin patriarkale, sot ka një balancim të autoriteteve dhe mendimi i gruas ka shumë peshe. Megjithatë, nuk duhet anashkaluar fakti që shumë gra, sidomos në zonat rurale, nuk e kanë fituar ende rolin që u takon. Ato janë ende të nënshtruara dhe mbi të ushtrohet dhunë. Këto gra janë viktimë e një mentaliteti kaq mesjetar. Ndryshimet që mund të ndeshësh në një udhëtim nëpër Shqipëri, janë të jashtëzakonshme, sa që të shtyn, të pyesësh veten, se sa i madh është vendi ynë? Si ka mundësi që në një vend kaq të vogël të ketë ndryshime kaq të mëdha në shoqërinë shqiptare? Një gjë e tillë nuk ekziston edhe në vende urbane me një zhvillim ekonomik dhe social siç janë Tirana, Durrësi, Vlora, Elbasani, etj. Në disa zona malore dhe vende të varfra gjen gra që nuk kanë guximin të heqin as shaminë e kokës nga frika bashkëshortit.

Për fat të mirë, shumë prej këtyre grave janë ndërgjegjësuar dhe kanë raportuar padrejtësitë që u bëhen. Shifrat në Shqipëri vërtetojnë se numri i denoncimeve nga gratë po vjen duke u rritur. Shumë organizata nuk ngurrojnë t'u vijnë në ndihmë këtyre grave, duke i bërë të kuptojnë sa të rëndësishme mund të bëhen në shoqëri. Sot, fatmirësisht demokratizimi i sistemit ka ndikuar pozitivisht edhe në demokratizimin e familjes e shoqërisë. Është pozitive dhe për t'u vlerësuar përkushtimi i madh në shkollimin dhe emancipimin e femrës krahas gjinisë tjetër. Shkollimi i femrës në vendet urbane nuk diskutohet, por fatmirësisht edhe në vende rurale përkushtimi në shkollim është i barabartë. Sot kemi femra mjeke, mësuese, inxhinierë, ekonomiste, juriste dhe çdo lloj profesioni tjetër. Gruaja vetëm punën e njëj dhe për të nuk përfundon orari asnjëherë. Sapo kryen orarin e punës, i kthehet turnit të dytë punës dhe obligimeve në shtëpi. Shoqëria jonë ka kuptuar vlerën e gruas dhe me sportivitet pranon integrimin e saj në çdo fushë.

Gratë janë e do të mbeten themeli bazë, ku ngrihen të gjitha vlerat dhe cilësitë

më të mira të shoqërisë bashkëkohore. Përfaqësimi i grave në listat e kandidatëve për Kryetare të Bashkive përpara Zgjedhjeve Vendore 2015, na përforcon bindjen se nëse ky përfaqësim nuk rregullohet me kuotë gjinore si një mekanizëm detyrues për partitë politike, ashtu sikurse për këshilltarët bashkiakë, gratë e vajzat nuk do të mundën dot asnjëherë të marrin pozicionin që u takon në politikë dhe Shqipëria do të vazhdojë të mbetet ndër vendet e fundit në Europë për përfaqësimin e grave si të zgjedhura në krye të Bashkive! Përfaqësimi më i lartë i grave në politikë e parlament, do të bëjë që pikëpamjet dhe interesat e grave dhe vajzave të kenë më shumë shanse të merren parasysh. Kjo do të reflektojë diversitet më të madh të politikave, politika më të mira për fëmijët e familjen dhe do të sigurojë modele për një shoqëri më demokratike. Ne besojmë se pjesëmarrja e grave në parlament nevojitet për të forcuar demokracinë dhe promovuar funksionimin e rregullt të saj. Krijta e pjesëmarrjes së grave në strukturat vendimmarrëse dhe jetën politike është mundësi për fuqizimin e grave. Institucionet dhe politikat mund të jenë më përfaqësuese dhe gjithë-përfshirëse, duke kontribuar kështu në një rrugë më të mirë të zhvillimit. Një grua e suksesshme frymëzon te tjera gra. Kur punoni si drejtuese, si e zgjedhur, mbani premtimet e bëra, punoni me këmbëngulje dhe vullnet. Punoni me profesionalizëm dhe shfaqni paanësi politike në ushtrimin e detyrave politike.

Silvana SADIRAJ, lindur në Vlorë , më 17 Dhjetor 1968. Ka përfunduar arsimin e mesëm në gjimnazin “*Halim Xhelo*”, njohëse e gjuhës italiane dhe që prej vitit 1998 Administratore dhe pronare e biznesit “Fjortes” Sh.P.K.



"UNË GRUAJA"...MIDIS BIZNESIT DHE GRUAS

Ing. Zeliha FERATI

*Drejtuese Teknike në shoqërinë "Ferati" sh.p.k
zeliha_ferati@yahoo.com*

Abstrakt

Gruaja shqiptare luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në familje por edhe në shoqëri. Është bërë një rrugëtim shumë i gjatë dhe jemi akoma në këtë rrugëtim për të ndryshuar konceptin e gruas në vendin tonë. Të drejtat e femrës janë një ndër temat më bashkëkohore jo vetëm në vendin tonë por dhe në përmasa botërore. Të jesh femër në ditët e sotme shpesh konsiderohet si fatbardhësi, kurse në kohët më të hershme ishte vetëm një fatkeqësi.

Në ditët e sotme, femrat po fitojnë gjithnjë e më shumë të drejta, gjithashtu, kanë më shumë rol dhe integrim në jetën sociale, politike dhe ekonomike. Me gjithë këtë, mjerisht, ende vazhdon dhuna fizike, psikike ndaj saj, keqtrajtimet e ndryshme, deri në mbytje, vrasje....! Sipas statistikave, një ndër katër gra ka shanse të bjerë viktimë e dhunës në familje.

Për këtë arsye nevojitet një projektligj për mbrojtjen dhe nxitjen e zhdukjes së dukurive negative në shoqërinë shqiptare. Kjo dukuri ka edhe pasojat praktike kur lidhet një fat bashkëshortor pa përgjegjësi, atëherë shpeshherë vjen edhe deri te shkatërrimi i familjeve bashkëshortore, kështu që divorcimi gjithnjë është në rritje. Le të mbetet në të ardhmen dhe të shpresojmë që brezi i ri të jetë më i vetëdijshëm për hapat që do të hedhin në të ardhmen, në procesin e zhvillimit dhe emancipimit të femrës shqiptare përkrah femrave bashkëkohore të familjeve të shteteve

Është ajo që të solli në jetë. Është ajo që të mbajti në duar, që ti të rritesh i shëndetshëm. Është ajo burimi i vazhdimësisë së jetës...

Fjalë kyçe: gruaja, diskriminim, projektligj.

Për ligjin dhe kodet mund të themi se ato janë thjesht në letër, sepse gjer më sot nuk ka raste të ndjekura penalisht nga shteti shqiptar për gjëra të tilla! Duhet të bëjnë një projektligj për mbrojtjen dhe nxitjen e zhdukjes së këtyre dukurive negative në shoqërinë shqiptare. Kjo dukuri ka edhe pasojat praktike kur lidhet një fat bashkëshortore pa përgjegjësi, atëherë shpeshherë vjen edhe deri te shkatërrimi i familjeve bashkëshortore, kështu që divorcimi gjithnjë është në rritje. Le të mbetet në të ardhmen dhe të shpresojmë që brezi i ri të jetë më i vetëdijshëm për hapat që do të hedhin në të ardhmen, në procesin e zhvillimit dhe emancipimit të femrës shqiptare përkrah femrave bashkëkohore të familjeve të shteteve

Të jesh femër do të thotë shumë, por shumë pak dinë ta vlerësojnë atë! E konsiderojnë si një qenie të dobët, që mund ta ndrydhësh e thyesh lehtë.

Gruaja shqiptare luan një rol të rëndësishëm jo vetëm në familje por edhe në shoqëri. Është bërë një rrugëtim shumë i gjatë dhe jemi akoma në këtë rrugëtim për të ndryshuar konceptin e gruas në vendin tonë. Të drejtat e femrës janë një ndër temat më bashkëkohore jo vetëm në vendin tonë por dhe në përmasa botërore. Të jesh femër në ditët e sotme shpesh konsiderohet si fatbardhësi, kurse në kohët më të hershme ishte vetëm një fatkeqësi.

Sot nuk janë më sekret apo fshehtësi krimet nga më mizoret që janë bërë ndaj femrës gjatë historisë. “Deri vonë gruaja nuk ka pasur të drejtën e votës, ishte e përjashtuar nga jeta kulturore dhe punët publike”. Deri para një shekulli, kudo në Perëndim, vendi i femrës ishte në shtëpi dhe puna më e madhe e saj ishte kujdesi që bënte për fëmijët. Ato ishin plotësisht të varura nga burrat e tyre apo meshkujt e tjerë të familjes...!

Në ditët e sotme, femrat po fitojnë gjithnjë e më shumë të drejta, gjithashtu, kanë më shumë rol dhe integritet në jetën sociale, politike dhe ekonomike. Me gjithë këtë, mjerisht, ende vazhdon dhuna fizike, psikike ndaj saj, keqtrajtimet e ndryshme, deri në mbytje, vrasje...! Sipas statistikave, një ndër katër gra ka shanse të bjerë viktimë e dhunës në familje.

Sot bota ka arritur të hedh hapa gjigantë në zhvillimin e gjinisë femërore! Ajo sot gjendet në pozicione përkrah burrit. Po të bëjmë një udhëtim në disa zona rurale të Shqipërisë mundet të hasim në skena të pabarabarta të gjinisë femërore shqiptare.

Diskriminimi i gjinisë femërore në Shqipëri, nis që në moshë shumë të hershme. Kjo gjë vihet re që në shkollat 8-vjeçare, por shprehet më theksueshëm kur vijon shkollën e mesme. Shpeshherë i përshpejtojnë martesat e tyre në moshën e re për t’ju shmangur shkollimit dhe emancipimit përkrah me burrin. Kjo është thjesht e turpshme, vajzës i gjendet burrë, me ose pa pëlqimin e saj, duhet të krijojë familje edhe pse ajo është thjesht një adoleshente që s’e ka idenë e familjes. Edhe kjo shpeshherë është nën ndikimin e mentalitetit të zonave rurale me qëllim që femra shqiptare të mbetet e “moralshme” (e padukshme, e pakontakt, e pashkollë, e pav-

lerë, si synim i një femre të ndershme).

Prezenca dhe pjesëmarrja e gruas në shoqërinë shqiptare është rritur ndjeshëm në zonat urbane dhe shihet qartë lëvizja e lirë e femrës në ambientet sociale, të punës, politikës, ekonomisë, etj. Një femër është një vajzë, grua, bashkëshorte, mjeke, politikane, misionare, mësuese, gazetare, artizane, sipërmarrëse etj, dhe për të gjitha këto ajo duhet të jetë prezentë dhe me dashuri, përkushtim dhe përgjegjësi të ofrojë modelin dhe kontributin e saj. Zhvillimi dhe emancipimi i gruas në shoqërinë e sotme moderne i jep një imazh shtetit se në cilën shkallë të kulturës jemi si popull apo komb.

Ne duhet të kultivojmë pa u lodhur tek fëmijët tanë paqen, dashurinë dhe harmoninë për të patur breza pasardhës në paqe për një shoqëri më të mirë. Sot ne gjendemi të përfshirë në shumë konflikte, debate dhe pasiguri, prandaj roli ynë si gra është shumë i rëndësishëm. Secila nga ne ka një përgjegjësi të madhe për të mos reshtur kurrë së ofruari si në familje, profesion e shoqëri dhe kjo kërkon shumë energji dhe kurajo duke kontribuar për një jetë më në paqe dhe një të ardhme për fëmijët tanë. Vetëm kështu ne do të jemi të vlefshme si në profesion, shoqëri, familje e kudo, duke bërë të mundur përballjen me sfidat e këtij realiteti ku gjendet mbarë shoqëria shqiptare dhe jo vetëm, por mbarëbotërore. Ne duhet të ofrojmë modelin tonë pa u lodhur çdo ditë, sepse kemi të gjithë nevojë për një jetë më të mirë, për një jetë në paqe, për dialog dhe bashkëpunim. Pa këto ne nuk do mund të jemi dot të realizuara si pjesëtare të shoqërisë të cilës i përkasim. Në politikë thuhet, pas një burri të suksesshëm qëndron një grua, unë them që pas një familje intelektuale, të emancipuar dhe e rregullt, qëndron një grua e hekurt.

Sot, fatmirësisht demokratizimi i sistemit ka ndikuar pozitivisht edhe në demokratizimin e familjes e shoqërisë. Është pozitive dhe për t'u vlerësuar përkushtimi i madh në shkollimin dhe emancipimin e femrës krahas gjinisë tjetër. Shoqëria jonë ka kuptuar vlerën e gruas dhe me sportivitet pranon integrimin e saj në çdo fushë. Në jetën politike kontribut të madh pa dyshim që jep edhe gruaja. Ne sot kemi femra deputete, ministre, udhëheqëse të shumë segmenteve të rëndësishme institucionale, por hapësira në pozitat menaxhuese është e vogël krahasuar me atë se gjysma e popullsisë janë femra. Jeta ka sfida dhe sakrifica, por ne nuk duhet të presim shumë nga mëshira e burrave, por duhet ta përkrahim njëra tjetrën, duhet të jemi me motivuese dhe pretenduese në karrierën tonë sepse shoqëria jonë ka nevojë më shumë për ne.

Përmes kulturës, vetëdijes, pabarazisë gjinore të një populli, mund të kuptohet se emancipimi i saj është një proces i domosdoshëm në të mirën e saj dhe të tërë shoqërisë. Nëse emancipimi i saj nuk u arrit në shkallën e duhur, mund të vlerësohet se nuk ke mundur ta ndërtohet atë popull në skemën e duhur të një populli të zhvilluar. Në një shoqëri që nëpërkëmbet femra, atëherë nuk ka familje të shëndoshë! Duhet të dy partnerët apo e thënë ndryshe bashkëshortët të kenë të drejta të barabar-

ta sepse nuk mund të kesh një bashkëjetesë normale kur njëri është zot dhe tjetri shërbëtor i urdhrave dhe diktateve.

Për ligjin dhe kode mund të themi se ato janë thjesht në letër, sepse gjer më sot nuk ka raste të ndjekura penalisht nga shteti shqiptar për gjëra të tilla! Duhet të bëjnë një projektligj për mbrojtjen dhe nxitjen e zhdukjes së këtyre dukurive negative në shoqërinë shqiptare. Kjo dukuri ka edhe pasojat praktike kur lidhet një fat bashkëshortor pa përgjegjësi, atëherë shpeshherë vjen edhe deri te shkatërrimi i familjeve bashkëshortore, kështu që divorcimi gjithnjë është në rritje. Le të mbetet në të ardhmen dhe të shpresojmë që brezi i ri të jetë më i vetëdijshëm për hapat që do të hedhin në të ardhmen, në procesin e zhvillimit dhe emancipimit të femrës shqiptare përkrah femrave bashkëkohore të familjeve të shteteve

Është ajo që të solli në jetë. Është ajo që të mbajti në duar, që ti të rritesh i shëndetshëm. Është ajo burimi i vazhdimësisë së jetës...

Ing.Zeliha FERATI, lindur në Vlorë, më 28.10.1958. Në vitin 1977 ka përfunduar arsimi e mesëm profesional për Gjeodezi, më pas është diplomuar në vitin 1981 Në universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit për inxhinier për ndërtime civile industrial. Ka kryer disa kurse kualifikimi pasuniversitare si *“Gjeoteknika Sizmike”*, *“Projektim ndërtim monitorim e vepra inxhinierike me lëndë bazë dhera si diga damba, sipas euro kodit 7”* si dhe kurs kualifikimi për *“Menaxhim Biznesi”* në Greqi. Zotëron gjuhët e huaja anglisht, italisht dhe rusisht, si dhe programet kompjuterike profesionale të inxhinierisë. Përvoja profesionale e saj ka nisur në vitin 1981 si specialiste në Degën teknike, ku dhe më pas bëhet kryetare e Degës Teknike në ndërmarrjen Komunale Banesa në Vlorë. Nga viti 1989 deri në vitin 1998 ka punuar si Kryeinxhinierë e ndërmarrjes. Nga Marsi i vitit 1998 është drejtuese teknike dhe njëkohësisht bashkëpronare e shoqërisë *“Ferati “* Vlorë.



TË DREJTAT E GRAVE NË SHQIPËRI

Dr. Arjana LLANO

*Lektore, Departmenti i Drejtësisë Universiteti “Ismail Qemali “ Vlorë
ariana-llano@live.com*

Abstrakt

Roli i gruas në vështrimin historik . Rregullimi kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e grave. Parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut janë pjesë integrale e të gjithë legjislacionit në përgjithësi dhe e çdo ligji e akti nënligjor në veçanti. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk trajton në mënyrë të veçantë të drejtat e grave por duke qenë një dokument sa politik aq edhe normativ, në mënyrë telegrafike ajo i ka gjetur vendin e duhur kujdesit ndaj gruas si nënë. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton qartësisht rol të barabartë të grave dhe burrave në shoqëri. Ligji Për barazinë gjinore në shoqëri e përkufizon “barazinë gjinore” si pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës, si pozitive e barabartë midis grave dhe burrave, mundësi dhe shanse të barabarta për të gëzuar të drejta dhe për të plotësuar detyrime në shoqëri dhe pasur përfitime të barabarta nga arritjet dhe zhvillimet e tyre.. Çfarë përcakton ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës? Cilat janë të drejtat tona që ligji i mbron nga diskriminimi? Aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e gruas . Situata aktuale e pabarazisë gjinore në Shqipëri . Pengesat në zbatim të kuarës gjinore në Shqipëri lidhen me mentalitetin e shoqërisë , me konkurrencën e pandershme midis burrave dhe grave , me agresivitetin e mjedisit politik dhe me mungesën e solidaritetit femëror.

***Fjalë kyçe:** grua, roli i gruas, të drejtat e gruas*

1. Roli i gruas në vështrimin historik

Në periudhën e neolit egzistonin fiset patriakale ku rolin kryesor e luante gruaja .Në epokën e bronzit gruaja e humbi pozitën e saj përcaktuese në familje dhe në shoqëri. Celula bazë e shoqërisë në këtë kohë u bë familja e madhe patriakale ku rolin kryesor e kishte burri .1Në iliri normat e të drejtës ilire ligjëronin pushtetin e burrit mbi gruan .Në Arbëri në vitin 1190-1199 pushteti i sundimtarit ishte i trashëgueshëm. Në rast se mungonin fëmijët meshkuj, pushteti i lartë shtetëror në Arbëri mund të trashëgohej nga gruaja e sundimtarit. Kështu pas vdekjes së Dhimitrit pushtetin e trashëgoi e shoqja e tij Komnena.2 Gjatë periudhës së Skënderbeut u bënë ndryshime në të drejtën zakonore ,ai e forcoi pozitën e gruas në familje .Skënderbeu ndryshoi normën e vjetër zakonore që e lejonte burrin në çdo rast ta shkurorëzonte gruan pa shkak dhe pa i dhënë pasuri .Kështu sipas Kanunit të Skëndebeut gruaja nuk mund të shkurorëzohej pa shkak, Dy shkaqe ishin për shkurorëzim vjedhja, tradhëtia bashkëshortore.Në rast se gruaja ndahej pa arsye ajo do të merrte gjysmën e tokës për sigurimin e jetesës. “Kanuni i Lekë Dukagjinit” i diskriminonte gratë dhe vajzat kështu,ishte parashikuar që Kanuja njëf për trashëgues djalin dhe jo vajzën . “As te prindja as te burri gruaja s’hin në pjesë të trashigimit ”.3 Sot Gratë dhe vajzat trashëgojnë mënyrë të barabartë 4.Kur’ani, është burim i shariatit islam. Në Kuran janë trajtuar të drejtat e grave. Zoti zbriti një sure (kaptinë) të tërë me 176 ajete, të cilat rregullojnë të drejtat e grave si dhe çështje tjera. Ajo sure quhet sureja “Ennisa’ – Gratë”.Këtu do të mjaftohem të përmendi vetëm dy ajete kur’anore, të cilat u jepin të drejtë grave në trashëgimi: “Grave jepnu dhuratën e kurorës së tyre (niqahin) me të mirë, e në qoftë se ato nga vullneti i vet ju falin diçka nga ajo, atëherë hane atë hallall të mirë.” (S. En-Nisa’, ajeti 4). Po ashtu edhe ajeti tjetër: “Meshkujve ju takon pjesë nga pasuria që e lënë prindërit e të afërmit (pas vdekjes), edhe femrave ju takon pjesë nga pasuria që lënë prindërit e të afërmit, le të jetë pak ose shumë ajo që lënë, ju takon pjesë e caktuar .5

Gjatë periudhës osmane, gruaja ishte nën autoritetin e burrit , ajo i nënështrohej sundimit të tij të plotë dhe detyrohej ti bindej në mënyrë të verbër.Kur ajo nuk i bindej burrit, ky kishte të drejtë të përdorte ndaj saj ndërshtime trupore.

Në shoqërinë patriakale romake , në të cilën kishte një rëndësi të veçantë potestas i paterfamiljas , gratë kishin një inferioritet të dukshëm .Ato ishin të përjashtuara nga çdo lloj pjesmarrje në jetën publike dhe nga funksionet me karakter

1 Bashkautorë Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri.f.12 Tiranë 2004

2 Bashkautorë Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri f.86

3 Kanuni i Lekë Dukagjinit

4 Bashkautorë Historia e shtetit dhe së drejtës në Shqipëri.f.189 Tiranë 2004

5 <https://kosovapost.net/te-drejtat-e-gruas-sipas-kuranit-dhe-kanunit/>

publik , por edhe në të drejtën private nuk mund të ishin kurrë në krye të familjes .6Gratë gjithashtu ishin të përjashtuara nga ius suffragii dhe ius honorum , e drejta aktive dhe pasive e votimit.

Deri pas Luftës së Dytë Botërore gratë ishin të përjashtuara nga votimi.Gratë e fituan të drejtën e zgjedhjes vetëm në saj të lëvizjeve të vazhdueshme dhe këmbnguljeve të organizatave feministe në të gjitha vendet. Edhe gratë shqiptare patën mundësi të votonin për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore, pasi deri në atë kohë të gjitha ligjet kushtetuese shqiptare kishin njohur vetëm parimin e përgjithshëm mashkullor të votimit .7

Të drejtat e grave dhe veçanërisht ius suffrage dhe ius honorum e grave, si një pjesmarrje integrale e të drejtave të njeriut janë superiore ndaj akteve normative që qëndrojnë në themel të shtetit. Në këtë linjë, të gjitha ligjet duhet të formulohen në përputhje me to. Pabarazitë midis burrave dhe grave prekin gëzimin e lirë të të drejtave themelore. Për këtë arsye barazia gjinore dhe mbrojtja e të drejtave të grave duhen promovuar nga shteti me anën e instrumenteve ligjorë dhe instucionalë.8

2. Rregullimi kushtetues dhe ligjor për mbrojtjen e grave .

Kuadri ligjor në Shqipëri

Barazia gjinore dhe të drejtat e grave mbrohen nga parimet e Kushtetutës Shqiptare dhe nga ligje të veçanta si, Ligji për barazinë gjinore në shoqëri, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi , Kodi Zgjedhor, Kodi i Punës ,Kodi i Familjes, Kodi Penal, Kodi i Procedurave Administrative

Kushtetuta nuk e ka rregulluar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen e gruas por kjo del nga neni 54 i kushtetutës ku në të parashikohet se:

1-fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtje të veçantë nga shteti .9

Përveç këtij neni është dhe neni 18 I kushtetutës që afirmon barazinë e të gjithëve , dhe mosdiskriminimin.

1-të gjithë janë të barabartë përpara ligjit .

2-Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia ,rraca ,feja,etnia ,gjuha bindjet politike fetare e filozofike ,identiteti gjinor,orjentimi seksual, gjendja ekonomike e pasurore ,arsimore origjina shoqërore,lindja

6 A.Mandro E drejta Romake Tiranë 2011 f.162

7 L.Omari,A.Anastasi E Drejta Kushtetuese .Tiranë 2017 f.156

8 Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimarrje në Shqipëri. Tiranë 2012-2013

9 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 54.

aftësia e kufizuar, përkatësia shoqërore ose prindërore.

3-Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme. 10

Nga ky nen del dhe parimi i barazisë midis bashkëshortëve. Afirmimi i barazisë midis bashkëshortëve mbetet karakteristikë , veçanërisht i disa kushtetutave të hartuara pas Luftës së II Botërore, kurse sot kjo çështje shihet si një aspekt i rëndësishëm i barazisë gjinore. 11

Të gjitha aktet normative në Shqipëri duhet të përputhen me dispozitat kushtetuese, në veçanti, me parimet e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pas miratimit të Kushtetutës, u bë një rishikim i plotë i kuadrit legjislativ me qëllim për ta bërë të gjithë kuadrin ligjor shqiptar në përputhje me Kushtetutën.

Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” (LBGj) luan një rol të posaçëm në këtë drejtim: 12

Ky ligj rregullon çështjet themelore të problemeve të barazisë gjinore, duke kërkuar trajtimin e barabartë të grave dhe burrave dhe mundësi dhe shanse të barabarta në ushtrimin e të drejtave

në të gjitha fushat e jetës shoqërore.

Ligji e përkufizon “barazinë gjinore” si pjesëmarrje e barabartë e femrave dhe meshkujve në të gjitha fushat e jetës, si pozitive dhe barabartë midis grave dhe burrave, mundësi dhe shanse të barabarta për të gëzuar të drejta dhe për të plotësuar detyrime në shoqëri dhe pasur përfitime të barabarta nga arritjet dhe zhvillimet e tyre.

Pavarësisht nga ligji për barazinë gjinore dhe ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, numri i vajzave dhe i grave që kandidonin për kryetare të njësive vendore mbetet i kufizuar. Ligjet dhe politikat që synojnë të rrisin pjesëmarrjen e vajzave dhe të grave në vendimarrje aplikohen me vështirësi në shumë vende të botës. Opinioni e qytetarëve shqiptarë , sidomos të meshkujve ndaj vënies në praktik të diskriminimit pozitiv në favor të grave në vendimarrje, janë jo shumë të favorëshme . Për më tepër gratë që kanë pozicione të rëndësishme në shoqërinë shqiptare nuk janë shumë në favor të masave të diskriminimit pozitiv në mbështetje të karrierës së grave dhe vajzave . Pengesat në zbatim të kuartës gjinore në Shqipëri lidhen me mentalitetin e shoqërisë , me konkurrencën e pandershme midis burrave dhe grave , me agresivitetin e mjedisit politik dhe me mungesën e solidaritetit femëror .

Pjesëmarrja e kufizuar e grave në politikë është e lidhur me faktin se grave nuk u janë dhënë shancet e duhura. Grupi tjetër i faktorëve që e pengon pjesëmarrjen e gruas në vendimarrje u referohet paragjykimëve dhe burimeve jo të mjaftueshme

10 Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë neni 18.

11 L. Omari, A. Anastasi “E Drejta Kushtetuese “ Tiranë 2017 f.164

12 Ligji Nr.9970,28\7\2008 Për barazinë Gjinore në shoqëri

financiare të grave për të përballuar fushatën zgjedhore.13 Diferencat gjinore në preceptimin e gruas politikane mund të jenë të lidhura me natyrën patriakale të shoqërisë shqiptare.

Arsyet pse duhet votuar një femër për kryetare bashkie apo komune.

Profesionalizmi dhe reputacioni i mirë janë dy karakteristikat kryesore për të votuar një femër kandidatë, arsyeja e dytë, se kanë më shume efektivitet në punë ,kanë aftësi të mira për të komunikuar, ndjeshmëria ndaj problemeve sociale dhe ekonomike.14

Kodi Zgjedhor nuk parashikon ndërshkime për partitë politike të cilat nuk zbatojnë kuantat gjinore në listat e kandidatëve për kryetar të njësive vendore .15

Shteti shqiptar është një shtet mashkullor.Politika më e lartë e tij,por dhe nivelet e mesme drejtohen nga burrat.Gratë,edhe nëse mbulojnë poste nominalisht të rëndësishme,asnjëherë nuk kanë dorë e personalitet të lirë në vendimarrje,çka është dhe treguesi kryesor i peshës që ato do të kishin në politikë e në shtet.16

Ligi e përkufizon “diskriminimin me bazë gjininë” (Neni 4/3) si dallime, përjashtime, apo kufizime mbështetur në gjininë, të cilat synojnë apo rezultojnë në dëmtim, mos-njohje, mos-gëzim dhe mos-ushtrim në mënyrë të barabartë, nga të dy gjinitë, të të drejtave njerëzore dhe lirive themelore në fushat politike, ekonomike, sociale, kulturore, dhe civile, sikundër janë parashikuar në Kushtetutë dhe në legjisllacion.

Parimi i mosdiskriminimit është parashikuar jo vetën në Kushtetutë dhe në ligjin për barazinë gjinore në shoqëri por dhe në Kodin e Procedurave administrative dhe Kodin e Punës. Diskriminimi ndaj grave shkel parimet e barazisë së të drejtave dhe te respektimit te dinjitetit njerëzor, pengon pjesëmarrjen e grave, në të njejtat kushte me burrat, në jetën politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore të vendeve të tyre, pengon ngritjen e mireqenies së shoqërisë e të familjes, dhe vështirëson më tepër zhvillimin e potencialeve të grave në shërbimin e atdheut të tyre dhe njerëzimit.

Në Kodin e Procedurave Administrative mos-diskriminimi është një prej parimeve themelore Ky kod përcakton se organet e administratës publike duhet të udhëhiqen nga parimi i barazisë. Organi publik, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, shmang çdo diskriminim për shkak të gjinisë, racës, ngjyrës, etnisë, shtetësisë, gjuhës, identitetit gjinor, orientimit seksual, bindjeve politike, fetare ose filozofike, gjendjes ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzënisë, përkatësisë prindërore, përgjegjësisë prindërore, moshës, gjendjes familjare ose martesore, gjendjes civi-

13 Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimarrje në Shqipëri Tiranë 2012-2013

14 Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimarrje në Shqipëri 2012-2013 f.42

15 Raport ,Gratë dhe vajzat në zgjedhjet vendore. Tiranë 2012

16 Politika dhe demokracia, Tiranë ,Onufri 2006

le, vendbanimit, gjendjes shëndetësore, predispozicioneve gjenetike, aftësisë së kufizuar, përkatësisë në një grup të veçantë ose për çdo shkak tjetër.¹⁷

Kodi i Punës e ndalon diskriminimin në fushën e punësimit dhe ushtrimit të profesioneve. Neni 16 i LBGj-së kërkon që punëdhënësit të marrin masa për të siguruar mos-diskriminimin dhe shanse të barabarta për punësim për burrat dhe gratë në të gjitha pozicionet dhe sektorët.¹⁸

• Çfarë përcakton ligji për mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës?

Diskriminimi në këtë drejtim, ka lidhje me dallimin, kufizimin ose përjashtimin që mund t'i bëhet një personi lidhur me shpalljen e vendeve të lira të punës, përzgjedhjen dhe marrjen në punë të personave, trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës (paga, kualifikime, pushimi i paguar) etj. Ligji ndalon, gjithashtu, çdo lloj shqetësimi, përfshirë edhe shqetësimin seksual të punonjësit/es në vendin e punës, pavarësisht se kush e kryen atë, kolegët apo drejtuesit.

• Çfarë duhet kuptuar me termin “diskriminim” ?

Diskriminimi është dallimi ose përjashtimi që i bëhet një personi, në raport me të tjerët. Në jetën e përditshme, format e diskriminimit mund të jenë të hapura dhe të fshehta, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të kryera me anë të veprimeve ose mosveprimeve. Edhe kur ne preferojmë një person, midis të tjerëve, ose kur ndaj një personi vendosim kufizime dhe ndaj disa të tjerëve jo, kur janë në kushte të barabarta, jemi përpara diskriminimit ose trajtimit të pabarabartë të personave.¹⁹

Shembull: Në një shkollë private kërkohet të punësohet një mësues i matematikës. Në shpalljen e vendosur në gazetë punëdhënësi ka cilësuar, midis të tjerave, se kandidatët duhet të jenë meshkuj të diplomuar në Universitetin e Tiranës. Në këtë mënyrë ky punëdhënësi ka diskriminuar, me anë të përjashtimit, të gjitha kandidatet femra që kanë kryer studimet në këtë degë dhe që plotësojnë kriteret e tjera objektive për plotësimin e detyrës, të lidhur me vendin e punës. Gjithashtu, në mënyrë të paarsyetuar dhe të pajustificuar janë përjashtuar të gjithë kandidatët meshkuj që kanë përfunduar studimet në universitete të tjera.

• Cilat janë të drejtat tona që ligji i mbron nga diskriminimi?

17 Kodi i procedurave Administrative, neni 17

18 Kodi i Punës neni 9

19 Manual Për mbrojtjen nga diskriminimi, Tiranë 2011

Ligji garanton mosdiskriminim, në radhë të parë, në lidhje me të drejtat themelore që janë parashikuar në Kushtetutë, por jo vetëm për to. E drejta për mosdiskriminim është universale, ajo vlen për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që u janë përcaktuar me ligj, personave në Republikën e Shqipërisë. Megjithatë, në ligj janë përmendur disa nga të drejtat kushtetuese, për të cilat mund të diskriminohemi. P.sh., vendoset ndalimi i diskriminimit në ushtrimin e të drejtës për të zgjedhur e për t'u zgjedhur, si dhe ndalimi i diskriminimit lidhur me ushtrimin e lirisë së ndërgjegjes dhe të fesë.

Cilat janë detyrat e punëdhënësit në drejtim të mosdiskriminimit?

Ai duhet të zbatojë, të mbrojtë dhe të nxisë parimin e barazisë, të mos kryejë vetë diskriminim dhe të ndalojë çdo llojdiskriminimi që mund të kryhet nga të tjerët ndaj punëmarrësve të tij. Kur është rasti, ai duhet të marrë edhe masa disiplinore për mbrojtjen e punëmarrësve nga diskriminimi. Punëdhënësi duhet të pranojë dhe të shqyrtojë ankimet për shkak diskriminimi dhe t'u përgjigjet atyre brenda një muaji nga marrja në dorëzim²⁰

Kodi i Punës mishëron ndër të tjera parimet e mëposhtme të rëndësishme të barazisë në punë dhe në marrëdhëniet e punësimit:

Barazi në shpërblim (Neni 115): “I njëjti shpërblim si për gra edhe për burra që kryejnë një punë me vlerë të barabartë “;

Me synimin për të mbrojtur punësimin e grave, Kodi i Punës (Neni 105a) ndalon testet e barrës përpara punësimit, kur këto i kërkon punëdhënësi, me përjashtim të rasteve kur puna është e tillë që mund të ketë ndikim negativ në barrë, ose që mund të dëmtojë jetën e nënës dhe/ ose të fëmijës.. Në përputhje me, Kodin e Punës punëdhënësi duhet të provojë në rastet e zgjidhjes së kontratës së punës se shkak i largimit nga puna “Nuk ka qenë shtatzania apo lindja e një fëmije”.

Kodi i Familjes rregullon lidhjen e martesës, duke parashikuar kushte dhe ndalime të njëjta si për gratë edhe për burrat për pavlefshmërinë dhe mbarimin e martesës dhe pasojat e saj, të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga martesë, marrëdhëniet personale dhe të pasurore midis bashkëshortëve, çështjet e amësisë dhe atësisë, birësimi, kujdestarisë dhe të tjerat. Nga një analizë e përgjithshme e dispozitave të Kodit të Familjes, mund të konstatohet lehtësisht se në të gjitha dimensionet e tij, ai thekson parimet e reciprocitetit në të drejta dhe detyrime; barazinë e bashkëshortëve në lidhje me njeri tjetrin, fëmijët, martesën dhe familjen; mos-diskriminimin për shkaqe të qenit burrë ose grua. Neni 50 i Kodit të Familjes shprehimisht përcakton se “me martesë, burri dhe gruaja përftojnë të njëjtat të drejta dhe marrin përsipër të njëjtat detyrime”. Statusi martesor u jep bashkëshortëve disa të drejta dhe detyrime me karakter personal/jo pasuror si detyrimi dhe e drejta

për besnikëri; detyrimi dhe e drejta për mbështetje morale, ajo e mbiemrit, mbiemrit për fëmijët e tyre, detyrimin dhe të drejtën për një jetë të përbashkët, shtetësi, përfaqësim dhe të tjera.²¹

Dispozitat e Kodit të Familjes parashikojnë se, në regjimin e bashkësisë ligjore, çdo pasuri e fituar gjatë martesës qoftë nga njëri bashkëshort apo nga të dy bashkëshortët është pjesë e bashkësisë ligjore. Pasuria e bashkëshortëve prezumohet e përbashkët, me përjashtim të rastit kur bashkëshorti provon karakterin e saj vetjak.²² Pjestimi i pasurisë gjatë martesës ijep fund regjimit të bashkësisë duke i vendosur bashkëshortët nën regjimin e pasurive të ndara.²³

Për mbrojtjen e gruas parashikohen dispozita dhe në Kodin Penal.

Kodi Penal .Ndërsa respekton me rigorozitet kujdesin për të drejtën e jetës, si edhe liritë dhe të drejtat themelore të renditura në Kushtetutë, Kodi Penal ka në përmbajtjen e vet një sërë dispozitash të cilat mbrojnë në mënyrë të veçantë gruan.²⁴

Kështu:

- Është rrethanë rënduese kryerja e veprës penale kundër gruas shtatzënë.
- Vrasja e gruas shtatzënë konsideron si vrasje në rrethana cilësuese.
- Gratë janë të përjashtuara nga dënimi me burgim të përhershëm.

Vuajtja e dënimit me burgim për gratë bëhet në institucione të veçanta nga burrat.

Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” është një ligj me karakter administrativ civil e jo penal. Ai funksionon si një mjet më shumë krahas Kodit Penal.

Dhuna nuk është vetëm simptoma e një martese ose bashkëjetese në krizë, por përgjithësisht e një sjelljeje të papranueshme me të cilën duhet të merret ligji. Reagimet institucionale ndaj situatave të dhunës ndaj fëmijëve në familje ka ndryshuar në mënyrë radikale kryesisht për shkak të ndikimit që buron prej zbatimit konkret të Ligjit Nr. 9669 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”.

Qëllimi i ligjit është që të parandalojë dhe reduktojë dhunën në familje në të gjitha format e saj, me anë të masave të përshtatshme ligjore, si edhe të garantojë mbrojtjen me masa ligjore të pjesëtarëve të familjes, të cilët janë viktimat e dhunës në familje, duke i kushtuar vëmendje të veçantë grave, fëmijëve, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara.²⁵

21 Kodi i Familjes neni 50

22 A.Mandro, A. Anastrasi, E.Saliaj Të drejtat pronësore dhe gruaja .Tiranë, 2014A.

23 A.Mandro,E drejta Familjare ,Tiranë 2009

24 Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

25 A.Mandro Të Drejtat e Grave në kuadrin e të Drejtave të Njeriut. Tiranë ,2008

3. Aktet ndërkombëtare për mbrojtjen e gruas

Sigurimi i barazisë gjinore nuk është vetëm një detyrim i brendshëm kombëtar, por edhe një detyrim në nivel ndërkombëtar .

Përveç kushtetutës dhe akteve të tjera kombëtare për mbrojtjen e gruas kemi dhe aktet ndërkombëtare si Konventa Evropjane e të Drejtave të Njeriut ,ku parimi i barazisë gjinore është një nga parimet themelore të ligjit të të drejtave të njeriut.Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut vazhdimisht është shprehur se “barazia e sekseve është një nga qëllimet madhore të Shteteve Anëtare të Këshillit të Europës”,dhe kohët e fundit e ka deklaruar barazinë gjinore si një nga parimet themelore, thelbësore të Konventës.²⁶

Neni 14 i KEDNJ-së është dispozita bazë kundër diskriminimit.

Në të përcaktohet se:

Gëzimi i të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Konventë, do të sigurohet pa diskriminim, për çdo lloj arsyeje si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimi politik apo të tjera, origjina kombëtare apo sociale, të shoqëruarit me statusin e pakicës kombëtare, pronës, lindjes, apo ndonjë status tjetër.²⁷

Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Shqipëria e ratifikoi CEDAW-n më 1993 (Ligji 1769/ 9.11.1993)

Konventa CEDAW është një traktat novator i të drejtave të njeriut.

Ajo është Konventa e parë e të drejtave të njeriut e cila i detyron Shtetet palë të modifikojnë heqin dorë prej qëndrimeve sociale modeleve dhe praktikave kulturore ,të cilat mbështeten në idenë e inferioritetit apo superioritetit të secilit seks.

Ajo përshkruan detyrimet e Shteteve Palë për të eliminuar diskriminimin ndaj grave jo vetëm nga përfaqësues të shtetit , por edhe nga individë privatë , organiza-ta apo sipërmarrje .Ajo integron të drejtat civile të grave dhe të drejtat politike dhe të drejtat ekonomike , sociale dhe kulturore në kuadrin normativ të mos-diskri-minimit dhe të barazisë. CEDAW e përcakton diskriminimin ndaj grave si diçka që “përfshin çdo lloj diskriminimi, përjashtimi apo kufizimi në bazë seksi, që ka si pasojë apo qëllim cenimin apo mohimin e njohjes, gëzimit apo ushtrimit nga gratë, pavarësisht statusit të tyre martesor, në bazë barazie të burrave dhe grave, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore në fushën politike, ekonomike, sociale, kulturore, civile, apo në ndonjë fushë tjetër” (Neni 1).

Në Traktatin që ngrii Komunitetin Ekonomik Europian, të miratuar më1957, u përfshi vetëm një dispozitë e vetme (Neni 119 i Traktatit të KEE-së, tani Neni

26 Çështje të barazisë gjinore në standartet ligjore dhe jurisprudencën kombëtare e ndër-kombëtare. Udhëzues

27 Konventa Evropjane e të Drejtave të Njeriut, neni 14

141 i Traktatit të KE-së) për të luftuar diskriminimin gjinor, pra, parimi i pagës së barabartë midis burrave dhe grave për punë

të barabartë. Sfondi i kësaj dispozite ishte thjesht ekonomik: pra, fakti që Franca kish miratuar dispozita për pagë të barabartë për burrat dhe gratë shumë më herët se sa puna e lirë e femrave në Shtetet e tjera anëtare(ShA) do t'i vinte sipërmarrjet franceze në pozitë të pabarabartë.

Me hyrjen në fuqi të Traktatit të Amsterdimit në 1999, nxitja e barazisë midis burrave dhe grave në mbarë Komunitetin Europian është bërë një nga detyrat e qënësishme të Komunitetit(Neni 2 i KE-së).

4. Situata aktuale e pabarazisë gjinore në Shqipëri

Statistikat flasin për një diskriminim të dukshëm të grave në pjesëmarrjen në tregun e punës, në diferencimin në sistemin e pagave, në nivelin e papunësisë si dhe në pjesëmarrjen në pronën private, përfaqësim apo vendimmarrje politike dhe më gjerë .Programi për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara ka konstatuar se pagat e grave në Shqipëri janë 20 deri 50% më të ulta krahasuar me pagat të burrave, të cilët kanë në zotërim 92% të të gjithë pronës private. Sipas të njëjtit burim, burrat rezultontë kontribuojnë në rreth 84% të produktivitetit ekonomik kombëtar.28

Për sa i përket dhunimit të të drejtave të grave brenda familjes,dhuna në familje vazhdon të mbetet një nga tematikat më problematike në vendit tonë. Sipas një publikimi të Amnesty International 1 në 3 gra në Shqipëri, është dhunuar fizikisht brenda familjes së saj. Në shumicën dërmuese të rasteve, të përgjegjshëm për aktet e dhunës janë partnerët e tyre. Po sipas këtij publikimi 52.2% e grave që vuajnë nga dhuna në familje, nuk u kanë folur kurrë të tjerëve për dhunën e ushtruar ndaj tyre. Kjo shifër shpreh mungesën e ndërgjegjësimit të grave, që nuk e shohin dhunën si një akt që duhet denoncuar.

Gjithashtu rezulton se 11.5 për qind e vajzave dhe grave shqiptare të grupmoshës 15-44 vjeç, kur

kanë qenë fëmijë kanë qenë dëshmitare të dhunës në familje dhe 27.2 për qind e tyre kanë qenë viktime të dhunës fizike në familje gjatë fëmijërisë.

Pra, gratë vazhdojnë të mbeten seksi më i diskriminuar dhe më i dhunuar në familje, gjë që po reflektohet edhe në rastet e vetëvrasjeve, si pasojë e dhunës në familje. Në raport theksohet

se “...mbi 50% e rasteve të denoncuarra i përkasin Tiranës, ndërsa në rrethe duket se konsiderohet ende tabu denoncimi prej të dëmtuarve i dhunës së ushtruar

në familje”.²⁹

Të dhënat mbi përhapjen e fenomenit të dhunës në familje vazhdojnë të jenë të kufizuara. Kështu komisaritet e policisë, zyrat juridike, qendrat e kujdesit shëndetësor dhe ato tëshërbimeve sociale nuk janë të detyruara me ligj të grumbullojnë dhe prezantojnë të dhëna mbi dhunën. Shqipëria është një nga vendet e pakta në Evropë që nuk regjistron, publikon dhe prezanton zyrtarisht rregullisht të dhëna mbi përmasat dhe përhapjen e këtij fenomeni.³⁰

5. Konkluzionet

Pozita e gruas në periudha të ndryshme të historisë ka ndryshuar. Gratë i fituan të drejtat e tyre pas Luftës së Dytë Botërore.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton qartësisht rol të barabartë të grave dhe burrave në shoqëri, duke përjashtuar çdo mundësi diskriminimi si vlerë themelore e shoqërisë.

Barazia gjinore dhe të drejtat e grave mbrohen nga parimet e Kushtetutës Shqiptare dhe nga ligje të veçanta si Ligji për barazinë gjinore në shoqëri, Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, Kodi Zgjedhor Kodi i Punës, Kodi i Familjes, Kodi i Procedurave Administrative

Diskriminimi është dallimi ose përjashtimi që i bëhet një personi, në raport me të tjerët. Në jetën e përditshme, format e diskriminimit mund të jenë të hapura dhe të fshehta, të drejtpërdrejta ose të tërthorta, të kryera me anë të veprimeve ose mosveprimeve. Edhe kur ne preferojmë një person, midis të tjerëve, ose kur ndaj një personi vendosim kufizime dhe ndaj disa të tjerëve jo, kur janë në kushte të barabarta, jemi përpara diskriminimit ose trajtimit të pabarabartë të personave.

E drejta për mosdiskriminim është universale, ajo vlen për të gjitha të drejtat dhe detyrimet që u janë përcaktuar me ligj, personave në Republikën e Shqipërisë.

Sigurimi i barazisë gjinore nuk është vetëm një detyrim i brendshëm kombëtar, por edhe një detyrim në nivel ndërkombëtar. Konventa Evropjane e të drejtave të Njeriut ka përjashtuar çdo mundësi diskriminimi. Po kështu dhe Koventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave e ka përjashtuar mundësinë e diskriminimit. Po kështu nxitja e barazisë gjinore është parashikuar në disa Traktate dhe rezoluta.

Pavarësisht nga ligji për barazinë gjinore dhe ndryshimeve në Kodin Zgjedhor, numri i vajzave dhe i grave që kadidonin për kryetare të njëjësive vendore

²⁹ USAID, “Krijimi i një skuadre për bashkërendimin e reagimit ndaj dhunës në familje në Shqipëri. Nisma për të Drejtat e Grave”, Shqipëri.

³⁰ A.Mandro Të Drejtat e Grave në kuadrin e të Drejtave të Njeriut. Tiranë 2008

mbetet i kufizuar. Ligjet dhe politikat që synojnë të rrisin pjesëmarrjen e vajzave dhe të grave në vendimarrje aplikohen me vështirësi në shumë vende të botës.

Pengesat në zbatim të kuartës gjinore në Shqipëri lidhen me mentalitetin e shoqërisë, me konkurrencën e pandershme midis burrave dhe grave, me agresivitetin e mjedisit politik dhe me mungesën e solidaritetit femëror. Zbatimi i kuartës gjinore mund të kërcënojë disi monopolin mashkullor në politikë. Media duhet të rris ndërgjegjësimin e publikut mbi nevojën për pjesëmarrjen e gruas në politikë. Po kështu duhet të monitorohet mbulimi mediatik i grave në vendimarrje, për të tejkaluar paragjykimet gjinore dhe për të inkurajuar imazhet pozitive të grave si udhëheqëse në të gjitha fushat e jetës.

Pjesëmarrja e kufizuar e grave në politikë është e lidhur me faktin se grave nuk u janë dhënë shancet e duhura. Grupi tjetër i faktorëve që e pengon pjesëmarrjen e gruas në vendimarrje u referohet paragjykimëve dhe burimeve jo të mjaftueshme financiare të grave për të përballuar fushatën zgjedhore.³¹ Diferencat gjinore në preceptimin e gruas politikanë mund të jenë të lidhura me natyrën patriarkale të shoqërisë shqiptare.

Promovimi i barazisë gjinore në shoqëri është një proces i gjatë dhe i ndërlikuar. Steriotipet dhe pabarazitë gjinore janë zhvilluar gjatë dekadave, prandaj duhet të eliminohen këto pabarazi.

Për sa i përket dhunimit të të drejtave të grave brenda familjes, vazhdon të mbetet një nga tematikat më problematike në vendit tonë. Pra, gratë vazhdojnë të mbeten seksi më i diskriminuar dhe më i dhunuar në familje, gjë që po reflektohet edhe në rastet e vetëvrasjeve si pasojë e dhunës në familje. apo vrasjeve nga bashkëshorti i tyre.

6. Bibliografia

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.8417 datë 21.10.1998 ndryshuar me ligjin Nr.9675, datë 13.1.2007, ndryshuar me Ligjin Nr.9904, datë 21.4.2008, ndryshuar me Ligjin 88|2012 datë 18.9.2012, ndryshuar me Ligjin 137\2015, datë 17.12.2015, ndryshuar me Ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016)
2. Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë Tiranë 2016
3. Kodi Zgjedhor I Republikës Së Shqipërisë Tiranë, maj 2017 (Ndryshuar me ligjin nr.74/2012, datë 19.7.2012 dhe ligjin nr. 31/2015, datë 2.4.2015)
4. Kodi Penal I Republikës Së Shqipërisë Tiranë, gusht 2017

5. Kodi I Familjes I Republikës Së Shqipërisë Qershor 2016
6. Kodi I Punës I Republikës Së Shqipërisë Maj 2016
7. Konventa (BE) “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut”
8. Konventa “ Për eleminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave “
9. Ligji nr. 9669, datë 18.12.2006 “Për masa ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare
10. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”
11. Bashkautorë, Historia e shtetit dhe së drejtës në shqipëri. Tiranë 2004
12. Kanuni i Lekë Dukagjinit
13. A.Mandro “E drejta Romake” Tiranë 2011
14. L.Omari,A.Anastasi E Drejta Kushtetuese .Tiranë 2017
15. Raport “Pjesëmarrja e grave në politikë dhe vendimarrje në Shqipëri.
16. ,Gratë dhe vajzat në zgjedhjet vendore. Tiranë, Tiranë 2012-2013
17. Manual “Të kuptojmë dhe zbatojmë ligjin Për mbrojtjen nga diskriminimi” Tiranë 2011
18. USAID, Krijimi i një skuadre për bashkërendimin e reagimit ndaj dhunës në familje në Shqipëri. Nisma për të Drejtat e Grave, Shqipëri
19. A.Mandro Të Drejtat e Grave në kuadrin e të Drejtave të Njeriut. Tiranë 2008
20. Aleanca Gjinore për Zhvillim dhe MPÇSSHB Dhuna në Familje - Paraqitja e situatës aktuale, Prill 2006., Tiranë
21. Fico, D. 2007. Legjislacioni dhe politikat gjinore: sa efektive janë ato? Në Të jesh grua... Në Shqipëri, pas viteve 1990. Botimi Qendrës së Aleancës Gjinore për Zhvillim. Tiranë
22. Benedek Wolfgang and Nikolova Minna (eds). 2003 Understanding Human Rights. Manual on Human Rights Education. European Training and Research Center for Human Rights and Democracy. Vienna: MANZ CROSS-MEDIA
23. Mandro A., Meçaj V., Zaka T., Fullani A., 2006. E drejta Familjare, Tiranë,2007
24. Raporti periodik i parë dhe i dytë i kombinuar për Shqipërinë,13-31 Janar 2003. Komiteti për Eleminimin e Diskriminimit kundër Grave,

Sesioni 28.

25. A.Mandro, A. Anastrasi, E.Saliaj .Të drejtat pronësore dhe gruaja Tiranë, 2014

Dr. Arjana LLANO u lind më 25.01.1971 në Armen. Ajo ka studiuar për Juridik në Departamentin e Drejtësisë, Fakulteti i Ekonomisë në Universitetin e Vlorës, në vitet 2004-2008 dhe vazhdoi studimet Master Shkencor i Nivelit të Dytë për “Shkencat Administrative” në Universitetin UFO në vitet 2009-2011. Në vitin 2017 ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor” në fushën publike, kushtetuese dhe administrative. Përvoja e saj e punës përfshin pozicionin e juristes në Drejtorinë Arsimore të Vlorës në vitet 2009-2011 dhe mësimdhënien në Universitetin e Vlorës prej 7 vitesh. Zotëron rrjedhshëm dy gjuhë të huaja: anglisht dhe italisht.



NJË VËSHTRIM KRAHASUES I ANGAZHIMIT POLITIK TË TË R(INJVE)
EJAVE NË SHQIPËRI (PËRMES AKTIVIZIMIT TË TYRE NË ORGANIZA-
TAT E SHOQËRISË CIVILE)

MSc. Dafina PEÇI

*Asistent Pedagog/ Universiteti i Tiranës,
pecidafina@gmail.com*

Abstrakt

Çështja e angazhimit të të rinjve në politikë zë sot një vend të rëndësishëm në diskursin politik, jo vetëm të vendimmarrësve, por edhe ndër radhët e studiuesve të shoqërisë civile, si pjesa më integrale e aktivizimit politik, jashtë strukturave partiake/politike. Ndonëse ky diskutim ka marrë vëmendje tejkombëtare, si një fenomen që nuk karakterizon vetëm Shqipërinë, apo rajonin e Ballkanit Perëndimor, por edhe Europën mbarë, shpesh priremi t’i referohemi atyre (të rinjve) si një target grup homogjen dhe harrojmë diversitetin ndër ta. Diferencime jo thjesht prej përkatësisë së ndryshme socio-ekonomike të familjeve të tyre, diferencave kulturore dhe atyre rurale-urbane, që në fakt janë realisht prezente, edhe pse në planin social shumëkush prej nesh, në rastin më të mirë i shmang/eviton dhe në rastin më të keq nuk i pohon ato. Një tjetër dallesë, që njëlloj si të parat synohet të mos pohohet, reflektohet dukshëm në atë si ata e perceptojnë aktivizmin dhe veçanërisht atë politik, është të qenit mashkull apo femër. Ky lloj përcaktimi gjinor, në dukje diskriminues (qoftë dhe kur diskriminim është pozitiv), është i rëndësishëm për t’u konsideruar pikërisht se pse bëhet përcaktues i prirjes që të rinjtë/të reja kanë për t’u angazhuar ose jo në aktivitete politike, të drejtpërdrejta ose përmes organizatave të ndryshme të shoqërisë civile. Më konkretisht, nëse të rinjtë psh. ndajnë vlera të përbashkëta lidhur me familjen, dinjitetin dhe besnikërinë, ata “ndahen” në mënyrën si e perceptojnë ndërveprimin social dhe e përkthejnë atë në planin personal.

***Fjalë kyçe:** aktivizëm rinor, angazhim politik, të rinj/të reja, shoqëri civile, zhvillim social.*

Ky shkrim qëndron në bazë të pikëpamjes personale dhe përvojës politike, e cila filloi atë ditë në të cilën kuptova rëndësinë e të menduarit përtej vetes sime. Do të përpiqem të paraqes një pamje të gjallë të situatës së të rinjve shqiptarë: vlerat, ambiciet, dëshirat, shqetësimet, sfidat dhe mendimet e tyre.

Nëse etika ekziston kryesisht për të ndihmuar një person për të jetuar një jetë të drejtë me veten dhe të drejtë në lidhje me të tjerët, mund të themi që ajo vetë është e orientuar në mënyrë të ngjashme drejt drejtësisë. Jeta personale dhe shoqërore e çdo individi është e përhapur nga një ndjenjë e madhe drejtësie. Pa këtë mundësi të konstituimit të pikëpamjes botërore të komunitetit dhe mundësisë së individëve që përpiqen ta arrijnë atë, një sistem vlerash mund të jetë vetëm një element në “mendim-muzeun” e objekteve kulturore ose një fantazi.

Është gatishmëri e përhershme për të bërë ndryshime kulturore me qëllim të marrjes së këtij ekuilibri (Anthony Giddens, 2011). Bazuar në analizën e bërë nga Friedrich Ebert Stiftung dhe IDRA, “Rinia Shqiptare 2015: Ndryshimet e ngadalshme, Interneti dhe ... Besimi i BE-së”, 2015, mund të shohim se familja është elementi i pazëvendësueshëm që gëzon besim të plotë tek të rinjtë në Shqipëri. Vlerat më të rëndësishme për të rinjtë shqiptarë janë ato që lidhen me karakterin personal si dinjiteti dhe besnikëria. Vlerat që janë të lidhura me ndërveprimin shoqëror siç janë toleranca dhe statusi shoqëror vijnë në vendin e dytë. Vlerat e lidhura me arritjen e më shumë si konkurrenca dhe pasurimi shfaqen shumë javë në mentalitetin psikologjik të të rinjve shqiptarë. Fatmirësisht, të rinjtë shqiptarë mbrohen ende nga harmonia tradicionale fetare në Shqipëri dhe qasja e tyre ndaj besimit tregon tolerancën. Megjithatë nuk duhet të merret si e mirëqenë, por të monitorohet nga afër dhe të ruhet me kujdes.

Duke pasur parasysh se institucioni i parë në të cilin ne fillojmë në një mënyrë sjelljen tonë politike duke mësuar “ABC” -in e parë, është institucioni arsimor: kopshtet e fëmijëve, shkollat fillore, shkollat e mesme, universitetet.² James Altschul dhe David Kumar përmendur në librin “Vlerësimi i Shkencës dhe Teknologjisë Arsimit në Agimin e Mijëvjeçarit të Ri”, arsimit është duke u përdorur për politizimin e shoqërive si një mjet përmes dhe në të gjithë botën për të përcaktuar identitetin kombëtar dhe nënvizuar aspektin politik racional të zhvillimit social. Duke u kthyer në situatën shqiptare ne mund të kuptojmë se zhvillimi dhe përmirësimi i cilësisë së arsimit është shqetësimi kryesor për të rinjtë shqiptarë. Duke u përqendruar në kaosin aktual të papunësisë së lartë dhe numrit të lartë të të rinjve që kanë diplomë në bachelor ose master, megjithëse tani ka më shumë informacion mbi rëndësinë dhe përfitimet e arsimit profesional, të rinjtë janë ende

1 “Albanian Youth 2015: Sloë changes, Internet and...EU trust”, FES Tirana, IDRA, 2015, page.45

2 “Evaluation of Science and Technology Education at the Dawn of Neë Millenium”, James Altschul, David Kumar page, Springer Science and Business Media, 2002, page.167

të tërhequr kryesisht nga ideja e studimeve universitare përkundër perspektivës së punësimit. Ndërkohë, perceptimet mbi cilësinë e mësimdhënies në shkolla dhe universitete karakterizohen ende nga vëzhgime të pandryshuara të elementeve të korrupsionit, siç janë shënimi dhe blerja e provimeve, gjë që e dëmton reputacionin e tyre. Kjo pastaj çon në preferencën e tyre për të studiuar jashtë vendit ose në një rast tjetër për të dalë nga vendi sapo të përfundojnë shkollën. Brenga dhe aspiratat e rinisë shqiptare janë të ndërthurura me pikëpamjet e tyre për të tashmen dhe të ardhmen dhe rezultojnë nga një seri fenomenesh që i kanë shoqëruar gjatë këtyre viteve. Një nga ato që ende ushtron një ndikim të madh tek të rinjtë është emigrimi dhe emigracioni.³ Valët e mëdha të emigracionit pas viteve '90, ku më shumë se 1/3 e popullsisë shqiptare u arratis në Evropën Perëndimore, SHBA dhe Kanada, ka prekur çdo familje shqiptare pa marrë parasysh shtresat shoqërore apo zonën gjeografike. Ndonëse emigrimi masiv është në rënie, dëshira midis të rinjve shqiptarë për të zgjedhur përsëri një vend jashtë vendit për punësim apo jetesë nuk ka rënë. Megjithatë, pasojat e kësaj lëvizjeje kanë qenë gjithashtu ndryshime sociale negative, pasiguria dhe vështirësitë e të rinjve për të përballuar jetesën në zonat urbane.

Kur bëhet fjalë për sjelljen e tyre të institucionalizuar politike, kemi një nivel të ulët të institucionalizimit të shoqërisë, pasi të rinjtë nuk shohin në institucione një mënyrë për zgjidhjen e problemeve, por i konsiderojnë ato joprofesionale, jo të bazuara në shtet, por që varen nga qeverisja dhe nga politike. Kjo pikë shpreh një nuancë të rëndësishme të kulturës sonë politike, një hezitim të vazhdueshëm ndaj vendimmarrësve, institucioneve publike, administratës si një sistem ligjor për zgjidhjen e problemeve tona dhe përmbushjen e nevojave tona si qytetarë, një dimension që nuk shtrihet paralelisht me filozofinë e sistemit demokratik dhe vlerave demokratike.

Pyetja që shtrohet këtu është: Si të merremi me këtë situatë, tani, në këtë kontekst? Në këndvështrimin tim nuk ka kohë për të humbur në të menduarit me atë që merret më parë, por ne duhet të punojmë sistematikisht në sektorë dhe përmasa të ndryshme për të thelluar rëndësinë e ndërjegjësimit qytetar mbi fuqinë që ata duhet të kthejnë në motorin e zhvillimit. Në këtë rast duhet të shikojmë në pikat tona të dobëta ose ato pika që tashmë janë të brishta. Nuk ka qeverisje të mirë në një sistem demokratik, pa një sektor të shoqërisë civile që është i pavarur, i përgatitur mirë për reagim politik dhe i organizuar në mënyrë konstruktive bazuar në nevojat dhe interesat e tyre. Në emër të mbrojtjes së këtij sektori, duhet të jemi të kujdesshëm në atë se si po ndikojnë politikatat tona në klasën e mesme, si janë organizatat që përfaqësojnë qëndrimin e shoqërisë civile në aspekte të ndryshme, duke punuar dhe duke u financuar dhe cilat mekanizma mund të zhvillojmë sjellin këto

3 Albanian Youth 2015: Sloë changes, Internet and...EU trust", FES Tirana, IDRA, 2015, page.74

presione, në kuptimin pozitiv si një zë të fuqishëm në proceset e vendimmarrjes dhe gjithashtu në ato monitorime. Ne jemi të hapur për një platformë shumë më të madhe dhe premtuese komplekse, si Bashkimi Evropian dhe ne po përballemi me sfida të cilat ne duhet të kapërcejmë dhe unë do të them të dyja, qeverinë dhe shoqërinë civile.

Në Qershor të vitit 2014, pas disa përpjekjeve dhe përpjekjeve të vështira të cilat dolën si pasojë e klimës së rënduar politike në vend, Shqipëria më në fund iu dha statusi zyrtar i kandidatit nga Bashkimi Evropian, i cili në anën tjetër njohu sjelljen e qetë dhe të duhur të gjeneralit zgjedhjet e qershorit 2013. Hapi tjetër në procesin e integritit është edhe më i rëndësishëm: fillimi zyrtar i negociatave. Shqipëria ka ndërmarrë disa reforma të mëdha që korrespondojnë me prioritetet e përcaktuara nga ndryshimet e kërkuara nga Komisioni i BE-së megjithatë ka ende një rrugë të gjatë dhe të vështirë derisa të jepet një datë e caktuar për hapjen e negociatave të pranimit. Pas zgjedhjeve për Parlamentin Evropian në vitin 2014, nuk ka më një Drejtori të Zgjerimit por një Drejtori të sapoemëruar për Politikën e Fqinjësisë dhe negociatat e Anëtarësimit. Përveç qasjes kombëtare ne duhet të punojmë edhe në qasjen rajonale drejt procesit të integritit dhe të nënvizojmë këtu që nuk është vetëm për përmbushjen e standardeve, por edhe pranimin dhe promovimin e vlerave evropiane. Ne sot mund të flasim për shtetet e Ballkanit Perëndimor në një kuadër të ri të bashkëpunimit rajonal në funksion të integritit eventual. Ky proces filloi me Samitin e Berlinit në gusht të vitit 2014. Përbërë nga takimet vjetore të nivelit të lartë midis gjashtë qeverive të Ballkanit Perëndimor dhe disa Shteteve Anëtare të BE midis 2014 dhe 2018, ky proces synon të ripohojë perspektivën e rajonit në BE duke përmirësuar bashkëpunimin dhe stabilitetin ekonomik brenda saj. Lidhshmëria është një aspekt i rëndësishëm i këtij procesi, me investimin në infrastrukturë duke u parë si një mjet për krijimin e vendeve të punës, mundësive të biznesit dhe përfitimeve të tjera. Krijimi i lidhjeve politike të nivelit të lartë, pajtimi i shoqërive duke stimuluar shkëmbimin e të rinjve dhe projektet e arsimit dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve të pazgjidhura bilaterale, duke siguruar pjesëmarrjen e shoqërisë civile në të gjithë procesin, janë aspekte të tjera të rëndësishme të kësaj iniciative. Procesi i Berlinit gëzon mbështetjen e rajonit dhe të BE-së njësoj, si një nismë që sjell një perspektivë të re dhe shtysë në procesin e zgjerimit. Ka sjellë një moment pozitiv për bashkëpunimin rajonal, veçanërisht përmes projekteve të tij të cilat pritet të kenë një ndikim ekonomik dhe social që do të plotësojë ambiciet e anëtarësimit në BE të vendeve të veçanta. Meqë po flasim për perspektivën rinore dhe rinore, le të qëndrojmë në kapitullin në të cilin është përfshirë segmenti dhe të flasim për një nga rezultatet më konkrete të këtij procesi: Themelimi i Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor. Gjatë Samitit të Ballkanit Perëndimor në Vjenë, më 27.8.2015, Kryeministrat e Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kosovës *, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë kanë nënshkruar një “Deklaratë të përbashkët mbi themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor të Ball-

kanit Perëndimor “, në të cilën deklaruan se kanë rënë dakord të» krijojnë Zyrën Rajonale të Bashkëpunimit për Rininë në Ballkanin Perëndimor, si një strukturë rajonale e cila udhëheq dhe koordinon bashkëpunimin rinor në rajonin tonë «, me qëllim» të promovojë frymën e pajtimit dhe bashkëpunimit midis të rinjve në rajonin tonë “.

⁴Për të krijuar këtë strukturë, Kryeministrat deklaruan se ata kanë rënë dakord të “angazhojnë institucionet relevante të pjesëmarrësve për të zhvilluar, në bashkëpunim të ngushtë me Grupin e Punës, një grup i përbërë nga trembëdhjetë anëtarë, për çdo vend një përfaqësues nga pala qeveritare dhe një nga shoqëria civile. Ky grup ka punuar në dokumente, dokumente me propozime konkrete për misionin, strukturën, aktivitetet dhe financimin e Zyrës Rajonale të Bashkëpunimit Rinor dhe këto dokumente u finalizuan dhe u dorëzuan qeverive deri më 1 Mars 2016. Në muajt e fundit të gjashta qeveritë e Ballkani Perëndimor-kanë finalizuar dhe miratuar propozimet. Marrëveshja për krijimin e RYCO u nënshkrua më në fund në Samitin e Ballkanit Perëndimor në Paris më 4 Korrik 2016.⁵

Duke u kthyer në atë që u përmend më parë, në rëndësinë e sektorit të shoqërisë civile në proceset vendimmarrëse dhe sidomos kur është fjala për të rinjtë, ky proces përfshinte një pikë të mrekullueshme, bashkëpunimin midis shoqërisë civile dhe qeverisë, në këtë rast të rinjve, hapa shumë të parë. Të rinjtë shqiptarë tregojnë një qasje shumë pozitive ndaj bashkëpunimit rajonal dhe për ta njohja e të tjerëve shkon përtej lidhjes së tyre profesionale. E gjithë kjo ka të bëjë me mposhtjen e paragjytimeve dhe duke punuar në një dialog konstruktiv mes të rinjve në këtë rajon, të cilat përveç dallimeve, ndajnë shumë ngjashmëri të përbashkëta dhe sfida të përbashkëta, pasi të gjithë po ecim në të njëjtin drejtim: një rajon në paqe dhe në prosperitet. Kjo zyrë do të ofrojë mekanizma konkrete financiare dhe politike për të fuqizuar lidhjen e të rinjve, për të ndërtuar kapacitetet e tyre dhe për t’u dhënë mundësinë që projekt propozimet e tyre të zbatohen dhe të japin një ndikim konkret për shoqëritë. Ky është shembulli më i mirë se si t’u japim të rinjve hapësirën e duhur dhe kuadrin ligjor, politik, në mënyrë që ata të jenë të lirë dhe të motivuar ta formësojnë atë dhe ta ngjyrosin atë. Kjo zyrë, e vendosur në Tiranë, me një kuptim të përbashkët për ruajtjen e pronësisë rajonale, do të funksionojë në bazë të parave të dhëna nga çdo qeveri dhe donatorë dhe do të menaxhohet nga një staf i përzier profesionistësh të zgjedhur nga ky rajon. Është një iniciativë shumë premtuese, në një moment shumë të përshtatshëm, kështu shpresojmë që të rinjtë do të kontribuojnë dhe do ta shfrytëzojnë këtë mundësi në mënyrën më të mirë të mundshme.

4 Conclusions of Western Balkan Summit of Vienna 2015, available at: https://www.bmeia.gv.at/fileadmin/user_upload/Zentrale/Aussenpolitik/Chairman_s_Conclusions_Western_Balkans_Summit.pdf

5 https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/news_corner/news/2016/06/20160630_2_en

Në kërkim të makinerive të lumturisë ...

Nuk është aspak e lehtë të merret me jetën si një i ri në Shqipëri, në ditët e sotme. Duke pasur mundësinë të shohin imazhet më të mira të një bote plot bukuri, stil jetese i rafinuar, para dhe luks, nga mediat sociale dhe zhvillimi teknologjik, nuk korrespondon në përgjithësi me mundësitë që ofron shteti ynë dhe gjithashtu në përgjithësi me zhvillimin tonë ekonomik. Midis nevojës për të shprehur veten, për të shijuar vitet e mbushura me energji dhe për të eksploruar botën përreth, të rinjtë duhet të merren me formësimin e të tashmes dhe të ardhmes së tyre, duke marrë përgjegjësi si ata që duhet të gjejnë një zgjidhje në një sistem që nuk garanton shumë . Përveç jetës së tyre personale dhe profesionale, ata përpiqen të sjellin një zë në ato struktura që do të vendosin mbi ta. Sigurisht që ka nevojë për vullnet të mirë, kompetencë dhe këmbëngulje të vazhdueshme, por është e rëndësishme që në këto vite të tranzicionit ne po përballemi me një interes më të lartë të të rinjve në politikë. Nuk ka zhvillim, pa kohë të vështirë dhe dhimbje, por ndërkohë po flasim për jetët e njerëzve. Një jetë është një mundësi që jepet një herë e si për rrjedhojë koha na kufizon në ambicie dhe pretendim. Me kalimin e kësaj të fundit, ne do kuptojmë se nuk jemi në gjendje të ndryshojmë dhe përmirësojmë gjithçka që na rrethon, por të paktën është detyra e secilit të trajtuar me seriozitet përpjekjen vetjake në kërmim të makinerisë së lumturisë.

1. Bibliografi

1. Albanian Youth 2015: Sloë changes, Internet and...EU trust”, FES Tirana, IDRA, 2015, page.74
2. Conclusions of Western Balkan Summit of Vienna 2015, available at: https://www.bmeia.gv.at/fileadmin/user_upload/Zentrale/Aussenpolitik/Chairman_s_Conclusions_Western_Balkans_Summit.pdf
3. Evaluation of Science and Technology Education at the Daën of Neë Millenium”, James Altschul, David Kumar page, Springer Science and Business Media, 2002
4. Hackaj A., Madhi G. and Hackaj K., “Monitoring the Berlin Process: From Paris to Trieste”, Cooperation and Development Institute, January 2017, available at: <http://cdinstitute.eu/web/wpcontent/uploads/2017/02/Monitoring-theBerlin-Process-From-Paris-to-Trieste.pdf>.
5. Statement of the Foreign minister of Slovenia, Karl Erjavec during

the meeting of the Foreign ministers of the EU and the Western Balkans, part of the Brdo Process, on 24.04.2015, available at: http://www.vlada.si/en/media_room/news_letter/slovenia_weekly/news/article/fms_at_brdo_european_future_and_cooperation_remain_crucial_for_a_stable_and_successful_europe_52728/

6. https://ec.europa.eu/neighbourhoodenlargement/news_corner/news/2016/06/20160630_2_en

7. <https://europeanwesternbalkans.com/2016/07/14/young-people-are-not-our-futurebut-our-present/>, <http://pjpeu.coe.int/documents/1017981/9508453/>

8. Concept+Paper+Regional+Activity+Montenegro+2016.pdf/18788424-3d96-454e-bdaf2f8a013870c7 <http://www.kryeministria.al/en/newsroom/news/speech-of-prime-minister-rama-atthe-joint-press-conference-with-primeminister-vucic&page=1>

9. https://rycoblog.files.wordpress.com/2015/12/annex_1_jointdeclaration_establishment-youth-cooperation-office-westernbalkans-1.pdf

10. www.roadtoryco.com

11. http://www.dwpbalkan.org/cms_dwp/userfiles/file/BalkanPerspectives_Nationalism_Eng.pdf

E DREJTA PRONËSORE E GRAVE NË SHQIPËRI

Flavia KOLLESHI

*Pedagoge, Kolegji Universitar "Wisdom" ALBANIA
flavia.kenaj@wisdom.edu.al*

Abstrakt

Gratë përbëjnë një forcë të madhe dhe thelbësore për një shoqëri dhe ekonomi të shëndetshme dhe produktive, ku si burrat dhe gratë mund të kontribuojnë me të gjitha mundësitë dhe kapacitetet e tyre. Mundësia e grave për të përdorur e për të kontrolluar burimet prodhuese dhe ekonomike është një element kyç për të garantuar fuqizimin e tyre, për të marrë nën kontroll jetën e tyre dhe për t'u angazhuar plotësisht si një forcë pozitive në familje, në komunitet e më gjerë në shoqëri. Asetet fikse me vlerë, duke përfshirë token dhe pronën, u japin pronarëve një rezervë apo një mundësi shpëtimi në kohë të vështira. Për gratë në kontekstin familjar kjo do të thotë shumë më tepër. Të pasurit e një titulli pronësie mbi një tokë apo mbi një pronë të jep mbrojtje. Një titull pronësie përbën siguri për familjen në kohë të vështira, mund të rrisë pushtetin e negocimit brenda familjes dhe ofron mundësi për pavarësi ekonomike, qoftë dhe për mundësimin e kredive që mund të perdoren më tej për nisma sipërmarrëse. Synimi kryesor i këtij studimi është që të sjellë në vëmendje ngakëndvështrimi historik dhe aktual problematikë të drejtave pronësore të grave në Shqipëri, siprobleme të mbartura edhe ato të reja. Pra, origjinë në problemit, të shkuarën dhe të tashmen.

Fjalë kyçe: gratë, titulli pronësie, familje, regjime pasurore etj

1. Hyrje

Shumë gra dhe burra ndajnë të njëjtat perspektiva kulturore, pasi janë rritur nga të njëjtët mekanizma dhe institucione sociale. Sfida në këtë rast qëndron në

ndryshimine perceptimeve të të dyja palëve, burrave dhe grave, rrethrëndësisë së rivlerësimit të rolit dhe problematikave të guasnë shoqëri.

Gratë kontribuojnë në ekonomi dhe në luftimin e varfërispërmes punës së paguar dhe asaj të papaguar në shtëpi, në komunitet dhe në vendin e punës. Fuqizimi i grave është një faktor vendimtar në zhdukjen e varfërisë. Përderisa varfëria ndikon ekonomitë shtëpiake si tërësi, përshkak të ndarjes gjinore të punës dhe përgjegjësisive për mirëmbajtjen e ekonomisë shtëpiake, gratë bartin një ngarkesë të shpërpjesëtuar, duke u përpjekur të menaxhojnë konsumin dhe prodhimin e ekonomisë shtëpiake në kushtet e mungesës gjithnjë më të madhe. Varfëria është veçanërisht akute për gratë që jetojnë në ekonomitë shtëpiake rurale. Varfëria e grave lidhet drejtpërdrejtë me mungesën e mundësive dhe autonominë ekonomike, mungesën e qasjes në resurset ekonomike, duke përfshirë kreditë, pronësinë e tokës dhe trashëgiminë, mungesën e qasjes në arsimim dhe resurset për krahasim dhe pjesëmarrjen e tyre minimale në procesin e vendimmarrjes¹. Varfëria gjithashtu mund t'i detyrojë gratë në situata të tilla ku atobëhen të cenueshme ndaj shfrytëzimit seksual. Në një numër tepër të madh të vendeve, sistemet e mirëqenies sociale nuk marrin në konsideratë në masë të mjaftueshme kushtet specifike të grave që jetojnë në varfëri, dhe ka një tendencë për të zvogëluar numrin e shërbimeve të ofruara nga sisteme të tilla. Rreziku i rënies në varfëri është më i madh për gratë sesa për burrat, veçanërisht në moshë të madhe, kur sistemet e sigurimit shoqëror bazohen në parimin e punësimit të vazhdueshëm të paguar. Në disa raste gratë nuk e plotësojnë këtë kërkesë për shkak të ndërprerjeve nëpunën e tyre, për shkak të shpërndarjes së pabarabartë të punës së paguar dhe punës së papaguar. Për më tepër, gratë e moshuara, përballen me pengesa më të mëdha për të rihyrë në ekonominë e tregut. Në shumë vende të zhvilluara, ku niveli i arsimimit të përgjithshëm dhe trajnimit profesional të grave dhe burrave është i ngjashëm dhe ku ekzistojnë sistemet e mbrojtjes kundër diskriminimit, në disa sektorë transformimet ekonomike gjatë dhjetëvjeçarit të shkuar kanë rritur fuqimisht ose papunësinë e grave ose natyrën e pasigurt të punësimit të tyre. Si pasojë përqindja e gravenë nivelin e varfërisë është rritur. Në vendet me një nivel të lartë të regjistrimit të vajzave në shkollë, janë ato që lënë sistemin e arsimit më herët, pa ndonjë kualifikim që janë ndërmjet grupeve më të cenueshme në tregun e punës.² Në vende me ekonomi në tranzicion dhe në vende të tjera të cilat po përjetojnë transformime fundamentale sociale, ekonomike e politike, këto transformime shumë shpesh kanë çuar në një zvogëlim në të ardhurat e grave ose i kanë privuar gratë nga të ardhurat. Veçanërisht

1 Deklarata e Pekinit dhe Platforma për Veprim Konferenca e Katërt Botërore Për Gratë: Aksion ër Barazinë, Zhvillimin dhe Paqen (15 Shtator 1995)

2 John Drexhage, Deborah Murph Sustainable Development: from Brundtland to Rio 2012, Background Paper Prepared for Consideration by the High Level Panel on Global Sustainability at its First Meeting, 19 September 2010

isht në vendet në zhvillim, kapaciteti prodhues i grave duhet të rritet përmes qasjes te kapitali, resurset, kredia, toka, teknologjia, informatat, asistenca teknike dhe trajnimet, me qëllim tërritjes së të ardhurave të tyre dhe përmirësimit të të ushqyerit, arsimimit, kujdesit shëndetësor dhe statusit përbrenda ekonomivesh-tëpiake³. Shfrytëzimi i potencialit produktiv të grave është qenësore për të thyer ciklin e varfërisë në mënyrë që gratë të mund të shfrytëzojnë plotësisht përfitimet e zhvillimit dhe produktet e vetë punës së tyre.

2. Kuadri historik

Është me interes të nisësh këtë studim nga aspektet historike të së drejtës së pronësisë. Në kuadrin historik është e rëndësishme të analizojmë rrugëtimin që normat ligjore kanë përshkur për të mbërritur tek regjimet paurore qëna servir sot legjislacioni kombëtar në lidhje me të drejtat e fituara nga gratë në këtë kontekst. Kjo sepse historia e të drejtës pronësore ndikon shkarazi, tërthorazi apo edhe drejtpërdrejtë në statusin e të drejtave pronësore të grave në ditët esotme. Nuk janë të rralla rastet kur tradita zakonore lë në hije institutete së drejtës bashkëkohore që rend të qaset sa më shumë me standardet ndër kombëtare. E drejtazakonore, kërkon të jetë protagoniste duke cënuartë drejtat e grave si pronare po aq të ligjshme sa edhe gjinia tjetër. Këtë konstatim e gjejmë edhe në vlerësimin e ndikimit gjinor në administrim tokës bërë për Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnje Hercegovinën si dhe në studime të tjera.⁴

E drejta pronësore, si një e drejtë e rëndësishme, historikisht ka gjetur rregullim edhe në të drejtën

zakonore edhe në atë pozitive. E drejta zakonore ka si burime kryesore Kanunet. Pavarësisht diversitetit midis tyre, kanunet kanë gjashtë dhe bazë thauj unike në rregullimin e instituteve kryesore. Këtu përfshijnë edhe të drejtën zakonore pronësore. Sipas autorit, Aleks Luarasi në botimin me titull “Marrëdhëniet Familjare” trajtohen aspekte të jetës familjare sipas të drejtës zakonore shqiptare.⁵ Në këtë punim analizohen kanunet shqiptare dhe pozita e gruas në disa aspekte përfshi edhe ato pasurore. Konkluzioni është se gratë, sipas të drejtës zakonore, janë të zhveshura nga pronësia mbi pasurinë e përbashkët të familjes. Ato disponojnë vetëm sendet vetjake. Gruaja ishte e përjashtuar nga pronësia dhe trashëgimia si në famil-

3 Manfred Nowak Human Rights: a Handbook for Parliamentarians, OHCHR, Geneva 2005.

4 Shih “Assessing Land Administration Project’s Gender Impacts in the Western Balkans”, Country Case Studies: Albania, Bosnia-Herzegovina and Montenegro, June 2011, fq.9 ne <http://siteresources.worldbank.org/INTECA/Resources/landgenderassessment.pdf>; shih gjithashtu pjesen e këtij raporti ku renditen disa studime për Shqipërinë.

5 Aleks Luarasi “Marrëdhëniet Familjare”, fq 145-176 dhe 199-200.

jen e prindërve, ashtuedhe në atë të bashkëshortit. Sipas Kanunittë Lumës (nenet 1492-1493), bijat e pamartuarakishin të drejtë të jetonin në pasurinë e babait tëvdekur por ato nuk kishin pjesë në trashëgiminë lënë prej tij. Vetëm në kanunin e Lumës gjendetse, nëse trashëgimlënësi kishte vetëm vajza tëmartuara, atëherë këto thirreshin në trashëgimi sitrashëgimtare të radhës së dytë.⁶ Kjo pjesë e tyre- quhej “miraz” dhe tipar i kësaj ‘thuaje trashëgimie’ ishte se vajzat kishin vetëm të drejtën e uzufuktittë kësaj pasurie sa ishin gjallë sepse, me vdekjen e tyre, pasuria nuk u kalonte trashëgimtarëvetë tyre porkthehej kushërinjve meshkuj ngaana e babait.⁷ Gruaja nuk kishte as të drejtën tëdispononte të ashtuquajturin “selem” që, sipasKanunit të Skënderbeut, ishte pasuria që silltegruaja nga familja e saj prindërore. Kjo pasuri ukalonte me trashëgim vetëm djemve të familjes.

Në Kanunin e Lekë Dukagjinit, i cili është njëpërmbledhje zakonesh që vepronin kryesishtnë zonën veriore të Shqipërisë në periudhën emesjetës, vihet re pabarazia dhe diskriminimi igruas ndaj burrit.Kjo frymë nuk mungon edhe nëkanunet e tjera. E vetmja e drejtë e saj është që të marrë hua sendet e konsumit të përditshëmpra sende të zëvendësueshme⁸.Asnjë kontratëshitblerjeje apo këmbimi qoftë edhe për këto lloj sendesh nuk mund të lidhet nga ana e saj. Edhe për këto sende kërkohet leja e të zotit të shtëpisë.Sa i përket anëtarëve të tjerë të familjes ose tëashtuquajturve ‘gjindes së shpis’ sipas nenit 25 këtanuk mund të bëheshin ‘dorzanë pá lëje të zot’ttë shpis’ sikurse nuk mund të shisnin, blinin aposhkëmbenin pasurinë. Në Katund: 1) i zoti i shpísdo të përgjigjet për çdo dâm, qi t’i bânj kuej gjindja’.Në nenin 24.me titull “Tagri i gjindes së shpis” ndër tëtjera nënvizohet se ‘Gjindja e shpis ká tager: ... 2)Me hjekë të zojen e shpis, për n’ u raftë për sýsh sebrancon, a shet gjâ tinëz - edhë një kokërr voejet mekênë’. Pra, duke marrë si shembull pamundësinëpër të shitur edhe ‘një kokërr vezë’, kanuni najep qartësisht të drejtat e gruas në gëzimin dheadministrimin e pronës.Sa i përket trashëgimisë, KLD në nenin 88 përcakton sekanuni njeh për trashëgues djalin dhe jo vajzën dhejo vetëm kaq por trashëgonte vetëm djali i lindurnga martesë si edhe djemtë e këtyre. Kanuni nukë njihte trashëgiminë me testament.Rregulla tëposaçme për trashëgiminë gjenden në nenet 64-87 të KLD.⁹

“Shpërblimi për martesë” 10 jepet në prag të martesës, pra ditën që familja e djalit dhe vajzës caktonin datën e martesës dhe masa e saj caktohej nga familja e

6 Aleks Luarasi, po aty, fq. 179.

7 Kanuni i Lumes, neni 1529.

8 Sipas nenit.22 te KLD me titull “Tagri i se zojes se ships”, nder te tjera thuhet se: ‘E zoja e shpis ka tager: 1) Mbi te gjitha sendet, qi bahen ne shpi; 2) Me dhane a me lype uha miell, buke, krype, djathe a tlyen”.

9 Kanuni i Lek Dukagjinit.

10 Ne krahina te ndryshme haste me emertime te ndryshme te tilla si “merqiri”, “forca”, “kepuçet”.

vajzës. 11 Në Kanunin e Labërisë kjo konsistente në blerjen e rrobave nuses dhe jo në vlera monetare. Vetëm një pjesë shumë e vogël e këtij shpërblimi përdorej nga familja e vajzës për qëllime të saj ekonomike dhe përbënte turp nëse familja e vajzës nuk bënte kujdes që ti shpenzonte këto kryesisht për vajzën dhe blerjen e sendeve për të. “Paja” si praktikë dhe emërtim i tillë është njohur më shumë në pjesën jugore të vendit dhe kjo ka lidhje me veprimin e së drejtës fetare të rritortodoks më shumë sesa me të drejtën zakonore. “Paja” përfaqëson në vetvete një pasuri të luajtshme që vajza çon në familjen e burrit dhe që konsiston në artikuj që kanë të bëjnë kryesisht me veshjet e saj, dhuratat për të afërmit e bashkëshortit (gjithnjë të luajtshme) dhe sende të përdorimit të përditshëm të tilla si dyshekë, jorganë, jastëkë, qylyma, etj. Sa më e madhe paja aq më e vlerësuar ishte nusja dhe familja e saj. Meqë vajzat dalin nga familja e origjinës dhe marrin këtë pasuri prej saj, sipas të drejtës zakonore shqiptare, ato janë të përjashtuara nga trashëgimia edhe në familjen e origjinës edhe në familjen e bashkëshortit. Sikurse u përmend edhe më sipër, ajo nuk kishte pozita të barabarta në marrëdhëniet familjare, martesore dhe ekonomike. Sipas Kanunit të Labërisë, ajo nuk mund ta merrte fëmijën pasi ai ishte i burrit, nuk kishte asnjë të drejtë të trashëgonte as te babai as te burri dhe në asnjë mënyrë ajo nuk merrte pjesë në shitblerjet e pronave.¹²

Gruaja kishte të drejtë për të kërkuar ndarjen, dhe këtë vetëm në marrëveshje me babanë e saj, në rastet e shkëljes së kurorës nga burri ose kur ai kishte tentuar ta vriste apo kur kishte të meta fizike/psikike.¹³ Në këtë këndvështrim, këtu nuk shohim të njëjtin shtrëngim si te Kanuni i Lekës.

Në të njëjtën kohë, shohim një farë “lirimi” të të drejtave të gruas përsa i përket dhuratave të nusërisë pasi në Kanunin e Labërisë gruaja e martuar i kishte në pronësinë e vet të gjitha ato, në ndryshim nga Kanuni i Lekë Dukagjinit. Por në të njëjtën kohë edhe pasuria e tyre bashkëshortore ishte në duart e burrit me përjashtim të dhuratave të mësipërme. Këtu shohim që të dy janë përgjegjës për ruajtjen, zhvillimin dhe shtimin e kësaj pasurie. Por, administrimi i saj mbetet gjithmonë në tagrin e burrit.

Gruaja e ndarë, me ose pa fëmijë, merrte rrobat e trupit, ndonëse ato ishin blerë nga burri, pajën e sjellë me vete, si dhe dhuratat që i ishin bërë para ose pas martesës. Ajo kishte të drejtë, gjithashtu, të merrte prej burrit 60 okë misër për tre muaj, sipas sharteve të Idriz Sulit.¹⁴

Gjithashtu një ndikim në të drejtën zakonore shqiptare, përsa i përket temës

11 Nazmi Bicoku, “E drejta e Trashëgimise”, fq. 16. Ksanthipi Begeja “E Drejta Familjare e RPSSH”, Tirane 1984, UT, Fakulteti i Shkencave Politike e Juridike. Fq. 37.

12 Kan. Labërisë, fq. 39

13 Kan. Labërisë, fq. 123

14 Aleks Luarasi “Marredheniet Familjare” Botim i SHB Luarasi, Tirane 2001, fq. 200

që po trajtojmë, pati edhe Sheriati (e drejta myslimane) por ishin pak a shumë të njëjtat rregullime sikurse u trajtuan më sipër me Kanunin e Lekës, të Labërisë apo dhe Kanuneve të tjera. Më tej Kodi Civil i Mbretërisë së Ahmet Zogut i vitit 1929 ishte pari që tentoi të sanksiononte një barazi ndërmjet burrit dhe gruas sidomos në marrëdhëniet e tyre pasurore duke normuar për herë të parë edhe kontratën martesore para celebrimit të martesës përpara njënoteri duke i dhënë një dimension tëri marrëdhënies martesore dhe familjare sidomos për sa i përket pozitës së gruas në familje dhe shoqëri. 15 Pas vitit 1945 në fushën e marrëdhënies tëpronësisë u morën një sërë masash ndër të cilatpërmendim: shtetëzimi i pasurisë private, zbatimii reformës agrare dhe zhvillimi i kooperativave nëbujqësi dhe artizanat. Deri në 1976 njihej pronashtetërore, kooperativiste, personale dhe private. 16 Kushtetuta e RPSH e vitit 1946 në nenin 17 nënvizonte se “gruaja është e barabartë me burrin në çdo fushë të jetës private, politike e shoqërore”. Dalja e ligjeve në vijim e konsideroi këtë parimkushtetues, të paktën formalisht. Sipas traditës, përgjithësisht, me martesë, ‘nusja’ shkon në shtëpinë e ‘dhëndrit’. Në rastet elidhjeve të martesës pas vitit 1992, kur banesa ishte privatizuar nga familja e bashkëshortit, atëherë, për shkak tëvet procesit të privatizimit që ishte kryer mbi këtë banesë, ajo nuk ishtepronare e asnjë pjese. Pra, edhe nëse martesa zgjidhej, ajo nuk përfitonte asnjë pjesë tëkësajpasurie. Ne rast se martesa ishte lidhur përpara vitit 1992, bashkëshortja përfitonte në pjesëtakuese si bashkëpronare së bashku me bashkëshortin e saj si dhe personat e tjerë tëafërm tëkëtij (prindërit, vëllezërit, motrat) që ishin anëtare madhorë të familjes. 17 Nëse, në këtë lloj situatë, martesa zgjidhej, ajo do të përfitonte një pagesë si kundervleftë e pjesës sësaj si bashkëpronareme shumë persona të tjerë të familjes së bashkëshortit. Ndërkohë, kemi hasur vendime gjyqësore, në të cilat “nusja e djalit” edhe pse figuron në gjendjen familjare të familjes së bashkëshortitpërpara 1 dhjetorit 1992, nuk ështëpërfshirë në këtë proces privatizimi. 18 Kur privatizimin ebanesës e bënin vet bashkëshortët, atëherë gruaja si bashkëshorte kishte një pjesë të barabartëme bashkëshortin, sepse banesa ishte pasuri martesore. Në këtë rast, nëse zgjidhej martesa, përgjithësisht, sic ka treguar praktika gjyqësore, banesa bashkëshortore i lihej gruas të cilës i

15 Shih, Arta Mandro “E drejta Familjare” SHB Emal, Tirane 2009, pjesa e regjimeve pasurore martesore. fq.317.

16 Shih gjithashtu: de Waal C. Post-socialist Property Rights and Wrongs in Albania: An Ethnography of Agrarian Change. Conservat Soc 2004;2:19-50 ne: <http://ew.conservationsandsociety.org/text.asp?2004/2/1/19/49340>.

17 Vlen te bejme nje koment lidhur me termin ‘person madhor’. Sipas legjislacionit shqip-tarpersoni eshte madhor kur ka mbushur 18 vjec. Sipas dispozitave te KC ne fuqi, nese grua-jalidhte martese nen moshen 18 vjec, ajo konsiderohej se fitonte zotesi te plote per te vepruar-dhe pra ishte person madhor. KF i kohes lejonte lidhjen e martesës ne moshen 16 per vajzen dhe 18 per djalin.

18 Vendimi nr.6946/14.09.2011 i GjRRGJ Tirane.

lihejkujdestaria mbi fëmijet e mitur. Në këtë rast ajo duhej të paguante për pjesen takuese të ishbashkeshortit. Në rast kur të ardhurat e saj ishin/janë të limituara gruaja vendosej/et në një pozitëshumëtë vështirë.

Sot me Kodin e Familjes që ka hyrë në fuqi në vitin 2003 pozita e gruas është forcuar duke fituar dhe gëzuar të drejta të barabarta në fushën e drejtës pasurore. Në të njëjtën kohë vështruam edhe natyrën e etapave nëpërmjet të cilave shoqëria shqiptare kishte kaluar, etapa të cilat kanë ndikuar edhe në psikologjinë e legjislatorit për të përshtatur në mënyrën më të mirë të mundshme të shoqërisë me legjislacionin përkatës.

Sigurisht që sanksionimi i tyre në këtë Kod përbën një hap të rëndësishëm, si në aspektin juridik ashtu edhe në atë shoqëror si një rregullator i mirë i jetës familjare e sidomos i pjesës ekonomike të familjes.

Me gjithë zhvillimet dhe evoluimin e regjimeve pasurore martesore, ka akoma shumë për të bërë në këtë fushë.

3. Regjimet pasurore. Kuadri ligjor dhe i politikave në Shqipëri

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë (1998)

Kushtetuta e Shqipërisë (1998), në nenin 18 të saj, përcakton se “të gjithë shtetasit janë të barabartë përpara ligjit dhe se askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla, si: gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore e sociale”.

2. Kodi i Familjes (2003)

Kodi i Familjes, i miratuar më 08.05.2003, Ligji Nr. 9062, parashikon të drejta të barabarta midis burrit dhe gruas që të zgjedhin lirisht për t’u martuar apo divorcuar, si dhe të drejtat dhe detyrat e ndërsjellta në familje për edukimin dhe rritjen e fëmijëve.

3. Ligji ‘Për barazinë gjinore në Shoqëri’, i vitit 2008 ‘Përbarazinë gjinore në shoqëri’, i cili synon: mbrojtjen e qytetarëve ndaj çdo lloj diskriminimi me bazë gjinore; garantimin e mundësive të barabarta si për meshkujt dhe femrat për të arritur standarte sa më të larta në fushën e barazisë gjinore; integrimin gjinor; krijimin e strukturave të reja politike-bërëse, ekzekutuese dhe mbrojtëse; parashikimin e masave të veçanta të përkohshme në vendimmarrjen politike, siç është rasti i kuotës neutrale në masën jo më pak se 30%; ndërmarrjen e masave të posaçme në fushën e arsimit, punësimin; etj.

4. Kodi Aktual i Familjes.¹⁹ Marrëdhëniet pasurore mes bashkëshortëve

Nga analiza e deritanishme kemi konstatuar se marrëdhëniet juridike që krijohen midis bashkëshortëve nuk kanë vetëm natyrë personale por edhe pasurore. Kontributi material mund të përmbushet jo vetëm nëpërmjet të ardhurave financiare, por edhe në natyrë, nëpërmjet vënies në përdorim të familjes të sendeve vetjake të njërit prej bashkëshortëve, aktivitetit personal në drejtim të kujdesit ndaj familjes dhe atij të zhvilluar në drejtim të rritjes dhe edukimit të fëmijëve apo çdo aktivitet tjetër i kësaj natyre që do të kishte për qëllim evitimin e shpenzimeve të tjera që do të duhej të bënin bashkëshortët në mungesë të këtij aktiviteti të njërit prej tyre.

Këto të fundit ndahen në marrëdhënie me karakter periodik që nënkuptonin fitimin e sendeve të konsumit të përditshëm, si dhe marrëdhënie të tjera pasurore të cilat tejkalojnë kuadrin e kontributit të nevojshëm në interes të familjes dhe bashkëjetesës. Të gjitha këto marrëdhënie pasurore që lindnin ndërmjet bashkëshortëve apo edhe të tretëve janë të panumërta e nuk mund të parashikohen shprehimisht nga Kodi i Familjes. Ajo që i bashkonte këto marrëdhënie ishte fakti se si do të përcaktohej titullari i këtyre të drejtave, me fjalë të tjera, cilit bashkëshort i përkinin sendet e fituara gjatë martesës. Ndryshe nga marrëdhëniet e tjera civile, ku titullari i së drejtës ishte kurdoherë personi që e kishte fituar sendin në një nga mënyrat e parashikuara nga Kodi Civil.

Në rastin e sendeve të fituara gjatë martesës, ky përcaktim nuk është kurdoherë i thjeshtë. Për shkak të specifikës që ka martesja, e cila karakterizohet nga një besim reciprok ndërmjet bashkëshortëve, por edhe bazuar në faktin se pavarësisht nga të ardhurat financiare të gjithsecilit, kontributi në familje është si rregull i njëjtë edhe pse realisht në praktikë të dy bashkëshortët kontribuojnë sipas mundësive të secilit, në rastin e pasurisë së fituar gjatë martesës bëhet e vështirë për t'u dalluar se cili bashkëshort ka kontribuar realisht për fitimin e saj.²⁰

Nga ana tjetër, bazuar në këtë përcaktim do të zgjidhet më pas edhe problemi se cili prej bashkëshortëve, në cilësinë e titullarit të pasurisë, ka të drejtë të ushtrojë tagrat e pronësisë mbi këto sende, pra cili prej tyre mund t'i gëzojë e disponojë këto apo, cili prej tyre duhet të përmbushë detyrimet ndaj të tretëve. Sipas nenit 149 të Kodit Civil "Pronësia është e drejta për të gëzuar dhe disponuar lirisht sendet, brenda kufijve të caktuar nga ligji".²¹ Rezulton se ka një sërë faktorësh që influencojnë rezultatet aktuale të të drejtave pronësore të grave. Në cenimin e të drejtave pronësore ka rolin e vettradita, zakonet dhe mentalitetet mbizotëruese, mënyra sesi zbatohet ligji, niveli i ndërgjegjësimit të grave si dhe përpjekjet apo

19 Ligji nr.9062, datë 08.05.2003, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë.

20 Omari Sonila, "E drejta familjare" fq. 104.

21 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

stepjet e tyre për të marrë atë që u takon si dhe niveli i ndërgjegjësimit e profesionalizimit të aktorëve të sistemit të drejtësisë dhe shoqërisë në tërësi.

Analiza është përqendruar në marrëdhëniet familjare e martesore sepse këto institucionendikojnë në cilësinë e jetës dhe në respektimin e çdo individi si bashkëshorte, nënë, motër, bijë, etj. Cënimet e së drejtës fillojnë nga ato që quhen administrime të sendeve të vogla, që bëjnë pjesë në “sendet e përdorimit vetjak apo personal”. Nëse nukka gëzim të plotë të të drejtave mbi sendet e luajtshme, personale, që duken si me “më pakvlerë” ose të themi “të luajtshme”, nëse gruaja nuk administron dot të ardhurat nga puna e saj, nëse kontributi i saj si punë e papaguar nuk arrin të vlerësohet e respektohet as prejsaj dhe as prej anëtarëve të familjes, aspektet e gëzimit dhe administrimit të pasurive “tëmëdha” do të mbeten një utopi për gratë dhe objekt konfliktesh gjyqësore. Para lidhjes së martesës, duket se çiftet i kanë njohuritë të kufizuara lidhur me regjimet pasurore martesore. Gjatë martesës, ka gjithashtu privime në të drejtat pronësore. Njëmori aktesh juridike kryhen në padijeni ose në kushte mirëbesimi të bashkëshortes dheme keqbesim të bashkëshortit deri në mashtrim ose edhe të anëtarëve të tjerë të familjes. Këto raste përgjithësisht ‘zbulohen’ ose pas zgjidhjes së martesës ose pas largimit nga jeta të bashkëshortit dhe rrallë gjatë bashkëjetesës në çift. Gratë nuk i njohin mënyrat mbrojtjes ligjore prej bashkëshortëve që abuzojnë me pronën dhe nuk kontribuojnë në familje. Nuk ka asnjë rast në praktikën gjyqësore që gruaja t’i jetë drejtuar gjykatës me qëllim marrjen e autorizimit për kryerjen e veprimeve që janë në interes të familjes por që pengohen nga bashkëshorti. (rregulluar sipas neni 91 të Kodit të Familjes). Nga bashkëshortët dhe institucionet duket se nuk është i qartë neni 57 KF lidhur me kuptimin që merr ‘banesabashkëshortore’, pavarësisht statusit të saj si pasuri e bashkësisë apo vetjake.²² Gratë nuk e kanë të qartë kuptimin e ‘heqjes dorë’ nga pronësia mbi pasuritë e paluajtshme. Nuk hasëmasnjë rast në praktikën gjyqësore lidhur me aspektet e mbrojtura nga neni 61 i KF mbi ‘masat urgjente’ që mund të përcaktojnë gjykata me kërkesën e bashkëshortit në qoftë se tjetri nuk plotëson në mënyrë të dukshme detyrimet e tij dhe vë në rrezik interesat e familjes.

Në rastin e Shqipërisë, problemet e së drejtës pronësore vijnë edhe për shkak të ndryshimeve radikale që erdhën si pasojë e kalimit nga një sistem, që mund të thuhet se e eliminoi pronën private, në një sistem demokratik dhe që njohu të drejtën pronësore. Nga njohja e së drejtës deri në garantimin e saj real duket se ka rrugë ende të gjatë. Reforma ligjore në aspektet e të drejtës pronësore ka qenë një proces dinamik shoqëruar me përmirësime të vazhdueshme të standardeve të barazisë gjinore. Të njëjtën gjë themi edhe për aspektet e dokumenteve politike. Hartimi i tyre është bërë në mënyrë të kujdesshme dhe me prioritet të drejtat e gravenë kontekstin e veprimeve afirmative. Ndërkohë, sa kohë që rezultatet do të tregojnë

njëpabarazi të theksuar, kjo duhet marrë si nxitje për reforma ligjore e politikash në vijimësi. Këtu mund të veçojmë aspektet ligjore lidhur me trashëgiminë, politikat për tokën dhe të drejtat e grave në zonat rurale, çështjet e familjes bujqësore, politikat për strehim adekuat, çështjet mundësisë në kredi, probleme të pasurisë bashkëshortore gjatë martesës dhe në mbarimtë saj, etj. E drejtazakonore, kërkon të jetë protagoniste duke cënuar të drejtat e grave si pronare po aq të ligjshme sa edhe gjinia tjetër. Këtë konstatim e gjejmë edhe në vlerësimin e ndikimit gjinor në administrimin e tokës bërë për Shqipërinë, Malin e Zi, Bosnje Hercegovinën si dhe në njëvarg studimesh të bëra për Shqipërinë në këtë drejtim.

4. Konkluzione

Të drejtat njerëzore të grave dhe vajzave janë një pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandashme e të drejtave universale.²³ Në rastin e Shqipërisë, problemet e së drejtës pronësore vijnë edhe për shkak të ndryshimeve radikale që erdhën si pasojë e kalimit nga një sistem, që mund të thuash se e eliminoi pronën private, në një sistem demokratik dhe që njohu të drejtën pronësore. Nga njohja e së drejtësderi në garantimin e saj real duket se ka rrugë ende të gjatë. Reforma ligjore në aspektet e të drejtës pronësore ka qenë një proces dinamik shoqëruar me përmirësimet e vazhdueshmetë standardeve të barazisë gjinore. Të njëjtën gjë themi edhe për aspektet e dokumenteve politikë. Hartimi i tyre është bërë në mënyrë të kujdeshme dhe me prioritet të drejtat e gravenë kontekstin e veprimeve afirmative. Ndërkohë, sa kohë që rezultatet do të tregojnë njëpabarazi të theksuar, kjo duhet marrë si nxitje për reforma ligjore e politikash në vijimësi. Këtu mund të veçojmë aspektet ligjore lidhur me trashëgiminë, politikat për tokën dhe të drejtat e grave në zonat rurale, çështjet e familjes bujqësore, politikat për strehim adekuat, çështjet mundësisë në kredi, probleme të pasurisë bashkëshortore gjatë martesës dhe në mbarimtë saj, etj. Zhvillimi i qëndrueshëm dhe rritja ekonomike e cila është edhembështetëse dhe e qëndrueshme, janë të mundshme vetëm përmes përmirësimit të statusit ekonomik, shoqëror, politik, ligjor dhe kulturor të grave. Zhvillimi i drejtë shoqëror që pranon fuqizimin e të varfërve, veçanërisht të grave, për shfrytëzimin e resurseve mjedisore në mënyrë të qëndrueshme, është një themel i nevojshëm për zhvillimin e qëndrueshëm. Suksesi i politikave dhe masave që synojnë përkrahjen apofuqizimin e promovimit të barazisë gjinore dhe përmirësimi i statusit të grave, do të bazohen në integrimin e perspektivës gjinore në politikat e përgjithshme që kanë të bëjnë me të gjitha sferat eshoqërisë si dhe zbatimin e masave pozitive me përkrahje adekuate institucionale dhe financiare në të gjitha nivelet. Shpesh herë në ligjet neutrale duket se fshihen pasoja diskriminuese nga

këndvështrimi gjinor. Gjithashtu rregullimet ligjore lidhur me institutin e bashkëjetesës në çift dhe mundësisë nëpronë e çifteve që jetojnë në bashkëjetesë është kërkesë e kohës. Ndërhyrjet ligjore duhet të mbajnë në konsideratë ndikimet e të drejtës zakonore me qëllimeliminimin e tyre. Ratifikimi i një numri të madh konventash nuk e ezaron plotësisht problemin sepse ende zbatueshmëria e konventave nuk është e duhura kjo edhe për efekt të njohurive të limituar lidhur me to por edhe sepse zbatueshmëria e tyre nuk është e mundur për shkak se kërkohet dalja e një ligji të veçantë. Një harmonizim i brendshëm i kuadrit ligjor mbetet me rëndësi.

5. Bibliografia.

5. Aleks Luarasi “Marrëdhëniet Familjare” Botim i SHB Luarasi, Tiranë 2001.
6. Konferenca e Katërt Botërore Për Gratë , Deklarata e Pekinit & Platforma për Veprim, Aksion për Barazinë, Zhvillimin dhe Paqen, 1995.
7. .Deklarata e Vienës & Programi për Aksion, 1993.
8. John Drexhage, Deborah Murph Sustainable Development: from Brundtland to Rio 2012, Background Paper Prepared for Consideration by the High Level Panel on Global Sustainability at its First Meeting, 19 September 2010.
9. Kanuni Labërisë.
10. Kanuni i Lek Dukagjinit.
11. Kanuni i Lumës.
12. Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, Miratuar me ligjin nr.7850, datë 29.7.1994; ndryshuar me ligjet nr.8536, datë 18.10.1999; nr.8781, datë 3.5.2001 dhe nr.17/2012, datë 16.2.2012; 121/2013, datë 18.4.2013
13. Manfred Nowak Human Rights: a Handbook for Parliamentarians, OHCR, Geneva 2005.
14. Nazmi Bicoku, “E drejta e Trashegimise”, Onufri, 1997
15. Ksanthipi Begeja “E Drejta Familjare” Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave Politike-juridike, 1980 .
16. Omari Sonila, “ E drejta familjare”, Tirane, 2008.
17. Shih “Assessing Land Administration Project’s Gender Impacts in the Western Balkans”,

18. De Waal C. Post-socialist Property Rights and Wrongs in Albania: An Ethnography
19. Arta Mandro “E drejta Familjare” SHB Emal, Tirane 2009.
20. UN Women Country Office Albania, Të Drejtat Pronësore Të Grave Në Shqipëri, Tiranë,2016.
21. Vendimi nr. 6946/14.09.2011 i GJRRGJ Tiranë
22. Country Case Studies: Albania, Bosnia-Herzegovina and Montenegro, June 2011,
23. <http://siteresources.worldbank.org/INTECA/Resources/landgenderassessment.pdf>;
24. Ligji nr. 9062, datë 08.05.2003, Kodi i Familjes i Republikës së Shqipërisë.
25. <http://www.conservationandsociety.org/text.asp?2004/2/1/19/49340>.

Flavia Kolleshi lindur në Tiranë, më 17.09.1987. Ka përfunduar studimet e larta në ciklin e parë Bachelor dhe të dytë Master Shkencor në degën e Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Europian të Tiranës gjatë periudhës 2006-2011, si dhe studimet Master Shkencor në profilin “E Drejtë Publike” gjatë periudhës 2012-2013 në Fakultetin e Drejtësisë pranë Universitetit të Tiranës. Është trajnuar dhe kualifikuar më tej në fushën e kërkimit shkencor dhe të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Kolegjin Universitar “Wisdom”. Znj. Kolleshi ka ushtruar profesionin e pedagogut në Kolegjin Universitar Wisdom që nga viti 2013. Është njohëse e mirë e gjuhës angleze dhe italiane dhe pjesëmarrëse në shumë Konferenca Shkencore, e simpoziume akademike, përfshi këtu edhe projekte kërkimore shkencore .



GRUAJA NDËRMJET ‘PRODHIMIT’ DHE ‘RIPRODHIMIT’

Një reflektim mbi problemet bioetike të riprodhimit të asistuar

PhD Gerta MEHMETI

*Konsullata e Përgjithshme e Italisë Vlorë
mehmetigerta@hotmail.com*

Abstrakt

Preteksti për të shkruar këtë artikull ishte ftesa për të pjesëmarrë në konferencën dedikuar gruas dhe integritit të saj, e ndërsa vrapoja për në punë pasi kisha shpënë më parë dy vajzat e mia të vogla në kopsht, mendova sa e vështirë është për një grua-nënë-punëmarrëse të mbijetojë në një ambient kaq global, ku gjithçka sillet rreth parasë. Po nëse vajzat e mia nuk do të kishin ardhur me vullnetin e tyre në jetë, a do ta kisha gjetur ndonjëherë kur do të ishte “momenti i përshtatshëm” për tu bërë nënë? Po nëse një grua vendos të ketë një fëmijë pasi ka arritur pjekurinë profesionale dhe ka maturuar financat por ka humbur fertilitetin, si e ndihmon shkenca me anë të teknikave të riprodhimit të asistuar? Gjithçka mund të jetë e realizueshme me anë të teknikave të reja, por gruas do t’i duhet të përballet sidoqoftë me një seri problematikash bioetike, mjekësore, ligjore dhe të opinionit publik, si dhe do të duhet të përballojë kosto të konsiderueshme, të gjitha këto probleme të panjohura për gratë e së kaluarës. E gjendur mes ‘prodhimit’ dhe ‘riprodhimit’ në kuptimin kapitalist-marksist, ndoshta mëmësia është sfida më e madhe dhe e heshtur e gruas sot. Le të reflektojmë pak...

***Fjalë kyçe:** Grua, riprodhim, problemet bioetike.*

1. Hyrje

“Kjo botë u ka përkritur gjithnjë meshkujve, pavarësisht se asnjë nga arsyet që na janë paraqitur për këtë nuk na janë dukur të kënaqshme”, pat thënë Simone de Beauvoir në Seksi i dytë. Edhe titulli e bën provokuese a priori hierarkinë e sekseve [1]. Por si është ngritur kjo lloj hierarkie? Për të kuptuar këtë nevojitet një përjasje filozofike ekzistencialiste e prehistorisë, historisë, etnografisë dhe gjeopolitikës. Sipas tregimeve, sidomos mbi Amazonat e Dahomeit gratë kanë marrë pjesë në luftëra e rezistenca, por në prani të epërsisë fizike të burrave dhe handikapit të “tmerrshëm” të detyrimeve të riprodhimit ato prisnin në prapavijë të mbrojtura nga burrat, në mungesë edhe të kontrollit të lindjeve pasi natyra nuk u siguronte periudha shterpësie, ndërsa pjelloria absurde e pengonte gruan të ishte forcë punëtore duke bërë që të ishte burri baraspesha mes prodhimit dhe riprodhimit. Kujtojmë që kategoritë tradicionale të prodhimit dhe riprodhimit kanë qenë padyshim të rëndësishme gjithashtu në një pjesë të madhe të debatit feminist edhe në vitet ‘70 dhe ‘80 dhe përkufizimi i prodhimit dhe riprodhimit të sjell në mend Engelsin i cili përkufizon si “moment determinant të historisë prodhimin dhe riprodhimin e jetës së menjëhershme”, duke shpjeguar më pas dy aspekte në të cilat kjo ndahet: “nga njëra anë kemi prodhimin e mjeteve të jetesës dhe nga ana tjetër prodhimin e vetë njerëzve: riprodhimin e specieve”[2].

Le ta projektojmë hierarkinë e sekseve në kushtet e globalizimit. Gruaja sot luan një rol thelbësor në globalizimin ekonomik i cili vazhdon të jetë dukshëm i padrejtë dhe i pabarabartë, ku emancipimi i disa grave paguhet nga varësia e të tjerave. Në një jetë gjithnjë e më të kushtëzuar nga paratë, gratë paguajnë akoma çmimin më të lartë në terma përjashtimi dhe forma të reja ‘padukshmërie’. Në fakt “inseririmi” i gruas në proceset që karakterizojnë globalizimin, është mistifikim i ideologjisë së zhvillimit të gruas për sa kohë kjo e fundit tashmë është prezente në të gjithë sektorët, ndërsa vazhdon të jetë e vështirë që një grua të dëgjohet, të marrë fjalën dhe të injorojë buzëqeshje ose fraza “miqësore” që shpesh e trajtojnë ‘trup-objekt’. Qendrimi im do të jetë sigurisht feminist dhe ajo që përbën shqetësimin tim si grua dhe nënë e re dyfish është zgjidhja e atij momentit ekuacion me dy të panjohura që nga njëra anë ka ndërtimin dhe ruajtjen e raporteve të punës dhe nga ana tjetër ka fertilitetin dhe funksionin riprodhues që bazohet mbi fuqinë ekskluzive për të krijuar.

Pavarësisht se mjedisi global na detyron t’i dedikohemi prodhimit në kuptimin “marksist” duke vonuar mëmësinë, shkenca ndërhyr në proceset riprodhuese duke dhënë mundësinë e fekondimit ‘in vitro’ përtej modaliteteve natyrale. Duhet kujtuar që këto teknika të reja moderne të riprodhimit, përfshirë atij të asistuar janë transformuar tashmë në përgjegjësi dhe shpenzime të panjohura për gratë e së kaluarës dhe përmbajnë një sërë problematikash bioetike, mjekësore, ligjore dhe

të opinionit publik, prandaj ky artikull do të ndalojë pikërisht këtu: në problemet etike që lidhen me këtë sfidë të re të gruas sot.

Si mund ta imagjinojmë tensioni më i madh mbi argumentin u krijua mes mendimit filozofik laik dhe atij fetar. Në legjislacionin italian, më i ploti në lidhje me këtë argument, ligji mbi riprodhimin e asistuar është aprovuar përfundimisht nga Dhoma e Deputetëve në vitin 2004 [3] dhe u bë menjëherë objekt kritikash të shumta pasi sipas kontestuesve të këtij ligji, ky i fundit në vend që të siguronte një ndërmjetësim mes pozicionit katolik dhe aspiratave shkencore vendos një numër të madh barrierash që pengojnë veç të tjerash kërkimin, por edhe dëshirën dhe mundësinë për amësi dhe atësi. Embrioni këtu fillon të trajtohet si subjekt i së drejtës. Pranimi i një parimi të tillë në normativën juridike hyn në konflikt me nevojat e kërkimit shkencor [4], prandaj është kërkuar vazhdimisht të modifikohet me referendum teksti i këtij ligji por ende nuk është arritur kjo. Por cilat janë aspektet më kontroverse të këtij ligji? Së pari disiplina e re bazohet mbi parimin e lejimit të fekondimit të asistuar duke ndaluar teknikat që përdorin elementë të huaj nga ata të çiftit kërkues që mund të sjellin në të ardhmen paqartësi në lidhje me atribuimin e amësisë ose atësisë. Është e ndaluar gjithashtu mëmësia surrogate ose qiradhënia e uterit. Ligji preokupohet gjithashtu për të përcaktuar përfituesit e trajtimeve të fekondimit të asistuar me qëllim të shmangen rastet kur këta të fundit mund të sjellin situata që kundërshtojnë natyrën, si mund të jetë lindja e një fëmije nga një nënë shumë e madhe në moshë (mamatë-gjyshe) apo nga çifte ku të dy prindërit janë të të njëjtit seks apo përdorimi i semenit të ngrirë të një babai që ka vdekur në momentin e ngjizjes. Por duke qenë se ligji e njeh bashkëjetesën si bashkim fakti, edhe çiftet bashkëjetuese mund të përfitojnë nga kjo teknikë. Pjesa më e rëndësishme dhe më e kontestuar e ligjit është në fakt dhënia dhe njohja e të drejtave të embrionit [5]. Përpara ligjit 40/2004 embrionet konsideroheshin masa celulare dhe mund të krijoreshin disa për arritjen e një shtatzënie dhe më pas pjesa e mbetur pas arritjes së rezultatit, përdoreshin për qëllime kërkimore. Ligji përcakton se nuk mund të krijohen më shumë se tre embrione çdo herë dhe të tre duhet të implantohen menjëherë te gruaja. Kështu evitohet përdorimi i embrioneve për kërkime shkencore por edhe kufizohen në mënyrë drastike mundësitë për arritjen e një shtatzënie të asistuar. Të kujtojmë se statistikisht vetëm pas përpjekjes së tretë teknika rezulton e suksesshme dhe garancia është vetëm 30%. Sidoqoftë ky ligj pasqyron sensibilitetin e një vendi si Italia e cila pavarësisht se është një shtet laik, përbëhet në masën më të madhe nga popullsia katolike por që sidoqoftë ka formuluar një legjislacion që merr parasysh problemet etike dhe duke kërkuar zgjidhje për t'i pajtuar me nevojat kërkimore shkencore dhe dëshirat natyrore për mëmësi dhe atësi dhe të drejtat e embrionit dhe dinjitetin e jetës.

Ndërkohë në Shqipëri ka vetëm një normë në Ligjin “Për shëndetin riprodhues”[6], neni 13/3 që parashikon se të gjithë individët kanë të drejtë për të përfi-

tuar nga progresi shkencor dhe teknologjitë e reja lidhur me riprodhimin e seksualitetin, kur ato janë të sigurta dhe të pranueshme.

Në Francë me një ligj të 1994 [7] përcaktohet se vetëm çiftet e martuara ose bashkëjetuese prej të paktën dy vjetësh mund të kryejnë farëzimin artificial dhe nuk lejohet dhënia me qera e uterit.

Në Gjermani me ligjin e 1990 [8] pranohet farëzimi homolog dhe heterolog për çiftet e martuara, in vitro vetëm homolog. Ndalohet transferimi në trupin e gruas të më shumë se tre embrioneve, inseminimi post mortem dhe mëmësia surrogate.

Në Britaninë e Madhe parashikohet e njëjta situatë për riprodhimin e asistuar por lejohet dhënia në përdorim e uterit por jo kundrejt pagesës.

Ndërsa në Spanjë [9] gjejmë ligjin më të vjetër në këtë materie, në 1987, i cili lejon inseminimin artificial në çiftet e martuara e bashkëjetuese nëse kjo vendoset në mënyrë të lirë dhe të ndërgjegjshme.

Por krahas çështjes bioetike gjejmë edhe kosto të papërbalueshme të kurave të infertilitetit, kosto të larta të inseminimit artificial, garanci të ulët të suksesit të ndërhyrjes dhe nevojë për të përsëritur inseminimin disa herë. Si mund të perceptojmë edhe në bazë të asaj që analizova më lart, zgjidhja e problemit të riprodhimit në kushtet e globalizimit është një sfidë e vërtetë e gruas sot.

Po ju, cila mendoni se është sfida e gruas moderne?

2. Referenca

1. BEAUVOIR Simone, Seksi i dytë, I, Faktet dhe mitet, Çabej MÇM, 2002;
2. ONGARO Sara, Le donne e la globalizzazione: domande di genere all'economia globale della ri-produzione, Rubbettino, 2001;
3. Legge 40 del 2004, G.U. n. 45, 24 febbraio 2004 (regolamento attuativo G.U. 17 agosto 2004);
4. PALMER Larry I., Endings and Beginnings: Law, Medicine, and Society in Assisted Life and Death, Praeger, 2000;
5. FRANCO Vittoria, Bioetica e procreazione assistita. Le politiche della vita tra libertà e responsabilità, Donzelli Editore, 2005;
6. Ligji Nr.8876, datë 4.4.2002 "Për shëndetin riprodhues" në Republikën e Shqipërisë;
7. Code de la santé publique, Article L2141-1 (modifié par LOI n°2011-814 du 7 juillet 2011 - art. 28 et LOI n°2011-814 du 7 juillet 2011 - art. 31)

8. ROBERTSON John A., Reproductive Technology in Germany and the United States: An Essay in Comparative Law and Bioethics, https://law.utexas.edu/faculty/jrobertson/rt_germany_usa.pdf

9. Ley 35/1988, de 22 de noviembre 1988 sobre las técnicas de reproducción asistida

PhD. Gerta MEHMETI, ka lindur në Vlorë më 15 maj 1988. Pas diplomimit në Universitetin e Vlorës në degën Drejtësi, zgjedh të vazhdojë studimet *post lauream* në Universitetin La Sapienza të Romës, ku merr titullin Master në *E drejta Private Evropiane* me vlerësimin 110/110. Në qershor të vitit 2016 merr titullin Doktor në *Ekonomia, E drejta dhe Institucionet* pranë Universitetit Tor Vergata në Romë, për cilësi të dalluara të tezës dokto­rale mbi argumentin e aplikimit të të drejtave të njeriut në kontratat e rrezikshme. Aktualisht punon pranë Konsullatës së Përgjithshme të Italisë në Vlorë, pas disa eksperiencave të mëparshme në pozicione administrative, kontabël, mësimdhënie etj. Njohëse e shkëlqyer e disa gjuhëve të huaja, prej janarit të këtij viti është Përkthyes Ligjore e gjuhës italiane pranë Ministrisë së Drejtësisë. Vazhdimisht aktive në kërkimet poliedrike dhe publikimet në fushën e së drejtës, është e pasionuar pas filozofisë, historisë dhe hulumtimeve bioetike.



RËNDËSIA E SHËNDETIT MENTAL DHE FIZIK PËR REALIZIMIN E OBJEKTIVAVE TË ÇDO FEMRE

MSc. Jerina CELAJ

*Pedagoge, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
jerinacelaj13@gmail.com*

Abstrakt

A jemi ne gratë të vëmendshme aq sa duhet rreth shëndetit tonë, në mënyrë që të realizojmë kështu objektivat tona, në familje, punë, shoqëri?

Në vlerësimin e rolit të gruas në shoqëri, si një pjesë e rëndësishme e funksionimit të duhur të shoqërisë, shumë pak flitet mbi impaktin e shëndetit në realizimin e objektivave që çdo grua ka. Gruaja për të përmbushur detyrat e saj më së miri si nënë, bashkëshorte apo për tu rritur profesionalisht shpesh lë mënjanë përkujdesjen ndaj vetes.

Kjo përkujdesje për të cilën dua të vë theksin sot me referimin tim, është pikënisja e çdo suksesi në jetën e gruas. Po flas pikërisht për përkujdesjen në shëndet sesa atë në imazhin e gruas në përditshmëri.

Sa e njohim ne femrat veten në drejtim të shëndetit tonë fizik apo mendor?

A i kushtojmë ne vetes vëmendjen e duhur për të kryer kontrollet bazë rutinë të gjendjes shëndetësore?

Disa nga problematikat e përshkruara në këtë punim janë: kanceri i qafë së mitrës, sëmundjet tumorale, shëndeti amtar, depresioni post partum etj.

Ne gjithmonë jemi të prirura të lëmë veten në çdo gjë të fundit, por kujtoni shpesh që s'mund të jesh një nënë e fortë, një bashkëshorte e denjë, një grua në karrierë, një profesioniste e zonja, në qoftë se nuk jemi te shëndetshme mendërisht e fizikisht.

***Fjalë kyçe:** përkujdesja ndaj shëndetit, shëndeti mendor, shëndeti seksual, diagnostikimi i hershëm.*

A jemi ne gratë të vëmendshme aq sa duhet rreth shëndetit tonë,në mënyrë që të realizojmë kështu objektivat tona, në familje, punë, shoqëri?

Në vlerësimin e rolit të gruas në shoqëri, si një pjesë e rëndësishme e funksionimit të duhur të shoqërisë, shumë pak flitet mbi impaktin e shëndetit në realizimin e objektivave që çdo grua ka. Gruaja për të përmbushur detyrat e saj më së miri si nënë, bashkëshorte apo për tu rritur profesionalisht shpesh lë mënjanë përkujdesjen ndaj vetes.

Kjo përkujdesje për të cilën dua të vë theksin sot me referimin tim, është pikënisja e çdo suksesi në jetën e gruas. Po flas pikërisht për përkujdesjen në shëndet sesa atë në imazhin e gruas në përditshmëri.

Sa e njohim ne femrat veten në drejtim të shëndetit tonë fizik apo mendor?

A i kushtojmë ne vetes vëmendjen e duhur për të kryer kontrollet bazë rutinë të gjendjes shëndetësore?

Përveç se të rendim pas problematikave të familjes apo punës, duhet pikë së parin të krijojmë brenda vetes sonë besimin e fortë se çelësi i suksesit dhe i mbarëvajtjes së gjithçkaje mbetet padyshim shëndeti i plotë fizik dhe mendor. Jo më kot, edhe përkufizimi i OBSH (Organizata Botërore e Shëndetësisë) mbi shëndetin është zgjeruar.

Shëndeti nuk nënkupton vetëm mungesën e sëmundjes në aspektin bio-mjekësor. Shëndeti përkufizohet si një gjendje e mirëqenies së plotë fizike, mendore dhe sociale dhe jo thjesht prania e fuqisë fizike të organizmit. Mendoj se ajo që është më e rëndësishme është ndërgjegjësimi i çdo gruaje, që çdo përkujdesje, sado të vogël në dukje, ta fillojnë së pari nga vetja e tyre. Kjo do të jetë një mënyrë shumë e mirë për të arritur me efikasitet çdo realizim të gruas në aspektin e qenies një faktor kyç ne familjen dhe shoqërinë e sotme.

Sot promocioni shëndetësor, fatmirësisht është bërë metoda bazë që aftëson çdo individ në shoqërinë tone të kontrollojë shëndetin e tij, të njihet me faktorët që e rrezikojnë shëndetin dhe si rrjedhojë të njihen me masat parandaluese për të minimizuar çdo problem mbi shëndetin. Ekziston një listë e gjatë sëmundjesh, ndaj të cilave të gjitha ne jemi të riskuara, por disa prej nesh me predispozicion më të madh. Rëndësia e njohjes së disa prej sëmundjeve që prekin më shumë femrat qëndron në faktin se disa prej tyre mund të parandalohen ose më tej të kurohen plotësisht. Njohja me këto patologji na bën më vigjilente në situata të caktuara kur ne mbartim mbi vete dhe faktorë të tjerë risku.

Secila prej nesh, sipas moshës, sipas të dhënave të trashëgimisë, sipas stilit të jetesës duhet të jetë në gjendje të dijë të monitorojë trupin dhe shëndetin e saj. Unë nuk dua të flas sot për sëmundjet e rënda që shpesh kërcënojnë jetën e nje gruaje, që shpesh ndalin ëndrrat e një femre që ende nuk është bërë nënë apo që shpesh nuk e lënë një nënë të shijojë arritjet e fëmijës së saj apo shpesh që nuk e lënë një

grua të fortë në pushtet e të denjë për shoqërinë te tregojë deri në fund vlerat e saj. Kuptoni që jam duke folur për sëmundjet më të rënda të një gruaje sëmundjet tumorale. Nëse secila prej nesh do të kryejë një eko gjiri apo një mamografi sipas protokollit,sa shumë do të ulej incidenca e kancerit të gjirit, sepse vetëm në 2015 në mbarë botën humbën jetën 570.000 gra të moshave të ndryshme nga kjo sëmundje.

Sa mirë do të ishte që të gjitha ta dimë, se diagnostikimi në stadet më të hershme rrit aq shumë mundësinë jo vetëm për mbijetesë, por edhe për shërim. Një mamografi e gjirit të paktën një herë në vit te çdo femër mbi 35 vjeç do të na sillte veç efekte pozitive në jetën tonë. Një tjetër sëmundje po aq lehtë e diagnostikueshme, e kurueshme është kanceri i qafës së mitrës. Një Pap Test ,me pak kosto që realizohet në çdo klinikë gjinekologjike apo spital e bëjnë një femër të fitojë me sukses betejën me këtë sëmundje. Pas çdo fillimi të një marrëdhënieje seksuale për të parën herë një femër duhet në listën e gjatë të saj të objektiveve të ketë të përfshirë një herë në vit dhe më tej sipas këshillës së mjekut specialist kryerjen e një pap testi. Mos neglizhoni asnjë simptomë klinike që mund të jetë shenjë e fortë orientuese. Një hemorragji pas aktit seksual,një dhimbje këmbësh, një lodhje e pashpjegueshme, mungesë oreksi, humbje e dukshme në peshë pa shkak të qartë janë të gjitha shenja klinike,që dhe nëse keni harruar të kryeni ekzaminimet,duhet të filloni menjëherë.

Një marrëdhënie seksuale e mbrojtur mbron çdo femër nga kanceri i qafës së mitrës, sepse shkak është një virus HPV që transmetohet seksualisht. Kjo dhe shumë të tjera sëmundje që merren në rrugë seksuale kërkojnë një vëmendje të veçantë nga ana e femrës. Sëmundjet e tjera SST edhe pse mund të mos jenë jetëkërcënuese, ato shfaqin probleme e komplikacione që ndërhyjnë në cilësinë e jetës së gruas.

Probleme të tjera, që vënë në rrezik jetën e gruas janë ato të shëndetit amtar. Ndodh,që nje grua,që sjell një jetë të re në jetë të mos arrijë dot të quhet nënë. Kjo sepse gjatë momentit të vështirë të lindjes si pasojë e komplikacioneve të ndryshme ndodhin ato që njihen si vdekje amtare. Prandaj,një grua shtatzënë që me aq padurim,prët të bëhet nënë duhet të ndjek me kujdes jo vetëm ndryshimet në pamjen fizike që pëson trupi i saj,por edhe të kryejë gjithë kontrollet bazë gjatë periudhës 38-42 javë të gravidancës. Periudha më e vështirë për një grua të saponbërë nënë është periudha pas lindjes,që e vendos femrën përballë një problemi tjetër madhor për shëndetin.

Këtu po përmend depresionin post partum apo paslindjes. Do të ishte diçka shumë e rëndë nëse një nënë e re që nuk ka mbështetjen e bashkëshortit apo njerëzve të dashur, ardhjen në jetë të asaj krijese të pafajshme ta përjetonte mes trishtimit, lotëve, indiferencës ndaj bebit të saj. Kjo formë depresioni prek rreth 20% të nënave të reja në mbarë botën.

Sipas OBSH në mbarë botën humbin jetën 287.00 gra gjatë lindjes së bebit të tyre, ose si pasojë e problemeve të shëndetit riprodhues. Këtu një nga shkaqet e rëndësishme është dhe abuzimi me përdorimin e metodave kontraceptive, ku si në shumë raste femrat abuzojnë ndoshta me veten, për hir të dikujt tjetër.

Mos të presim derisa të na shfaqen simptoma klinike e shqetësime me shëndetin, por ti bëjmë këto ekzaminime si objektivin tonë, ashtu siç kemi objektivat tona për të qenë të plotësuar në çdo drejtim.

Së fundmi, kërkoj t'u bëj me dije se edhe probleme të tjera që shpesh ne i neglizhojmë, janë po aq të rëndësishme sa ato më të rëndat për shëndetin. Një keqshqyerje, një mungesë regjimi, mungesë aktiviteti, lodhje e tejzgatur, stresi i vazhdueshëm që në dukje duket sikur i kemi nën kontroll, kërkojnë më shumë vëmendje nga ne. Ne gjithmonë jemi të prirura të lëmë veten në çdo gjë të fundit, por kujtoni shpesh që s'mund të jesh një nënë e fortë, një bashkëshorte e denjë, një grua në karrierë, një profesioniste e zonja, në qoftë se nuk jemi të shëndetshme mendërisht e fizikisht. Sepse që të ecim pa pengesa në rrugën tonë të vështirë, plot sfida, na duhet force dhe askush më mirë se vetja nuk na udhëheq dot në këtë rrugëtim. Kujtoj që për të gjitha ne gratë duke menduar sesa pak mendojmë ne për veten në mbarë botën në kalendarin e ditëve të ndërgjegjësimit gjen një datë që është 28 Maji. Kjo është dita ndërkombëtare e ndërgjegjësimit për shëndetin e gruas prandaj jo më kot po e mbyll punimin tim me këtë datë. Shënojeni diku në bllokun të mbushur plot me agjendë e plane për familjen a punën në një cep këtë datë që të paktën çdo fund maji në një ditë të vetme mes ditëve aq të zëna të gjejmë fare pak kohë për një kontroll të përgjithshëm për veten tonë. Do të sigurojmë në këtë mënyrë, që jemi në gjendje ti përmbushim apo jo atë listë të gjatë objektivash të një gruaje të ditëve të sotme.

MSc. Jerina ÇELAJ, lindur në Vlorë, më 12 Nëntor 1989, diplomuar në Universitetin e Mjekësisë Tiranë, Fakulteti i Mjekësisë, për mjekësi të përgjithshme. E ka nisur karrierën si mjekë e përgjithshme pranë Qendrës Shëndetësore nr:3 Vlorë. Ka njohuri shumë të mira në nivel profesional të gjuhës angleze dhe frënge. Aktualisht është Pedagoge, në Fakultetin e Shëndetit Publik, pranë Universitetit “*Ismail Qemali*“ Vlorë.



MODELI I GRUAS NË PROCESIN INTEGRUES “NJË VAKSINË SOCIALE” NË FORMIMIN E GJENERATËS SË RE

Dr. Ledina MERKAJ

*Departamenti i Gjuhëve të Huaja,
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
ledina_merkaj@hotmail.com*

Msc. Fjona CUKANI

*Departamenti i Gjuhëve të Huaja,
Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë
fjona2002@yahoo.it*

Abstrakt

Edukimi i brezave ka si bazë të gjenezës së tij familjen. Kjo e fundit si një institucion përkujdesës në mirëritjen dhe edukimin e tyre, shpesh përballet me përkatësinë, ndarjen e roleve, kompetencat e sfida të tjera. Kush është rregullatori(a), misionari(a), mentori(a), nxitësi(a)? Dikotomia burrë-grua, gjithnjë e më shumë po i afrohet modelit të një mentori në familje, ku të dy pjesët përbërëse kanë të njëjtat të drejta dhe detyrime në bashkërendimin e saj. Në ditët që jetojmë, në kushtet e integritit të përgjithshëm të jetës shoqërore dhe familjes shqiptare, nuk konsiderohet ide e tepërt apo përfytyrim iluminist beteja për emancipimin e rolit të gruas në familje. Qoftë në aspektin intim apo në mënyrën si ajo i lidh dhe i ndërton marrëdhëniet sociale me të tjerët. Nuk ka asnjë dyshim që pozita e grave në familje dhe në shoqëri, qoftë nga ana sociale apo aspektin sociologjik mbetet një nga treguesit e rëndësishëm sintetik, mënyrë e sigurt për të matur dhe treguar nivelin e zhvillimit të qytetërimit tonë, masën dhe intensitetin e procesit integrues të jetës sociale dhe familjes shqiptare.

Në këtë punim, duke bërë një analizë të evoluimit të gruas shqiptare që nga periudha komuniste, ajo postkomuniste apo postmoderne, nxjerrim në pah domosdoshmërinë e sensibilizimit dhe nxitjes në nivel politikbërje dhe rrethet intelektuale dhe akademike, të krijimit të programeve edukuese me bazë edukimin gjinor që në sistemet elementar, duke evituar kështu diskriminimin dhe dhunën gjinore. Duke qenë se femra është shtylla e familjes dhe ajo është ekskluzivisht faktori kyç i edukimit të fëmijëve, atëherë është më se e rëndësishme që ajo të jetë e shkolluar dhe që të jetë një shembull i mirë dhe me kompetencë ndaj fëmijëve të vet në radhë

të parë dhe ndaj shoqërisë në tërësi. Kjo është një sfidë për programet qeveritare dhe ato akademike. Ajo duhet të jetë sipërmarrëse, lehtësuese në një ambient tepër maskilist, të jetë sfiduese në ambiente profesionale, me vet-besim për rrugën dhe sfidat që e presin. E ndodhur përpara një procesi të gjatë integruar, dinamika e gruas shqiptare do ta çojë gjeneratën e re në progresin e dëshiruar.

Fjalë kyçe: edukimi, procesi integruar, grua, burrë, familje.

1. Hyrje

Nëse do të bëjmë një hulumtim të konceptit qytetërim do të gjejmë në fjalor shpjegimin “Tërësia e arritjeve në fushën e kulturës materiale e shpirtërore dhe në zhvillimin shoqëror, që karakterizojnë një formacion ekonomik-shoqëror ose një popull a vend të caktuar.

Çfarë kuptojmë me fjalën emancipim?

Me fjalën emancipim kuptohet lirimi apo pavarësia nga kontrolli dhe mbikëqyrja e tjetrit -ky tjetri mund të jetë kushdo: mund të jetë një njeri në cilësinë e tij si prind, burrë, apo grua, por edhe një institucion, një abstraksion, një ide, një traditë, një rregull, një zakon, etj. Emancipimi është koncept gjithëpërfshirës, që kap nën ombrellën e tij aspekte nga më të ndryshmet.

Të emancipohesh nuk do të thotë të largohesh nga çdo rregull që imponon shoqëria: së paku një rregull fundamental moral nuk mund të shkulët kurrë pa e shpërfillur njëkohësisht edhe emancipimin: nuk mund të shkelësh lirinë e tjetrit në emër të emancipimit tënd. Emancipim, pra, nuk do të thotë lirim nga çdo përgjegjësi që njeriu ka ndaj tjetrit; emancipim do të thotë lirim nga ato tradita, ato zakone, që bien ndesh me vetëdijen e njeriut si qenie e lirë dhe morale.

Si është figura grua kundrejt këtyre definicioneve? A është ajo e arrirë materialisht dhe shpirtërisht në shoqërinë shqiptare, po emancipimi i saj në çfarë niveli është?

Nuk besoj se në kohën tonë, në kushtet e integritit të përgjithshëm të jetës shoqërore dhe familjes shqiptare, të konsiderohet ide e tepërt apo përfytyrim iluminist beteja për emancipimin e rolit të gruas në familje. Nuk ka asnjë dyshim që pozita e grave në familje dhe në shoqëri, qoftë nga ana sociale qoftë në aspektin sociologjik mbetet një nga treguesit e rëndësishëm sintetik, mënyrë e sigurt për të matur dhe treguar nivelin e zhvillimit të qytetërimit tonë, masën dhe intensitetin e procesit të integritit social.

Të drejtat e qytetarisë së grave nuk mund të jenë më objekt në dorën e burrave,

të cilët akoma dëshirojnë të kenë ekskluzivitetin e përcaktimit të madhësisë së qytetarisë për gratë në familje dhe shoqëri. Kjo betejë nuk është objekt që duhet të mbesë në dorën e tyre. Madje as gratë nuk duhet të mbesin në pozitën pritëse duke e kërkuar këtë të drejtë si dhuratë nga burrat e tyre biologjikë apo social. Koha kërkon që respektimi i të drejtave qytetare të gruas në familje dhe shoqëri, të mos shikohet me optikën pritëse se çfarë do bëjnë “burrat e shtëpisë” apo “burrat e shtetit” për ne. E rëndësishme është se çfarë do bëjnë ne me veten tone, për të patur të garantuar në mënyrë integrale të drejtat e qytetarisë femërore në familje dhe shoqëri, si vlera dhe cilësi universale për të qenë qytetare të barabarta dhe të vlerësuara si të tilla në familjen dhe shoqërinë shqiptare.

2. Figura aktuale e gruas shqiptare

Po të bëjmë një vështrim në kohë do të shohim se figura grua në Shqipëri është fuqizuar. Në 2017 kemi 28 % gra në parlament, 35 % këshilltare në bashki, 5 nga 61 kryetare bashkie dhe 6 në 14, ministre kabineti dhe një zv.kryeministre. Po a është kjo një “begenisje” që na bëjnë për çështje shifrash/statistikë, apo ne vlerësohemi se dimë të bëjmë llogaritë mirë dhe të ruajmë ekuilibrat.

Ambasadorja e Delegacionit të BE në Shqipëri, Romana Vlahutin, në një takim me aktivistë të shoqërisë civile për të drejtat e gruas në Shqipëri duke iu referuar situatës aktuale theksoi se “gratë përbëjnë një nga vlerat, asetet më të mira që ka Shqipëria. Ato janë një kapacitet jashtëzakonisht i madh për Shqipërinë, i cili nuk po përdoret. Përgjegjësia bie mbi shtetin. Shteti duhet të sigurojë zgjidhje sistematike për probleme sistematike”.

Kjo deklaratë na nxit të vlerësojmë situatën aktuale ku ende kemi vend për ndryshime si në konceptimin e programeve dhe kurrikulave për edukimin gjinor në sistemin elementar, i cili eviton diskriminimin dhe dhunën duke rritur qytetar të shëndetshëm, ashtu edhe në programet kualifikuese profesionale për gratë dhe nxitje për sipërmarrje të vogla dhe të mesme.

A është gruaja shqiptare e varfër?

Globalisht, 70% e 1.5 miliardë njerëzve që jetojnë me një dollar në ditë ose më pak janë gra. Ky fenomen është më se i qartë që ka prekur edhe gratë shqiptare, pavarësisht se nuk dihet i qarte akoma koeficienti real, pasi studimet janë të koordinuara nga sektorë të ndryshëm me privilegje e pozicione sociale të ndryshme. Ka shumë faktorë që kontribuojnë në mënyrë disproporcionale për gratë që përjetojnë varfërinë dhe shumë mënyra në të cilat gratë përjetojnë varfërinë ndryshe nga burrat.

Marrim një shembull duke u nisur nga zonat rurale në Shqipëri. Gratë fermere punojnë tokën por nuk e zotërojnë atë. E njëjta gjë ndodh edhe në rrugë globale

, edhe pse gratë janë përgjegjës për 60-80% të prodhimit të ushqimit në vendet në zhvillim, trashëgimia dhe prona me ligjet që ekzistojnë shpesh përjashtojnë gratë nga pronësia e tokës. Gratë kanë më pak akses në burimet ekonomike. Gratë kanë arsim më pak në zonat rurale. Brenda familjeve dhe komuniteteve, gratë kanë bërë pak vend për pushtet, gjë që e cila i kufizon akseset e tyre ndaj shume burimeve të rëndësishme.

Gratë punojnë më shumë se meshkujt. Globalisht, gratë punojnë më shumë orë pune se sa burrat. Pjesa më e madhe e kësaj pune është e papaguara dhe për punët brenda në shtëpi, edhe pse shumë gra duhet të punojnë për të balancuar punën e tyre të papaguar me llojet e tjera të të ardhurave ekonomike. Duke punuar me gratë është provuar të jetë një mënyrë e suksesshme veçanërisht efektive për të luftuar varfërinë, sepse gratë kanë tendencë për të investuar fitimet e tyre në ushqim, kujdes shëndetësor dhe arsimim për fëmijët e tyre.

Idetë tradicionale që gratë personifikojnë nderin dhe pastërtinë të ashtuquajtura simbolike të një komuniteti, drejton femrën veçanërisht femrën vulnerabël, drejt dhunës. Dhe kemi jo pak raste dhunimi ndaj gruas deri edhe në raste fatale, vrasjeje.

Në përmirësimin e qëndrueshëm dhe afatgjatë të situatës luan rol edukimi qytetar dhe ndryshimi i mendësisë patriarkale ku burri e sheh gruan si pronën e vet, mendësi që gjeneron marrëdhënie të dhunshme ndaj saj.

Sistemi arsimor duhet t'i kushtojë rëndësi të dorës së parë edukimit qytetar dhe paqësor të djemve dhe vajzave; që modeli i sjelljes së tyre gjinore t'i kundërvihet modelit patriarkal që ata mund të kenë në familjet apo komunitetet e tyre. Që nga arsimi parashkollor deri në arsimin e lartë duhet nxitur ndryshimi kulturor, edukimi qytetar me parimet e barazisë gjinore, respektin reciprok dhe kundërshtimin e stereotipeve për rolin e djemve dhe vajzave në shoqëri.

3. Barazia gjinore në edukim- një mekanizëm për një model të emancipuar

Të bëhesh grua apo burrë nuk është një proces linear. Çështja ndërmjet sekseve, meqenëse është çështje kulturash dhe jetese, është edukuese. Për këtë motiv, një praktikë pedagogjike gjinore, që ofron dëgjim dhe vë në qendër fjalët e vajzave dhe djemve të rinj, është e vjetmja që mund të ofrojë mundësinë e të kuptuarit të asaj çfarë ndodh e çfarë ndryshon. Ndaj i propozohet të hapet një refleksion i ri mbi këtë endje të vetvetes grua apo burrë, e cila është një punë e përditshme. Imazhi i vetvetes në të ardhmen, konfrontimi me eksperiencat e përjetuara dhe me marrëdhëniet e të tashmes, është puna për rritje që duhet të realizohet mbi të gjitha në institucionin edukues.

Institucionet e arsimit të lartë duhet ti ofrojnë gjithsecilit mjetet dhe mundësinë për tu kuptuar, kështu që çdo femër dhe çdo mashkull të mësojë të pranojë dhe të ndajë intimisht brishtësinë që mbart. Shkolla është një vend me maxhorancë gruan, por vetë mësueset kanë vështirësi të përballojnë tema dhe detyra të një pedagogjie gjinore; paralelisht meshkujt kanë në shkolla pak modele të gjinisë së tyre dhe jetojnë shpesh me mungesa të tilla edhe në familje.

Për sa i përket diskriminimit në arsim, ai është i pranishëm në: mësimdhënien dhe materialet e papërshtatshme bazuar në paragjykimin gjinor; mungesën e lehtësirave për tu arsimuar, në vecanti nëpërshtatje me nevojat e vajzave. Këtu e kemi fjalën për prioritizimin e disa programeve të studimit që u bëhet meshkujve si psh degë si informatika, apo inxhinieritë e ndryshme, matematika, fizika, ndërsa femrat priren drejt shkencave humane, infermieritë.

Pse ndodh kjo? Sepse duhet një hartëzim dhe edukim i mirëfilltë që në fëmijëri i brezave. Jo ndarje, ky profesion është mashkullor dhe ky profesion është femëror.

Është shumë e rëndësishme përhapja e një edukate respektuese dhe jodiskriminuese ndër brezat e rinj. Duhet investuar në një përmirësim të programeve mësimore në të gjitha nivelet e sistemit arsimor duke integruar në to koncepte të barazisë gjinore.

Është gjithashtu i nevojshëm kualifikimi konstant i aktorëve kryesorë në formimin e drejtpërdrejtë të studenteve. Duhet sensibilizuar dhe informuar mësuesit dhe akademikët rreth parimit të barazisë gjinore nëpërmjet kurseve dhe trajnimeve formuese. Përmes pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në mësimdhënien, por edhe shtimit të numrit të tyre në postet menaxheriale gjithashtu mund të arrihet një integrim gjinor më i madh në arsimin shqiptar.

Në nivelin europian edukimi shihet në funksion të konkurrencës ekonomike dhe politikave gjinore në fushën arsimore propozohen kryesisht për të promovuar pjesëmarrjen e vajzave në profesionet shkencore dhe teknologjike. Vullneti për të zbatuar politikën dinamike të formimit shkencor dhe për t'ju dhënë qytetarëve aftësi dhe kompetenca për tu adaptuar në tregun e punës.

Në politikën europiane për arsimin hasim objektivin e uljes së izolimit gjinor të karrierave në fushat teknologjike dhe shkencore. Ndër objektivat strategjike të dhjetëvjeçarit të ardhshëm janë dhe ato të rekrutimit dhe të trajnimit të mësuesve, të cilëve u kërkohet kujdes ndaj dallimeve kulturore dhe gjinore. Nënshtrimi i politikave gjinore nën objektivin e nxitjes së punësisë së grave, përtej stereotipeve gjinore, shihet edhe në dokumentet e policave të dedikuara për shanset e barabartatë Drejtorisë Gjenerale të Punësimit dhe Punëve Sociale, të Këshillit të Europës, si për shembull Road Map.

Për sa i përket instrumenteve legjislative europiane të të drejtave të njeriut dhe garantuesve të parimit për barazinë gjinore bazat themelore janë Konventa

për mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (www.echr.coe.int/Documents/Convention_ENG.PDF), e firmosur në Romë në vitin 1950 dhe 14 Protokollat e saj shtesë, si dhe Karta Sociale Evropiane (<http://conventions.coe.int/Treaty/ita/Treaties/Html/163.htm>), aprovuar në vitin 1961, e ripare në vitet 1991 dhe 1996 dhe Protokollat shtesë të 1988-s dhe 1995-s.

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk trajton në mënyrë të vecuar të drejtat e grave por duke qenë një dokument sa politik aq edhe normativ, në mënyrë telegrafike ajo i ka gjetur vendin e duhur kujdesit ndaj gruas si nënë. Kushtetuta ka shprehur detyrimin për një mbrojtje të veçantë nga shteti për nënat e reja dhe gratë shtatzëna në nenin 54 të saj.

Në Kushtetutën shqiptare përdoren përemra të tillë si “të gjithë”, “kushdo”, “askujt”, “secilit”, etj, për të treguar së bashkësia njerëzore të cilës i drejtohet dispozita nuk bën asnjë përjashtim, asnjë diskriminim, sepse të drejtat dhe liritë themelore u garantohen të gjithëve, gra e burra, të mitur e madhor, shtetas shqiptarë e të huaj, pakicave kombëtare.

Organizata botërore e shëndetësisë konstaton se shkaku kryesor i vdekjeve femërore është rrjedhojë, më shumë se nga sëmundje të rënda si tumori, e dhunës së ushtuar ndaj tyre nga burrat (<http://www.who.int/research/en/>). Mjafton kjo edhe në për të na kujtuar se i vetmi dhe i fundit revolucion i “Shekulli i ekstremeve”, që historiani Eric Hobsbawm e identifikonte në revolucionin femëror, nuk është përmbushur akoma (Hobsbawm E. J., *Age of Extremes - The Short Twentieth Century 1914-1991*, Pantheon Books, New York, 1994). Ndaj është me shumë se kurrë e rëndësishme kundërveprimi ndaj stereotipeve që prodhojnë sjellje diskriminuese, shtypëse dhe të dhunshme ndaj grave dhe vajzave por të promovohen marrëdhëniet empatike duke përfshirë në edukimin gjinor jo vetëm studentet por edhe mësuesit, pedagogët dhe familjet.

4. Konkluzione

Padyshim është një aksion i madh social për të përmirësuar familjen shqiptare dhe rolin e grave në të. Kjo do të thotë së pari që kjo betejë që është e shumanshme që duhet të fillojë me ndryshimin e dëshirës së grave, të cilat kanë nevojë të men-dojnë ndryshe për veten dhe rolin e tyre në familje. Ky është kushti i madh që ato të ndihen ndryshe në rolet e tyre seksuale, edukative e familjare. Në këtë kontekst është e udhës që më shumë duhet bërë, më shumë vëmendje i duhet kushtuar familjes si strukturë por dhe cilësisë dhe mënyrës së organizimit të jetës personale të grave në kuadrin e saj.

Në shpesh herë kur flasim për familjen, problemet e seksualitetit dhe të edukimit, problemit i drejtohem i ose me konceptione politike të vjetra ose me termi-

nologji sociologjike arkaike, duke e parë atë në mënyrë të njëanshme apo duke e vlerësuar thjesht si institucion social. Nuk është e lehtë të thuash se në cilat aspekte familja është më e dobët, në funksionet intime apo në rolin social, sepse duket që në të dy aspektet e kësaj strukture ka probleme të mëdha, të shfaqura në formën e divorcit, dhunës, dobësimit të kohezionit familjar, dhe në aspektet e roleve sociale dhe detyrave integrale të edukimit qytetar të pjesëtarëve të saj.

Në këtë aspekt është shqetësues fakti që nga zbehja e këtyre roleve thelbësisht ekzistenciale, po ndikon që familja të reduktohet në institucionin e zbehtë biologjik, të bazuar vetën në detyrimin e realizimit thjesht të detyrave të riprodhimit. Me gjithë ndryshimet që kanë ndodhur kohët e fundit në strukturën, funksionet dhe rolet e partnerëve në familjen shqiptare, duket se akoma nuk kemi dalë nga qerthulli i vjetër i familjes tradicionale, në të cilën “individët gra” kanë qenë dhe në një masë të konsiderueshme akoma janë të varur apo të nënshtuar ndaj “individëve burra”. Duhet konsideruar shqetësim social dhe problem sociologjik fakti që akoma në shumë drejtime, ka tregues që vërtetojnë lehtësisht të vërtetën se familja shqiptare vazhdon të jetë më shumë burim i maskilizmit të sigurt dhe fare pak i plotësimit të kushteve ekzistencialisht dhe realisht të realizimit të sigurimit të kushteve për shfaqjen dhe konsolidimin e “qytetarisë femërore.

Gruaja, duhet ta shikojë veten si një aktore të rëndësishme në institucionin familje, jo të presi çfarë do të sugjerojë burri.

Edukimi gjinor, si një mekanizëm shumë vendimtar në formimin e brezave, duhet të nisë të ndryshojë filozofinë dhe përkatësimin. Nuk ka profesione të ndara, kjo për burrin, kjo për gruan. Ne jemi individë me të drejta të barabarta.

Le t’ia lemë gruas përcaktimin e rrugës së edukimit të brezave sepse ajo është një mentore e ndjeshme e përgjegjshme dhe këmbëngulëse dhe burri si një “coach”-trajnuar hap pas hapi i këtij procesi.

5. Bibliografia

1. EACEA P9 EURYDICE, Gender Differences in Educational Outcomes: Study on the Measures Taken and the Current Situation in Europe, Eurydice, Bruxelles, December, 2009. GADC, Aleanca Gjinore per Zhvillim, Prespektiva Gjinore ne Tekstet Shkollore. Udhëzues per shtepite botuese te teksteve shkollore, Pegi, Tirane, 2008
2. Pomeroy, Sarah, B.: Goddesses, Whores, Wives and Slaves in Classical Antiquity, Knoph Doubleday Publishing Company, New York, 2011
3. Risman, Barbara. J.: Gender as a Social Structure: Theory Wrestling With Activism, Gender & Society, 18(4):429-450, 2004

4. French, Elizabeth, G., & Lesser, Gerald, S.: Some characteristics of the achievement motive in women, *Journal of Abnormal-Social Psychology*, 68(2):119-128, 1964
5. www.echr.coe.int
6. <http://eca.unwomen.org/en/digital-library/publications/2016/10/albania-gender-brief>
7. http://www.qag-al.org/WEB/publikime/raporti_shqip.pdf

Dr. Ledina MERKAJ Dr.Ledina Merkaj, lindur në Vlore, më 22 shtator 1980. Diplomuar në Universitetin “*Ismail Qemali*”, Vlorë me titullin mësues dhe përkthyes i gjuhës Angleze. Përfundon studimet postgraduate në 2008, dhe specializohet për përkthim në gjuhën angleze. Aktualisht mban titullin doktore shkencash në përkthim dhe komunikim dhe ndjek studimet post-doktoraturë për përkthim teknologjik dhe mediatore ndërkulturore në Universitetin e Porto, Portugali, në kuadër të programit Erasmus Mundus+. Karriera akademike si lektore e studimeve të komunikimit dhe përkthimit pranë departamentit të gjuhëve të huaja, në Universitetin “*Ismail Qemali*” Vlorë, si dhe aftësitë e kompetencat linguistike në gjuhën angleze i kanë dhënë mundësinë të jetë koordinatore e disa projekteve ndërkombëtare dhe kombëtare me donatorë si UNICEF, UNDP, Cooperacione Italian, në programe bashkëpunimi INTERReg IVc dhe IPA si dhe eksperte në hartimin e Strategjisë dhe planit të veprimit për fëmijët 2013-2017 dhe konsulente tematike në strategjinë e zhvillimit të qëndrueshëm për qarkun Vlorë 2011. Është përkthyesë ligjore e autorizuar nga Ministria e Drejtësisë së Shqipërisë dhe autore e shumë artikujve shkencor botuar në revista dhe buletin kombëtar dhe ndërkombëtare si ne Buletini i universitetit të Vlorës, Buletini shkencor “DARDANIA ,Pejë, revista periodike ANAS në Shkup të Maqedonisë, IJAS revista online European Scientific Journal etj, dhe përthyesë e albumit “Vlora, views and values in continuity” 2010.



Msc. Fjona ÇUKANI, lindur në Vlorë, më 31 janar 1980. Përfundon më 2005 studimet e larta dhe Masterin Shkencor pranë Universitetit të Salentos në Leçe (Itali), Fakulteti Gjuhë e Letërsi e Huaj, ndërsa më 2008 përfundon studimet postmaster pranë Universitetit Tor Vergata në Romë(Itali) dhe specializohet për Gjuhë e Letërsi Italiane. Në 2008 në kuadër të projektit njëvjeçar “Promoalba” INTERREG III - B.E. bashkëpunim mes disa universiteteve shqiptare dhe italiane merr titullin “Përkthyesë”. Në 2012 specializohet për hartim, menaxhim, realizim projektsh duke kryer studimet Master Profesional në shkrim projektsh evropiane pranë Eurogiovani Bolonja (Itali). Prej vitit 2006 është pedagoge pranë departamentit të gjuhëve të huaja në Universitetin “*Ismail Qemali*” Vlorë, me disa ndërprerje pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Vlorë si specialiste e kurrikulës dhe pranë Drejtorisë Rajonale të Arsimit Profesional Vlorë si anëtare e Bordit Drejtues dhe lektore. Ndërkohë është përfshirë për shumë vitesh si koordinatorë dhe eksperte në dhjetëra projekte të shoqërisë civile me fokus formimin dhe edukimin e të rinjve. Është autore e një monografie dhe shumë artikujve në lëmin akademik e shkencor botuar në revista dhe buletine kombëtare dhe ndërkombëtare, pjesëmarrëse në dhjetëra konferenca shkencore e në shumë seminare për përfitim e certifikim kompetencash profesionale. Formimi perëndimor dhe përvojat e punës e tërheqin natyrshëm të japë ekspertizën e vet në sfidat e reja të arsimit të lartë në Shqipëri në fushën e drejtimeve të reja të studimit, të projekteve dhe të kërkimit shkencor.



GRATË NË VENDIMARRJEN AKADEMIKE

Dokt. Meri KRAJA

*Pedagoge, Departamenti privat,
Kolegji Universitar “Wisdom”, Tiranë
e- mail: meri.kraja@wisdom.edu.al*

Dokt. Uarda ROSHI

*Pedagoge, Departamenti publik,
Kolegji Universitar “Wisdom”, Tiranë
e- mail: uarda.roshi@wisdom.edu.al*

Abstrakt

Shoqëria në të cilën jetojmë ende ka një çekuilibër të fortë gjinor dhe nuk ofron kushte të përshtatshme për të mundësuar dhe për të promovuar barazi të plotë të shprehjes së potencialit të grave dhe burrave. Evolucionin e rolit dhe i statusit të gruas ka ndryshuar thellësisht shoqërinë tonë në strukturimin dhe esencën e saj. Është një lëvizje e gjerë me pasoja shumë komplekse që nuk e njohim ende dhe vetëm e ardhmja do na e zbulojë. Komuniteti akademik, në të gjithë komponentët e tij, për fat të keq nuk është i përjashtuar nga ky trend.

Qëllimi i këtij studimi është të analizojë barazinë gjinore në kuadrin e arsimit të lartë, më specifikisht përfaqësimin e grave në organet e qeverisjes, si dhe ndikimin që ka në shoqëri, në mënyrë që të konstatojmë problemet e shumta që meritojnë vëmendje dhe reflektim nga të gjithë aktorët. Objektivi është të arrihet në një strategji dhe metodikë që u lejon universiteteve më shumë impakt në politikën e barazisë gjinore në tërësi, nëpërmjet kërkimit shkencorë dhe përfaqësim më të lartë të grave në organet qeverisëse. Kjo është një temë e cila ndihmon në përmirësimin e klimës organizative, dhe aftësisë së hulumtimit dhe kërkimit, është një çështje për t’u trajtuar në drejtim të qëndrueshmërisë më të mirë sociale të universiteteve në tërësi.

***Fjalë kyçe:** Barazi gjinore, Qeverisje, Universitet, Shoqëri, Evolucion.*

1. Hyrje

Pabarazia gjinore është një fenomen që prek organizimin e kërkimit shkencor dhe përfaqësimin në organet drejtuese akademike, dhe që ndërthuret e mbivendoset me pabarazitë e tjera. Kjo është një problematikë që nuk zgjidhet në mënyrë të natyrshme me evoluimin e sistemeve sociale, por nevojiten iniciativa konkrete që kanë në fokus analizimin e çështjeve të diversitetit.

Realiteti tregon se në sektorin e arsimit, dhe jo vetëm, ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme gjinore. Barazia që nga procesi i aplikimit, pra në hyrje të këtij sistemi, deri në arrijten e kualifikimeve arsimore është thelbësore, aq më shumë në qoftë se gratë arrijnë të realizohen e të bëhen ato orientueset e ndryshimit. Vetëm nëpërmjet pjesëmarrjes sa më të gjerë të grave dhe të vajzave në arsimim mund të arrihet minimizimi i pabarazisë në shoqëri. Arsimi është një e drejtë themelore e çdo individi dhe një mjet thelbësor për arrijten e barazisë gjinore.

Që nga vitet 90` numri i të diplomuarve në Shqipëri është në rritje dhe rezulton që femrat mbizotërojnë kundrejt meshkujve. INSTAT publikon të dhënat në përqindje për të diplomuarit sipas fushave të studimit dhe gjinisë. Sipas të dhënave të INSTAT 64% e të diplomuarve gjatë vitit 2015 janë femra krahasuar me 36% të meshkujve¹. Fusha e studimit me numrin më të madh të studentëve të diplomuar është ajo e biznesit, administrimit dhe ligjit, ku raporti mes femrave dhe meshkujve është 59% me 41%. Në ndryshim nga vitet e mëparshme edhe shkencat natyrore dominohen nga të diplomuarat femra në masën 73%. Po ashtu shkencat e arsimit, shëndetit dhe mirëqenies regjistrojnë më shumë studente të diplomuara në masën 80% dhe 76%. Fushat e dominuar nga meshkujt janë shërbimet (63%), inxhinieritë (58%), bujqësia (55%) dhe teknologjia e informacionit (51%)².

Sikurse kuptohet nga të dhënat e INSTAT, si meshkujt ashtu dhe femrat zgjedhin kryesisht fusha studimi që identifikohen me rolet e stereotipet tradicionale. Këto diferenca lidhur me stereotipin gjinorë në fushën e arsimit, mund të influencojnë negativisht edhe në rritjen ekonomike dhe përfshirjen në jetën sociale të grave. Ja pse është e nevojshme që në Shqipëri të krijohen praktika rreth studimeve të kësaj teme, në mënyrë që të eliminojmë stereotipet që klasifikojnë gratë në një rol social të caktuar.

Në këtë kontekst, është e nevojshme të sensibilizohen gratë që të zgjedhin degë si informatikë, inxhinieri, degë që ofrojnë hapësira të mëdha kërkimi shkencor për

1 <http://www.instat.gov.al/në-shqipëri-diplomohen-më-shumë-femra-se-meshkuj>. Mapo. 24/05/2016INSTAT/ Femrat e shkolluara në Shqipëri, sa dyfishi i meshkujve

2 „Alias Del Re, Valentine Longo, Lorenza Perini. I confini della cittadinanza. Genere, partecipazione politica e vita quotidiana: Genere, partecipazione politica e vita quotidiana, FrancoAngeli, 2010, Milano, fq 85.

të ardhmen, dhe në të njëjtën kohë dhe më shumë mundësi punësimi në Universitete. Në këtë mënyrë barazia gjinore, akoma shumë e ngadaltë në zhvillimin e saj në fushën akademike mund të arrihet. E rëndësishme është që si institucionet dhe politikatat e arsimit të ndër marrin hapa në këtë drejtim në mënyrë që barazia gjinore të bëhet motori i progresit social në shoqërinë tonë. Ky studim analizon mënyrat dhe politikatat nëpërmjet të cilave vendet përballen me pabarazinë gjinore në fushën e arsimit. Studimi analizon gjithashtu dhe eksperiencën evropiane këtë fushë, për të kuptuar nëse ekziston një nivel gender mainstreaming në politikatat arsimore. Qëllimi i këtij punimi është të analizojë përfaqësimin e barazisë gjinore në nivel akademik, më specifiku përfaqësimin e tyre në organet e qeverisjes.

2. Natyra e pabarazisë gjinore në fushën arsimore

Ndonëse situata ka ndryshuar në mënyrë radikale përse i përket përqindjeve të pjesëmarrjes në arsim, dallimet gjinore akoma ndikojnë në karrierën e përzgjedhur akademike .

Pabarazia gjinore në fushën arsimore është një çështje e rëndësishme, që ka ndikim si në perceptimin individual rreth arritjeve profesionale dhe zhvillimit në karrierë ashtu edhe në suksesin e institucioneve të arsimit të lartë. Problematikat e grave për të arritur në nivele të larta akademike, nuk janë vetëm një fenomen shqiptarë, dhe mbi të gjitha jo vetëm i botës akademike. Arsytet, edhe në këtë rast janë të artikuluar ndryshe. Diskutimi mbi barazinë gjinore në shoqërinë tonë zhvillohet në një terren të caktuar social dhe politik, në të cilin shfaqen ndikime të fuqishme të natyrës gjeografike, psikologjike, mentale dhe sociale.

Nga ky studim është evidentuar se ende ekzistojnë dallime midis meshkujve dhe femrave si në përzgjedhjen e studimeve të larta, ashtu dhe në rezultatet përfundimtare të arritura nga të dyja palët. Në nivel legjislativ ne disponojmë politika në lidhje me barazinë gjinore në fushën e arsimit, me objektiv kalimin e roleve tradicionale dhe të stereotipeve, duke u përqendruar në rritjen e numrit të grave në organet vendimmarrëse, në kapërcimin e modeleve absolute edukuese si dhe luftën ndaj ngacmimeve seksuale në punë, por ka një mungesë të thellë në aplikimin e këtyre politikave sidomos në zonat rurale, si dhe mungojnë iniciativat për të informuar rreth politikave për barazinë gjinore. Shoqëria civile nuk ka luajtur ndonjë rol të rëndësishëm në këtë drejtim, pasi nuk ka arritur të krijoj politika orientuese. Sidoqoftë, ne mendojmë t'u propozohet Universiteteve dhe Kolegjeve Universitare të hapin departamente specifike në këtë drejtim, procedurë që ndjek prej vitesh Bashkimi Europian.

Ajo që vihet re në shoqërinë tonë, është vështirësia e grave në arritjen e niveleve të larta të menaxhimit akademik, kjo reflektohet në përfaqësimin që ato kanë në

organet qeverisëse: sikurse mund të jenë zgjedhjet e Dekanëve apo përgjegjëseve të departamenteve. Nga të dhënat e mëposhtme do shohim se, universitetet jopublike kanë qenë më të suksesshme në respektimin e barazinë gjinore, pasi kanë një përfaqësim më të lartë të grave në organet drejtuese.

Rezultatet për Rektor në universitetet publike në 2016-ën, nxjerrin si përfundim 12 fitues ku rezultoi se përfaqësimi i grave është në vlerën 8.3%, pra vetëm një grua e cila përfaqëson Universitetin “Aleksandër Moisiu”.

Nga një hulumtim që kryem mbi një kampion prej nëntë Universitetesh Publike në Shqipëri, për barazinë gjinore në Senatet Akademike, reflektohet një raport nga një total prej 179 profesorësh gratë e përfaqësuar janë 35%. Ajo që bie në sy gjatë hulumtimit është një përfaqësim inekzisten i grave në Senatet akademik të Universitetit të Sporteve, ku raporti është 12 burra dhe 0 gra. Ndërsa analiza e një kampioni prej shtatë Universitetesh Jopublike në Shqipëri për barazinë gjinore në Senatet Akademike, tregon se raporti nga një total prej 73 profesorësh, është 54% gra dhe 46 % burra. Sikurse del nga të dhënat e mësipërme barazia gjinore në senatet akademike në Universitetet Jopublike është arritur, por ngelet shumë për të bërë në përfaqësimin e tyre në organet e tjera qeverisëse sikurse mund të jenë rektorët apo dekanet femra. Në fakt, karriera e vështirë e femrave në universitet nuk është problem vetëm në Shqipëri.

Politikat europiane³ vitet e fundit kanë vajtur drejt një përkujdesje më të madhe në këtë fushë, psh: në Bruksel që nga viti 2011, mbahet çdo vit një l’European Gender Summit, nga i cili dalin, ndër të tjera, rekomandimet e formimit të kërkuesve shkencorë në fushën e studimeve gjinore, duke e përfshirë këtë dimension në çdo kërkim shkencorë Universitar. Kjo është një mënyrë mjaft efikase për të fituar fonde nga Bashkimi Europian, dhe në të njëjtën kohë duke e kthyer atë në një mundësi për të siguruar rritjen në karriere dhe praninë e grave në të gjitha nivelet e vendimmarrjes Akademike. Vullneti për të zbatuar politika dinamike të formimit shkencor dhe për t’ju dhënë qytetareve aftësi dhe kompetenca për t’u përshtatur në tregun e punës në ndryshim gjatë zbatimit në Këshillin e Lisbonës të 2004 nga ku u aprovua dhe Traktati me të njëjtin emër në vitin 2007 si dhe programi i punës “Arsim dhe Trajnim 2010”, me synim përcaktimin e kompetencave për mësimin lifelong learning, uljen e analfabetizmit si dhe uljen e përqindjes së braktisjes së studimeve.

Interesi Evropian për temën u rikonfirmua nga dokumenti “Strategy for equality between women and men 2010-2015”, objektivi i të cilit ishte që të lehtësonte

3 http://www.europarl.europa.eu/summits/lis1_it.htm.

4 Document drawn up on the basis of COM(2010) 491 final, SEC(2010) 1079 and SEC(2010) 1080. European Commission, strategy adopted in September 2010, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2011.

ndryshimet kulturore në Universitete dhe institucione kërkimore⁵ (Komisioni Evropian, 2012). Bazuar në raportet e mëparshme, Komisioni Evropian kishte nënvizuar efektet e kundërta që rrjedhin nga mungesa e diversitetit gjinor në procesin e gjenerimit të njohurive dhe në Institucionet Shkencore (Komisioni Evropian, 2004).

Për më tepër, është vënë në dukje se mungesa e grave në pozicione të larta dhe leadership nuk lehtëson studiueset e reja për të zhvilluar më lart aspiratat e tyre. Në Europë kemi mjaft raste suksesi sikurse mund të jenë qendra mbi gjininë dhe edukimin (CSGE), apo Masteri shkencor i Univeritetit të Bolonjës Erasmus Mundus GEMMA. Tendenca është të hapen në Universitete departamente të reja studimi specifike për studimet gjinore⁶. Në nivel evropian edukimi shihet në funksion të konkurrencës ekonomike dhe politikat gjinore në fushën arsimore propozohen kryesisht për të promovuar pjesëmarrjen e vajzave në profesionet shkencore dhe teknologjike.

3. Politikat orientuese

Limiti për arritjen e të drejtave të barabarta dhe të mundësisë reale të rritjes profesionale për gratë është i lidhur në shoqërinë tonë me atë që mund ta konsiderojmë pengesa kryesore “përkujdesja familjare”! Edhe pse kemi patur disa lehtësi si psh: përfitimin e lejes së lindjes nga viti 2015 mund ta marrin edhe burrat në mënyrë që karriera e grave të mos njohë regres. Por këtyre limiteve i bashkohen dhe shumë pengesa të tjera sociale dhe kulturore që në një farë mënyre të gjitha së bashku kanë ndihmuar të ndërtojnë, një pengesë të padukshme, që kufizon rolin e gruas në shoqëri, i ashtuquajtur “tavan qelqt”.

Ekzistenca e një asimetrie gjinore në shoqëri, ose më specifikisht në brëndësi të zhvillimit shkencor, përfaqëson një problem në planin etik, social dhe ekonomik. Kjo asimetri është në kundërshtim me vlerat e barazisë dhe bashkëjetesës sociale tek të cilat universiteti inspirohet dhe konkretizon strategjitë e tij.

Nevojitet që të përqëndrohemi dhe të ndërhyjmë më shumë në arsyet që kanë shkaktuar këtë çekuilibër shoqëror, sikur mund të jenë:

1) promovimin e një Plan Veprimi pozitiv për të siguruar heqjen e pengesave dhe për të realizuar në mënyrë të plotë dhe të barabartë punësimin mes grave dhe burrave;

2) nxitjen e kushteve të punës që lejojnë, duke ruajtur cilësinë e shërbimeve,

5 CED, Department of gender studies, European Union Erasmus Mundus, Central European University.

6 A. Liccardo, M.C. Agodi, A. Gargano, M. Masullo, I. Picardi, O. Pisanti, Primo Bilancio di Genere dell'Ateneo Fridericiano, Federico II Open Access University Press, Napoli 2016, fq 9-10.

fleksibilitet më të madh dhe harmonizimin e jetës familjare, e cila ka të bëjë me kujdesin e fëmijëve, por që gjithashtu shtrihet në kujdesin e të moshuarve etj,⁷.

Të vendosësh në axhendë çështjen e gjinisë për akademikët do të thotë:

1. Të impeniohesh që barazia gjinore të konsiderohet si një element apo metodë në të gjitha veprimet e qeverisjes Universitare, pasi kjo është një çështje që përfshin të gjithë, burra dhe gra;

2. Nëpërmjet kësaj teme të promovohet trajnimi dhe ndërgjegjësimi në të gjitha nivelet për të kontribuar në ndryshimin kulturor të shoqërisë⁸;

3. Të promovohen dhe mbështet *rrjete sociale* në nivel kombëtar dhe ndër-kombëtar që përmes tyre të trajtojnë këto çështje dhe të merren masa kritike⁹;

4. Të përdoret një komunikim i brendshëm dhe i jashtëm gjithmonë në respekt të gjinisë si në të folur ashtu dhe në imazhe;

5. Të merren parasysh, në përgatitje e orareve mësimore, nevojat e kolegëve dhe kolegeve me fëmijë deri në 3 vjeç, kjo në përputhje me cilësinë e përgjithshme të shërbimit;

6. Të vendosen teknika organizimi në punë ku programimi i kohës të marrë në konsideratë oraret e mbledhjeve¹⁰;

7. Të promovohen programe *mentoring të cilat të krijojnë një suport për studiueset e reja në fushën e gjinisë*.

Pedagogët dhe akademikët duhet të bëjnë të tyren filozofinë dhe metodologjinë e një edukimi gjinor të ekuilibruar, të gjithëpranuar, dhe jashtë indoktrinimit gjinor. Gjithashtu duhet të njohin nga afër dhe në detaje tendencat globale, kornizat ligjore ndërkombëtare dhe kombëtare, politikat arsimore dhe dimensionet humane të kurrikulave universitare. Duket sikur gjithçka e thënë deri tani ka qenë thjesht demagogji apo sofizëm i kulluar. As njëra, as tjetra nuk e shpien botën përpara...!

4. Konkluzione

Mbizotëron një nevojë për të përfshirë barazinë gjinore në politikat strategjike të universiteteve me qëllim përmirësimin e klimës organizative, mundësinë për të diversifikuar talentet, dhe aftësinë e hulumtimit dhe kërkimit. Jo më pak e rëndë-

7 G.M. Cavaletto, A scuola di parità: Educare le giovani generazioni alla parità di genere, Franco Angeli, Milano 2017, fq 112.

8 R. Bracciale, Donne nella rete. Franco Angeli, Milano 2010. fq 67.

9 F. Carinci- A. Pizzoferrato, Diritto del lavoro dell'Unione Europea, UTET,Torino,2010, fq 436.

10

sishme është analiza e problemeve dhe pengesave për arritjen e barazisë gjinore, e cila është një pikë për t'u trajtuar në drejtim të qëndrueshmërisë më të mirë sociale të universiteteve në tërësi. Rruga drejt barazisë gjinore në universitete është akoma e gjatë. Si në Shqipëri po ashtu dhe në pjesën tjetër të Europës, n.q.se, duam të krijojmë kushte reale barazie dhe mundësish, nevojiten ndryshime kulturore dhe strukturore të institucioneve akademike.

Kjo është një çështje e cila në të ardhmen mund të trajtohet dhe në Konferencën e Rektorëve të Universiteteve Shqiptare, ku mund të kërkohet nga ana e tyre dhe inkuadrimi i klauzolës së barazisë gjinore dhe studimeve shkencore në këtë fushë në statutet përkatëse të universiteteve.

Një sistem i barabartë, gjithëpërfshirës, dhe i qëndrueshëm duhet të ofroj mundësi të shumta, dhe t'u lejoj kërkuesve dhe kërkueseve shkencore një mënyrë të barabartë konkurrimi, pa qenë pikërisht gjinia ajo që do vendos mundësinë e suksesit. Këto janë vlera nëpërmjet të cilave shoqëria përmirëson kapacitetin për të projektuar veten në mënyrë të vetëdijshme drejt një të ardhme të qëndrueshme.

5. Bibliografia:

Liccardo, M. C. Agodi, A. Gargano, M.R. Masullo, I. Picardi, O. Pisanti, Primo Bilancio di Genere dell'Ateneo Fridericiano, Federico II Open Access University Press, Napoli 2016.

F. Carinci, A. Pizzoferrato, Diritto del lavoro dell'Unione Europea, UTET, Torino, 2010.

G.M. Cavaletto, A scuola di parità: Educare le giovani generazioni alla parità di genere. Franco Angeli, Milanom 2017.

R. Bracciale, Donne nella rete. Franco Angeli, Milano 2010.

Del Re, V. Longo, L. Perini. I confini della cittadinanza. Genere, partecipazione politica e vita quotidiana: Genere, partecipazione politica e vita quotidiana, Franco Angeli, 2010, Milano.

Mapo. 24/05/2016INSTAT/ Femrat e shkolluara në Shqipëri, sa dyfishi i meshkujve

Document drawn up on the basis of COM(2010) 491 final, SEC(2010) 1079 and SEC(2010) 1080. European Commission, strategy adopted in September 2010, Luxembourg: Publications Office of the European Union, 2011.

CED, Department of gender studies, European Union Erasmus Mundus, Central European University.

6. Sitografia

http://www.europarl.europa.eu/summits/lis1_it.htm.

<http://www.instat.gov.al/në-shqipëri-diplomohen-më-shumë-femra-se-meshkuj>.

Doktorante Meri KRAJA, lindur në Shkodër me 31. 05.1981. është diplomuar në degën juridik në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër, në vitin 2003. Mban titullin e Avokates nga viti 2013. Më pas vazhdoj studimet në Universitetin e Torinos Itali, ku u diplomua në 2011, Shkenca ndërkombëtare (Bachelor në studime ndërkombëtare dhe Master Shkencor në Shkenca Ndërkombëtare). Aktualisht ndjek studimet doktorale, në Universitetin e Histori-Filologjisë, dega Marrëdhënie Ndërkombëtare. Ka punuar si pedagoge në disa universitete private, dhe aktualisht është pedagoge e brendshme në Kolegjin Universitar “Wisdom”. Zotëron rrjedhshëm dy gjuhë të huaja: anglisht dhe italisht.



Doktorante Uarda ROSHI u lind më 18.05.1988 në Vlorë. Ajo ka studiuar në degën Juridik, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet 2007-2011. Aktualisht ndjek studimet doktorale në Universitetin e Tiranës. Përvoja e saj e punës përfshin mësimdhënien në universitete private, konsulencën juridike në zyrë avokatie dhe OJF. Aktualisht është pedagoge e brendshme në Kolegjin Universitar “Wisdom”. Zotëron rrjedhshëm dy gjuhë të huaja: anglisht dhe italisht.



E DREJTA E PËRFAQËSIMIT TË GRUAS NË KUADRIN E BARAZISË GJINORE

DR. Stela MEÇAJ

*Lektore në Departamentin e Drejtësisë, Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë
stela.mecaj@yahoo.com*

Abstrakti

Barazia gjinore përbën një vlerë thelbësore për demokracinë në Shqipëri. Në mënyrë që kjo të arrihet vërtet, barazia mes grave dhe burrave duhet, jo vetëm që të njihet ligjërisht, por të zbatohet me efikasitet në të gjitha aspektet e jetës politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Jeta politike shqiptare dhe qeverisja, në të dyja nivelet kanë nevojë për krijimtarinë dhe kompetencat e grave për të përballur sfidat dhe aspiratat për një Shqipëri evropiane. Me gjithë përpjekjet e ndryshme për të trajtuar barazinë gjinore dhe për të arritur njohjen e saj formale, në praktikë gratë dhe burrat nuk gëzojnë të njëjtat të drejta. Këto pabarazi janë rezultat i formësimeve shoqërore të bazuara në stereotipe të shumta gjinore të pranishme në familje, në proceset politike, në jetën publike, në procedurat administrative dhe në organizimin e shoqërisë. Lëvizjet e grave për barazi dhe drejtësi sollën ndryshime thelbësore në mirëqenien e gruas në botë, si e drejta e votës, shkollimit, punësimit, por edhe sot gruaja vazhdon të jetë e papërfaqësuar, siç duhet në proceset politike. Përfaqësimi jo i barabartë i grave në proceset e zhvillimit shoqëror, ekonomik dhe politik ka qenë dhe vazhdon të jetë temë kryesore e kritikëve feminist. Ky punim ka për qëllim të evidentojë problematikat e hasura për të siguruar barazinë gjinore në vendimmarrje dhe rëndësinë e saj në përparimin e shoqërisë në tërësi.

***Fjalët kyçe:** barazi gjinore, kuotat gjinore, partitë politike, shoqëria civile etj.*

1. Hyrje

Në shumë vende trajtimi i grave nga ana e shoqërisë, e cila ka qenë e dominuar nga burrat nënkuptonte, se gratë nuk gëzonin të drejta të barabarta me burrat në sfera të ndryshme të jetës.¹ Gjatë luftërave, gratë në gjithë botën kanë kontribuar në mënyra të ndryshme. Në shumë pjesë të Evropës, si në Britaninë e Madhe, pozita e grave në shoqëri ka ndryshuar në mënyrë drastike, si rezultat i luftërave. Në Jugosllavi fillimi i Luftës së Dytë Botërore ka shënuar fillimin e hyrjes së grave në jetën sociale dhe politike, prandaj shumë gra luftuan për të lënë prapa kulturën e rrënjosur patriarkale.² Në të kaluarën grave u ishte ndaluar, që të zotëronin pronë; të kërkonin divorc ose të mund të padisnin dikë; të kishin qasje në planifikimin familjar; të mbroheshin nga përdhunimet, sulmet seksuale ose dhuna në familje/abuzimi; të kishin të drejtën për të votuar dhe për t'u zgjedhur; të arsimoheshin; të bëheshin pjesë e të njëjtave profesione, si burrat dhe në kultura të ndryshme ishte e papërshtatshme, që gratë të dilnin vetëm ose të merrnin vendime, që do t'u ndryshonin jetën.³

Sot gratë kudo në botë gëzojnë më shumë liri dhe akses i tyre në jetën publike dhe vendimmarrje është duke u rritur shumë ngadalë. Megjithatë ekzistojnë barrierat ekonomike, politike, ligjore e kulturore duke përfshirë: mungesën e implementimit të ligjeve të barazisë gjinore, mungesën e mbështetjes familjare apo kulturën politike mashkullore jomiqësore etj. Ato janë ende të diskriminuara dhe larg nga realizimi i potencialeve të tyre.⁴

2. Kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të grave në Shqipëri

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të drejta, që lindin bashkë me çdo qenie njerëzore dhe kanë karakter universal.⁵ Të drejtat e njeriut përbëjnë një tërësi të drejtash ose garancish, që mbrojnë individët dhe grupet nga veprimet ose

1 European Centre for Minority Issues (ECMI) Kosova, "Planprogrami për të Drejtat e Grave", 2014, fq. 12.

2 B. Barlovic, B. Matejic, "The role of women from World War II to Post-War Yugoslavia. From anti-fascist fighters to unknown heronies", <http://www.geschichtswerkstatteuropa.org/media/projekte/>, (Aksesuar më 01.02.2018), fq. 4.

3 European Centre for Minority Issues (ECMI) Kosova, "Planprogrami për të Drejtat e Grave", 2014, fq. 13.

4 V. Zeneli, "Të drejtat e gruas janë të drejta të njeriut", 2014, <http://www.panorama.com.al/te-drejtat-e-gruas-jane-te-drejta-te-njeriut/>. (Aksesuar më 01.02.2018).

5 A. Mandro, A. Guxholli dhe D. Berisha, "Të drejtat e grave në kontekstin e të drejtave të njeriut", Mediaprint, 2008.

mosveprimet, që mund të pengojnë liritë dhe dinjitetin njerëzor të tyre.⁶ Të drejtat e gruas janë pjesë e pandarë e të drejtave dhe lirive të njeriut.⁷ Të drejtat për gratë, si pjesë e të drejtave të njeriut janë parashikuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, si dhe në aktet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë nuk trajton në mënyrë të veçantë të drejtat e grave, por duke qenë një dokument sa politik aq edhe normativ, në mënyrë telegrafike ajo i ka gjetur vendin e duhur kujdesit ndaj gruas, si nënë.⁸ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka sanksionuar parimin e barazisë dhe atë të barazisë gjinore, si parime kushtetuese.

Aktet ndërkombëtare, që lidhen drejtpërdrejtë me mbrojtjen e të drejtave të grave, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë janë: “Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, ratifikuar në vitin 1994, si dhe protokollin shtesë i kësaj Konvente, “Konventa ndërkombëtare për të drejtat civile e politike” ratifikuar në vitin 1991, “Konventa ndërkombëtare për të drejtat ekonomike, sociale e kulturore” ratifikuar në vitin 1991, “Konventa Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut” ratifikuar në vitin 1995. Në kuadrin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit është duke u kryer një veprimtari e gjerë për përfaqsimin e legjislacionit të brendshëm shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian.⁹

Në mënyrë të veçantë mund të evidentohen disa prej ligjeve, që sanksionojnë në mënyrë të posaçme mundësi dhe mjete për të ushtruar të drejtat e grave, si dhe garanci për realizimin e tyre, si Kodi i Familjes, i cili rregullon lidhjen dhe zgjidhjen e martesës, marrëdhëniet midis bashkëshortëve, marrëdhëniet midis tyre e fëmijëve. Ky ligj bazohet në parimin e barazisë gjinore në jetën private e familjare.¹⁰ Kodi Zgjedhor¹¹ përmban dispozita të rëndësishme, që garantojnë, jo

6 Amnesty International, “Becoming a Human Rights Friendly School: A guide for schools around the world”, 2012, fq. 3.

7 A. Anastas, “Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar”, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2010, fq. 7.

8 Neni 54 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë: “1. Fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna dhe nënat e reja kanë të drejtën e një mbrojtjeje të veçantë nga shteti. 2. Fëmijët e lindur jashtë martese kanë të drejta të barabarta me të lindurit nga martesa. 3. Çdo fëmijë ka të drejtë të jetë i mbrojtur nga dhuna, keqtrajtimi, shfrytëzimi dhe përdorimi për punë, e veçanërisht nën moshën minimale për punën e fëmijëve, që mund të dëmtojë shëndetin, moralin ose të rrezikojë jetën e zhvillimin e tij normal. 4. Interesi më i lartë i fëmijës ka përparësi në të gjitha çështjet, që lidhen me të”.

9 Në këtë kuadër nevojitet veçanërisht përfaqsimi i legjislacionit shqiptar me Direktivën 2006/54 KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, 5 korrik 2006 “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe të profesionit”.

10 <http://konica.al/2017/06/te-drejtat-e-grave-dje-dhe-sot/>, (Aksesuar më 30.01.2018).

11 Ligj Nr. 10019, dt. 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”.

vetëm të drejtën e votës për gratë, por edhe të drejtën për t'u zgjedhur në organet e larta përfaqësuese, qëndrore e vendore. E drejta për t'u zgjedhur rregullohet në mënyrë të barabartë për të gjithë, si për gratë edhe për burrat, por kjo nuk mjafton për të eliminuar barrierat e krijuara nga shoqëria dhe klasa politike shqiptare për pjesëmarrjen e gruas në qeverisje. Sistemet e kuotave zgjedhore në thelbin e tyre janë masa të përkohshme, derisa të eliminohen barrierat, që i pengojnë gratë të marrin pjesë në vendimmarrje.¹²

Ligjet luajnë një rol mjaft të rëndësishëm për garantimin e të drejtave të gruas. Këto ligje rregullojnë në mënyrë të hollësishme të drejtat e sanksionuara në Kushtetutë, ose shpallin të drejta të tjera me karakter ligjor. Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri”,¹³ rregullon marrëdhëniet shoqërore në jetën publike, veçanërisht në fushën e arsimit, të punës dhe të shërbimeve në bazë të parimit për barazi gjinore në shoqëri. Njohja dhe zbatimi i dispozitave të ligjit jannë thelbësore për mbrojtjen e këtij parimi. Ndërsa, ligji “Për mbrojtjen nga diskriminimi”¹⁴ është mjaft i rëndësishëm, sepse rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe të mosdiskriminimit, jo vetëm në lidhje me gjininë, por edhe për çdo shkak tjetër.

2.1. Kuota gjinore në legjislacionin shqiptar

Ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” paraqet, si një nga kërkesat kryesore të parimit të barazisë gjinore, përfaqësimin e barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, si dhe në institucionet e tjera publike të vendit. Ky përfaqësim duhet të shtrihet, jo vetëm në përbërjen e anëtarëve ose punonjësve të këtyre organeve, por edhe në organet drejtuese të tyre. Ligji vendos një kuotë përfaqësimi në masën mbi 30% për secilën gjini. Gjithashtu, ai vendos disa garanci për të siguruar këtë përfaqësim të barabartë, si detyrimin që të gjitha institucionet të respektojnë procedura e kritere të njëjta për secilën gjini gjatë konkurimit ose emërimit të punonjësve. Gjithashtu, ligji ka përcaktuar edhe kuotën gjinore për kandidimin në organet e zgjedhura qëndrore e vendore, duke kërkuar një përfshirje mbi 30 % të secilës gjini në listat e kandidatëve për organet vendore dhe jo më pak se 30% për listat e kandidatëve për deputetë.¹⁵ Për zbatimin e kuotës gjinore në zgjedhje, një rol mjaft të rëndësishëm paraqet Kodi Zgjedhor, i cili parashikon rregulla për përmbushjen e saj, si në organet e zgjedhura qëndrore, ashtu dhe në organet e zgjedhura vendore.

12 <http://konica.al/2017/06/te-drejtat-e-grave-dje-dhe-sot/>, (Aksesuar më 30.01.2018).

13 Ligj Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.

14 Ligj Nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

15 <http://konica.al/2017/06/te-drejtat-e-grave-dje-dhe-sot/>, (Aksesuar më 30.01.2018).

3. E drejta e votës për gratë në Shqipëri në vitin 1945-1990

Në fillimet e shtetit shqiptar, nuk ka ekzistuar e drejta e grave për të zgjedhur e as për t'u zgjedhur. Në nenin 6 të ligjit për "Zgjedhjen e deputetëve" i vitit 1920 theksohet, se: "gjithë ata burra që kanë moshën 20 vjeç e përpjetë, paguejnë a s'paguejnë vergji, kanë të drejtë vote në çdo zyrë zgjedhjeje për zgjedhje të dytë". Në Statutin Themeltar të Mbretërisë Shqiptare, theksohet: "Të gjithë shtetasit gëzojnë në mënyrë të barabartë të drejtat politike e civile dhe pranohen në të gjitha nëpunësitë civile e ushtarake, përveç përjashtimevet të caktueme prej ligjës". Ky ligj ndryshoi pas ardhjes së komunistëve në pushtet.

Për herë të parë në Shqipëri, e drejta e votës për gratë është njohur në vitin 1945. Në Statutin e Republikës Popullore të Shqipërisë të vitit 1946, në kapitullin "Të drejtat dhe Detyrat e Shtetasve", neni 14 theksohet: "Të gjithë shtetasit pa ndryshim seksi, kombësie, race, besimi shkalle kulturore ose banimi dhe që kanë mbushur moshën 18 vjeç kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjitha organet e pushtetit shtetëror". Në nenin 17 theksohet, se: "Gruaja është njësoj me burrin në çdo fushë të jetës private, politike dhe shoqërore". Në ligjin zgjedhor Nr. 783, datë 20.1.1950 në kapitullin "Dispozita të përgjithshme" në nenin 5 theksohet, se: "Gratë kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen në Kuvendin Popullor njëlloj, si burrat".¹⁶

Pas miratimit të këtij ligji, për herë të parë u zgjodhën deputete në Kuvendin popullor, në Legjislaturën e parë të tij 1945-1950 në një përqindje prej 6%. Përqindjen më të madhe të përfaqësimit në parlament gjatë gjithë legjislaturave, gratë e kanë arritur në vitin 1974 me 33%. Por kjo përqindje ishte thujtse fiktive, sa i përket peshës, që kishin gratë në shoqërinë komuniste. Të njëjtën peshë vote në të vërtetë kishin edhe burrat, pasi vota në sistemin komunist nuk kishte asnjë kuptim. Gruaja në komunizëm mori artificialisht përmasat e burrit. Në Shqipëri gratë votuan për herë të parë në vitin 1946. Në legjislaturën më të fundit, para përmbyesjes së diktaturës, në vitet 1987-1991 në Parlament hynë 75 gra. Për 45 vjetët e regjimit komunist-totalitar duke qenë, se ekzistonte vetëm sektori publik, gruaja e gjeti deri diku rolin e saj si "forcë lëvizëse" dhe shpeshherë si "kukull" në parti, pushtet dhe administratë.

4. Gratë politike në Shqipëri pas vitit 1990

Pavarësisht apeleve të ripërsëritura ndërkombëtare për pjesëmarrje prej 30% të femrave në politikë, skena politike mbizotërohet ende nga meshkujt. Statistikat tregojnë, se në zgjedhjet parlamentare të vitit 1996, 21 gra fituan mandatin e deputetes. Zgjedhjet parlamentare të vitit 2005 u mbyllën me dhjetë gra deputete, ndërsa pas zgjedhjeve parlamentare të 28 qershorit 2009 të gjitha partitë politike janë përfaqësuar nga 23 deputete femra. Parlamenti i ri i Shqipërisë i dal nga zgjedhjet e 25 qershorit 2017 ka 39 deputete femra nga 140 deputet ose 27.85%. Ky është niveli më i lartë i përfaqësimit të grave në Kuvendin e Shqipërisë, që prej vitit 1992, kur u zhvilluan zgjedhjet e para pluraliste.¹⁷ Legjislativat me më pak deputete femra janë ato të mandatit '92-'96 me 9 gra dhe në vitet 2001-2005 me të njëjtën shifër. Grupmosha e femrave në politikë varion nga 30-50 vjeç dhe vetëm pak prej tyre janë propozuar, si kandidatura dhe kanë fituar më shumë se një mandat.

Vitet e fundit, veçanërisht që prej zgjedhjeve të qershorit 2013, rregullimi i përfaqësimit prej grave dhe sidomos vendimi i marrë për vendosjen e shumë grave në postet ministore apo edhe zv/ministore në qeveri i hapën rrugë të gjerë menaxhimit të shtetit prej grave dhe lëkundën paragjykimet për aftësitë e tyre drejtuese. Një veprim i tillë është sa i drejtë, aq edhe i domosdoshëm për shoqërinë tonë. Gruaja është një figurë më e pastër, ruajtëse më e mirë e moralit të vet, të familjes dhe të shoqërisë në krahasim me burrat, për rrjedhojë ato janë më pak të korruptueshme. Shoqëria shqiptare duhet të ndërgjegjësohet për të pranuar, mundësuar, lehtësuar dhe mbështetur ndarjen e pushtetit qendror dhe vendor me drejtuese gra.¹⁸ Vendosja e grave në krye të institucioneve në nivel qendror dhe vendor do të shtonte vlera të reja, të cilat do të ndikonin në ndërtimin dhe konsolidimin e institucioneve demokratike.¹⁹ Dilema para kutisë së votimit, që krijohet për kandidatin për arsye gjinie dhe jo tjetër, dëshmon se paragjykimin e kemi ende bashkëudhëtar dhe si shoqëri jemi akoma larg asaj që pretendojmë.²⁰

5. Pse është e rëndësishme të kemi përfaqësim të barabartë të dy gjinive në parlament?

17 <http://www.panorama.com.al/>. (Aksesuar më 13.02.2018).

18 Th. Nikuli, <http://shekulli.com.al/gruaja-dhe-perfaqesimi-i-saj/>, (Aksesuar më 28.01.2018).

19 Po aty.

20 Th. Nikuli, <http://shekulli.com.al/gruaja-dhe-perfaqesimi-i-saj/>, (Aksesuar më 28.01.2018).

Përfaqësimi i barabartë i gruas në politikë është konsideruar të jetë shumë i rëndësishëm. Një ndër argumentet kryesore është, se përderisa gratë përbëjnë 50% të popullsisë është e drejtë juridike elementare, që gratë të përfaqësohen në institucionet politike në mënyrë të barabartë me burrat. Demokracia e kërkon një gjë të tillë dhe mospërfaqësimi i barabartë i grave në politikë bie në kundërshtim me konceptin e demokracisë.²¹ Gratë duhet të marrin pjesë në politikë, sepse pa to koncepti i demokracisë nuk është i plotë dhe pa perspektivë për një vend.²² Pra një përfaqësim i barabartë i grave në politikë është parakusht për funksionimin e demokracisë, për ndryshime sociale dhe zhvillim ekonomik.

Sipas shkencëtares politikane angleze Ann Philips gratë kanë interesa, nevoja dhe eksperiencia të ndryshme nga burrat dhe këto interesa mund të përfaqësohen vetëm nga grate. Për këtë arsye duhet të ketë përfaqësim të barabartë të dy gjinive në parlament. Sipas Ann Philips, në institucionet politike të dominuara nga meshkujt çështjet, që kanë të bëjnë me grate, si dhuna në familje, dhunimi, abuzimi dhe diskriminimi seksual, varfëria të gratë, sëmundjet e grave dhe shumë çështje të tjera lihen të papërfaqësuar.²³

6. Aktorët, që mund të ndikojnë në ndryshimin e pozitës së gruas në politikë

1. Partitë Politike

Problemi me partitë politike është, se ato kanë inkuadruar gra në partitë e tyre, por ato rrallë herë nominohen, si kandidate për poste më të larta.²⁴ Çfarë duhet të bëjnë partitë politike? Përderisa mënyra më e zakonshme për t'u përfshirë në politikë është përmes partive politike, partitë politike luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm, sa i përket inkuadrimit të gruas në proceset politike. Në mënyrë që partitë tona politike ta luajnë këtë rol të rëndësishëm duhet që të adaptojnë një strukturë të brendshme demokratike, pra partitë politike duhet të demokratizohen. Partitë politike duhet të aplikojnë “mekanizma për përfaqësim të drejtë” dhe për këtë arsye “pa demokratizim brenda partisë dhe fuqizim të gruas në vendim-marrje brenda partisë politike është shumë e vështirë, që gruaja në qeveri të jetë

21 F. Pacolli, “Gratë vetëm numër apo zë i vërtetë në politikë?”. (Aksesuar më 30.01.2018).

22 Sipas Luljeta Vuniqit, drejtoreshë ekzekutive e Qendrës Kosovare për Studime Gjinore.

23 Fitore Pacolli, “Gratë vetëm numër apo zë i vërtetë në politikë?”, <https://telegrafi.com/>. (Aksesuar më 30.01.2018).

com/.

24 Po aty.

e përfaqësuar denjësisht”.²⁵ Partitë politike duhet t’i sigurojnë përkrahje grave dhe financim në mënyrë, që t’i ndihmojnë në kandidimin dhe fitoren e tyre. Partitë politike duhet t’i përfaqësojnë gratë në mënyrë të barabartë me burrat duke i inkuadruar ato edhe në nivele më të larta të partisë, jo vetëm në nivele të ulëta.

1. Kuotat

Sa i përket kuotave, ato kanë luajtur një rol të rëndësishëm në ngritjen e përfaqësimit të gruas në politikë. Megjithatë, kjo ngritje e përqindjes në parlament nuk solli ndonjë ndryshim të gjendjes së përgjithshme të pozitës së gruas në politikë. Kuotat kanë krijuar standarde mekanike, të cilat i detyrojnë partitë politike të arrijnë 30 përqindshin e grave në parlament. Kuotat ngritën numrin e grave në Parlament, por jo edhe zërin e tyre. Pra, tani për tani gratë deputete nuk janë në parlament t’i përfaqësojnë gratë, por janë aty sepse partitë politike detyrohen nga ligji për barazi gjinore dhe në këtë rast gratë në parlament nuk i përfaqësojnë gratë dhe interesat e tyre, por interesat e partisë.²⁶

1. Shoqëria civile

Në demokracitë moderne, shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm dhe kontribuon në mënyra të ndryshme në promovimin dhe inkuadrimin e grave në proceset politike. Shoqëritë civile mund t’i ndihmojnë gratë duke lobuar për të siguruar, që çështjet e grave të adresohen në platformën e partisë dhe për ndryshime në legjislativ, duke organizuar projekte të ndryshme për t’i edukuar qytetarët për rëndësinë dhe arsyet, pse duhet të kemi një përfaqësim të barabartë të grave në politikë.

Organizatat joqeveritare të grave kanë luajtur një rol të rëndësishëm për barazinë gjinore duke organizuar projekte të ndryshme në lidhje me çështjet, që kanë të bëjnë më pozitën dhe përfaqësimin e gruas në institucionet politike. Iniciativat e ndërmarra nga OJQ-të e grave nuk mund të arrihen pa ndihmën e deputeteve femra, të cilat janë prezente në parlament. Edhe pse kuota prej 30 përqind për përfaqësimin e grave në Parlament është arritur, sërish gratë vazhdojnë të lihen jashtë proceseve politike, si në postet udhëheqëse në pushtetin qendror, po ashtu edhe në pushtetin vendor. Interesat e grave në Shqipëri vazhdojnë të jenë të papërfaqësuar.

²⁵ Po aty.

²⁶ F. Pacolli, “Gratë vetëm numër apo zë i vërtetë në politikë?”, <https://telegrafi.com/>. (Aksesuar më 30.01.2018).

7. Konkluzione

Kuota legislative gjinore e parashikuar në legjislacionin shqiptar dhe e zbatuar deri më sot përmirësoi përfaqësimin e gruas në Kuvend, por nuk arriti rezultatin, që ligji “Për barazinë gjinore në shoqëri” ka synuar. Prandaj, ka nevojë për përmirësime në Kodin Zgjedhor, me qëllim që përfaqësimi gjinor mbi 30% të arrihet në rezultatin zgjedhor dhe jo vetëm në listën e kandidatëve. Ka mendime sipas të cilave mungesa e gruas në proceset politike është rezultat i kualifikimit të ulët të tyre, mungesës së talentit, mungesës së ambicieve politike dhe të vetëbesimit për të marrë vendime politike. Është e vërtetë, se në shumë raste niveli i edukimit të gratë është më i ulët sesa te burrat, por kjo nuk do të thotë se gratë janë më të paaferta, por se gratë gjithmonë kanë qenë të diskriminuara dhe vazhdojnë të diskriminohen në aspektet e edukimit dhe të punësimit. Prandaj mungesa e mundësive materiale për t’u promovuar, kushtet e rënda ekonomike dhe sociale për shumë gra janë disa nga pengesat, të cilat nuk i lejojnë gratë të inkuadrohen në politikë. Përveç këtyre pengesave, ndër pengesat kryesore janë barrierat institucionale, si për shembull sistemi i rekrutimit në partitë politike dhe e gjithë kjo po ndodh, si rezultat i diskriminimit të grave pikësëpari nga liderët politikë dhe po ashtu edhe nga vetë institucionet vendore. Politika vazhdon të udhëhiqet nga burrat dhe gratë shërbejnë vetëm, si numër për të plotësuar kuotat, prandaj hapa të menjëhershëm duhet të merren nga partitë politike, institucionet vendore, ndërkombëtare dhe nga vetë gratë në parlament për ndryshimin e kësaj gjendje.

8. Bibliografia

1. Amnesty International, “Becoming a Human Rights Friendly School: A guide for schools around the world”, 2012.

1. Mandro, A., Guxholli, A. dhe Berisha, D., “Të drejtat e grave në kontekstin e të drejtave të njeriut”, Mediaprint, 2008.

1. Anastas, A., “Të drejtat e gruas në legjislacionin shqiptar”, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, 2010.

1. Direktiva 2006/54 KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, 5 korrik 2006 “Mbi zbatimin e parimit të mundësive të barabarta dhe trajtimit të barabartë të burrave dhe grave në çështjet e punësimit dhe të profesionit”.

1. European Centre for Minority Issues (ECMI) Kosova, “Planprogrami për të Drejtat e Grave”, 2014.

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, 2016.

1. Mandro, A., Guxholli, A. dhe Berisha, D., “Të drejtat e grave në kontekstin e të drejtave të njeriut”, Mediaprint, 2008.
1. Zeneli, V., “Të drejtat e gruas janë të drejta të njeriut”, 2014.
1. Ligj Nr. 10019, dt. 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i RSH”.
1. Ligj Nr. 9970, dt. 24.7.2008 “Për barazinë gjinore në shoqëri”.
1. Ligj Nr. 10221, dt. 4.2.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.
1. <http://shekulli.com.al/gruaja-dhe-perfaqesimi-i-saj/>.
1. <http://konica.al/2017/06/te-drejtat-e-grave-dje-dhe-sot/>.
1. <http://www.geschichtswerkstatteuropa.org/media/projekte/>.
1. <https://telegrafi.com/grate-vetem-numer-apo-ze-i-vertete-ne-politike/>.
1. <http://www.panorama.com.al/>.

Dr. Stela MEÇAJ u lind më 23.06.1989 në Vlorë. Ajo ka studiuar në degën Juridik, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës në vitet 2007-2011 dhe vazhdoi studimet Master Shkencor për “Legjislacionin dhe Institucionet e Bashkimit Evropian” në Institutin e Studimeve Evropiane në vitet 2012-2014. Në vitin 2017 ka mbrojtur gradën shkencore “Doktor”. Përvoja e saj e punës përfshin mësimdhënien në Universitetin e Vlorës prej 7 vitesh, konsulencën juridike në zyrë avokatie dhe ekspertizën në legjislacionin mjedisor pranë OJF-ve. Zotëron rrjedhshëm dy gjuhë të huaja: anglisht dhe italisht.



DISA MENDIME NË VEND TË KONKLUZIONEVE

Qëllimi i konferencës rajonale “Zgjerimi i rolit të gruas në zhvillimin tërësor të shoqërisë” është më tepër se sa përmbushja e objektivave të strategjisë së kërkimit shkencor të Kolegjit Universitar “Pavarësia Vlorë” për të stimuluar dhe mbështetur nismat kërkimore-shkencore dhe ekstrakurrikulare, me karakter rajonal.

Përveçse për të zhvilluar bashkëpunimin në kontekstin rajonal, të institucioneve të arsimit të lartë me institucionet dhe aktorët vendorë e rajonalë, kjo konferencë shërben si promotor i përkthimit të këtij bashkëpunimi në një tjetër nivel, atij të përcaktimit të objektivave të përbashkët e më pas për t'i adresuar ato kah aksioneve dhe veprimtarive konkrete. Ne, si një institucion i arsimit të lartë, e ushtrojmë ditë pas dite rolin tonë si kërkues-vëzhgues të kujdesshëm të realitetit, të problemeve dhe të nevojave të tij, përmes hulumtimeve e studimeve që secili koleg ndërmerr individualisht apo dhe studimeve në nivel departamenti, fakulteti dhe më gjerë. Por, kur këto studime diskutohen dhe integrohen brenda strategjive sektoriale të institucioneve publike, shtetërore ose jo, organizatave të shoqërisë civile, organeve të qeverisjes vendore e asaj qendrore, bëhen një konglomerat i plotë i binomit problem-zgjidhje.

Kjo konferencë, e para në llojin e saj e organizuar nga një institucion akademik, mëton të mbetet një traditë e Kolegjit Universitar “Pavarësia Vlorë” dhe në formatet e saj të ardhshëm të përfshijë edhe më shumë aktorë e faktorë të tjerë të rëndësishëm, duke mos i humbur kështu karakterin dinamik vetë temës së konferencës. Ndonëse me karakter rajonal, konkluzionet e saj janë një kontribut i çmuar, në diskutimin mbi Gruan dhe rolin e saj për zhvillimin tërësor të shoqërisë, por mbetet kontribut modest për sa i përket dimensioneve ku roli i gruas e ndikon zhvillimin e shoqërisë. Nuk mundet të jetë kurrsesi vetëm qëllim i një konference (sado akademike dhe shkencore qoftë ajo) diskutimi mbi rolin e Gruas në shoqëri, pikërisht se rëndësia e saj gjendet jo doemos në panelet, podiumet apo forumet ku diskutohet për ‘të. Roli i Gruas, qartazi e më së shumti, duhet kërkuar përtej dukjes, përtej asaj që është e zëshme, e bukur, e fortë.

Jo pa qëllim e menduam të tillë formatin e konferencës, me karakter gjithëpërfshirës, me zonja të cilat qëndrojnë midis profileve të ndryshme, nga ai i mësuesisë, publicistikës, letërsisë, artit, turizmit, jurisprudencës, mjekësisë, akademizmit, biznesit, aktivizmit social, aktivizmit rinor, politikës lokale e qendrore, si drejtuese institucionesh, apo pjesë të administratës. Pikërisht se të diskutosh, të analizosh, të zbatosh (nga perspektiva e një Gruaje) e më pas të vlerësosh rolin e Gruas për zhvillimin e shoqërisë duhet së pari ta njohësh Atë, më gjithë dimensionet që i plotësojnë thelbin: si qenie humane, qenie sociale dhe qenie politike, në një përballje të vazhdueshme midis “vetes personale” dhe “vetes profesionale”; midis “privates” dhe “publikes”; midis “Uni-t” dhe “Ne-së kolektive/shoqërisë”. Këtu

është pikëtakimi i çdo gruaje, po aq sa është dhe pikëtakimi i shumëkujt që nuk është një Grua, dhe që rreket të gjejë ekuilibrin mes këtyre kundërshtive.

Vetëm duke e projektuar Gruan në këtë pluralitet profilesh, mund t'i përfaqësojmë sadopak njohjes sa më të plotë të saj dhe të kuptojmë rëndësinë e zgjerimit të rolit të Gruas, edhe aty ku ajo ende "nuk ka shkelur" në shoqëri, apo gjurmët e saj janë akoma të zbehta/të njoma. Sigurisht që një pohim i tillë nuk duhet të tingëllojë e të lexohet si një slogan i ndonjë lëvizjeje feministe për të drejtat e grave, por si një ftesë për secilën për të reflektuar e për të bërë disa bilance. Për të reflektuar për veten; nëse janë aty ku kanë projektuar vazhdimisht të jenë; nëse kanë punuar mjaftueshëm për objektivat e tyre; nëse pengesat apo vështirësitë gjenden vetëm në mendimet e tyre? Dhe nëse jo, cila është përpjekja e tyre për ta tejkaluar gjithçka që kërkon ta zmbarsë?

Kjo konferencë shtroi disa pyetje në fillim të saj, i elaboroi një pjesë të konsiderueshme të tyre (referoju artikujve) dhe natyrshëm shtroi të tjera për diskutim. Bindshëm, asnjë artikull nuk është një përgjigje shteruese e temës që trajton, por është një qasje konkrete, e prekshme e autoreve, që i përgjigjet realitetit rajonal të rolit të gruas në zhvillimin tërësor të shoqërisë. Konkluzioni kryesor i kësaj konference ishte se refleksionet për zgjerimin e rolit të gruas në shoqëri, nuk duhet të jenë si kërkim i një "Modeli të vetëm" që ekziston apo që mundet ta krijojmë, por duke e konsideruar çdo Grua një Model më vete, një model unik në llojin e vet, një potencial që mbart një fuqi të vërtetë, një fuqi autentike që materializohet kur personaliteti i përgjigjet dhe i shërben energjisë së brendshme, pikërisht aty ku buron Fuqia. Fuqia, jo si indikator pushteti i matshëm apo i krahasueshëm me fuqinë që zotërojnë burrat, por si një mundësi, për të ndikuar veten dhe gjithë çka vërtitet rreth saj.

Disa nga konstatimet, rekomandimet dhe përfundimet dolën sipas sesioneve në vijim:

- Nga gra biznesemene: midis biznesit dhe Gruas;
- Nga gra në fushën e mësuesisë, OJF, studente, publicistikë, artiste;
- Nga gra në administratë, specialiste;
- Nga gra në pozicione drejtuese;
- Nga gra në politikë;
- Nga gra akademike;

Një klasifikim i tillë i temave dhe ndarja në sesione sipas profesionit, nuk është për të nxjerrë në pah diferencat si diferencime ndër Gratë, por për të grupuar problematikën dhe sfidat rast pas rasti. Nëse më sipër pohuam që një Grua është autentike dhe kontributi i saj është i përveçëm, zgjidhja dhe adresimi i problemeve/vështirësive duhet të vendoset në një emërues të përbashkët. Dhe kjo nuk e çënon

aspak thelbin unik të saj, por përkundrazi. Një grua, disa gra, shumë gra, i përkasin po njësoj shoqërisë, si shumëkush, sikundër dhe një i ri, një burrë, disa të rinj apo disa burra. Ajo/Ato janë njësoj të ekspozuara ndaj mundësive dhe pamundësive; arritjeve dhe pengesave; suksese dhe dështimeve; shanseve dhe rreziqeve.

Duke synuar të mos bëhemi përsëritës në ato që pohojmë, vlen të theksohet se gjithë çka diskutuam duhet të jetë në vëmendje të secilës prej Nesh ditë pas dite; se ajo që projektojmë për veten reflektohet pashmangshmërisht në shoqërinë të cilës i përkasim dhe e anasjellta është po kaq e vërtetë: Ne reflektojmë atë çka shoqëria ka krijuar (krijon) për Ne si mendësi. Nëse edukojmë mendjen, kemi edukuar doemos sjelljen!

Komiteti Organizativ
PhD Candidate Saniela Xhaferi,
MSc.Blerina Dhrami
Vlorë, më 2 Mars 2018